

VIKTOR CANOSINAJ
ROMAN SATIRIK



KATER'YJE,
NE QYTEL

1985

Një ditë të bukur shtatori të vitit 1985, ndërsa ora e madhe e qytetit ra si me përtim tetë e gjysmë, në ballkonin e apartamentit të katit të katërt të pallatit nr. 107, ndërtuar pranë shëtitores së gjatë në breg të detit, doli një burrë shtatlartë që sa po i kishte kapërcyer të pesëdhjetat, veshur me një robdëshambër kadife vishnje, me fytyrë të lodhur, flokë të shprishur e sy të buhavitur. Ai u ul ngadalë në një kolltuk, mbështeti krahun e djathtë në parvaz si Tolstoi plak kur dilte në stolat e kopshtit të tij, pastaj e hodhi vështrimin tutje në det duke psherrëtirë i lehtësuar sikur të kishte parë një të njojur të vjetër për të cilin e kishte marrë malli. Në ato çaste pamja e tij s'kishte asnjë ndryshim nga ajo e një kapiteni të regjur me dete e stuhi që del lart në urën e komandimit pas një nate të mundimshme. Kjo figurë e menduar, e cila që në pamje të parë të krijonte përshtypjen e

një njeriu jo të zakonshëm, ishte shkrimtari Miltiad Nerënxa, i cili të djeshmen deri natën vonë kishte ndenjur duke punuar mbi veprat e tij.

Një transoceanik minerali po nisej për në det të hapur si një djalosh në një takim dashurie, dy peshkarexha të rënduara nga ngarkesa po ktheheshin nga gjuetia si ato gratë shtatzëna kur kthehen në shtëpi pas shëtitjes së këshilluar nga mjeku, ndërsa pranë bregut ca valë lozonjare ndiqnin njëra-tjetrën gëzueshëm si flutura në një livadh të kaltër. Kështu e mendoi shkrimtari përshkrimin e peizazhit që shtrihej para tij, ndërsa e kundronte atë me sy të përgjumur. Mëngjeset e artistëve mund të jenë nga më të ndryshmet e më të çrrëgulltat, por në jetën e shkrimtar Miltiad Nerënxsës kjo periudhë e ditës i nënshtrohej një disipline të vërtetë ushtarake ashtu si e gjithë veprimtaria e tij. Përveç mëngjeseve të ftohta e atyre me shi, gjithmonë në tetë e gjysmë ai dilte në ballkon, ulej në kolltuk dhe sodiste me nge detin e pafund, prej nga, ashtu si pulëbardhat në tarracën e pallatit, vinin muzat e frymëzimit të tij. Bile një fqinji i tij, një rekordmen duhani që vuante nga pagjumësia, bënte be kokën e vajzës së vëmet se një natë gushti kishte parë muzën e tras-gjedisë, hyjneshën Melpomeni, të vinte fluturim me ca krahë të bardhë puplorë, të hynte nga dritarja në studion e shkrimtarit dhe aty ta puthte atë në ballin e rrudhur si nëna e dhembshur kur i jep bekimin të birit. Ky fakt kishte çuditur gjithë lagjen, megjithatë shumëkush e kishte besuar.

Në orën nëntë pa një çerek, një grua e mbajtur mirë, e cila dallohej lehtë se ishte bashkëshorte e një artisti, u afrua me tepër kujdes dhe i vuri para Miltiadhs Nerënxsës një filxhan me kafe.

— Faleminderit, Sofi, — tha ai. — Ulu edhe ti pak.

Sofia u bind dhe qëndroi pranë të shoqit duke e vështruar atë me admirim siç mund të vështrohet një njeri i madh që vetëflijohet për artin.

— Milto, e ke parë si të janë nxirë rrathët e syve? — pëshpëriti ajo me keqardhje. — Të lutem, mos puno më aq vonë. Gjithë bota flenë, kurse ti shkruan e shkruan.

— Më duhet, Sofi, më duhet të punoj, — ia ktheu i shoqi me ëmbëlsi. — Veprat nuk duhen lënë të ftohen.

— Të paktën shkruaj ca më pak.

— Ah, e dashur, atë s'e kam në dorë unë. Ne artistët kemi një gjeneral të ashpër që na urdhëron, frymëzimin.

— Milto, duhet të kujdesesh ca për veten. Po mbush 52 dhe me moshën s'bëhet shaka.

— Ah, Sofi! — pshëretiu Nerënxa. — Si s'më kuptove një herë! Për ne artistët nuk ka moshë. Jeta jonë s'matet me vite, por me vepra.

Ajo uli kokën, e bindur plotësisht për bordinë e pagabuar filozofike të fjalëve të të shoqit. Ndoshta rrallë ndonjë artist e ka provuar aférinë e bashkëshortes, devotshmérinë dhe sakrificën e saj për të dhe artin e tij ashtu si shkrimtari

Miltiadher Nerënxa. Veçanërisht pas daljes në pension dëvotshmëria dhe sakrifikimi i Sofisë kishin arritur deri në pagjumësi dhe ankth për veprat dhe shëndetin e të shoqit. Përkuqdesjet e saj nisin që në mëngjes me filxhanin e kafesë dhe mbaronin vetëm në dy të natës kur Miltiadher Nerënxa e linte punën në studion e tij dhe ajo e priste zgjuar duke e pyetur se mos kishte dhimbje koke apo ndonjë shqetësim tjetër. Fakti që ishte e shoqja e një shkrimtari të njobur i kishte dhënë Sofisë në sytë e grave të pallatit e të lagjes një paraqitje të veçantë dhe e kishin veshur me një vel të lehtë misteri e zilie. Natyrish, kur diskutohej nëpër apartamente për një firmë si Miltiadher Nerënxa, s'kishte si të mos diskutohej edhe për Sofinë. Interesimi për gratë apo të dashurat e shkrimtarëve të mëdhenj ka ekzistuar gjithmonë ashtu si edhe mjegullat e thashethemeve që i kanë rrrethuar ato.

Në orën nëntë pa pesë Miltiadher Nerënxa filloj të vishej me kujdesin që i takon një shkrimtari të njobur. Sofia i qëndronte vazhdimisht pranë, i shkundte supet e xhaketës, i kontrollonte drejtimin e kollares, i pastronte këpuçët dhe çantën e madhe të punës duke iu vërtitur rrrotull si ajo bleta punëtore lules.

— Milto, të lutem mos u grind me njeri për punën e dramës, — e porositi ajo. — Dëgjoi edhe të tjerët.

Miltiadher Nerënxa buzëqeshi.

— S'kam pse grindem më, Sofi. Pasnesër jetpet premiera.

- Vërtet?! U vendos?
- Po.
- Shyqyr! Sa ke vuajtur me atë dramë!
- Sofi, veprat e mëdha janë si foshnjat, lindin me dhimbje. Vetëm gratë dhe shkrimtarët e dinë se ç'janë dhimbjet e lindjes!

Në orën 9.00 Miltiadher Nerënxa doli. Po bë-heshin tre vjet që ai nisej për në punë atë kohë, sepse Komiteti Ekzekutiv dhe dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të rrethit i kishin miratuar një orar të reduktuar për nevojat e domosdoshme krijuese. Me të shkelur në rrugë, shkrimtari e përqendroi vështrimin diku përpara dhe filloj të çapitej ngadalë me një pamje tepër të menduar duke tundur në dorën e djaththë çan-tën e madhe në ngjyrë të zezë, ku mund të futeshin deri në gjashtë kopje të «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe» ose dhjetë kilogramë zar-zavate. Kishte kohë që në qytet Miltiadher Nerënxa merrej si pikë referimi për tri gjëra të spikatura: pamja e menduar, deri diku ëndërrim-tare, fiokët e dendur, të drejtë, që i binin herë pas here mbi ballë dhe çanta e zezë me lëkurë të bukur që vezullonte në diell e në shi. Banorët e qytetit, kur tregonin ndonjë ngjarje apo histori në të cilën ndonjë person ecte i përhumbur në mendime, thoshin: «Ngjante si Miltiadher Nerënxa kur shkon bullevardit.» Huthimin e shkrimtarit të gjithë e pranonin si diçka të natyrshme duke thënë: «S'ka faj,është kokë e madhe, jeton në dy botë, në tonën dhe në atë tjet-rën të heronjve të vet». Dhe kur bëhej fjalë për ndonjë çantë të madhe, shpreheshin: «Si çanta

e shkrimtar Miltiadher Nerënxs.» Muajt e fundit çantën e tij kishin filluar ta imitonin ca tipa snobësh, por dihet se origjinali mbetet gjithmonë i papërsëritshëm.

Miltiadher Nerënxa e përshkoi bulevardin kryesor me bindjen e plotë se kalimtarët e tjerë po e ndiqnin me sy. Duke qenë një figurë e njo-hur në qytet, ai rrallë i fliste njeriu, por vetëm priste që ta përshëndesnin. Shpesh i qëllonte që të kapte në ecje e sipër pëshpërima plot respekt në adresë të tij dhe kjo gjë e kënaqte jashtë mase. Dy çaste të tilla Miltiadher Nerënxa nuk do t'i harronte dot deri në vdekje. Një mëngjes, një vajzë e re, ndërsa po kalonte pranë tij me një shoqe, ishte shtangur befas dhe kishte klithur e mrekulluar: «Ua, mami! Sa i ngjaka Majakovskit!» Ndërsa një mbrëmje, një burrë kishte thënë pas supit të tij, në një lokal: «Flitet se veprat e tij do të fillojnë të lexohen ndoshta nga fillimi i shekullit tjetër.»

Në qendër të qytetit, para Pallatit të Kulturës, ku zakonisht vendoseshin lajmërimet, pllakatet e afishet e veprimtarive kulturore-artistike, shkrimtar Miltiadher Nerënxa e ngadalësoi hapin dhe u afrua te një stendë me sfond blu në të cilën ishte shkruar me të kuqe:

RRUGA E SUKSESIT

dramë në tri akte nga Miltiadher Nerenxa.

Shfaqet për herë të parë më 10 shtator.

Ai u vrenjt. E kishte përfytyruar trotuarin plot me njerëz që diskutonin me të madhe, por përfat të keq para stendës që njofontë shfaqjen së shpejti të dramës së tij ishin ndalur dy djem të vegjël që hanin akullore dhe bisedonin për pulla poste. «Duhet ta kishin vënë në vend të dukshëm, — murmuriti Miltiadher Nerenxa i pakënaqur. — Na mbytën njerëzit e paaftë. Nuk dinë të reklamojnë artin e bukur.»

Ndërkohe një grup gjimnazistësh u afroan aty duke qeshur.

— Ua, dramë e re, — thirri një zeshkane me gërshteta. — Do të shkojmë ta shohim?

— Ehu! — ia priti një bionde. — Tani po bëjnë ca drama që të mërzisin. Një avazi i bien të gjithë këta dramaturgët! Po ky Miltiadher, kush na qenka, ndonjë letrar i ri?

— Çnë?! — tha zeshkania me gërshtëta. — Kam dëgjuar se është shkrimitar i madh, shkruan gjithë natën, por nuk ia botojnë veprat se grindet shumë më redaktorët.

Gjimnazistet lëshuan pasthirrma habie në kor.

— Posi! — ia bëri biondjë. — Po të ishte kaq i madh, do ta bënim edhe ne në letërsi.

— Ndoshta e futin në program kur të harto-
hen tekstet e reja.

Një buzëqeshje e émbël u përhap deri në pë-
riferitë e fytyrës së Miltiadher Nerenxës. Ai u dha
një herë flokëve sipër, veprim të cilin e pëlgente

shumë, pastaj u nis drejt teatrit. Të gjitha moshat diskutonin për të. Ky ishte një fakt.

Në ndërtesën e madhe të teatrit zyra e Miltiadh Nerënxsës ndodhej në kat të tretë. Ishte e pamundur të hyje në të dhe të mos mbeteshe disa minuta i mrekulluar. Përballë ndesheshe me një fotografi të zmadhuar të Aleksandër Moisiut në rolin e Hamletit që dukej sikur pyeste: Të rrosh a të mos rrosh. Në të majtë ngrihej një bibliotekë me libra për teatrin, ndërsa në të djathtë një raft i mbushur me dosje veprash dramatike, mbi të cilin ishte vendosur një autoportret i Rembrandit. Tavolina e madhe e shkrimtarit qëndronte mu në mes të zyrës dhe mbi të një bust në miniaturë i Beethovenit. Dukej të ishe njeri jashtë mase i pagdhendur dhe pa edukim estetik që të mos e ndieje veten të lidhur me artin në atë mjeshtë.

Miltiadh Nerënxa i përshkoi korridoret e institucionit me pamjen që mbante edhe në rrugë, e hapi derën e zyrës pa u ngutur, vendosi në një karrige çantën e madhe, pastaj u ul në tavolinë ku ishte lënë një libër i Bertold Brehtit. Kishte gjashtë vjet që ai punonte libretist i teatrit dhe nëpër qytet thuhej se e kishte ndryshuar gjendjen në mënyrë të dukshme, ndonëse plani i shfaqjeve nuk realizohej asnjëherë dhe nëpër gazeta shkruheshin kritika të ashpra. Banorët e qytetit ishin bërë tepër enigmatikë. Drama nuk u pëlqente për qamet, ndërsa për shfaqjet e estradës rrinin në radhë për bileta pa u mërzitur fare. Ky fenomen ishte vërtet i çuditshëm dhe kishte tërhequr vëmendjen e një studiuesi arti, i cili kishte arritur në përfundimin

se bashkëqytetarët e tij kishin një prirje të fortë drejt humorit, ndërsa veprat serioze nuk i donin.

Miltiadher Nerënxa uli sytë mbi librin e Breheit, por ishte e pamundur të përqendrohej. Kishste ditë që e kishin mbërthyer ethet e dramës së re. Ishte përgatitur për një sukses të bujshëm. Vepra e tij trajtonte probleme të mprehta të revolucionit tekniko-shkencor dhe të dashurisë. Çdo punonjës i prodhimit, çdo i ri apo e re mund të gjente në të vveteten.

Ai ndenji deri në orën dhjetë duke u menduar për pritjen që do t'i bëhej dramës, pastaj nxori nga çanta mëngjesin që e shoqja ia jepte gjithmonë me vëte dhe filloi të hante me oreks duke vështruar në mënyrë pyetëse autoportretin e Rembrandit. Kam frikë, mjeshtër, se s'do të më kuptojnë dot, mërmëriti, ashtu siç nuk të kuptuan ty njerëzit e epokës sate.

Në orën dhjetë e gjysmë fillonin provat përfundimtare të dramës. Miltiadher Nerënxa zbriti dhe zuri vend në sallë, diku në radhën e pestë. Ndërkohë aktor Ajet Shkëmbi iu afrua, e vështroi një copë herë me respekt, pastaj tha me një zë kumbues:

— Milto, ke shkruar një kryevepër. Do të bësh bujë shileriane, më beso.

Shkrimtari i buzëqeshi me mirënjojje Ajet Shkëmbi u ul pranë. Ai ishte një burrë i bëshëm, me flokë kaçurrel e mustaqe të dendura si ata malësorët e hershëm, tip gazmor e me një zë prej basi që mund të të shkaktonte infarkt me një të bërtitur. Galeria e roleve të Ajet Shkëm-

bit ishte e larmishme, megjithatë në të spikatin figurat e armiqve: xandarë, ballistë, diversantë, oficerë gjermanë, të cilët i përshtateshin së tepërm, sipas mendimit të shumë regjisoreve. I vetmi rol kryesor në tërë karrierën artistike të Ajet Shkëmbit kishte qenë ai i Otellos me të cilin kishte pasur sukses të jashtëzakonshëm. E kishte luajtur me aq pasion, saqë gjatë një shfaqjeje desh e kishte mbytur me të vërtetë partneren Dezdemonë dhe spektatorët, të llahtarisur, kishin filluar të thërrisin: Mjaft, Ajet, se e vdiqe! E vdiqe! Por shumëkush në qytet, më parë sesa aktor, Ajet Shkëmbin e njihte pér notar dhe këngëtar lirik. Ai e hapte sezonin e plazhit në prill dhe e mbyllte në fund të tetorit duke përshkuar gjatë kësaj periudhe distanca prej qindra metresh si një delfin i vërtetë. Ndërsa kur mbérthente kitarën, tregonin se të linte të mekur me ca këngë të vjetra dashurie, gjatë të cilave e ulte dhe e ngrinte zërin dallgë-dallgë. Kitara ishte objekti më tërheqës në studion e tij.

— Ajet, dyshoj te një regjisori si Kleo Bre-gu, — i tha Miltiadher Nerënxa. — Kam inate të vjetra me të. Dyshoj se e ka sakatuari dramën qëllimi.

Aktori tundi kokën në shenjë pohuese.

— Ti po i jep dorë me veprën tënde që të ngrihet e të bëhet i njobur, por ai nuk e kupton.

— Pa të shohim, tani, filluan.

Miltiadher Nerënxa u perqendrua në skenë. Aktin e parë po e ndiqte krejt i harruar në botën e veprës së vet, por befas, nga fundi i tij, brofi në këmbë duke thirrur:

— Stop! Të ndërpritet shfaqja! Stop!
Dritat u ndezën të tëra. Miltiadhi u vërvit
në skenë me rrëmbim dhe iu drejtua regjisori,
Kleo Bregut, kërcënueshëm:

— Jeni në vete apo jo? Me ç'të drejtë e keni
hequr pjesën e mbledhjes së kolektivit?

— Ajo pjesë është zgjatje krejt e panevoj-
shme, — iu përgjigj regjisori qëtësisht.

— Autori jam unë! Ti s'ke të drejtë të më
ndyshosh veprën!

— Dëgjo, Milto, spektatori s'vjen këtu për
mbledhje, por përmart.

— Unë nuk nlejoj shkurttime!
Pas këtyre fjalëve edhe Kleo Bregu, s'u
përbajt dot.

— Edhe unë s'lejoj ndërhyrje! Ç't'i bëj drej-
torit, se as që kisha për ta vënë këtë farë drame!
Nëse është dramë!

— Atëherë hiqni dorë!

— Ja, që tani! Po më fute mbledhje, unë nuk
i vazhdoj më provat.

— E ç'regjisori jeni ju!

— Pika që s'më bie kur lidhem me një dra-
maturg si ju. Nëse jeni dramaturg!

Kjo grindje profesionale kushedi me ç'batuta
do të kishte përfunduar po të mos kishte ndër-
hyrë drejtori me një ton të prerë:

— Të vazhdojmë provat! Pjesa e mbledhjes
do të hiqet! Pa diskutime të kota!

Miltiadhi Nerënxa uli kokën. Rënkoj duke u
kthyer në sallë, «këtu fillon paaftësia që te drej-
tori! Bëj art po deshe!» Dy aktet e tjera i ndoqi
tepër i nervozuar. Në fund të shfaqjes nuk foli
me kërkënd. Doli jashtë në rrugë. Aktor Ajet

Šhkëmbi po e priste aty. Pas orës 12.00 ata pinin zakonisht kafenë te bufe «Gjuetari». Shkrimtari porositi një të hidhur, ndërsa aktori një të mesme. Ndonjë gjysmë ore kaluan duke diskutuar për dramën, Miltiadher Nerënxa ankohej vazhdimisht. Ajet Shkëmbi i jepte të drejtë.

— Rasti yt është fatkeqësi, Milto, — tha më në fund duke psherëtirë. — Veprat e tua meritojnë «Globusin» e tyre dhe jo këtë trupë **zënatçinjsh**.

Pas këtyre fjalëve shkrimtari uli sytë i menduar në fundin e zi të filxhanit të kafesë.

— Jam në ankth, Ajet, jam në ankth.

Në orën një Miltiadher Nerënxa u rikthye në zyrë me gazetat e ditës nën sqetull. Zakonisht ai merrej me to deri në dy kur vinte koha për të ziñxhirosur çantën e madhe dhe për t'u kthyer në shtëpi duke ecur përmes bulevardit kryesor me pamjen e vet të menduar.

II

Rreth orës tre, pas një dreke të shijshme dhe dy gotave me ujë mineral, Miltiadher Nerënxa u shtrit në dhomën e vet ku, nëpërmjet drifores së hapur, hynte flladi i freskët i detit me atë aromën e vet të veçantë. Pasditeve ai flinte gjatë në mënyrë që të përballonte punën e lodhshme të natës. Gjatë kohës së gjumit Sofia nuk lejonte njeri ta shqetësonte, megjithëse thellësia e përhumbjes së të shoqit ishte e asaj grade saqë edhe një elektromotor i vënë te koka e krevatit s'shkaktonte dëm. Në pallat e në lagje flijtej se shkrimitar Miltiadher Nerënxa shihte shumë ëndrra për shkak të lodhjes së madhe mendore, bile edhe subjektet e veprave të veta i shfaqe-shin fillimisht në ëndërr. Por, kur e kishin pyetur për këtë një ditë, ai e kishte hedhur poshtë duke thënë se nuk pajtohej kurrsesi me Frojdizmin.

Pas zgjimit në orën gjashtë, Sofia i solli ka-

fenë e pasdites, të cilën Miltiadhi Nerënxa e pinte zakonisht mbështetur.

— Hë, si fjete? — e pyeti e shoqja e merakosur. — Të lodhën shumë ëndrrat?

— Jo, aspak, — iu përgjigj ai duke buzë-qeshur. — Jam mësuar. Një artist, po nuk pa shumë ëndrra, është njeri i zakonshëm dhe jo artist.

— Thonë se ju shkrimtarët ju zë një së-mundje speciale.

— Unë jam ende i ri, Sofi, tepër i ri.

Miltiadhi u ngrit çapkënçe, mori në dollap një kostum ngjyrëçokollatë me të cilin dilte zakonisht shëtitje dhë filloj të vishej. Sofia e ndoqi një copë herë me vështrimin e saj të merakosur duke menduar për ëndrrat e frikshme dhe atë sëmundjen speciale të shkrimtarëve, nga e cila, siç thoshte Zhani, një fqinjë që dinte frëngjisht, kishte vdekur i shquari Gi dë Mopasan dhe disa koka të tjera të botës së letrave.

Është provuar tashmë shumë herë nga historia se shoqëria e një artisti të madh ka qenë e përbërë kryesisht nga artistë. Këtë e tregonte edhe një herë tjetër rrethi i ngushtë i shkrimtar Miltiadhi Nerënxs. Në lulishten e madhe në qendër të qytetit atë po e prisnin aktor Ajet Shkëmbi, piktor Alajdin Arbana dhe inxhinieri i hekurudhave, Kristo Shigjeta. Miltiadhi u buzëqeshi nga larg e thirri gëzueshëm:

— Tungjatjeta, kolegë! Si ia kaluat sot? Si dukeni?

— Jashtëzakonisht mirë, — tha piktori.

— Të freskët, qefull fare, — shtoi inxhinieri.

— Kohë e bukur po na mban, — e pasoi

Ajet Shkëmbi me zérin e vet prej basi.

Shkrimtari u ul mes tyre.

— Hë, si shkuan provat gjenerale? — pyeti Alajdin Arbana.

— Ç'ka, — ia ktheu Miltiadher Nerënxa duke treguar se s'ishte fort i kënaqur.

— Dekoret më mbetën peng, ta dish. Po të m'i kishin lënë mua, do t'i kisha qarë, — piktori tundi kokën me keqardhje.

— Mos u mërzit, Alajdin, herën tjetër, — tha Miltiadher Nerënxa. — Ti e di, unë s'të kam lënë kurrë thatë.

Alajdin Arbana kaloi gishtat nëpër flokët e tij të dallgëzuar, të kthyer sipër, që i jepnin një pamje tërheqëse hollake. Rrallë ndonjë piktor njihej në qytet si ai. Në plot shtëpi veprat e tij ishin vendosur në vendet më të dukshme të korriderave apo dhomave të pritjeve dhe paraqisnin kryesisht çifte bashkëshortësh të lumtur në sfond bojë qielli ose një ligen natën, mbi sipërfaqen e të cilat shkëlqente hëna në ngjyrë portokalli dhe lëkundëj lehtazi një barkë me dy dashnorë, ku djali i binte kitarës, ndërsa vajza dëgjonte plotësisht e mekur, me sy gjysmë të myllur. Vetëm nëpër ekspozita lokale dhe kombëtare ai nuk kishte sukses dhe këtë shumëkush e shpjegonte me faktin se veprat e tij ishin tepër moderne dhe komisionet e pranimit trembeshin prej tyre. Flitej se Alajdin Arbana kishte ndikime të forta nga dy pasimpressionistët, Van Gogu e Tuluz Lotreku, dhe një ditë, kur kishin hyrë rastësisht në studion e tij dy turistë norvegjezë, kishin mbetur gojëhapur, bile edhe ia kishin fotografuar disa vepra. Studioja e tij ndodhej në një

pjesë mjaft të qetë të qytetit dhe dimrit aty mblidheshin shpesh katër shokët pér të diskutuar pér artin. Lidhjet e Alajdin Arbanës me Miltiadher Nërenxën ishin çelikosur veçanërisht pas caktimit të tē dytit si libretist në teatër. Me ndërhyrjen e tij Alajdinit i jepeshin herë pas here pér të përgatitur dekoret e Teatrit të Kukullave, të trupave amatore të ndërmarrjeve apo ndonjë porosi tjetër. Alajdin Arbana punonte mësues vizatimi në një shkollë tetëvjeçare dhe, nën kujdesin e tij, nxënësit ishin bërë mjeshtër pér të vizatuar shtamba, ibrikë ose qilima me motive populllore. Kohët e fundit pér piktorin diskutimet ishin shtuar së tepërmë, sepse ai po punonte pér një tablo të madhe kompozicionale kushtuar klasës punëtore. Tabloja titullohet «Përpara pér fitore të reja» dhe, sipas fjalëve të përhapura, pritej të sillte risi në llojin e vet.

— Milto, kam frikë se ai regjisori Kleo Bregu është i paaftë, — tha Alajdin Arbana pas pak.

— Tmerrësisht i paaftë.

Ai i përdorte dendur ndajfoljet që mbaronin me prapashtesën -isht.

— Kjo dihet, — ia ktheu Miltiadher Nërenxa.

— Më duket se ti, Milto i dashur, kë mbetur në atë institucion si fazani në mes të puhave, — ndërhyri Kristo Shigjeta.

Shkrimitari hapi krahët, veprim që donte të thoshte: ç't'i bësh.

— Gjithsesi, ti mos u mërzit, i dashur, — shtoi Kristo Shigjeta duke ngritur mbi hundë syzet e tij miopike me numër +4.

Ai ishte një tip i shkathët, i qeshur dhe me një fjalor tepër të rënduar me figuracion nga

fauna e tokës dhe e detit. Të gjitha krahasimet e tij ose shpjegimet metaforike ngriheshin mbi kafshë të ndryshme ose peshq. Sepse Kristo Shigjeta ishte gjuetar në qytet. Çiften ia kishin të gjithë zili, por sidomos ia lakmonin tre zagarët e palodhur, të cilët mbanin emra të lezetshëm: Pipi, Roza e Majku, ky e fundit emër i huazuar nga një vepër e Xhek Londonit. Tregonin se, kur ai dilte për gjah, nuk shkonte dot më larg se dy a tre kilometra, ngaqë rëndohej shumë nga preja e vrarë dhe nuk ecte dot. Kristoja punonte inxhinier në oficinën nr. 1 të Ndërmarrjes së Hekurudhave ku e mbanin për një novator e racionalizator të talentuar. Kohët e fundit ai po merrej me një racionalizim shumë të rëndësi- shëm te lokomotivat me avull, nga i cili do të kursehej një sasi e konsiderueshme karburanti dhe do të shtohej shpejtësia e lokomotivave edhe pesë kilometra të tjera në orë. Në qytet në fillim shumëkush habitej kur e shikonin inxhinierin me shkrimitar Miltiadher Nerënxon, aktor Ajet Shkëmbin dhe piktor Alajdin Arbanën, sepse nuk e dinin që ai ishte edhe një përkthyes i zoti i poezisë botërore. Zotëronte frëngjishten e italishten dhe flitej se po merrej me dy poetë pak të njojur nga lexuesi: Zhak Preverin e Salvatore Kuazimodon.

Këta katër shokë të ngushtë kishin kohë që tërhiqnin ngado vëmendjen e mbarë qytetit dhe njiheshin si Shoqëria e Katër Artistëve. Bile disa amatorë të apasionuar të artit i kishin cilësuar si katër yje të rralla dhe i kishin quajtur «Kostelacioni M A K A», duke u mbështetur në inicialet e emrave të tyre. Megjithatë, në qytet

të gjithë e pranonin pa ngurrim se ylli më i ndritur i kostelacionit ishte shkrimtar Miltiadherenxa.

Kur katër artistët dolën në sheshin «Rilindja», Alajdin Arbana i ftoi ata në studion e tij për t'i hedhur një sy tablosë kompozicionale «Përpara përfitore të reja», por të tjerët e lanë përondonjë ditë tjetër, sepse bënte shumë vapë. Ata vazhduan të shëtisnin ngjeshur sup më sup menjë pamje krenare sikur përveç tokës të kishin shkelur edhe në tre a katër planete të tjera të sistemit tonë diellor.

Në orën tetë e gjysmë Miltiadherenxa u kthye plot humor, me trupin të lehtë nga shëtitja dhe hyri në kuzhinë duke buzëqeshur.

— Hë, po argëtoheni ngapak? — iu drejtua Sofisë dhe të birit që shikonin televizor. — Shumë mirë. Ernest, si ia kalove andej nga Tirana ti?

- Njëfarësoj, — ia ktheu i biri pa qejf.
- E bëtë seminarin për Zolanë?
- Po.
- I shfrytëzove ato tezat që të dhashë unë?
- Jo. Nuk diskutova fare.
- Je shumë gjumash, — tha babai me qortim.

Ernesti ndiqte vitin e dytë të Gjuhë-Letërsisë, degë të cilën e kishte kërkuar me këmbënguljen e të atit, por që në të vërtetë s'e kishte pasur aspak me dëshirë. Të gjitha lëndët që bënte, sidomos ato të gjuhësisë, ai i quante të mërzitshme dhe kjo e nervozonte Miltiadherenxën herë pas here. Por ajo që kishte filluar ta trembutë atë si prind ishte një ftohje e akullt kohët e

fundit e Ernestit për librat artistikë dhe një humbje respekti për shkrimtarët. Një mbrëmje ai kishte thënë se shkencëtarët janë dhjetëfish më të rëndësishëm për një shtet se shkrimtarët, kurse gjuhëtarët i kishte quajtur «më parazitët e superstrukturës» dhe për këto mendime kishin debatuar gjatë. Vetëm ndërhyrja e Sofisë e kishte shmangur grindjen. Miltiadher Nerënxa s'guxonte më t'ia jepte të birit veprat e veta për t'ia lexuar si më parë në gjimnaz, sepse Ernesti vrenjtej dhe thoshte me ankım:

— Baba, të lutem, nuk lexoj dot, se më dhemb prapa kokës. Kam marrje mendsh.

Ai ishte tip që nervozohej shpejt, flinte shumë, kishte ca lëvizje të ngadalta e të prerasi prej roboti dhe, pa e pyetur njeri për gjësendi ose pa i kërkuar mendim, s'merrte mundimin t'i fliste.

— Po me Ilon pate leksion? — pyeti Miltiadher Nerënxa pas pak.

— Jo, — tha Ernesti shkurt.

— Iloja është pedagog i zoti, e kam shok.

— Ashtu flitet edhe andej nga fakulteti.

Miltiadhi pothuaj çdo mbrëmje interesohet përlëndët që bënte i biri dhe pedagogët, leksionet e të cilëve i shfletonte me vërejtje duke dhënë konsiderata në përgjithësi kritike. Në të tilla raste Ernesti thoshte me ironi: «S'ka gjë, baba, fundja leksione gjuhë-letërsie janë. Të ishte ndonjë shkencë serioze, atëherë po.»

Kur pa se i biri s'po e kishte më qejf bisëdën, Miltiadhi u kthyesh nga televizori.

— Hë, ç'po na dhënkan sonte? Mbrëmje letrare-artistike? Bukur! Pa shiko! Kush është

ky që kanë futur në studio? Agron Dibra! Paskan gjetur shkrimtar të ftojnë!

Ernesti nënqeshi.

— I mirë, i keq, më shumë libra se ti ka botuar ai, baba.

Miltiadhi Nerënxa u vrenjt.

— Vlerat e një shkrimtari s'maten me sasi librash.

— Edhe kritikët e lavdërojnë, — shtoi Ernesti.

— Uf, kritikët! Kritikëve merru të kundërtën e asaj që thonë.

Sofia i bëri të birit një shenjë qortuese. Ernesti hapi menjëherë gojën, pastaj u ngrit duke murmuritur:

— Po shkoj të shtrihem unë.

— Se mos do lexosh ndonjë libër! — i tha i ati.

— Ç'i do librat, baba? Më mirë të shohësh filma. Sqarohesh për një orë e gjysmë sesa të thartosh trutë një javë.

— Shko, shko se na kënaqe! Se ç'ka ky djalë, — iu kthyte Miltiadhi së shoqes. — Është bërë shumë zevzek.

— Mos ia vër re, — tha Sofia. — E ka nga lodhja.

— Ç'lodhje, moj grua! Të studiosh për letërsi, do të thotë të mos e njoħešh lodhjen. Më kupton? Do të thotë të provosh vetëm kënaqësi.

— Mbështetës ndryshon vitin e tretë e të katërt.

— Të shohim.

Në orën dhjetë pa pesë, veshur me rob-dëshambrin e madh ngjyrë vishnje, Miltiadhi Nerënxa hyri në studion e tij duke i uruar së

shoqes gjumë të ëmbël, ndonëse e dinte mirë që ajo s'do të flinte. Ai largoi perden nga dritarja e hapur, pastaj iu afrua tavolinës së ulët e të gjerë dhe u rregullua në një kolktuk me lëkurë të zezë. Me një vështrim të kënaqur e përblo-dhi gjithë studion e tij. Ajo ishte goxha e madhe. Kishte katër vjet që, pas kërkesash të shumta e këmbëngulëse për zgjerim drejtuar Komitetit Ekzekutiv dhe degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Miliadh Nerënxs i ishte dhënë ai apartament me dy dhoma, një kuzhinë e një studio për punë krijuese.

Kujdo që hynte në studion e tij i tërhoqte vëmendjen një portret i Balzakut, një peizazh nga deti i piktor Alajdin Arbanës, por më kryesorja ishte një gaforre e madhe, e kuqe, e vendosur në mes të bibliotekës. Flitej se kjo gafore e llahtarshme i sillte Miliadh Nerënxs frymë-zim dhe ai e mbante për ogur ashtu siç mbante Shileri në tavolinën e punës mollë të kalbura. Por ata që e njihnin nga afër thoshin se gaforrja ishte simbol i lidhjeve të ngushta shpirtërore të shkrimtarit me detin, të cilit ai i kishte kushtuar një poemë të gjatë dhe dhjetëra poezi.

S'numëroheshin ata që ishin mahnitur pas bibliotekës së shkrimtar Miliadh Nerënxs. Ajo përbolidhte treqind vëllime në shqip, njëqind në gjuhë të huaj dhe zinte komplet një faqe muri. Tregonin se një pjesë të madhe të vep-rave shkrimtari ia kishte blerë fare lirë një prifti katolik.

Të gjithë habiteshin se si Miliadh Nerënxs i dilte koha për të lexuar aq shumë në gjuhë të huaj, por shpesh harronin se ai i zotëronte në

majë të gishtërinje gjuhët kryesore të Perëndimit, bile edhe turqishten (duke llogaritur edhe turqishten e vjetër). Kishte kohë që në lagje po flitej se po merrej me përkthimin e një vëllimi të trashë të Nazim Hikmetit.

Në vendin më të dukshëm të bibliotekës Miltiadhi Nerënxa kishte vënë veprat e veta, mbledhur me kujdes me plastmasë të bukur përti mbrojtur nga pluhuri dhe vjetrimi. Titujt e këtyre veprave dallohen në larg: «Në aksion», poemë për pionierë, botuar më 1965, «Zgjuarsia e ketrit», vëllim me përralla e fabula, botuar më 1967, «Kopshti i mollëve», vëllim me vjersha për fëmijë, botuar më 1970 dhe «Flamuj fitoresh», vëllim me poezi për të rritur, botuar më 1974. Ndonëse që nga viti 1974 Miltiadhi Nerënxsë s'i ishte botuar më asnjë libër, emri i tij vazhdonte të ishte i njojur në jetën letraro-artistike përmes veprave dramatike. Katin e parë të bibliotekës së tij e zinin mbi tridhjetë dosje me vepra të pabotuara dhe dhjetë dosje me drama të vëna në skenë nga trupat amatore të qytetit. Në dorëshkrimet e pabotuara të lidhura me kujdes e të sistemuar kronologjikisht, numërohen pesë poema, dhjetë novela, dy romane historike, një roman për pionierë, një vëllim me përralla, një vëllim me poezi, dy vëllime me tregime dhe tetë pjesë për teatrin e kukullave, njëra prej të cilave, me titull «Kryengritje në pyll», që tregonte për luftën e kafshëve të një pylli kundër regjimit të egër mbretëror të Juanit dhe tre ujqve princa, kishte pasur sukses të jashtëzakonshëm në qytet e nëpër turnë. Kishte raste kur natën vonë, për tu clodhur, Miltiadhi Ne-

rënxa çohej nga tavolina, afrohej te veprat e veta të pabotuara, i përkëdhelte dosjet me dorë dhe u murmuriste:

— Prisni, mos u mërzisni. Do të vijë edhe koha juaj. Një ditë unë do të bëhem i famshëm dhe atëherë ata redaktorë që s'ju kanë pëlqyer, do të vijnë të më luten e të më kapin për xhakete. Dhe ju do të mbushni vitrinat e librarive.

Herë pas here Miltiadher Nerënxa qëndronte i menduar edhe para katër veprave të veta të botuara. U buzëqeshte tituje me nostalqji, ndonëse tashmë ata ishin harruar plotësisht në çdo bibliotekë të Republikës. Ishte konstatuar se në bibliotekën e fëmijëve të qytetit dhjetë kopje të poemës «Në aksion» i kishin ngrënë minjtë për shijen e këndshme të letrës, por bibliotekaret habiteshin sepse nuk kishin pasur kurrë minj ose buburreca në institucion. Kurse vëllimi me poezi «Flamuj fitoresh», botuar më 1974, kishte ndenjur nëpër vitrinat e librarive gjashtë vjet rresht derisa ishin detyruar ta shisnin në prag të Vtit të Ri bashkangjitur me kalendarët, veprim për të cilin drejtoreshën e shpërndarjes së librit e kishin kritikuar...

Miltiadher Nerënxa e afroi kolltukun edhe ca te tavolina, pastaj futi këmbët në një palë papuce të mëdha leshti, të cilat i mbathte gjithmonë kur niste procesin krijues, sepse këmbët e ngrohta ndikonin shumë në veprimtarinë normale të trurit, kështu kishte lexuar diku. Pas këtyre veprimeve i uli sytë mbi një fotografi të madhe të Tolstoit plak, veshur me rroba muzhiku, e cila ishte vendosur nën xhamin e gjerë të tavolinës. Mbi këtë fotografi ishte shkruar me shkron-

nja të mëdha citati i Gëtes: «Po humbe guximin, humbe gjithçka», i cili e frymëzonte Miltiadherë Nerënxe në raste zematicash shpirtërore, sidomos kur redaktorët xhahilë ia kthenin veprat mbaprash.

Pasi u mbush një herë thellë me frymë, ai afroi para vetes një dosje të madhe, mbi të cilën ishte shkruar: «Liria do të kthehet përsëri», tragjedi në 6 akte, pastaj rrëmbeu një penë të gjata dhe e ngjeu me bojë. Kjo vepër me subjekt nga shekulli i pesëmbëdhjetë që trajtonte rrethimin e Shkodrës nga turqit dhe rënien e saj, ishte më e rëndësishmja në jetën krijuar të Miltiadherë Nerënxe. Ai po punonte mbi të që prej gjashtë muajsh dhe kishte mbërritur në aktin e katërt. Në letërsinë e realizmit socialist shqiptar kuskush s'kishte shkruar tragjedi dhe pikërisht te ky fakt qëndronte ideja e guximshme e Miltiadhit. Ai do t'i bindte të gjithë se tragjedia nuk kishte vdekur, ajo mund të kishte përsëri sukses, po të merrej në duar nga një autor i talentuar.

Në qendër të veprës Miltiadherë Nerënxa kishte vendosur një princ shkodran, familjen, shokët dhe ushtarët e tij trima që kishin mbetur të rrethuar në kështjellën Rozafa. Ngjarjet kishin mbërritur deri në çastet kur pashai turk i dërgonte prncit një letër ku i kërkonte të dorëzohej.

Lajmi se në studion e firmës Nerënxa po shkruhej një tragjedi ishte marrë vesh në të gjithë lagjen dhe dalëngadalë po përhapej nëpër qytet duke shkaktuar njëfarë habie për ndërmarrjen e guximshme sikur të bëhej fjalë për një

«Faust» të dytë. Në pallat e në lagje ishin të shumtë ata që e pranonin se Miltiadhi ishte një shkrimtar me prodhimtari të lartë, bile kur kishin pyetur për këtë një djalë që ishte specializuar në Austri për biokimi, ai e kishte shpjeguar talentin e rrallë të shkrimtarit me nivelin e lartë të acidit urik në gjakun e tij që, sipas shkençtarëve, ishte tregues kryesor i talentit dhe gjenialitetit. Miltiadhi Nerënxa ishte shkrimtar që s'vuante nga ciklotimia, në jetën e tij krijuese s'kishte periudha shfrimesh apo apatie. Ai shkruante normalisht në çdo muaj të vitit, në çdo ditë të muajit, në çdo gjini e zhanër, si një gejzer i ngrrohtë e i vrullshëm që s'di të pushojë.

Pasi punoi dy orë rresht për skenën e shtatë të aktit të katërt, ku princi shkodran i kthente përgjigjen e merituar pashait turk, Miltiadhi u ngrit dhe iu afrua dritäres së hapur që vështronë nga deti. Mbi sipërfaqen e shtruar të tij ndriste një hënë e zbehtë. Si fytyrë anemike valët shushurinin në breg si një e zvargur plakash. «Deti në vetvete është një orkestër gjigante që luan lloj-lloj simfonish, — mendoi ai. — Kush nuk arrin të kuptojë muzikën e dallgëve të tij, është një veshderr i vërtetë».

— Milto! Milto! — u dëgjua ndërkohë zëri i Sofisë pas derës.

— C'është, moj? — ia bëri ai duke mbledhur vetullat.

— Të të sjell një kafë?

— E po mirë, sille.

Pas kafesë shkrimtari u riul në tavolinë dhe kësaj radhe hapi një fletore të trashë mbi të cilën ishte shkruar: «Ditari artistik 1985». Kishte

kohë që, nën shembullin e Tolstoit, ai mbante shënimë të rregullta për ngjarjet që i ndodhnin, përshtypjet, takimet. Por vlerat e vërteta të këtij ditari ishin embrionet e veprës së ardhshme, subjektet e të cilave Miltiadhi Nerënxsës i lindnin befas në kokë e në shëtitje, nëpër lokale, në punë e kudo.

Në orën një vendin e fletores së ditarit e zuri makina e shkrimit dhe dosja e romanit për fëmijë «Pushka e vjetër dhe krismat partizane», vepër për të cilën Miltiadhi kishte punuar gjatë dhe tanj po e përgatiste për në shtëpinë botuese. S'kishte stinë të vitit që ai të mos kishte ndonjë vepër për shqyrtim në redaksitë e shtëpisë botuese. Jo më larg se të nesërmen kishte lënë një bisedë telefonike me përgjegjësin e redaksisë së poeziës për vëllimin dyqindfaqësh «Fllade e stuhi», vepër tek e cila kishte mbështetur shpresat për t'u bërë korife në këtë gjini.

Kishte ndonjë çerek ore që po shtypte kapitullin e dhjetë të romanit, kur befas nga katër i poshtëm u dëgjua një zë i ngjirur:

— Ej, ti, tragedian! Na çmende me atë makinë! Ta hajë dreqi! S'do të rri të vuaj unë për ato veprat e tua.

— Lëre se ai do ta nxjerrë teatrin tonë në selamet, — ia priti një zë tjetër.

Miltiadhi Nerënxa u dha në dritare i nervozuar.

— Më tepër respekt për artin, — tha ironikisht. — Tregoni kulturën tuaj.

— Ku ka kulturë pas mesit të natës, mor vëlla! — u ridëgjua zëri i ngjirur. — Do na lësh rehat apo jo?

Miltiadhi e mbylli dritaren duke murmuritur i pakënaqur: «Eh, ku më kanë rënë fqinjë këta injorantë! S'e duan artin fare, vetëm sporti i kënaq.» Ai vuri nën makinë një shilte dhe vazhdoi të punonte nëpër natë duke vështruar herë pas here gaforren e kuqe në qendër të bibliotekës, ashtu siç vështronte mjeshtri francez bustin e vogël të Napoleonit, të cilil ishte betuar t'ia sfidonte shpatën e lavdishme me penën e tij.

Fragmente nga ditari artistik

... Një shkrimtar i madh duhet të jetë përherë në vëzhgim. Ai duhet të zbulojë te gjërat e mëdha të zakonshmen dhe tek e zakonshmja të madhërishmen. Në radhë të parë ai duhet të jetë psikolog. Nga një detaj i vogël të arrijë me intuitë tek e tëra si ai dedektivi që nga një gjurmë arrin te krimineli.

Sot, ndërsa po kthehesha nga teatri, vura re një gjimnaziste që ecte si në ëndërr ose më mirë fluturonte me ca krahë të padukshëm. Ç'më bëri përshtypje? Ajo ishte krejt e hutuar dhe fliste me vete. Këtu nisi zhbirim i im psikologjik. Shtrova pyetjen: Ç'i ka ndodhur kësaj vaze 17-vjeçare? Me aftësinë time të veçantë përtë depërtuar në botën e brendshme shpirtërore të njerëzve nëpërmjet deshifrit të fytyrave të tyre, arrita në përfundimin se ajo vajzë ishte puthur sot për herë të parë me një djalë.

Puthja e parë! Sa poezi ka kjo ngjarje! Ajo

është nga ato të pakta kujtime që nuk harrohen gjithë jetën. Tek ngjisja shkallët e pallatit i menduar, e imagjinoja atë vajzë se si do të kthehet në shtëpi e druajtur, se si do të përpiqej ta fshihte sekretin e saj, se si do të qëndronte deri natën vonë pa gjumë duke pshëretirë. Vendosa menjëherë të shkruaja një poezi të gjatë me titull «Puthja e parë». Hyra drejt e në studio, u ula, por befas u kujtova se kisha të bëja me një gjimnaziste. A puthen gjimnazistet tonë? Në asnjë mënyrë! Morali ynë i shëndoshë nuk e pranon diçka të tillë. Vetëm në botën borgjezo-revizoniste mund të puthet një gjimnaziste.

Kështu, dola nga studioja pa keqardhje dhe u ula të haja drekë duke e harruar atë gjimnaziste jo tipike:...

Nga bisedat nëpër shkallët e pallatit

— E morët vesh? Miltiadher Nerënxa po mbaron tragjedinë. Ai është gjeni.

— Gjeni?! Ai është i shkalluar. Kush shkruan më tragjedi sot? Pale, na tërboi edhe për gjumë.

— E ke gabim. Miltoja do ta rikthejë përsëri tragjedinë nëpër skena, mbajeni mend këtë llaf!

— Dëgjova se i kërcënohet një sëmundje speciale shkrimitarësh. Sofia është e trembur. U ankohet grave.

— Miltiadher Nerënxon ta zërë sëmundje?! Ç'na gajase! Ai ha e fle si gic, or mik. Natën rri zgjuar deri më dy se, domosdo, nuk i vjen gjumë.

— Gjithsesi për ne si pallat është nder i madh që kemi këtu një shkrimitar. Nesër shfaqet drama e tij «Ruga e suksesit». Duhet të shkojmë ta shohim.

— Bah! Shihen dot ata limonadat e Miltos!
Dy truste ka sot bota për limonada: «Koka-Kola» dhe «Miltiadher Nerënxa».
— Ti më duket se i përqmon shkrimtarët.
— Unë përqmoj kalemxhinjtë.
— Mos u lodhni kot. Miltoja është gjeni.
Më vonë do ta njihni, mos kini merak...

Ai u kthye në sallë dhe filloi të përshëndetej me të njohurit e shumtë nga fisi i vet, fisi i gruas dhe rrethet farefisnore të Ajetit, Alajdinit dhe Kristos, të cilët përherë kishin shpërndarë nga tridhjetë bileta me hir e me pa-hir. Vetëm kur drama filloi, autori i saj mbështeti mjekrën në pëllëmbë dhe psherëtiu i merakosur.

Shfaqja kishte mbërritur në aktin e dytë kur nëpër sallë filluan mërmërimat e bisedat me zë të ulët. Dikush doli jashtë për të ndezur një cigare. Një vajzë e vogël filloi t'u lutej prindërvë gati me të qarë:

— O babi, o mami, ejani shkojmë në shtëpi se plasa!

Deri në veshët e Miltiadhs Nerënxsës mbërriti zëri ankues i një vajze që i thoshte të fejuarit:

— Uf, ç'lloj dashurie është kjo nëpër drama! S'më bind fare.

Në aktin e tretë disa veta dolën nga sala duke u munduar të mos shkaktonin zhurmë.

— Ama, ç'na kënaqët! — tha një grua e shëndoshë, e cila ishte djersitur keqazi. Një grup djemsh filluan të diskutonin për aktoren M. M., e cila, kur kishte qenë e re, tregohej me gisht nëpër qytet për bukuri, ndërsa dy vajza hapën një pako ku ishte mbledhur një fustan.

Vetëm kur drama u kuptua se po mbaronte nëpër sallë kaloi një pshëritimë korale lehtësimi sikur të gjithë të kishin qenë në ndonjë vapor që i kanosej katastrofa. Dritat e skenës u ndezën dhe aktorët u rrështuan për të për-

shëndetur, por ndërkokë spektatorët kishin filuar të çanin nga të gjitha dyert. Vetëm ata të radhëve të para u detyruan të duartrokisnin. Më në fund nën skenë u ngjit autorë, kostumi blu i të cilit nën dritat e verdha merrte një embësi të veçantë. Ai u përkul thellë para rrëtheve farefisnore të Ajet Shkëmbit, Alajdin Arbanës, Kristo Shigjetës dhe njerëzve të afërt të familjes së tij që kishin mbetur aty. Në ato çaste askush nuk arrinte ta merrte dot me mend sa vuante Miltiadher Nerënxa shpirtërisht. Ai e kishte përfytyruar mbrëmjen e premierës së dramës «Rruja e suksesit» të stuhishme, me thirrje, duartrokitje, tufa lulesh në skenë, fotografi, por në sallë dëgjoheshin ca përplasje duarsh të thata dhe ata që kishin mbetur murmurisnin me vete: Hë, mbaroni me këto ceremoni se na plasët. Megjithatë autorë nuk e jepte veten. U buzëqeshi spektatorëve me dorën në zemër, pastaj u tërhoq me modesti.

Në korridorin e madh të teatrit po e priste Sofia dhe tërë shokët e tij të ngushtë me gratë e tyre. Ernesti ishte zhdukur. Miltiadher Nerënxa u afroa duke u dhënë një herë flokëve sipër. Piktori Alajdin Arbana i zgjati dorën i pari duke folur i emocionuar:

— Urime, Milti!

— Për mua ky qe një sukses, — tha Kristo Shigjeta.

— Që do të arrijë kulmin pas pak ditësh, — shtoi Ajet Shkëmbi.

Gratë e tyre buzëqeshnin dhe e vështronin Sofinë me bisht të syrit me një zili të papër-

mbajtur. Ajo, krejt e lumtur, fluturonte diku duke imagjinuar lavdinë e të shoqit.

— Atëherë do të pimë një kafe kolektivisht, — tha shkrimtari.

— Patjetër, — tha Alajdin Arbana. — Si gjithmonë.

Kur çifti Nerënxa u kthye në shtëpi, Ernesti po bëhej gati për të fjetur. Diçka murmuriste nëpër dhëmbë duke sharë gjuhëtarët.

— Po ti, more djalë, trembesh nga teatri që ike ashtu me vrap? — i tha i ati me një ton qortues. — Pa na i trego pak përshtypjet. Si tu duk drama?

— E zakonshme, — tha Ernesti. — Megjithëse unë s'para i kam qejf dramat.

— Ti kurrë s'ke dhënë një gjykim me vlerë për letërsinë, — tha Miltiadhi Nerënxa i nxehur.

— Për gjërat që s'të pëlqejnë detyrimisht do të japësh gjykime të shtrembra, — ia ktheu i biri duke hapur gojën. — Kjo është abeceja e logjikës.

— Ernest! — e ngriti zërin Sofia.

— Fli, fli se na kënaqë, — tha Miltiadhi Nerënxa. — Se nga ka ngjarë ky djalë, as vetë s'e marr vesh, — i pëshpëriti pastaj së shoqes.

Të nesërmen në mbrëmje Miltiadhi e ndoqi shfaqjen e dramës në një lozhë, i zhytur në një dëshpërim të thellë. Në sallë bëheshin gjithsej nëntëdhjetë veta. Dëshpërimi i tij arriti kulmin kur pas shfaqjes mori vesh se regjisori Kleo Bregu ishte shprehur ironikisht: Ja, edhe «Rrugës së suksesit» po i afrohet fundi pa sukses,

Ky paradoks i hidhur e la shkrimtarin deri afër mëngjesit pa gjumë, më keq se një ulcerë e vjetër.

Mbrëmjen e tretë në sallë bëheshin gjithsej nja tridhjetë e pesë veta dhe shfaqja u anulua me urdhër të drejtorit. Miltiad Nerënxa u ngjit në zyrë dhe u mbyll brenda. Është e pamundur të merresh vesh me këtë lloj publiku, rënroi me dhimbje, e pamundur. U ul në tavolinë dhe mbërtheu kokën me duar. Jashtë filloj të binte shi.

Pas ndonjë gjysëm ore ai doli dhe mori i vetëm përmes bulevardit. Njerëzit ishin futur nëpër lokale e dyqane, Shiu binte shtruar, por autori i pafat as që e ndiente. Flokët e lagur i kishin rënë mbi ballë. Fytyra i pasqyronte trishtimin e një Saharaje të tërë..

— Shiko, shkrimtar Miltiad Nerënxa, — i tha një djalë së fejuarës në një pasticeri. — Më duket se e paska kapur ndonjë krizë profesionale.

— Thonë se po shkruan një tragjendi të llah-tarshme me turq, — ia ktheu ajo. — S'është e lehtë të kthehesh pesë shekuj prapa.

Befas një çadër e mbuloi shkrimtarin. Ishte Alajdin Arbana.

— Milto! — thirri ai i habitur. — Ç'paska ngjarë? Si?! Të anuluan shfaqjen e dramës? Dhe për këtë ti ke lëshuar veten?! Jo, i dashur, nuk bën kështu. Ti je figurë e njojur në qytet. Njerëzit mund të bëjnë lloj-lloj interpretimesh. Eja të shkojmë te «Gjuetari». Kristoja e Ajeti po na presin.

Në lokalin e bukur të «Gjuetarit» Ajet Shkë-

mbi e Kristo Shigjeta ishin ulur në një qoshe me nga një gotë verë përpara dhe, me sa dukej nga gjestet, inxhinieri po tregonte ndonjë skenë gjahu me çifte. Pamja e Miltiadhit i shtangu ata të dy. Alajdini ua përplasi gjendjen me pak fjalë.

— Oh, q'mbrëmje e hidhur! — rënkoj autorit.
— Të pimë! Të dehem! Na mbytën budallenjtë!
Kamerier, verë!

Atij i ishte tekur keqaz për verë dhe iu duk se rast më të mirë nuk do të gjente. Tashmë dështimet e Miltiadhit Nerënxs ishin bërë të zakonshme e periodike si ato shirat pranverore e vjeshtore dhe ai e ndiente veten të lodhur duke e ngushëlluar.

— Vërtet e trishtueshme. Të pimë! — e mbësh-teti Kristo Shigjeta, të cilit gjithashtu i kishte shkuar mendja për qefull skare.

— Ngjarje tmerrësisht e turpshme, — psherëtiu piktori. — Vetëm vera mund të na largojë mendjen nga këto banalitete. Kamerier, katër shishe!

Shkrimtari i vështroi shokët me dhimburi.

— Mbrëmje ferri, — tha i prekur. — Mirë e keni. Të pimë, të dehem, djema. Kishte të drejtë Bajroni kur shkruante se në këtë botë të gjithë janë tradhtarë e hileqarë, përveç jush, ndërsa gota e verës qëndron gjithmonë besnikë.

Një copë herë ata u përqenđruan te vera e peshku duke harruar fare q'kishte ndodhur atë mbrëmje. Vetëm kur lëngu i kuq e bëri efektin e vet magjik, iu kthyen dështimit të dramës, Kristoja e quajti regjisator Kleo Bregun «troftë hutaqe», drejtorin e teatrit «fokë të përgju-

mur»». Alajdini e cilësoi publikun «jashtëzakonisht mistrec». Ndërsa Ajeti e uli trupën duke e përcaktuar të nivitet të viteve 40.

— Bah, ç'tersllék po më ndjek! — psherëtiu Miltiadhi Nerënxa duke kthyer gotën e katërt.

— Edhe vëllimin me poezi «Fllade e stuhi» do të ma dërgojnë përsëri mbrapsht me vërejtje. Bisedova në telefon me ata të redaksisë. Është hera e pestë që s'ma pranojnë.

— Milto, derrin e egër është më kollaj për ta vrarë në brinjë, — tha Kristo Shigjeta. — Merri edhe ti shefit krahet, ke dy kushërinj në Ministri të Arsimit. Xhevati sidomos ta mbaron këtë punë.

— Oj, të mbaruar! — brofi Ajet Shkëmbi.

— Pse, s'po i shohim të tjerët si po botojnë? Të gjithë me ndërhyrje e miq.

— Fatkeqësisht po, — tha piktori. — Talentet e vërteta po i djegin. Talentin nuk e do njeri, i bien kokës. Duan ta detyrojnë që të têrhiqet. Por ti, Milto, s'je nga ata që têrhiqen, Unë e di që luftën do ta vazhdosh, veç tani përtani të duhet ca pushim se je shumë i lodhur. Lejen krijuese për këtë vit e ke të miratuar. E fillojmë bashkë.

— Mirë e ka Alajdini, — tha aktori. — Ne artistët kemi herë pas here nevojë për rekrekacion. Apo s'po mban edhe koha! Plazhi do të mbyllët vonë.

— Filloje lejen, Milto, filloje, — e këshilloi edhe inxhinieri i hekurudhave. — Veç plazhit, edhe ca gjueti peshku do të të bëjë mirë.

Miltiadhi Nerënxa piu ca verë.

— Nuk po juua prish, — tha pastaj, — po e filloj. Ndërkohë po nis për në shtëpinë botuese romanin për pionierë «Pushka e vjetër dhe krismat partizane». Ëdhe pak kapituj më kanë mbetur për të daktilografuar. Me redaksinë e fëmijëve e di unë si merrem vesh. Atje më heqin kapelën.

IV

— Bre, bre, ç'po më djeg kurrizi! Habi e madhe! Fund shtatori dhe vapa të mbyt si në korrik.

— Çuditërish duket sikur dimri s'do të vi-jë.

— Stinët sikur janë zhvendosur. Vera hyn vonë, por ama edhe del vonë.

— Ehë! Me siguri do të ketë pësuar gjësen-di tërë planeti.

Ky dialog zhvillohej rreth orës 11 në pistën e madhe të «Adriatiku i kaltër» mes Miltiadit Nerënxsës dhe Alajdin Arbanës, ndërsa të dy, me fijet e tendosura të peshkimit në duar, prisnin gjahun. Po bëheshin dhjetë ditë që të dy shokë artistë kishin filluar lejet krijuese dhe i ishin rikthyer plazhit e gjuetisë së peshkut si ditëve të verës.

Pak më poshtë qëndronte ngrehur një kam-balec, pranë të cilit ishin lënë hapur një ku-ti e madhe bojërash, kavaleti dhe penelet e pik-

torit, i cili kishte nisur një peizazh deti që prej një javë, por puna po i ecte tepër ngadalë, sepse e pengonte dielli i fortë.

Ndërkokë një plak iu afrua telajos, pastaj u foli dy gjuetarëve:

— Kush është piktori nga ju, mor djema? Unë desha që këtë pikturë, kur ta mbaroni, të ma shisni mua.

— A nuk do t'ju pëlqente një peizazh me lijen — u gjallërua Alajdin Arbana. — Është shumë më i bukur se ky.

Plaku u mendua një hop.

— Po mirë, edhe me lijen e blej.

— Atëherë do të më kërkosh në Rrugën e Dëshmorëve, pranë farmacisë nr.3.

— Ashtu qoftë.

I kënaqur që arti i tij kishte tërhequr edhe një plak në moshë të thyer, piktori iu kthye më me qejf gjuetisë.

— Ke dorë të ëmbël, Alajdin, — i tha shkrimtari. — Peizazhi yt të magjeps me ato impresionet e çastit të hedhura me vrull.

Tjetri buzëqeshi.

— Edhe impresionet e tua në poezi s'janë më pak magjepsëse, Milto.

Pas pak ia mbërriti aty Ajet Shkëmbi me bicikletë, u zhvesh me ngut dhe u vërvit në det duke thirrur:

— Edhe një muaj plazh e kemi të sigurt.

Me krahët e tij të fuqishëm ai filloi të notonte duke ngritur stërkala e shkumë si ish-rekordmeni i shquar, Xhon Veismyleri, në rolin e Tarzanit.

— Prite kur të kthehet ky tani, — tha Alaj-dini.

— Eh, noti është sport i bukur! — pshe-retiu Miltiadhi.

Në orën 12 në pistë erdhi edhe Kristo Shigjeta me një trastë të mbushur me tonja peshkimi.

— Hë, luan qefulli gjë? — pyeti me padurim.

— Qamet, — tha piktori. Inxhinieri fërkoi duart.

— A pa pa! Me 'hundë e nuhat Kristoja vendin e qefullit. Më ndjek prapa i uruari.

Ndërsa ata u bënë tre në pritje të gjahut, Ajet Shkëmbi vazhdonte të notonte drejt thellësisë. Dielli shkëlqente mbi det si ngjyrat e verdha e portokalli nëpër peizazhet e Alajdin Arbanës. Një fllad i lehtë sikur e bënte edhe më të ëmbël ngrohtësinë.

— Ah, det, ti je mrekullia e parë dhe e fundit e kësaj bote! — i shpëtoi Miltiadhi Nerën-xës një klithmë poetike.

Vetëm pas orës tre ata u bënë gati për t'u kthyer në qytet secili me nga dy kokrra qefulli në trastë, tersllék të cilin mjeshtër Kristo Shigjeta e shpjegonte me faktin se në atë kohë të ditës peshku ishte i ngopur dhe s'pranonte as t'i hidhte sytë grepit.

— Në orën gjashtë po ju pres në shtëpi, — i ftoi Miltiadhi shokët para se të ndaheshin. — Do të diskutojmë ca në studio.

Miltiadh Nerënxa ishte nga ata artistë që nuk ia lejojnë vetes tërheqjen. Ndonëse pas dështimit të dramës «Ruga e suksesit» muza e

tij kishte pësuar një plagosje të rëndë, dora e palodhur s'donte t'i bindej qetësisë. Në atë gjendje zbatice frymëzimi ai u ishte rikthyer veprave të veta të dikurshme për rishikim e ripunim. Pikërisht për këto vepra katër shokët filluan të diskutonin pasdite në studion e freskët, ndërsa Sofia u solli një shishe raki, ca sallatë e djathë.

— Këtu, shokë, kam ca poezi për fëmijë të shkruara në vitet gjashtëdhjetë, — tha Miltiadhi Nerënxa duke hapur mbi tavolinë një doasje të vjetër me kujdesin që hapet një kuti bizophush të rralla. — Disa prej tyre i kam ripunuar e aktualizuar. Ja për shembull poezia «Kampi ynë». Strofa e parë ka qenë:

*Mu te pishat e Golemit
gjendet kampi ynë,
seç i biem karadyzemit dhe hamë bukë
me tlyn.*

Unë e kam ikthyer në:

*Mu te pishat e Golemit
gjendet kampi ynë,
plot me këngë edhe hare
ditët shkojnë e vijnë.*

- Jashtëzakonisht bukur! — thirri piktori.
- I janë hequr poezisë ca ngjyra orientale.
- Krijohet ideja e ditëve tona plot vrull,
- tha Kristo Shigjeta.
- Strofa e dytë, — vazhdoi poeti, — ka qenë:

*Bëjmë not edhe qyfyre,
luajmë volejboll,
lart në qielin e kulluar
dielli ndrit gjithmonë.*

Unë e kam aktualizuar:

*Bëjmë not edhe stërvitje,
luajmë volejboll,
nëpër trupat muskulozë
duket forca jonë.*

— C'gjetje! — thirri aktori. — Sa bukur
jepet kalitia e brezit të ri.

— Tërësisht e përsosur, — shtoi Alajdin Ar-
bana.

— Ja edhe poezia «Zogu i vogël», — e mo-
ri fjalën përsëri Miltiadhi.

*Ciu, ciu, ciu, ciu,
ç'ka, vallë, ky zog?
Ciu ciu, ciu ciu,
ai nënën po kërkon.
Ciu ciu, ciu ciu,
një djalë e dëgjon,
ciu ciu, ciu ciu,
në fole atë eçon.*

— Po kjo qenka perlë! — tha Ajet Shkë-
mbi. — Kërkon ta ripunosh! As mos e luaj,
Milto, dëgjo mua!

— Ajet, sikur ke shumë ciu ciu, — ndër-
hyri piktori.

— Ehu, me ato ciu ciu plotëson strofat, — tha inxhinieri. — Plotësohet 200-lekëshi.

— Bah! — u prek Miltiadhi Nerënxa, — Artisti i vërtetë s'krijon kurrë për para, i dashur Kristo!

— E, fjala vjen, — u tërhoq inxhinieri i hekurudhave.

— Ato ciu ciu duhen ruajtur, sepse kanë një funksion artistik, — argumentoi piktori. — Shprehin dhimbjen e zogut. Poezia është plotësisht e botueshme.

— Interesant! — tha Kristo Shigjeta, duke kthyer gotën e rakisë, — Sa interesant!

— Dhe të mendosh se ka qenë vetëm një gjimnazist, — shtoi Alajdin Arbana. — Ah, talenti është i lindur, vellezër, s'u takon të gjithëve.

— Ashtu është, — e mbështeti aktori. — E ka provuar shkenca.

Pasi u tregoi shokëve një tufë poezish të ripunuara e të aktualizuara, Miltiadhi u ngrit, iu afroa bibliotekës, vështroi një herë gaforen e madhe, pastaj mori një dosje dhe u kthye në tavolinë duke thënë:

— Kurse kjo është novela «Aroma e tokës» me temë nga fshati që e kam shkruar më 1969. Mendoj ta rishikoj me problemet e sotme të fshatit dhe ta kthej në roman. Material kam boll. Fabula me pak fjalë është kjo: dy të rinj nga qyteti shkojnë për të punuar e jetuar në fshatin tonë socialist dhe mposhtin atje shumë vështirësi.

— Po pse të mos shkojë në fshat vetëm një djalë nga qyteti dñe atje të martohet me një

kooperativiste shembullore? — tha Kristo Shigjeta.

— Ide interesante, — i pëlqeu shkrimtarit dhe e mbajti shënim. — Ta shohim.

— Unë mendoj të gërshtohet linja kryesore edhe me problemet e tufëzimit, — ndërhyri aktori. — Kjo do t'i shtonte vlerat.

— Detyrimisht, — e mbështeti piktori. — Bile mund të futej edhe një linjë retrospektive për të treguar të kaluarën e mjeruar të fshatit tonë.

— Po, ju kuptova, — tha Miltiadhi Nerënxa duke vazhduar të mbante shënime. — Ah, ky roman do të më lodhë shumë, e ndiej. Kërkon njohje të thellë. Do të më duhet të shkoj ca kohë në fshat.

— Lejen krijuese të 1986-s mund ta bësh në fshat, — tha Alajdini. — Ky do të ishte një shembull i mirë për të gjithë krijuesit.

— Jeta e fshatit, mes natyrës, ta shton frymëzimin, — tha inxhinieri.

Shkrimtari lëvizi vendit.

— Sa bukur e menduat, shokë! E shoh se ky roman do të sjellë përmbyshje në planet e mia.

Në studio mbretëroi një copë herë heshtja.

— Do të doja që të mblidheshim një ditë kështu edhe në oficinën time, — tha pastaj inxhinieri i hekurudhave. — Pse jo, mund të bëjmë edhe një shëtitje me lokomotivë.

— Do të vijmë, Kristo, mos u mërzit, — e siguroi shkrimtari. — Do të shëtisim edhe me lokomotivë.

— Më parë të mblidheshim një herë në stu-

dion time, — ndérhyri piktori. — Kam ecur goxha me tablonë kompozicionale.

— E ke zgjidhur përfundimisht? — pyeti shkrimtari.

— Po. Megjithatë mund të bëj ndryshime në se ju më propozoni ndonjë ide të bukur. Detyrimisht që do të bëj ndryshime.

— Do të mbidhemi edhe për tablonë tënde, Alajdin, rri i qetë.

Katër shokët ndenjën gjatë duke diskutuar për romanin e ardhshëm të Miltiadhit me temë nga fshati, për tablonë kompozicionale «Përpara për fitore të reja» të Alajdinit dhe për lokomotivat me avull. Kur miqtë u ngritën, i zoti i shtëpisë i përçolli deri poshtë në rrugë i ndjekur nga vështrimet kurioze e plot respekt të fqinjëve që diskutonin e pëshpërisnin për figurat e piktorit, aktorit dhe inxhinierit të hekurudhave sikur këta të ishin të mësuanë.

Pasët në shtëpi ra qetësia, Ernesti doli nga dhoma e tij, përplasi mbi tavolinën e korridosit një tekst gramatike dhe, duke fërkuar sytë e buhavitur, iu drejtua të atit:

— E, kishe miqë? Sa koka të mëdha që janë ata të tre! Gjithë qytetin e mahnisin!

Miltiadhi Nerënxa e vështroi të birin hetueshëm. Në fytyrën e tij të përgjumur s'merrej vesh a vlerësonte apo ironizonte, tallej apo fliste seriozisht.

— Njerëzit e artit e të shkencës qyteti duhet t'i respektojë, — tha.

— Ou, sidomos atë Kristo Shigjetën, — vazhdoi Ernesti. — Por edhe aktori me piktorin

s'imbeten prapa. U lumtë! Dhe po deshi le të mos shkojë përpara arti me këta njerëz të talentuar!

Pas këtyre fjalëve Ernesti u fut në banjë për t'u freskuar. Eh, bela, murmuriti Miltiadhi Nerënxa, pse është bërë kaq zevzek ky djalë?

— Me mëra 10 mina lumeni parë kohë —
— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

— Me mëra 10 mina lumeni parë kohë —

— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

— Mes e harraqit kopshti përmendë Shukrulli Miltiadhi, që iu përdorur për shkak e tij. Azi kemi një kohë e interesantej si qëndrueshëm do të marrë veç që shkallëzuar së pâqësuar mbretëri i Vlora përqindet.

është që dëgjohet se është një shokët e Miltos? Në këtë rast, që do t'i përmirrojë s'ka që dëgjohet se është një shokët e Miltos, do t'i përmirrojë s'ka që dëgjohet se është një shokët e Miltos. Në këtë rast, që do t'i përmirrojë s'ka që dëgjohet se është një shokët e Miltos, do t'i përmirrojë s'ka që dëgjohet se është një shokët e Miltos.

Nga bisedat nëpër shkallët e pallatit

— I njohtët nga afër shokët e Miltos? Hajde njerëz me kulturë hajde! Tamam shoqëri artistësh.

— Sidomos atë inxhinierin e hekurudhave e tregojnë fenomen.

— Pse piktor Alajdin Arbana s'ju duket mjeshtër?

— Ajet Shkëmbin thonë se e ka kërkuar televizioni për një film serial.

— Mos u bëni budallenj! Mos u besoni fjalëve që qarkullojnë poshtë e lart për qyfyre. Shokët e Miltos janë të gjithë zero me xhufkë. Ç'prisni nga një inxhinier si Kristo Shigjeta? Ai e ka mendjen te çiftja e zagarët.

— Po ai piktori që shet peizazhe me liqene dhe me dashnorë anemikë. Pika që s'i bie!

— Pale Ajet Shkëmbi! Tund një pallat pësekatësh kur reciton.

— Pushoni! Mos u tallni! E keni gabim.

Miltoja është kokë. Edhe shokët i ka njerëz të ngritur. Dinë gjuhë të huaja, punojnë në bibliotekë. I keni parë si studiojnë apo jo?

— Thonë se Kristoja përkthyeka poezi nga japonishtja.

— Kurse Alajdini i ka hyrë një stil i tepër dekadent, me spërkatje.

— Më thuaj me kë rri, të të them se cili je. Mos e harroni këtë proverb! Shikoni Milton dhe gjykonit për shokët e tij. Ata janë ajka e intelektualëve të qytetit. Koha do ta provojë këtë.

— Më mirë të mos flasim para kohe.

Pr. Todorov's "Art in Theory 1400-1800" is a compilation of 140 entries by 100 scholars from 20 countries. The entries are arranged chronologically and thematically, covering the period from the late 14th century to the early 19th century. The book is divided into four main sections: "Theories of Art," "Theories of Style," "Theories of History," and "Theories of Reception." The entries range from short definitions to longer essays, providing a comprehensive overview of the development of art theory over five centuries. The book is a valuable resource for anyone interested in the history of art and its theoretical underpinnings.

Fragmente nga ditari artistik

... E kaluara e largët kurrë s'duhet t'i shpëtojë një artisti, sepse pa dimensionet e gjera historike ai s'do të ishte artist i vërtetë. Historia e lavdishme shpesh na shfaqet mu para syve, ndërsa ne mundohemi ta kërkojmë në për libra. Kjo sigurisht vjen nga një lloj konceptimi intelektualist i jetës në përgjithësi.

Sot shkova nga amfiteatri antik dhe pa kuptuar pamja e tij më gozhdoi në vend. Vështroja arenën e zbuluar dhe mendoja për betejat e përgjakshme të zhvilluara dikur në të. Sa jete skllëvërish të pafajshëm mund të kenë humbur aty për të zbavitur aristokracinë e pa-shpirt! Befas imagjinata më vërviti në thellësi të shekujve të shkuar kur qyteti ynë ishte i pushtuar nga romakët dhe amfiteatri ishte mbushur me skleverb ilirë. Subjekti i një novele historike m'u ravijëzua në pak çaste. Në një nga bodrumet e amfiteatrit është mbyllur që prej gjashtë muajsh një ilir trim, i cili është

kthyer në skllav. Ai ka fituar shumë dyluftime, por vjen një ditë dhe e caktojnë të ndeshet me një shokun e tij të ngushtë. Këtu konflikti arrin kùlmin. Iliri trim vendos të ngrëjë të gjithë sklevërit në kryengritje dhe t'u shpalë luftë romakëve. Një natë, sklevërit e mbyllur në amfiteatër vrasin rojat, dalin jashtë dhe ngrënë popullin e qytetit në këmbë. Romakët shpartallohen. Dy muaj rresht qyteti mbetet i çliruar, por romakëve u vijnë përforcime me ngut dhe kryengritja shtypet. Udhëheqësi i saj vritet me shpatë në dorë.

Më duhet të falënderoj pjellorinë e imagjinatës që po më dhuron herë pas here subjekte tèrheqëse. Kështu ndodhka kur artisti rrroka orë e minutë me shqetësimin krijues.

Vetëm konflikti i tragjedisë sikur s'po më ecën. Jam në hall me të. Ngjarjet kanë mbërritur në një udhëkryq tepër të vështirë, prej të cilët varet i gjithë shtjellimi i mëvonshëm. Por kam besim se imagjinata, si ai pusi që nuk shteron kurrë, do të më çojë drejt rrugëzgjidhjes.

Romanin «Pushka e vjetër dhe krismat partizane» e nisa për botim. Pres që ai t'i sjellë freskinë e dëshiruar prej kohësh letërsisë përfëmijë të mbetur në stacion...

V

Në jetën krijuese të Miltiadhd Nerënxs nuk ishin të pakta rastet kur ideve të lindura natën vonë ai u përvishej që në mëngjes për t'i kthyer në vepra ose atyre të lindura në mëngjes u shtrohej në 12 të natës, pa e lënë frysmezimin t'i vakej. Kështu, një ditë të bukur tetori, ndërsa vazhdonte lejën krijuese, ia mbërriti në amfiteatër bashkë me Alajdin Arbanën për të nisur novelën që i merrte ngjarjet nga koha e pushtimit romak të qytetit. Miltiadhd Nerënxa ishte shkrimtar i pasioneve të forta, ndaj piktorin nuk e habit men-dimi i tij që novelën ta hidhte në letër poshtë, në thellësi të amfiteatrit. Përkundrazi, ai e mbështeti dhe, për ta shoqëruar, mori me vete pajisjet për t'i hyrë një peizazhi ku antikiteti i qytetit të dilte në plan të parë.

Fiks në orën nëntë Alajdin Arbana ngriti kambalecin e tij në një shesh të vogël mbi am-

fiteatër, ndërsa shkrimtari bëri te poshtë shkallëve të gurta duke thënë:

— Alajdin, ti mos u mërzit se unë do të vonohem ca.

— S'na lë puna të mërzitemi, Milto, — ia ktheu shoku.

Duke zbritur me kujdes shkallët e gurta të amfiteatrit, Miltiadher Nerënxa hyri në një korriaor të gjatë, pastaj pak më poshtë në një guvë të gjerë me tavan të përkulur nga ku depërtonin fasha të trasha drite. Vendi ishte tërë lagështirë dhe herë pas here nga gurët këputeshin pika uji që lëshonin ca tingëllima të mytura. Shkrimtarin e përshkoi një rrëqethje e përgjithshme, por e mblođhi veten shpejt. Zgjodhi një pozicion nga ku dukej arena dhe, pasi u ul mbi një shtyllë të rrëzuar mermeri, hapi mbi gjunjë një fletore të trashë. Sipas skicidesë që kishte bërë, novela do të fillonte me një betejë të përgjakshme sklevërish ku heroi kryesor shtrinte përdhe katër kundërshtarë. Klithje, rënkime dhe vringëllima shpatash përhapeshin nga arena e gjakosur, mendoi Miltiadher Nerënxa. Kjo do të ishte fjalia e parë. Sqarimet historike do të vinin më poshtë. Ai uli stilografin dhe filloi të shkruante me vrull.

Ndërkohë që novelisti humbiste në mugëtirën e shekujve, mes sklevërve të mjerë që përlesheshin, sipër nën ngrohtësinë e diellit piktori hidhte mbi telajo linjat e peizazhit të tij. Banorët e shtëpive aty pranë kishin dalë nëpër dritare dhe e ndiqnin me vëmendje. Por lëvizjet e shkathëta të dorës së tij nuk vazh-

duan gjatë, sepse një burrë i moshuar, në prag të pensionit, ia mbërriti aty me një kuti shahu në krah. Me sa dukej duhej të ishte roja e amfiteatrit.

— Puna e mbarë! — përshëndeti ai. — A u lodhe?

— S'lodhemi ne artistët, — ia ktheu Alajdin Arbana.

— Sikur të uleshe ca, — vazhdoi roja. — Puna në këmbë s'është e lehtë.

Piktori ia nguli sytë kutisë së shahut.

— Po ti i luan gjë ata gurë?

Rojës i qeshi fytyra.

— Eja ta provojmë.

— Të gënjen mendja, xhaxha. Plotësisht. Unë të gozhdoj mat me dhjetë lëvizje.

— Të shohim. Ndoshta të gozhdoj unë ty.

Piktorin e mbërtheu inati i garës. Ai la penelat mënjanë dhe u ul përballë rojës duke përveshur mëngët. Loja u ndez e ashpër, por rojën e kishin bërë rrëthanat e punës kandidat mjeshtër. Pasi e lodhi Alajdinin mirë e mirë me ca variante të ngatërruara nga krahët, ai thirri befas duke qeshur:

— Ja edhe mat më në fund.

— Nuk ka mundësi! — u befasua piktori. — Si ma punove kështu?! Megjithatë unë ty të mund. Po deshe vemë edhe një bast të vogël.

— Është vëmë, — pranoi roja. — Birrë e bërxollë.

— Tërësisht dakord.

Alajdin Arbana filloi të djersinte nga sikleti. Edhe lojën e dytë e humbi. Roja buzëqeshte herë pas here me vete dhe pinte cigare të drejtë.

dhura. Ata apo kishin nisur lojën e tretë, kur nga thellësia e amfiteatrit erdhën ca thirrje të Miltiadhit. Roja brofi në këmbë.

— Mos u shqetëso, — tha piktori. — Është një shoku im.

— E ç'bën atje nën dhe ai?

— Shkruan, xhaxha, shkruan.

Alajdini u afrua te një e çarë.

— Milto, si vete puna?

— Alajdin, dëgjo, ti je skllav. Dakord?

Piktori hapi sytë i trembur.

— Ta zemë se nesër do të vdesësh, — vazhdoi shkrimtari. — C'do të mendoje gjatë kësaj kohe?

Piktori vështroi një herë rrötull, pastaj tha i hutuar:

— Do të kujtoja shtëpinë, gruan, fëmijët, gjithë të njohurit.

— Të lumtë! — thirri i gëzuar Miltiadhi. — Faleminderit!

Duke tundur kokën sa majtas-djathtas, piktori u ul përsëri përballë rojës. Më në fund arriti t'ia merrte një lojë dhe u hodh në sulm të mëtejshëm. Por kundërshtari i ndërronte variantet si lakuriqi i natës drejtimin e fluturimit. Në orën 12 rezultati ishte 5 me 2 në favor të vendësit.

— Alajdin! O Alajdin! — u dëgjua përsëri zëri i shkrimtarit.

— Bre! Akoma brenda qenka ai? — u çudit roja.

Piktori u afrua përsëri tek e çara,

— Ç'është, Milto?

— Alajdin, ta zëmë se të duhet të vrasësh

shokun tēnd tē ngushtē. Ç'do tē bēje ti? Mos harro se je një skllav.

— S'do ta vrisja kurrē, Milto. Kësaj i thonē njëloj sikur tē tē vras ty. Unë do t'u sullesha atyre që do tē më detyronin tē vrisja shokun tim. Do t'ia vërvvisja shpatën ndonjë aristokrati romak.

— Tē lumtē Alajdin! Faleminderit shumë!

Piktori u rikthye në duel. Në orën një e gjysmë rezultati kishte shkuar 7 me 3.

— A më takon tani ta pi atë birrēn? — tha roja duke buzëqeshur me pamjen e një fitimtari.

Alajdini tundi kokën me keqardhje.

— Tē takon ta pish, xhaxha. Vec dije se për ty ka qenë një birrë si e Pirros.

— Jo, më mirë e pimë këtu te rostiçeria e Sokratit. Ka bërxolla tē ngrohta në këtë orë, — ia ktheu roja.

Āta tē dy zbritën tē zënë për krahu si miq tē vjetër duke diskutuar për shahun dhe hynë në rostiçerinë e Sokratit që mbante me shaka emrin «Tymi i këndshëm». Morën birrë e bërxolla dhe ndërsa pinin, Alajdini filloi ta gërmonte rojën se mos i kishte bërë hile gjatë lojës, sepse ishte hera e parë që mundej aq rëndë. Tjetri u prek dhe, për tē treguar ndershmërinë e vet, e ftoi mikun që tē vinte sa herë tē donte në amfiteatër e tē ndesheshin me bast. Tymi i këndshëm i bërxollave që lodronte gëzueshëm nëpër lokal dhe sekretet e pafundta të shahut i mbajtën dy imiqtë si pa kuptuar aty deri afër orës tre.

Kur piktori u kthye në amfiteatër, Miltiadh

Nerënxa s'dukej kurkund. Ai u përkul tek e cara mbi shkallët e gurta dhe thirri.

— Këtu jam, këtu! — iu përgjigj një zë i ngjirur që poshtë, i cili u pasua nga një e kollitur e fortë.

— Milto, eja se mbetëm në këtë gërmadhhë. Ora vajti tre!

— Alajdin, edhe një paragraf! Po i afrohem kryengritjes!

— Milto, të lutem!

Më në fund, në tre e njëzet, Miltiadhi Nerënxa doli në drithë të diellit duke u kollitur e duke u dridhur i téri sikur të kishte qenë i mbyllur brenda në frigorifer. Fytyra i ishte nxirë, megjithatë i qeshte prej gjëzimit krijues, si një eskimezi kur kthehet nga gjuetia e bollshme.

— Alajdin, i mbarova njëzet faqe, — tha krenar. — Tani më ka mbetur kryengritja dhe mbyllja e novelës. Edhe dy ditë punë.

— Të lumtë, Milto, — tha piktori duke e parë fytyrën e nxirë të shokut i lemerisur. —

— Më kujtove Zolanë që hynte nëpër miniera. Ikim tani. Edhe unë eca goxha me peizazhin.

— Ikim se po më bie të fikët për të ngrënë.

Pasdite Kristo Shigjeta, Ajet Shkëmbi e Alajdin Arbana e priten gjatë Miltiadhi Nerënxi, në lulishten në qendër të qytetit ku takohen zakonisht, por ai nuk u duk. Piktori dyshoi, megjithatë e bënë një shëtitje të gjatë duke menduar se do ta ndeshnin shokun në ecje e sipër. Por më kot.

— Kam frikë se Miltoja do të jetë sëmurë, — tha Alajdini atëherë. — Duhet të shkojmë patjetër ta shohim.

Frika e tij nuk qe pa baza. Kur ata të tre u ngjitën në apartamentin e Nerënxajve, e gjetën shkrimtarin shtrirë, me zë të fikur, mbytur nga kolla e nga temperatura. Sofia i rrinte te koka e merakosur duke mërmëritur e trembur dhe duke dyshuar për atë sëmundjen speciale të shkrimtarëve.

— Milto, s'duhet të arrije, deri në atë sakrificë për artin, — tha Alajdini i prekur. — Çdo gjë ka kufi.

Kur inxhinieri i hékurudhave dhe aktori morën vesh rrëthanat në të cilat shoku i tyre ishte ftohur, nuk mundën ta përmbanin habinë dhe respektin.

— Kur artin e ke me pasion, sakrificat për të nuk i vë në hesap, — filozofoi Kristo Shigjeta. — Milto, sot na ke dhënë një mësim të madh.

— Jashtëzakonisht të madh, — e mbështeti Alajdin Arbana.

— Unë për vete s'do ta harroj, — tha aktori.

Lëngata e shkrimtarit zgjati afro një javë, por, me gjithë kushtet e vështira ai arriti ta përfundonte novelën e sklevërve kryengritës dhe, pasi i vuri titullin «Shpata që sollën lirinë», e la penën mënjanë me dorë të dridhur duke vështruar nga dritarja e hapur e studios tutje në det. Do të ishte krim po të mos ma botonin këtë novelë, murmuriti i lodhur.

— Kjo është kompozicioni i tij i këtij vitese —
— Do të shikoj si do të përfundon që e mundur
që e mundur —
— Do të shikoj si do të përfundon që e mundur —
— O Ajet! Në këtë gjësimi —
— Milto —

Fragmente bisede në studion e piktor:

Alajdin Arbanës

— Kjo tablo kompozicionale do të jetë një sfidë. Më kuptioni? Prandaj unë mendoj që dimensionet e saj të shtohen edhe më shumë.

— O, Kristo, po kësaj i thonë që Alajdini të fillojë edhe një herë nga e para.

— Pavarësisht, Milto. Le t'i diskutojmë idetë.

— Tjetër, si vepër sfiduese, tabloja duhet të ketë më shumë figura punëtorësh, sepse jepet uniteti dhe forca jonë.

— Këtu jam dakord edhe unë. Alajdin, do të doja të të ofroj edhe një mendim. Si kohë në tablo të zgjidhet dimri. Kështu theksohet ideja e forcës së klasës sonë punëtore që s'pyet për të ftohtët dhe acarin.

— Do ta shikoj këtë mundësi, Milto, sigurisht.

— Unë s'jam dakord!

— E pse, Ajet?

— Koha e tablosë duhet të jetë vera që të dalin në pah muskujt dhe trupat e fuqishëm të punëtorëve tanë.

— Edhe unë jam për verën.

— Do të shtoja diçka tjetër. Ngjyra e kuge, e verdha dhe e kaltra duhen theksuar që të jepet perspektiva e ndritur.

— O Ajet, ti ke gusto ciganësh.

— Ndoshata.

— Ah, tani m'u kujtua edhe diçka tjetër, Alajdin!

— Urdhëro, Kristo!

— Në arkitekturën e tablosë fut edhe një pjesë të qytetit. Ne kemi qytet shumë të bukur.

— Do ta mendoj.

— Mua më duket se numri i punëtorëve në tablo nuk është i drejtë. Aty jepen dy burra dhe një grua. S'jam dakord që numri i punëtorëve të shtohet shumë, por ama duhen bërë katër. Dy burra e dy gra. Kështu del që punës sonë ndërtimit ia japim tonin barabar edhe burrat edhe gratë.

— Të kuptovat Milto. Katër do t'i bëj.

— Po sikur dy prej punëtorëve të vishen me rrøba ushtarake? Ndërtimi i socializmit është i pandare nga mbrojtja e atdheut, apo jo?

— Ide interesante, Ajet!

— Është vepra jote e madhe Alajdin që të shtyn të debatosh e të mendosh për ide të reja...

Po bëheshin ditë që Miltiadher Nerenxa kishte ngecur në aktin e pestë të tragjedisë «Liria do të kthehet përsëri». Ndonëse ai rrinte deri vonë duke i kërkuar ndihmë imagjinatës së tij të ndezur, halli po bëhej gjithnjë e më kercë-nues. Afati i planifikuar përmbarimin e tragjedisë po vihej në rrezik dhe Miltiadher Nerenxa ishte nga ata autorë këmbëngulës që s'dinët'i shtyjnë veprat përmë vonë.

Ishte koha kur turqit, në pamundësi përmë të marrë kështjellën e Shkodrës, po orvateshin të vrisnin princin sundimtar. Problemi ishte se si do të kryhej vrasja. Këtë vështirësi shkrimtari e kishte diskutuar disa herë me shokët e tij të ngushtë në shëtitje, por, përmë habi, asnjëra prej ideve të tyre s'po e bindte. Ai s'donte të luante nga plani i vet, sipas të cilit princi duhej vrarë pabesish.

Ndërkohë fqinji i shkrimtarit, ai tipi që vu-

ante nga pagjumësia dhe mbahej si rekordmen duhani, filloi të betohej e stërvetohej rishtazi se një natë e kishte parë përsëri muzen e tragjedisë, Melpomenin, të vinte fluturim drejt studios së Miltiadher Nerënxs. Ngaqë dritarja kishte qenë e mbyllur, ajo kishte trokitur në xham. Shkrimtari kishte dalë dhe ata diç kishin pesnpëritur. Para se të largonej, Melpomeni e kishte puthur Miltiadhin në ballë si herën e parë. Fqinji i pagjumë u lutej banorëve të pa-natit që ta besonin dhe në të vërtetë nuk qenë të pakë ata që ia morën fjalët në konsideratë.

Një natë nëntori Miltiadher Nerënxa qëndronte i menduar në tavolinën e vet të punës në kërkim të rrugëzgjidhjes së konfliktit. Ai kishte besim se imaginata nuk do ta linte në baltë dhe befas, atëherë kur po i rëndohej koka për gjumë, ajo ia dhuroi çelësin për të hapur portën e mbyllur të Sezamit mundues. Princin do ta vrisnin dy kështjellarë të shitur te turqit. I ngazëlyer nga kjo ide, shkrimtari u ngrit, hodhi pallton supeve, hapi derën e jashtme me kujdes dhe doli. Ishte një natë e ftohtë, por me një qell të kthjellët, plot yje. Autori i tragjedisë e cte me hap të shpejtë. Nja treqind metra më poshtë, në një pallat pesëkatësh, banonte aktor Ajet Shkëmbi.

Miltiadhi u ngjit në kat të katërt me një frymë. Në hyrje mbretëronte qetësia si në ndonjë muze. Ai iu afrohej dymbëdhjetës dhe në ato çaste kraharori i gjerë prej sportisti i Ajet Shkëmbi ulej e ngrihej ritmikisht në thellësinë e

gjumit të parë. U deshën dhjetë minuta trokitje që ai të zgjohej.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti me zérin e vet prej basi. — Kush është?

— Hape, Ajet, jam unë, — iu përgjigj shkrimtari.

Aktori flloi të kërkonte diçka nëpër korridor.

— Milto, nuk po gjej dot çelësin, — tha pas pak.

— Lëre, përkulu këtu te brava.

— Hë, ç'ka ndodhur?

— E gjeta zgjidhjen e aktit të pesët. Princin do ta vrasin dy kështjellarë të shitur. Për vrasjen kam këto variante: me thika dhe me helmim. Ajet, si të duket?

— Ide gjeniale, Milto, — erdhi përgjigjja nga ana tjetër e derës. — Veç dy vrasësit të mos jenë kështjellarë. Shqiptari nuk shitet kolaj. Më mirë bëj turq të maskuar si fshatarë të ardhur nga krahinat. Dëgjon? Sa për vrasjen, thikat dhe helmi janë shpërdorur ca si shumë në teatër. Po sikur princin, ta mbysje?

— Ta mbysja? Ajet, të lumtë! Ashtu do të bëj. Do ta mbys!

Ndërkohë, në apartamentin përballë, fqinja e Ajet Shkëmbit, një grua te të pesëdhjetat, ishte ngritur të pinte sodë për stomakun, gjë që e bënte shpesh natën. Zëri i shkrimtarit në korridor e trembi dhe u afrua të mbante vesh. Kur dëgjoi fjalët e fundit, ajo vuri duart përmbi zemër dhe klithi e lebetitur:

— Au! Një kriminel! Një kriminel! Po mby sin një njeri!

Miltiadħ Nerënxa ngriu. Ndérkaq fqinja e aktorit arriti tē zgjonte tē shoqin, i cili brofi nē ballkon dhe me duart si hinkē para gojës dha kusħtrimin:

— Ċohuni, burra! Ċohuni, djema! Po vrasin një njeri nē hyrjen tonë! Krimineli eshtë nēpér shkallé!

Pēr pak sekonda dyert filluan tē hapeshin e tē pērplaseshin me zhurmē. Dēgjoheshin 'herē pas here klithma grash. Burrat dhe disa djem tē rinv u dhanē shkalléve armatosur me shkopinj, sēpata e hanxharé, bile njéri shtrëngonte nē dorē thikēn e bukës. Miltiadħ Nerënxa u ngjesh pas murit i tmerruar. Ndérkohé dera pērballé u 'hap dhe fqinji i Ajet Shkembit nxori paksa kokën. E shoqja e tērhiqtē pēr pizhamesh duke thirrur e trembur:

— Guri, jo ti, aman, se je me zemér! Guri, futu brenda!

Dalēngadalé burrat e djemtē e armatosur po i afroheshin shkrimtarit, i cili s'bente asnje lēvizje. Nēpér hyrje thirrjet vazhdonin. Nē kēto e sipér Ajeti, i xhindosur nga inati, e ngriti gjithē shtepinē nē kēmbē duke kērkuar gelēsin. Mos e prekni, thērriste nga brenda, eshtë shoku im.

— Burra, kujdes! — thirri fqinja qē kishte dhēnē alarmin. — Eshtë i armatosur me thikē. Ka edhe kuti helmi.

Pas kētyre fjaléve banorét e pallatit u sten-pēn.

— Kiço, ti mos u ngatērro se do tē tē ma-

rrin për dëshmitar, — e këshilloi një grua të shoqin.

— Dëgjo, më mirë dorëzohu dhe eja të shkojmë në polici, — i foli Miltiadhi Nerënxsës një pensionist.

— Si?! Unë në polici?! Kurrën e kurrës! — thirri shkrimtari.

— Çojini fjalë Bedriut, — tha një djale. — Ai është oficer, ka revole.

— Jo, më mirë të telefononi policinë, — ia priti një tjetër.

Por ndërko'hë aktori arriti ta hapte derën.

— Ajet, ruaj veten! — i thirrën fqinjët në kor.

— Ju jeni të gjithë të çmendur, — ua ktheu ai. — Ç'keni kështu? Ç'më jeni armatosur si indianë? Nuk e njihni këtë burrë fisnik? Është shoku im, shkrimtar Miltiadhi Nerënxa.

Pas këtyre fjalëve burrat e djemtë filluan të férkonin sytë e të lëshonin pasthírrma habie.

— Ta hajë dreqi! — shfryu pensionisti i moshuar. — Pse na e prishni gjumin kot? Shoku Milto, të na falni!

— Kush e dha alarmin xhanëm? Si ndodhi? — filluan pyetjet poshtë e lart.

— Nuk ka rëndësi, — tha shkrimtari me një pamje lapidare. — Çdo gjë kaloi. Mund të shkoni të qetë tani.

Burrat e djenitë filluan të ktheheshin nëpër shtëpi duke i kërkuar të falur. Ajet Shkëmbi e mori shokun e vet për krahu dhe e futi bre-

nda ku e përfunduan plotësish problemi e vrasjes së princit.

— Ajet, — tha pastaj shkrimtari i mallën-gjyer. — Së shpejti të pret një provë e vësh-tirë. Unë do të të besoj rolin e princit. Këtë personazh po e krijoj posaçërisht për ty. Është një personazh i natyrës shekspiriane dhe ti ua ke marrë dorën këtyre personazheve.

Aktori hapi krahët i prekur thellë.

— O, faleminderit shumë, Milto! Vlerësimi yt më vë para një përgjegjësie të madhe. Princi është figurë shumë komplekse.

— Unë kam shumë besim në aftësitë e tua. Këtë rol vetëm ti mund ta luash në gjithë Republikën.

— Falemnderit për konsideratën!

Ata u ndanë duke u përqafuar. Vetëm në orën një e gjysmë Miltiadher Nerënxa u kthyesh në pallatin e tij. E trembur, duke mos e gjetur të shoqin në studio, ku ishte afruar si gjithmonë ta këshillonte që të mos lodhej shumë se shihte èndrra dhe e zinte ajo sëmundja speciale, Sofia kishte dalë te shkallët.

— S'ka ndodhur asgjë, e dashur, — e qetë-soi ai. — Isha deri tek Ajeti.

— Dëgjova dy kalimtarë që thoshin se kanë parë një kriminel këtej afër.

— Budallallëqe! Te ne s'ka kriminelë, Sofi. Eja, qetësohu!

Pasi e çoi të shoqen në shtrat, Miltiadher Nerënxa u kthyesh në studio dhe doli prej andej vetëm pasi shkroi tri skena radhazi. Për ca ditë nëpër qytet u fol se në pallatin nr. 87 ishte ka-

pur një vrasës, se ishte gjetur një psikopat i ikur nga spitali dhe komenti më i fortë qe ai që thoshte se shkrimtar Miltiadher Nerënxa kishte dashur të vriste aktor Ajet Shkëmbin, se pse ky i kishte vjedhur subjektin e një tragjedi të famshme. Por kur ata të dy i panë në shëtitje së bashku, vala e thashethemeve u shua pa vonesë.

VII

Brenda një muaji nuk ishin të pakta ditët kur shkrimtar Miltiadhi Nerënxa, piktor Alajdin Arbana, inxhinieri i hekurudhave e përkthyes Kristo Shigjeta dhe aktor Ajet Shkëmbi shkonin në bibliotekën e qytetit për të studiuar. Në shumicën e rasteve ata mblidheshin atje së bashku dhe kjo binte në sy menjëherë. Të gjithë lexuesit fillonin e pëshpërisnin me njëri-tjetrin për shoqërinë e katër artistëve dhe zellin me të cilin ata studionin vepra të trasha në gjuhë të huaja që të merrte frika kur i shikoje. Zakanisht katër shokët futeshin të parët në sallë dhe dilnin prej saj të fundit, veprime këto që nga shumëkush merreshin si shembuj idealë të vullnetit.

Ishte një pasdite fundnëntori kur katër shokët e ngushtë po ngjiteshin duke diskutuar për në bibliotekë. Miltiadhi kishte marrë me vete çantën e zezë, Kristoja mbante një çantë të

bukur ngjyrë portokalli që e kishte blerë gjatë një shërbimi në Itali, ndërsa Alajdini e Ajeti kishin futur nën krahë nga një dosje. Ata u përshëndetën me bibliotekaren, e cila i njihte mirë dhe ua ktheu përshëndetjen gëzueshëm.

— O, mirë se ardhët, shokët e artit! Ju lutem plotësoni fletëkérkesat se nuk i mbaj mend tërë librat që ju duhen.

Duke buzëqeshur ata hapën çantat e dosjet, nxorën stilografët e blloqet e shënimave. Në fletëkérkesën e shkrimitarit u radhitën dy vëllime për pushtimet turke të shekujve XV-XVI, tri vëllime të Enciklopedisë së Vjetër Italiane, një botim anglez për Rilindjen Evropiane dhe një botim francez me studime për Evropën Juglindore. Në fletëkérkesën e inxhinierit vendin kryesor e zunë revistat italiane e franceze për hekurudhat, pastaj dy vëllime të vjetra për termodynamikën. Piktori kérkoi një album të kryeveprave të Luvrit, një album tjetër të pikturesh mesjetare japoneze dhe një studim për kubizmin. Kurse aktori një historik të teatrit anglez, një të teatrit francez dhe një monografi të Shekspirit. Bibliotekares iu këput dora duke plotësuar kartelat. Më në fund ata të katër hynë në sallë me krahët ngarkuar.

Kur shihnin tavolinat e tyre dinga me vepra, lexuesit e tjerë mbeteshin ca çaste të shtangur, librat e tyre u dukeshin çikërrima pa vlerë. Nga të katër shokët pamjen më tërheqëse natyrisht e kishte Miltiadher Nerënxa. Flokët e rënë mbi ballë dhe dora e majtë e vendosur mbi njërin prej vëllimeve të Enciklopedisë Italiane e

bënin të dukej një tragjedian i vërtetë. Po edhe Kristo Shigjeta nuk mbetej më prapa. Syzet miopike e paraqisnin më intelektual e më të mençur. Balli i rrudhur i Ajet Shkëmbit dhe vetullat e tij të mbledhura tregonin qartë se nuk ishte gjë e lehtë të merreshe me teatër dhe të analizoje zhvillimin e tij nëpër shekuj. Kurse ftyra e menduar e Alajdin Arbanës të bindte se ishte e pamundur të mos magjepseshe kur shikoje kryeveprat e muzeut të Luvrit.

Kishte kaluar ndonjë çerek ore që katër shokët ishin thelluar mbi veprat e tyre kur një pensionist i ulur pranë Kristo Shigjetës, i cili po lexonte një numër të revistës «Ylli», iu drejtua atij me respekt:

- Shok, mos jeni përkthyes?
- Jam, — tha Kristoja duke buzëqeshur, — por profesioni im është inxhinier hekurudhash.
- Ashtu?! Kam dëgjuar se japonezët kanë bërë një lokomotivë me korrent që ecën me 300 kilometra në orë. A është e vërtetë?
- Po, xhaxha, është.
- E si shpjegohet gjithë kjo shpejtësi, mor djalë?
- Unë s'merrem shumë me to, xhaxha, por me lokomotivat më avull. Hë, si të duket?
- Kureshtar jam edhe për lokomotivat me avull. A e ke bezdi të më tregosh gjësendi?
- Me gjithë qejf!
- Ej, ju, shokë, qetësi ju lutem! — u ankuau disa lexues.
- Më mirë dalim jashtë, — e ftoi Kristo Shigjeta pensionistin.

Ndërkohë shikimin përpirës prej piktori të Alajdin Arbanës e tërroqi një studente simpatike me flokë kaçurrel dhe sy në formë bajameje. Ai hapi me vrull dosjen, nxori një fletë të bardhë, një laps plumbi, u kthyte nga studentja dhe filloi ta skiconte. Vështrimet e tij e hütuan flokëkaçurrelësen. Ajo u skuq dhe uli kokën. Piktori u ngrit dhe iu afrua.

— Mos u shqetësoni, vajzë, — i foli me ton prindëror. — Unë vetëm do t'ju vizatoj. Jeni jashtëzakonisht ekspressive. Ju lutem ngrijeni kokën. Ashtu. Vazhdoni të lexoni pa e pasur mendjen tek unë. — E zënë ngushtë, vajza bëri një gjest që tregonte se ishte dakord. Alajdini u kthyte në vendin e tij dhe rrëmbeu përsëri lapsin.

Në këto e sipër aktori vuri re se një djalë i ri para tij kishte marrë koleksionin e Sportit Popullor të vitit 1974 dhe po shfletonte numrat e kampionatit botëror të futbollit. Ai tërroqi karrigen dhe iu afrua.

— Jeni tifoz? — e pyeti djali.

— Shumë, — tha aktori me qejf.

— Eja të lexojmë bashkë. Ka gjëra interesante.

Ndërsa Kristo Shigjeta po e linte gojëhapur pensionistin duke i treguar për lokomotivat me avull, Alajdin Arbana vizatonte flokëkaçurrelësen dhe Ajet Shkëmbi po lexonte për fitoren e famshme të Holandës ndaj Brazilit, Miltiad'h Nerënxa dalloi në tavolinën para tij ca poezi të daktilografuara. Një djalë rreth të njëzetave po i shfletonte ato me vëmendje. Ai i foli që të afrohej dhe t'i merrte poezitë me vete.

— Shkruan? — e pyeti me ngrohtësinë e një autori të moshuar.

— Ngapak, — tha djali me druajtje.

— Po mua, a më njihni?

— Ju jeni dramaturg, Miltiadher Nerënxa...

— Edhe poet ama! Pa të shohim, ç'ke shkruar. Ai lexoi nja dhjetë poezi radhazi, u mendua ca, pastaj tha me tonin e sigurt të një njohësi të pagabueshëm të letërsisë:

— Po më pëlqen, paske nerv poetik. Edhe strofën e njihke. Poezia «Kthimi në vendlindje» qenka shumë e bukur.

Në fytyrën e djalit u ravijëzua një shprehje habie.

— Po këtë poezi ma kanë sharë! — tha ai.

— Kush e paska sharë?

— Andon Kodra, redaktor në «Drita».

— Ama, me Andonin merresh ti! Ai e njeh poezinë sa c'njeh ti etruskët. Është për ta çuar shitës zarzavatesh. Tjetër, poezia «Shoqes sime» është e dobët në përgjithësi.

Djali përsëri shprehu habi.

— Po këtë poezi poeti Mark Kodheli ma ka lavdëruar shumë!

Miltiadher Nerënxa nënqeshi.

— Mos i beso një poeti si Mark Kodheli. Është mendjemadhe dhe shkruan pa frysëzim, me logjikë. Unë e kam mësuar të thurë vargje. Disa lexues kërkuan përsëri qetësi

— Eja, — e ftoi Miltiadher Nerënxa letrarin e ri, — të diskutojmë jashtë.

Ata u ulën në një stol në lulishten pranë bibliotekës dhe, duke shfrytëzuar bagazhin e

vet të gjerë letrar, shkrimtari filloi të mbante një leksion të gjatë për poezinë. Uli poshtë vargun e lirë dhe ngriti lart strofën, shau pa përjashtim të gjithë poetët e qytetit dhe një pjesë të atyre që punonin në Tiranë, duke i lënë letrarit të ri të kuptonte se poezi të bucura shkruante vetëm ai, por redaktorët e pakualifikuar nuk arrinin ta kuptionin dhe e sulmonin padrejtësisht. Djali duroi sa duroi, pastaj filloi të bënte lëvizje nervoze për të treguar sikletin që e kishte mbërthyer, por Miltiadhi as që e vinte re. Kur ai filloi të fliste për figurat letrare, metrin e llojet e rimave, letrari i ri s'duroi dot më dhe tha me drujtje:

— Më falni, shoku Miltiadh, por më duhet të ngrihem. Kam ca punë.

— Ashtu?! — u vrenjt shkrimtari. — Mirë, shkon. Dhe dëgjo! Kur të kesh nevojë, m'i sill poezitë të t'i shoh.

— Faleminderit! — tha djali dhe nxitoi të zhdukej sikur të kishte dalë nga provimi.

Miltiadh Nerënxa u ngrit. Ndërkohë Kristo Shigjeta po kthehej zënë për krahu me pensionistin dhe kishin kaluar në bisedë gjuetie. Me sa dukej kishte qenë për të pirë kafe.

— Kristo, do të vazhdojmë studimin? — pyeti shkrimtari.

— Patjetër, — ia ktheu inxhinieri i hekuru-dhave.

Ata u kthyen në sallë dhe u përqendruan përsëri mbi veprat e tyre. Kishin kaluar kështu nga dy orë të forta studimi të përqendruar, kur Ajet Shkëmbi i pëshpëriti Alajdin Arbanës:

— S'do të bëjmë pak pushim?

— Natyrisht. Ja, t'u flasim edhe Miltos e Kristos.

Katër shokët dolën në korridorin e jashtëm të bibliotekës dhe ndezën aty nga një cigare. Kristo Shigjeta filloi të tregonte diçka interesante për lokomotivat angleze me avull të shekullit të nëntëmbëdhjetë duke theksuar se stadi aktual i arritjeve hekurudhore u detyrohej shumë atyre. Pas tij Ajeti bëri të njojur zbulimin e tij se gruaja e Shekspirit kishte qenë nja shtatë vjet më e madhe se i shoqi e megjithatë ata ishin martuar pas një dashurie tepër të fortë.

— Gjenive u lejohen të tillë gjëra, — tha shkrimtari. — Pikërisht gjérat e jashtëzakonshme janë simptomat e gjenialitetit.

Ata e kaluan diskutimin në jetën e gjenive të artit e të shkencës. Edhe një gjysmë ore studim u kishte mbetur kur në bibliotekë hym arkeolog Odise Gramshi. Ai ishte një burrë i shkathët, me shumë kulturë dhe flitej se gjatë verës kishte bërë diku pranë Plazhit të Akacieve, në veri të qytetit, një zbulim të rëndësishëm: një anije që i përkiste epokës bizantine, shekullit të gjashtë apo të shtatë.

Katër shokët e rrethuan menjëherë duke u interesuar për kërkimet e tij. Si pa u ndier pyetja pasoi pyetjen dhe mes atij rrathi intelektual me interesa të gjerë shkencore u ndez një diskutimi fortë për arkeologjinë. Nga anija e epokës bizantine vëmendja u zhvendos në pozicionin e qytetit në kohën para pushtimit romak,

në objektet e rëndësishme që fshiheshin ende nën dhe. Mes habisë së të gjithëve Miltiadherënxha tregoi se kishte lexuar diku për ekzistencën e një teatri të hapur në qytet në periudhën para pushtimit romak dhe ata filluan të bënin hamendje se ku mund të kishte qenë ndërtuar ky teatër. Varianti më i besueshëm mbeti ai i Kristo Shigjetës, sipas të cilit rrënojat e teatrit duhet të ndodheshin diku aty pranë bibliotekës.

Dalëngadalë akrepat përpinë edhe një orë tjeter. Kur katër shokët u kthyen në sallë, nuk mundën të qëndronin dot aty më shumë se dhjetë minuta, ngaqë bibliotekarja dha sinjalin e mbylljes. Pa u ngutur ata filluan të përgatisnin çantat e të stivonin librat. Pasi dolën jashtë duke shpirë ballin në pjesën midis vetullave dhe duke kërcitur damarët e qafave të lodhura nga përkulja, u nisën për të pirë nga një kafe te «Gjuetari».

— Moshë bën të vetën, — tha inxhinieri duke psherrur, — studimi ha filluar të na lodhë.

Të tjerët pohuan në heshtje.

me qëndrojnë e lindjeve të këtij vjeti. Më shumë se
një qipë më pështë se të jetë i saktë që dëshiron
të luftëzuar shqiptarët që përfunduan në përgjithësia
çdo o llogarë i saktë që përfunduan në përgjithësia
bështë përpjekja e komunizmit që përfundua me një
përfundim që nuk ka mundje që përfundua me një
përfundim. Averni i më i përsosur është që i
kryeza Shqipëria që e bështë i cili i konsideron e
dubrues që i ndihmon e gjithë qytetin e tij që
dhe që i kryeza që i ndihmon e gjithë qytetin e tij që
dhe që i kryeza që i ndihmon e gjithë qytetin e tij që
Fragmente nga ditari artistik

Tipikja! Sa nociion kompleks është ajo! Sa herë
e mashtron shkrimitar! Sa herë hyn në laboratorin
e tij krijues një tipike e gabuar, e huton
duke depërtuar në filtrin krijues, bile arrin të
dalë edhe në vepra të botuara. Lexuesi merr
një roman apo novelë dhe e sheh befas jetën të
shtremberuar. Atëherë ai ka të drejtë të thotë
i nervozuar: More, i kanë sytë në ballë këta
artistët apo jo?

Sot, edhe mua desh më ndodhi diçka e tillë.
Një tipike e gabuar deshi të më mashtronte, por,
falë filtrit tim të padepërtueshëm, ajo u spraps.
Në mëngjes hapa dritaren e studios dhe pashë
tek hynte në port një anije peshkimi. Lëvizte si
një udhëtar i lodhur nën qiellin e trazuar. Mbrë-
më tërë natën ka bërë një stuhi e lemerishme
dhe, kur mendova se në mes të saj peshkatarët
tanë lundronin përmbi dallgë, nuk durova dot.
U vesha me ngut dhe dola. Shkelja mbi pellgje,

Hyra në ndërmarrjen e peshkimit me rrëmbim. Roja u mundua të më ndalonte, por, kur i tre-gova kush isha, ai më tha: Më fal. Anija që pa-shë nga studioja apo ishte breguar në bankinë. Hyra në të dhe u shtrova mes peshkatarëve tanë të palodhur me idenë fikse për të shkruar një tregim të gjatë me titull «Stuhia». Bisedova rreth një orë me ta, mbajta goxha shënime, mbresa që vinin era det.

Por e papritura më ndodhi kur shkova në administratë. Pyes për anijen e sapombërritur, kur më thonë se ajo është shumë keq me planin! U shtanga. Dola dhe fillova të mendohesha duke u çapitur buzë detit: A është tipik një ekuipazh që nuk realizon planin? A përfaqëson ai punonjësit tanë të fronteve më të vështira? Nuk u lëkunda gjatë. Pavarësisht nga stuhia e përballuar, ai ekuipazh nuk është tipik dhe unë u ktheva në shëtëpi. Tregimin nuk do ta shkruaj. A më lejojnë lexuesit e mi ta jap jetën të shtrembëruar?...

Sot bisedova në telefon me shefin e redak-sisë së letrësisë për fëmijë dhe mësova se njëri prej recensioneve të romanit «Pushka e vjetër dhe krismat partizane» ishte kthyer. Së shpejti vepra do t'i nënshtrohet redaktimit. Trembem shumë se mos bjerë në duart e redaktor Arqile Vetëtimës. Ai është veteriner dhe jo njeri i botës së letrave. Jam grindur disa herë me të dhe inati është si puna e verës...

Përditë e më shumë gjithçka brenda meje po bie nën pushtetin e fuqishëm të idesë së ro-

manit tē ri me temē nga fshati. Mendoj vazhdimisht pēr tē. Linjat e subjektit mē shtrihen para syve si shinat e hekurudhës. E ndiej se ky roman do tē mē ngjisë nē Everestin e hierakisë letrare...

— Kusp i bështës këto fise qëndrues
— U t'is tifem se Millojaq i vlerësuar
nëpun vetëm zezë qëndruesuar mërtësuar është
Dogonë. Ai qëpës zëtë sëpë dë vës përgjigjet e
dheri te tijfet
— U t'i C'bo nis qëgjoljeve tëpshët
— Gjithasë sapë tashë dë Dogonë duhet te
ber e thonjën këtë qëz. Dhe ber te lëshet pë
vone.
— E keni qëllinat atë lirullin e lirapjorë
— Sparrë sparrë bëz qëllës...
Nga bisedat nëpër shkallët e pallatit

— E morët vesh? Dodona e pallatit përbri
po çmendet pas shkrimtarit të hyrjes sonë.
— Ua! E dashuron?!
— Tmerrësiht! Gjumi i natës nuk e zë.
— S'ka faj e shkreta! Miltoja është figurë
e madhe. Ndonjë vajzë mund të dashurohet
me të thjesht për lavdi e snobizëm.
— Thonë se edhe një aktore po luan mendsh
pas tij.
— Ka shumë mundësi.
— Po më ardhka keq për Sofinë. Kushedi
sa vuani.
— Kështu është kur e ke burrin të fam-
shëm. Të nxihet jeta nga xhelozia.
— E 'habitshme! Dhe kush, Dodona që du-
ket aq e urtë!
— Kam frikë se do të jetë ndonjë qyfyre
e kurdisur nga këta djemtë e lagjes.
— Në asnje mënyrë!

— Kush i përhap këto fjälë xhanëm?

— Unë them se Miltiadher Nerënxa i nxjerr namin vetes sikur dashurohet marrëzisht prej Dodonës. Ai është një snob që nga këpucët e deri te flokët.

— Уа! Ç'по на дëгjojnë veshët!

— Gjithsesi është fakt që Dodona duket të për e tronditur këto ditë. Edhe për të fjetur bie vonë.

— E keni dëgjuar atë titullin e famshëm:
«Shumë zhurmë për asgjë»?...

Ma pionneur n'a pas seulement été un pionnier à l'origine

The second map's Dohors & Bellotti begin

— K. B. BISHOP, AGENT, BOSTON, MASS.—

Journal of Bus
Econometrics 1971, 6

The original Chinese is better than a set of English translation.

— The following table gives the number of miles traveled by each state in 1890.

— 2 —

The following table gives the number of members of each club in the State.

S. S. Smith, Kinsley, Kansas

and the following year he was granted a patent for his invention.

—With a great many thanks to you —

1920 specification stat. 1000, 1921

which he can hold, such as a chair or a table.

→ Es müssen eigentlich die ersten Pioniere des Qua-

— Kewa tñrige se qo pe jœis abouje dñziric

and the following year he became a member of the Royal Society.

VIII

Misteri nisi në pallatin ku banonte Miltiadher Nerënxa. Filloi të flitej përditë e më shumë se një vajzë simpatike me emrin Dodona, e pallatit përbri, po qmendej pas tij dhe po dobësohej në mënyrë të dukshme. Pati nga ata që një fakt të tillë e quajtën të natyrshëm. Vajzat gjithmonë janë marrosur pas artisteve të mëdhenj sidomos kur këta kanë qenë burra të pashëm. Kuptohej që Dodona s'kishte mundur t'i bënte ballë adhurimit për shkrimtarin, një figure të tillë që njihej në qytet që nga fëmijët e deri te pleqtë dhe mbahej në gojë prej të gjithëve. Por edhe Miltiadher Nerënxa s'kishte mundur të qëndronte pa iu përgjigjur dashurisë së përvuajtur të saj.

Të bërë kureshtar, banorët e lagjes filluan të kërkonin detaje bindëse për këtë aventurë mes Dodonës dhe shkrimtarit. S'ishin të paktë ata që e kishin vënë re me kohë se dritarja e

studios së Miltiadher Nerënxsës dhe ajo e dhomës së Dodonës ndodheshin në një vijë jo dhe aq të pjerrët, kështu që komunikimi mes tyre mund të realizohej me lehtësi. Dihej se shkrimtari punonte deri vonë, por ndërkoħe edhe drita e Dodonës kishte filluar të fikej pas orës 12 ose 1. Ky detaj u provua me lehtësi nga disa gra tē lagjes. Bile njëra njoftoi se i kishte parë dy dashnorët duke bërë shenja tepér tē dyshimta. Pas këtyre fjälëve lidhjet mes Miltiadhit e Dodonës u bënë fakt i kryer.

Por vala e thashethemeve arriti kulmin kur filloi tē pëshpéritez se shkrimtari dilte natën nga shtëpia fsheħurazi. Se ku shkonte, kjo kuptohej me lehtësi. Ndérkoħe edhe dy detaje tē tjetra u shtuan pál vonesët nga djemtē e rinji tē lagjes: Miltiadher Nerënxa i kishte kushtuar së dashurës së vet njëzet sonete tē tipit sheksprian dhe një poemë tē gjatë me titull «O Venus i kétij shekulli», värgjet e para tē së cilës tē magjepsnin:

*Fjala e parë e dhjetëra e dhjetëra mëngjeseve,
fjala e fundit e qindra e qindra mbrëmjeve,
ëndrra lodhëse e tē gjitha netëve,
e shtrenjta ime ti!*

Ndërsa detaji tjetër i takonte një pusulle që Dodona i kishte dërguar gjeniut tē saj tē adhruuar dhe në tē cilën ishin shkruar pak a shumë këto fjälë:

Ditë pas dite e natë pas nate e ndiej gjithnjë e më shumë se nuk mund të jetoj dot pa dashurinë tuaj. Po nuk m'u përgjigjet, do të më shtyni në mënyrë të pashmangshme drejt vetëvrasjes.

Ju adhuroj marrëzisht, o Tolstoi im!

Thuhej se kjo pusullë kishte rënë në dorë të Sofisë, por pjesa më e madhe e grave të lagjes e hidhnin poshtë këtë variant duke u mbështetur në qetësinë e plotë të saj. Kuptohej se ajo nuk kishte marrë ende vesh asgjë për prapskenën. Në të tilla rrethana, një fqinjë e Sofisë që kalamajtë e thërrisin teto Bule, e prekur thellë nga sjellja imorale e Dodonës, mori guximin dhe iu hap shoqes me lot në sy:

— Sofi, shpëtoje Milton nga turpi... mos e lejo atë bishtdredhurën...

Sofia u mek e tëra.

— Bule, c'po më thua kështu?!

— Shpëtoje Milton nga Dodona, Sofi!...

— Dodona?!

Dhe teto Bulja ia tregoi gjithë ç'flitej në lagje për të shoqin, i cili ishte bërë viktimë e një femre ekstravagante. Sofia qau një copë herë, ndërsa teto Bulja e shoqëronte e prekur thellë e më thellë.

Dy ditë e dy net rrësht e shoqja e shkrimitarit e humbi fare. Një valë dyshimesh e mësynë. Disa herë kishte dëgjuar natën vonë lëvizje dyersh të papërcaktuara, dritaren e studios të të shoqit e gjente shpesh hapur, një natë ai kishte dalë nga shtëpia fshehurazi dhe i kishte

thënë se kishte qenë tek aktor Ajet Shkëmbi. Ç'donte ai tek Ajeti në atë orë? Veçanërisht gjatë Kohës që shkruante trágjedinë ai sikur ishtë ftohur ndaj saj. E tmerrshme, mendonte ajo. Në këtë moshë! Ah, Dodonë, moj shtrigë!

Natën e trefë Sofia e përgjoi si dedektiv dritaren e dhomës së Dodonës. Bulja kishte pasur të drejtë! Drita ësaj deri në një ndenji ndezur. Në mëngjes gruaja e shkrimtarit nuk ngurroi më. Më prit, Dodonë, mërmëriti me dhëmbë shtrënguar. Ta tregoj unë dashurinë ty!

Dodona ishte një vajzë e shëndetsëshme, afro të dhjetë kilogramë në peshë, shitëse kinkalie, begare, e cilë dalëngadalë po u afrohej të dyzetave. Ajo kishte qenë dy herë e fejuar dhe ishte ndarë sepse e tregonin tip shumë të zorshëm për tu marrë vesh.

Sofia hyri në dyqanin e saj në një çast kur s'kishte brenda asnë blerës. Dodona i buzëqeshi, por si përgjigje mori një shpullë që lëshoi në faqen e bëshme shkëndija elektrike.

— Dodonë, po guxove ta lako më burrin tim, dö të të djeg me vajguri! — tha Sofia, me një ton aq kërdënuesh, saqë tjetërë mend i ratë fikët dhe filloi të qante centrembur. Por se shoqja e shkrimtarit nuk e zgjati më. Me pamjen e një gruaje krenare që për burrin e saj mund të bëjë cdo lloj sakifice, doli nga dyqani. Në drekë, kur Miltiadhi Nerënxa u kthyesh në shtëpi, e gjeti të shoqen në një pikëllim të thellë, me lotët e tharë faqeve.

— Sofi, ç'ka ndodhur? — pyeti ai i tronditur. I cili i dorëzoi që

Befas ajo shpërtheu në të qara.

— Milto... i dashur... është e vërtetë se më ke... se më ke tradhtuar me atë... Dodonën?

Shkrimtari u shtang. As lajmi se pritej brenda orës një tërmët i fuqishëm detar nuk do ta kishte hutuar aq shumë.
— Sofi, ç'flet kështu?! Me cilën Dodonë të të kam tradhtuar?

— Me Dodonën e pallatit përbri.

— E kush ta tha?

— Njerëzit flasin.

Atij iu drodh gjithë kraharori.

— Sofi, si mund t'i besosh këto?! Si mund të të tradhtoj unë ty! Ty që më ke ndenjur gjithmonë pranë e je kujdesur aq shumë deri natën vonë. Të betohem, Sofi, që s'është e vërtetë. Unë nuk di asgjë për këtë Dodonë.

Ajo u hodh në krahët e të shoqit e lumtur.

— Shtriga, — mërmëriti, — i hap fjalët vetë që t'i dalë nami se bën dashuri me një shkrimtar të shquar.

Ndërkohë, mbyllur në dhomën e saj, Dodona qante me keqardhje dhelinat njëkohësisht. Me ç'të drejtë Sofia e kishte fyri ashtu panasnjë fakt? Gjithsesi ajo dyshonte se duhej të ishte ndonjë keqkuptim dhe se e shoqja e shkrimtarit do të vinte t'i kërkonte të falur. Por kaluan dy ditë dhe asgjë s'ndryshoi. Atëherë Dodona vendosi të pyeste nëpër fqinjë. Desh iu mbajt fryma nga çudia kur dëgjoi tërë ato thashetheme për dashurinë e saj, për shenjat nëpër dritare, takimet natën vonë, pusullat e fshehta, sonetet shekspiriane, poemën «O Venus

i këtij shekulli» e plot të tjera. Por pastaj e mbërtheu një valë aq e fortë inati, saqë dy djem të hyrjes së saj i hapën rrugë të trembur ndërsa po ngjiste shkallët.

Të nesërmen paradite, me të mbyllur kin-kalerinë në orën 11, Dodona u nis për në teatër dhe u ngjit drejt e në zyrën e libretistit. Ndërkohë Miltiadhi Nerënxa ishte përqendruar mbi një tragjedi të Korneit. Dodona hyri dhe, pa iu dridhur syri, si një amazonë, ia dëngjeshi atij me shpullë me sa i hante krahu. Shkrimtarit i shkoi koka anash.

— Ç’do të thotë kjo?! — pyeti ai me gojë hapur.

— Ju jeni një egoist! — thirri Dodona. — Një mashkull egoist. Mburreni se gjoja unë po qëmendem nga dashuria për ju, meqë jeni një shkrimtar i madh. Dëgjo, Miltiadhi Nerënxa, nëse unë rri deri vonë me dritë ndezur, e bëj këtë për të mësuar matematikë e kontabilitet, sepse ndjek shkollën e mesme ekonomike të natës. Kupton? Më mirë është të rrish deri në një duke zgjidhur ushtrime matematike, sesa të matufepsesh si ti duke shkruar ca psikopat-lleqe. Egoist! Unë më mirë pranoj të bie në dashuri me karrocierin e ndërmarrjes sime që po i afrohet pensionit sesa me një derdimen si ti. Mburravec!

Pas kësaj breshërie fjalësh Dodona doli duke e përplasur derën aq fort saqë suvaja anash u shkërmoq. Miltiadhi Nerënxa mundi të vinte në vete vetëm pas ndonjë ore. Çudi e madhe, mërmëriste herë pas here, çudi! Unë s’po

kuptoj asgjë në këtë mes. Me t'u kthyer në shtëpi, ai i kërkoj Sofisë që ta sqaronte edhe një herë me hollësi për ato që fliteshin nëpër lagje. Ajo ia riprodhoi të gjitha thashethemet detaj për detaj. Në fund ai u mbyll në studio dhe ra në mendime. Gjithçka ishte zhvilluar krejt pa dijeninë e tij.

Kur Miltiadħ Nerënxa ua tregoi ngjarjen e Dodonës shokëve tē tij tē ngushtë duke e qu-ajtur atē «Vajzé me emér tē huazuar nga mitologjia greke», ata nuk u habiten aspak.

— Ndoshta ajo vajzë të ka dashruar me
të vërtetë, — tha Alajdin Arbana. — Sigurisht
që të ka dashruar. Edhe një kolegia ime më
ka folur me shumë adhurim për ty.

— Pse aktore Iris Dajti a nuk ka dobësi për Milton? — shtoi Ajet Shkëmbi. — Në teatër të gjithë e kanë vënë re këtë.

— Lavdia e një artisti të madh nuk mund të konceptohet pa adhurimin e grave, — thirri Kristo Shigjeta duke rregulluar syzet mbi hundë. — Shembulli i Miltos e provoi edhe një herë këtë.

Unë, Miltiadhi Nerënxa, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve që nga viti 1965, autor i katër librave, i njëzet dramave, dhjetë pjesëve teatrale për kukulla, i shumë veprave në prozë e poezi, duke qenë i mbytur keqazi në punë, paraqes këtë kërkesë për leje krijuese që do të m'i lehtësonte ca rrrethanat.

Kërkesa e shkrimtar Miltiadhi Nerënxsës për leje krijuese për vitin 1986

Unë, Miltiadhi Nerënxa, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve që nga viti 1965, autor i katër librave, i njëzet dramave, dhjetë pjesëve teatrale për kukulla, i shumë veprave në prozë e poezi, duke qenë i mbytur keqazi në punë, paraqes këtë kërkesë për leje krijuese që do të m'i lehtësonte ca rrrethanat.

Kam në shqyrtim në shtëpinë botuese romanic «Pushka e vjetër dhe krismat partizane», jam në kriçim e sipër të tragjedisë historike «Liria do të kthehet përsëri» dhe në ripunim të vëllimit poetik «Fllade e stuhi», por qëllimi im kryesor është njojja e thellë e fshatit tonë të ri socialist për të cilin do të nis së shpejti një roman voluminoz. E ndiej të nevojshme njojjen e thellë të jetës së fshatit tonë me ndryshimet e shumta që ai ka bërë, ndaj më nevojiten të paktën dy muaj leje për të jetuar

e punuar atje, siç na porosit Partia. Ju lutem që leja të më shoqërohet me dieta, sepse kam llogaritur që shpenzimet do të jenë të konsiderueshme.

Besoj se nisma ime për të jetuar e krijuar në fshat do të mirëpritet e do të pasohet nga shumë të tjerë. Të mos mbetemi shkrimtarë zyrash, shokë! Të shkojmë atje ku vlonjeta!

Përhëndetje
Miltiadh Nerënxa,
prozator, poet e dramaturg

XI

te

edhur

ne

do

Desa

IX

Dalëngadalë tragjedisë «Liria do të kthehet përsëri» po i afrohej fundit bashkë me ditët e janarit. Miltiadher Nerënxa shkruante, prishte e rishikonte skenat e aktit të gjashtë, ngjarjet e të cilat shënonin rënien e kështjellës së Shkodrës pasi princi ishte mbytur në gjumë nga turqit e maskuar dhe princesha e tij ishte helmuar nga trishtimi i madh. Ky akt mbyllej me fjalët e një kështjellari trim, i cili në çastet e fundit të jetës u thërriste pushtuesve turq: «Ju vërtet e morët këtë kështjellë, osmanlinj, por kurrë s'do ta ndieni veten të qetë. Shpatat tonë do t'ju dalin edhe në gjumë për t'ju tmerruar.»

Më 25 janar, në orën një të natës, ndërsa Miltiadhi Nerënxa shkroi fjalën «fund» dhe e mbylli tragjedinë në një dosje të re, jashtë binte shi. Ai u afrua në dritare dhe vështroi qielin duke menduar për përblysjen e koncepteve që do të sillte vepra e tij në mendimin

teatral brenda dhe jashtë vendit. Befas sytë i shkuan nga dritarja e dhomës së Dodonës. Drita e saj ishte fikur. Kishte ditë që ajo fitkej pa kaluar ora nëntë e mbrëmjes.

Lajmi se Miltiadher Nerënxa e kishte përfunduar tragjedinë e tij historike me gjashtë akte u përhap në pallat e në lagje pa vonesë. Të gjithë kishin qenë vazhdimisht në tension përfatit e saj. Por, befas, ditën e parë të shkurtit, një lajm tjetër i tronditi burra e gra, djem e vajza: tragjedia kishte humbur pa as më të voglën shenjë. Dyshohej se ajo ishte vjedhur. Shkrimtari dhe e shoqja e kishin kërkuar në çdo pëllëmbë të studios dhe të shtëpisë, por më kot. Kjo është një fatkeqësi eskiliane, u shpreh një nga djemtë e pallatit.

Ata që e takonin tragjedianin ato ditë të para të shkurtit nuk u besonin syve. Ai e kishte humbur fare dhe fliste me vete. Kur e pyesnin për veprën e grabitur, përgjigjej me një zë të fikur:

— Akoma asnë gjurmë.

Mbrëmje për mbrëmje te Nerënxit mblidheshin fqinjët dhe diskutonin pa ndërprerë për tragjedinë e zhdukur sikur ta kishte rrëmbbyer ndonjë fantazmë. Në këto diskutime jepeshin mendime nga më të ndryshmet, por asnjeli nuk e qetësonte dot shkrimtarin. Ndërkohë disa ziliqarë e njerëz pa kulturë filluan të pëshpërisnin se ai s'kishte shkruar kurrë ndonjë tragjedi dhe gjithë atë zhurmë e bënte për t'i rritur lavdinë vetes. Por këto pëshpërima u mbytën shpejt.

Kur Miltiadħ Nerënxa u tregoi shokëve tē tij tē ngushtē pér mynxyrēn e tragjedisē, ata u hidhruan jashtē mase.

— Në goftē se e ka marrē dikush pér ta kopjuar, — tha i pari Alajdin Arbana, — ky do tē ishte një veprim tmerresisht i ulёт.

— Vetém një buf mund ta bënte këtë gjë, — e pasoi Kristo Shigjeta. — Miltoja ka plot dëshmitarë që tragjedia është e tij.

Ajet Shkëmbi tundi kokën.

— Unë i trembem tjetër gjëje. Milto, a ka njerëz në lagje që tē kanë inat?

— Nuk e besoj.

— Kam frikë se veprën do ta kenë zhdukur pér punë hakmarrjeje. E tmerrshme! Kush e shkruan edhe një herë gjithë atë tragjedi! Unë mezi po prisja që tē filloja përgatitjen e rolit tē princit.

Befas Miltiadħ Nerënxs iu kujtua Dodona. Ajo duhej ta urrente jashtē mase. Po sikur tē kishte shtyrë ndonjë njeri pér t'i grabitur tragjedinë? Në goftë se kishte ndodhur kjo, vepra s'do t'i kthehej më kurrë në duar.

— Në goftë se tragjedia është zhdukur pér hakmarrje, ky do tē ishte një krim ndaj artit, ndaj teatrit kontemporan, — tha Kristo Shigjeta.

— Unë kam besim se tragjedia do tē gjehet, — foli i menduar piktori. — Kurrë s'ka ndodhur që tē grabitet një shkrimtar i madh.

Atë mbrëmje ata u ulën tē katér nē bufe «Gjuetari» dhe ndenjën deri vonë duke diskutuar pér fatin e tragjedisë.

Kishte kaluar një javë nga zhdukja e misterishme e tragjedisë kur befas Sofia u kujtua për Ernestin që ndodhej me fakultetin në stërvitje ushtarake në Mamuras. Dosja kishte humbur një ditë pas nisjes së tij. Ky fakt dihej mirë. Burrë e grua e morën menjëherë djalin në telefon.

— Ernest, ka humbur tragjedia e babit, — foli e éma me zë të ngashëryer. — Mos e ke marrë ti me vete?

Nga ana tjeter e telefonit erdhi një e qeshur.

— Çne, moj mama! C'e desha unë tragjedinë me vete?!

— Po ku u zhduk dosja?

— Dosja është në shtëpi, jam i sigurt. Por tani vendin s'e mbaj mend .

Ata të dy u kthyen në shtëpi më të qetë. Kontrolluan edhe një herë qoshe më qoshe, por misteri vecse u shtua. Enigmë, mërmëriste Mil-tiadherë Nerënxa duke vështruar rrötull. Enigmë e madhe. Edhe një javë tjeter ai ndenji në ethe deri sa i biri u kthye.

Ernesti e kishte harruar fare bisedën telefonike dhe prindërit u detyruan t'ia kujtonin zhdukjen e tragjedisë.

— U, — ia bëri Ernesti, — ajo dosja e re! Po, e kam parasysh. Ishte në studio. Unë e mora të lexojaca faqel që të më zinte gjumi se babai e ka shkrimin të imët dhe më lodh shpejt.

— Ernest, ti je njeri antiart! — thirri Mil-tiadherë Nerënxa. — Turp kush e merr vesh se koka jote vazhdon studimet për letërsi.

— Ti më dërgove për gjuhë — letërsi, — ia ktheu i biri. — Unë s'desha. Ajo gjuha po ma nxin jetën!

— Ernest, vazhdo, — ndërhyri Sofia. — E more dosjen. Pastaj?

— Erdha në krevat, u shtriva. Dosja duhet të jetë këtu në krevat, Ah, po! Pa shiko poshtë dyshekut, mama.

Sofia e ngriti dyshekun me vrull dhe mbi sustë zbardhi dosja e tragjedisë.

— Eh, e futa se më rrinte koka ulët, — tha Ernesti. — Ti e di, mama, që më dhemb zona e trurit të vogël kur fle me kokë në nivelin normal.

— E di, bir, e di. Milto, e gjetëm më në fund!

— E gjetëm, Sofi! — psherëtiu ai i lehtësuar. Megjithatë ti, Ernest, mbetesh një përqmues i teatrit.

— Ka mundësi, baba, — ia ktheu i biri duke iu hapur goja.

Pas tërë asaj zhurme në pallat e në lagje për humbjen e tragjedisë ishte e pamundur që të tregoheshin rr Ethanat në të cilat ajo u gjet. Për të dhënë njoftimin e gjuar, Miltiadher Nerenxa me të shoqen përpunuani një variant tjetër, si pas të cilit dosja e tragjedisë ishte marrë gabimisht në vend të dosjes së romanit «Pushka e vjetër dhe krismat partizane» nga një kushëri i tyre që banonte në Laç. Të lehtësuar, fqinjët ia mbërritën për t'i uruar.

Pa vonesë shkrimtari filloi daktilografimin e tragjedisë duke planifikuar që nga fundi i marsit ta dorëzonte atë në komisionin artistik të teatrit, kurse një kopje t'ia jepte Ajet Shkëmbit për të filluar përgatitjen e rolit të princit.

pa-de ed t'ë skuzojnë që përcaksh të kryjnë ofrata tu jashtme.

— Tu kusova. Po, kjo e gjente që keni bërur atë që dolet tu kryesohet?

— Ma nuk e kide Ajetin. Ajetin e kane bërë këtë qëdo e bëj me këtë qëdo. Nuk ka kryer këtë qëdo.

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Nëse nuk e merrit këtë qëdo. — Tu nuk e keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Duket se është këtë qëdo. — Tu keni bërë këtë qëdo?

— Nëmijë përitëzish qëndrueshëm e vërtetës së
tum i lumit që më vulljaqë mështë bëhet
është këtia — nuk mund që po mështësh si tash
të mështësh. Ajet! Po që i llojeve të përkohshme
foton, kështu si qëllim që mështësh si tash
të mështësh.

Fragmente bisede në studion e piktorit

— Po na çudit, Alajdin! Ç'ndryshime i paske
bërë tablosë! Të lumtë, për nder! E ke dorën
flori! Dimensionet i paske ruajtur po ato. Bu-
kuri! Zmadhimi i tepruar e dëmton vërtetësinë.

— Pikërisht këtë mendova edhe unë.

— Po punëtorë sikur ke shumë më duket,
katër në ballë dhe pesë të tjerë më prapa.

— Po ti vetë i kërkove që t'i shtonte pu-
nëtorët!

— Mos u ngut, Ajet. Idetë ndryshojnë, ato
s'janë të ngurta.

— Unë do të dëshiroja që në qendër të ta-
blosë të ishin tre punëtorë, dy burra dhe një grua
në mes. Kështu vepra do të ishte më harmo-
nikë.

— Vërtet, Milto?! Po ti shprehe idenë që
burrat me gratë të barazohen.

— Artdashësi ynë e nënkupton këtë pavarë-
sisht nga raporti burrë-grua në vepër.

— Taksiratet e Alajdinit!

— Më vjen keq, Ajet, — jashtëzakonisht. Sugjerimet tuaja unë i mirëpres. Veprën mund ta ndryshoj përsëri.

— Atëhere ngjyrat e ndezura zbuti ca, se pse do të të akuzojnë që përpinqesh të krijosh efekte të jashtme.

— Të kuptova. Po pjesa e qytetit që kam futur si të duket ty Kristo?

— Më mirë hiqe, Alajdin. Ajo sikur ia zbut tonet madhore veprës me lirizmin e saj. Duhet të mbizotërojë plotësisht kantieri.

— Dakord! Edhe unë dyshoja për këtë.

— Veç mos u mërzit, Alajdin.

— Bah! Ç'është ajo fjalë!

— U mblozhëm këtu në studio përsëri, veç në oficinën time nuk po vini. Mos vallë nuk ju interesojnë lokomotivat më avull?

— Ç'është ajo fjalë, Kristo!

— Po kur do të vini pra t'i viziton?

— Do të vijmë së shpejti, mos u mërzit. Ja, sa, të shtrohet koha.

Fragmente nga ditari artistik

... Bota e madhe e fëmijëve tanë! Sa e larmishme është ajo! Sa spontane dhe e singertë! Një shkrimtar i madh detyrimisht duhet të shkruajë për fëmijët. Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë ai nuk e ka njojur jetën plotësisht.

Ja se ç'gjë interesante më ndodhi sot ndërsa dola në dritare: Në sheshin para pallatit një grup vajzash po luanin topaluftash. Befas, një djale dymbëdhjetëvjeçar hyri mes tyre si tiran i vërtetë dhe ua prishi lojën duke thënë.

«Mjaft na krakavitet tani! Ikni se do të luajmë ne çuñat futboll.»

E vështrova me kujdes dhe e njoba. Ishte Albani, një djale i pallatit përballë. Kjo monstër, me një kokë të madhe me cepa, me ca fokë të ashpër si furçë këpucësh, me një zë të ngjirur e me një pamje prej kapadaiu, është tmerri i kalamajve të lagjes. Të gjithë ankohen prej tij. Vajzat u detyruan ta linin lojën. U

futën në hyrjen e pallatit përballe dhe filluan
të shanin të revoluara:

«O Alban kokëmadhi! O katranjos! O shkata-
rraq!

«Ikni se ju erdha!» — u hakërrua Albani.

Befas, një vajzë thirri me inat:

«O Izrael!»

«O vegël e imperializmit!» — e pasoi një
tjetër.

Albani vuri duart në bel.

— «Si! Mua më thoni Izrael dhe vegël e im-
perializmit?! Mua që e kam babanë komunist
dhe gjyshin e kam pasur partizan?»

Unë qesha me të madhe në dritare. Sa të
zgjuar janë fëmijët tanë! Sa humor të natyrshëm
që kanë! Papritur më lindi ideja për të shkruar
një novelë të gjatë ose roman për ta. Në qendër
do të jetë Alban «Izraeli» dhe shoqëria e tij
në lagje. Ja shkurtimisht linja kryesore:

Albani bëhet problem në lagje e në shkollë.
Fajet e tij pasojnë njëri-tjetrin dhe me mësime
shkon keq. Kulmi arrin kur ai plagos një shok
në sy. Alarmohen të gjithë. Bëhen një sërë mble-
dhjesh kolektivi. Këtu nis kthesa e Albanit. Ai
urtësohet si qingj dhe u hyn mësimeve me vull-
net të shumëfishuar. Titulli i novelës ose romanit
do të jetë: a) «Mes shokëve» b) «Forca e kolek-
tivit» ose c) «Kthesa»...

Nesër ose pasnesër do të nisem për në shtë-
pinë botuese. Po më ndjek tersi. Romani «Pu-
shkë e vjetër dhe krismat partizane» ra në du-
art e redaktorit vandal, Arqile Vetëtimës. Asgjë
të mirë nuk pres prej tij. Gjithsesi do të di ta
mbroj veprën time nga sëpata e tij barbare...

zgjedhur qëndrueshme që më i cili është
një fragment i shkëputur nga romani
«PUSHKA E VJETËR DHE KRISMAT
PARTIZANE», KAPITULLI «SULMI MBI
AUTOKOLONËN NAZISTË».

**FRAGMENT I SHKËPUTUR NGA ROMANI
«PUSHKA E VJETËR DHE KRISMAT
PARTIZANE», KAPITULLI «SULMI MBI
AUTOKOLONËN NAZISTË»**

... Më në fund autokolona naziste si një gjarpër i zi hyri në grykë. U dëgjua një breshëri automatiku. Sinjali ishte dhënë. Një shi i dendur plumbash shpërtheu mbi makinat e pushtuesit. Gjermanët filluan të paloseshin njëri pas tjetrit duke thirrur të lemerisur në gjuhën e tyre të pakuptueshme.

Mihali, partizani më i vogël i kompanisë, s'duroi dot më. Me pushkën e vjetër të gjyshit ai u vërvit mes gjermanëve. Pasi vrau një toger të shëndoshë, i rrëmbeu atij automatikun dhe filloi të bënte kërdinë sa majtas e djathtas. Befas vuri re se një ushtar i plagosur nxori nga brezi një revolver dhe u mat të vriste komandantin e kompanisë që po u thërriste shokëve për sulm. Mihali u sul si një shqiponjë

mes plumbave, iu hodh gjermanit sipér dhe ia rrëmbeu revolverin nga duart.

— Na, mor derr i Hitlerit, — i thirri dhe ia zbrazi mu në ballë. Gjaku shpërtheu nga koka e gjermanit si shatërvan. Mihali nuk priti më. Me automatikun dhe pushkën në duar, me revolverin në brez, u turr pa iu dridhur qerpiku pas një grupi gjermanësh që po përpinqeshin të largoheshin duke u fshehur nëpër kaçuba. I arriti ata pa vonesë dhe pas një përleshjeje të ashpër i asgjësoi të gjithë.

Dalëngadalë në xhade u rikthye qetësia. Shtrirë në asfalt kishin mbetur mbi pesëdhjetë gjermanë, ndërsa nga kompania vetëm partizani azgan, Xhelo Kanina, ishte plagosur në krahun e djathë. Mihali e vështroi pushkën e vjetër të gjyshit i mallëngjyer, pastaj e puthi.

— Beteja tē tjera na presin, moj pushkē — top, — tha duke vështruar larg nē horizont...

X

Ndoshta asnje shkrimtar, poet, dramaturg, përkthyes, letrar i ri, redaktor, recensues, korrëktor, në përgjithësi asnje njeri i botës së madhe të letrave, nuk i kushtonte aq shumë rëndësi hyrjes në shtëpinë botuese sa autori Miltiadher Nerënxa. Ato çaste ishin vendimtare përtë, zeniti i kënaqësisë që të sjelljeta krijuese, të cilin pakfush ka fatin ta provojë. Ata pak hapa mund të sillnin përbysje në historinë e letërsisë.

Hyrja e shtëpisë botuese atë mëngjes shkurti ishte e qetë. Miliadh Nerënxa u afrua me një hap të shtruar, me një pamje të menduar, duke tundur paksa çantën e madhe, të zezë. Vetëm balli i tij i rrudhur sfidonte pamjen e dhjetë shkrimitarëve të përbotshëm marrë bashkë.

— Shok, ku shkoni ju? — u dëgjua një zë vajze. Ishte një ezmere me sy të shndritshëm që bënte dezhurnin.

Miltiadħ Nerënxa buzëqeshi me një ironi carmatosése.

— Lart, nēpér redaksi, — tha pa e vësh-truar ezmeren. — Mē duket se këtu nuk ēshtë Klubi i Gjuetarëve.

— Si ju quajnē, ju lutem? Ai u dha flokëve lart me gjestin e vet tē prerë.

— Unē jam shkrimtar Miltiadħ Nerënxa.

Pas ketyre fjalëve ezmerja hapi paksa sytē, pastaj vështroi anash si me siklet duke mërmëritur:

— Nē rregull... nē rregull... mund tē shkoni. Habi, ia béri me vete Miltiadħ Nerënxa, si i mbajnē nē institucione tē tillé njerëz që s'janē fare nē korrent tē jetës letrare. Ai mori sipér shkallëve me nge. Nē katin e dytë u ndal ca para një stende tē madhe ku ishin vendosur kopertinat e botimeve mē tē fundit.

Ndérkohé një korrektore simpatike dhe një përkthyese e re hynë me ngut nē një nga zyrat e redaksisë së fëmijëve ku punonin Arqile Vëtëtima dhe një redaktore tjetër.

— Arqile, erdhi ai! — thirri korrektorja. — Ai tipi! Firma Nerënxa! Aman kurdise ca se kemi kaq ditë pa qeshur!

— Arqile, si e di vetë, — tha përkthyesja. — Na e hiq mérziné.

Kur dëgjoi fjalët «firma Nerënxa», Arqile Vëtëtima ia ngjeshi ballit me dorë sikur nē shtëpinë botuese t'ia kishte mbërritur ndonjë tigër i frikshém.

— Bo bo! — ia béri ai me siklet. — Ma mérziti profesionin ky njeri. Ēshtë e katra herë

që më sjell një me demek roman. Mirë e keni, vajza. Kësaj here do ta përcjell përfundimisht, S'duroj dot më. Ju hapni ndonjë libër aty dhe kujdes, mos më zbuloni.

Ndërkohë Miltiadher Nerenxa mori përmes korridorit të katit të katërt pa lëshuar asnjë përshtendetje majtas edjathtas, u afroante dera 102 dhe hyri pa trokitur. Vështrimi i tij zhbirues ashtu si ai i shqiponjës mbi prenë, u ngul drejt e në fytyrën e redaktorit. Tjetri hapi krahët dhe buzëqeshi miqësisht, por shkrimtariv s'ishte nga ata që mashtrohen. Buzëqeshja ishte krejt false. S'kishte pse shpresonte më Romani do t'i ia kthehej. U ul i heshtur. Kolegja e Arqile Vetëtimës i buzëqeshi ëmbël. Të njëjtën gjë bënë edhe dy vajzat e tjera që ishin përkulur pranë saj. Ai tundi paksa kokën.

— Hë, Milto, keni ardhur të bisedojmë për romanin, ë? — tha Arqile Vetëtima me gjallëri. Mirë e bëre.

— Sikur të pinim një kafe? — e ftoi Miltiadher Nerenxa duke e ditur se ftesa ishte e kotë.

— Faleminderit, — ia ktheu redaktori. — Do të bisedojmë një herë.

— Mirë. Fillojmë. Arqile Vetëtima i dha fytyrës një pamje serioze.

— Në përgjithësi romani juaj është shkruar me frysëzim, me shumë ndjenjë, koha e luftës duket se njihet me hollësi. Figuracioni juaj i dendur meriton vërtet respekt. Vepra ka qartësinë e netëve të verës.

Miltiadher Nerenxa picërrroi sytë. E dinte se pas këtij rrezatimi të shkurtër lëvdatash do të

pasonte rrebeshi i vërejtjeve. Nuhatja nuk e gahonte. Dhe vërtet, pas një pauze të shkurtër, Arqile Vetëtima shtoi si me keqardhje:

— Megjithatë, i dashur Milto, romani vuani keqazi nga fragmentarizmi. Fëmijët i lodh shumë fragmentarizmi. Apo jo?

Shkrimtari tundi kokën.

— Nuk mund të jem dakord. Se si e shkruaj romanin, ajo është puna ime. Vepra ime është shkruar me teknika bashkëkohore, por me sa duket ju nuk e keni vënë re ose... ose nuk i njihni këto teknika.

Redaktori u shtir i turpëruar.

— Tani, shoku Milto, kuptohet, kultura ime s'mund të krahasohet me tuajën. Mosha, gjuhët e huaja që zotëroni ju kanë çuar shumë xhiro para. Unë ju heq kapelën për horizontin e gjerë, megjithatë...

Ndërkohë vajzat që ndodheshin në zyrë e dhanë sinjalin e parë. Ato nxorën si me lezet shamitë dhe i vunë para gojës duke kafshuar fillimisht buzët.

— Tjetër, — vazhdoi Arqile Vetëtima. — Vepra juaj ka karakter biografik. Nuk arrindot në përgjithësim artistik.

— Nuk jam dakord! — thirri shkrimtari. Aspak! Ju po më trajtoni si një diletant.

— Veç këtyre, — shtoi redaktori, — në vepren tuaj ka edhe gabime të shumta drejtshkrimore e gramatikore.

Miltiadhi Nerënxa brofi në këmbë dhe ia ngjeshi tavolinës me grusht. Letrat e shumta dhe mjetet e shkrimit të Arqile Vetëtimës kercyen përpjetë si me ankim.

Digat e shamine arritën ta përballonin shpërthimin e parë të lumit të të qeshurave të tri vajzave. Ato u përkulën edhe më mbi një fjalor të madh.

— Si guxoni! — thirri shkrimtari — Si guxoni të përgojoni bagazhin tim gjuhësor?

— Më falni, por ky është një fakt.

— Mua veprat m'i daktilografojnë sekretaret e teatrit dhe për gabimet e tyre le të përgjigjen ato.

— A, në qoftë kështu, ndryshon puna. — U duk sikur gjendja u qetësua. — Edhe diçka, — vazhdoi Arqile Vetëtima. — Bile e meta më e rëndësishme që e zbeh madhështinë e luftës në romanin tuaj. Vriten shumë armiq dhe vetëm një partizan. Duhej të ishin vrarë të paktën tridhjetë partizanë dhe njëzet të plagoseshin rëndë.

Miftiadhi Nerënxa brofi rishtazi në këmbë.

— Se sa do të vriten dhe do të plagosen, atë e di unë. Unë kam mbledhur të dhëna gjore nëpër veteranë.

— Me këto rrethana romani është i pabotueshmë, — dhe Arqile Vetëtima u ngrit në këmbë.

— Ju jeni redaktor skematik! Ju po më imponoheni!

— Romani juaj është një skemë e gjallë, e vjetëruar!

— Kurrën e kurrës! Unë jam autori dhe do të mbrohem nga gustoja juaj konservatore!

Ndërkohë dikush u mat të hynte në zyrë, por, kur pa Miftiadhin e Arqilenë në këmbë, u spraps mejëherë.

— Kam edhe vërejtjen e fundit, — tha redaktori duke u mbushur me frymë. — Heroi juaj kryesor është shumë i ngathët. Kur del partizan, ai duhet të hakmerret ndaj beut të fshatit, të paktën t'i djegë mullarët e sanës. Kur të kthehet nga lufta, duhet ta vrasë beun fare.

— Dëgjo, Arqile Vetëtima, romani është pjella ime dhe do të mbetet ashtu siç dua unë! Mullarët nuk i djeg! Beun nuk e vras!

Pas këtyre fjalëve qe redaktori që ia ngjeshi tavolinës me grusht.

— Mullarët duhen djegur dhe beu duhet vrarë!

— Kurrën e kurrës!

— Atëherë as mos u mundo ta ripunosh romanin.

Në këto e sipër Miltiadher Nerënxa mori pamjen e një njeriu tepër të prekur d'he tha me një ton dinjitoz:

— Veprën do ta marr fare. S'pranoj që ajo të masakrohet në këtë mënyrë. Bjereni! S'dua të bisedoj më me ju. Jeni tepër anadollak!

Me gjithë shtrëngimin e mundimshëm, diga e shame para gojëve të vajzave nuk mundi të qëndronte dot më. Të qeshurat shpërthyen me zhurmë tamam si ai lumi kur del nga shtrati. Por Miltiadher Nerënxa ishte aq i nxehur, saqë s'vuri dot gjë re. Ai rrëmbeu dosjen e romanit dhe e përplasi në çantë me inat.

Hapi derën dhe ndërkohë vuri re se në korrider ishin mbledhur një grup punonjësish të institucionit. Ata ia ngulën sytë pa e fshehur habinë. I ndodhur në ato rrethana, shkrimitari iu kthye redaktorit duke e ngritur zërin edhe më shumë.

- Jeni një njeri i paaftë dhe veprën time as që meritoni ta prekni me dorë!
- Kurse ju jeni ngatërruar kot me letërsinë!
- Arqile Vetëtima u dha në prag të derës.
- Redaktor mizor!
- Autor grafoman!
- As që dua të t'i shoh më sytë. Tredhës kryeveprash!
- Ik, mor i falimentuar!
- Shko, mor Cerber i portës së talenteve!
- Dije pra: pa vrarë 30 partizanë, pa plagosur 20, pa djegur mullarët e beut dhe pa e vrarë fare, veprën mos u mundo ta sjellësh më!
- Pa dalë ti në pension, as që do të vij më këtu! Asnjë partizan më shumë nuk vras! As mullarët s'do t'i djeg dhe beun do ta lë të gjallë se më duhet për vëllimin e dytë. Unë nuk i nënshtrohem skemës sate!

Duke thënë këto fjalë, Miltiadher Nerënxa çau me kokën lart nëpër korridor i ndjekur nga vështrimet e punonjësve që kishin dalë nëpër dyer dhe nuk kuptohej për ç'arsye nxirrrnin me ngut shamitë për t'i vendosur para gojës.

— Më në fund shpëtova! — psherëtiu Arqile Vetëtima. — Sikur hoqa nga barku një tumor pesëkilësh. Uf! S'kisha rrugë tjetër. Vetëm kështu mund ti largosh këta tipa.

Ndërkohë në zyrën e tij tri vajzat vazhdonin të qeshnin me të madhe duke mbajtur barkun me dorë e duke u munduar nga lemza. Dikush u solli me ngut një broke me ujë.

— Uf! — rënkoj korrektorja simpatike. — Për këtë muaj nuk dua të qesh më.

XI

Një ekspozitë e rëndësishme lokale pritej të hapej nga mesi i marsit. Më në fund, pas shumë lëkundjesh, piktor Alajdin Arbana kishte vendosur të paraqiste në të tablotë e vet kompozicionale «Përpara për fitore të reja» për të cilën po punonte që prej dy vjetësh duke i bërë ndryshime njërin pas tjetrit. Ditët e fundit të shkurtit, në studion e njohur të tij, drita kishte filluar të shuhej vonë, bile banorët aty rrötull e kishin parë ndezur deri në mëngjes. Të gjithë ata që interesoheshin sadopak për piktorin e kishin marrë vesh se ai po përgatitej për të fituar një çmim të majmë.

Një mbrëmje të shtune me shi katër shokët e ngushtë ishin mbledhur në studion e Alajdinit si shpeshherë kur bënte kohë e keqe. Ajo seli artistike zinte një sipërfaqe afro njëzet metra katorë dhe mund të gjeje në të sende të cdo lloji të vendosura rrëmujë, duke filluar që

nga dërrasat e shishet e duke përfunduar te librat e revistat. Këtë çrregullim të studios shumë veta e motivonin me natyrën e vrullshme dhe të përqendruar prej artisti pasionant të Aladdin Arbanës. Këto veçori pasqyroheshin edhe në veshjen e tij, tek e cila gjithmonë do të gjeje ndonjë të metë. Nëpër mure ishin vendosur vepra të piktorit nga më të hershmet deri te më të fundit ku vendin kryesor e zinin peizazhet nga deti. Këto peizazhe kishin një vrazhdësi që të trempte dhe ca ngjyra të theksuara, por këto veçori shkrimtari Miltiadhi Nerënxa i shpjegonte me ndikimin e fortë të pasimpressionistëve. Mes peizazheve të shumta binin në sy tablo që paraqisin njëra një fonderi dhe tjetra një lëmë ku shihej gruri. Kristo Shigjeta i quante kryevepra këto dy tablo dhe faktin që ato s'ishin pranuar në dhjetë ekspozita radhazi, një gomarillëk. Kohët e fundit Alajdin Arbana kishte hyrë në bisedime me një kushëri të gruas, shef tregtë në rrethin e Mirditës, që tablotë e tij të bliheshin për pasticeritë e reja të fshatrave. Për aktor Ajet Shkëmbin kryevepra e Alajdinit ishte një portret vajze, të cilin ai e vinte në një nivel me madonat e Rafaelit. Atë portret piktorit ia kishin kthyer mbrapsht pesë komisione për të njëtin motiv: nuk shprehte mendimin artistik.

Në qendër të studios, mbi një kambalec të madh, ishte vendosur tabloja kompozicionale «Përpara për fitore të reja» me format 2,5 me 2 metra. Shumë vizitorë të ftuar apo të rastit që e kishin parë atë ishin magjepsur, ndonëse vepra ende s'ishte përfunduar. Pothuaj tre të katërtat

e tablosë e zinin anijet, slipet, shkallët metalike, qelli e deti, ndërsa në pjesën ballore dalloheshin dy punëtorë dhe një punëtore që diskutonin për një projekt. Punëtorët kishin krahië herkulianë dhe gjokse prej Muji e Halili. Me tërë pamjen e tyre ata tregonin se s'kishte vështirësi që të mos e mposhtnin. Edhe punëtorja s'mbeste prapa nga zhvillimi fizik, por në fytyrë i lexohej më shumë një zgjuarsi intelektuale.

Hipur mbi një shkallë të ulët, veshur me një përparëse doku të gjatë, me një penel në dorë, Alajdin Arbana po vendoste vrullshëm njolla të kuqe aty-këtu për të dhënë reflekset e saldatriçeve. Ulur në një stol të gjatë, me pamje akademikësh, shkrimitar, Miltiadher Nerënxa, aktor Ajet Shkëmbi dhe inxhinieri i hekurudhave e përkthyes Kristo Shigjeta, ia kishin ngulur sytë të menduar tablosë si specialistë që kanë kaluar nëpër dhjetëra galeri e muze.

— Alajdin, — foli shkrimitari duke u ngritur në këmbë, — do të më lejosh një vërejtje?

— Me kënaqësi, i dashur, — ia ktheu piktori.

— Qiellin kaltëroje më shumë. Qielli ynë është gjithmonë i pastër.

— Ka të drejtë Miltoja, — tha aktori. — Edhe deti duhet të duket më i gjzuar, më me dritë, të krijojë idenë e fitoreve të mëdha.

— Keni të drejtë, — miratoi piktori. — Ti, Kristo, ç'mendon?

Inxhinieri i hekurudhave dhe përkthyesi i poezisë botërore rregulloi syzet mbi hundë.

— Unë do të doja, Alajdin, që punëtorët t'i kishin krahet, linjat e muskujve edhe më të theksuara. Punëtori ynë është i fuqishëm, i shë-

ndetshëm, jo si punëtori teknefez që shfrytëzohet nga kapitalisti deri në palcë.

— Bukur! — ia bëri shkrimtari. — Sa mendim i bukur!

— Edhe unë jam dakord, — tha Alajdin Arbana. — Tërësisht.

— Tjetër, — vazhdoi Kristo Shigjeta, — a s'do të ishte mirë që krah u i punëtorit të majtë, i cili ndodhet disi pas punëtores, të vendoset mbi supet e saj? Pse, do të pyesni ju. Me funksion ideor, për të theksuar se mes punëtorëve e punëtoreve tonë ka miqësi e shoqëri të shëndoshë.

— Pu-pu, ç'gjetje! — thirri aktori. — Kristo, ti je vërtet një mitër idesh. Si të shkoi mendja, ë?

— Jashtëzakonisht interesante! — tha piktori.
— Do ta zbatoj patjetër.

Kristo Shigjeta buzëqeshi i përkëdhelur në sedër.

— Kisha edhe diçka të fundit, — shtoi pastaj. — Pse punëtori i djathtë të mbajë një cigare të ndezur në dorë? Cigarja tregon se ai është pesimist, i mbytur në halle, kurse punëtori ynë zien nga optimizmi dhe njeh veç gjëzime. Apo jo?

— Ashtu është, — e mbështeti Miltiadhi Nërenxa. — Cigarja është polivalente në kuptim si metafora, lë shteg për diskutime.

— Dakort, cigaren po e heq, — pranoi Alajdini.

— Alajdin, të të sugjeroj edhe unc diçka?
— tha Ajet Shkëmbi.

— Natyrisht, i dashur.

— Po sikur në tablo të shtoheshin edhe ca anije? Kjo do të tregonte se ne s'mbetemi prapa vendeve të tjera për prodhim anijesh. E?

— Edhe unë ashtu mendoj, — tha shkrimtari.

— Do ta kem parasysh edhe këtë, sigurisht.

Pasi ata i dhanë një listë të tërë me vërejtje e sugjerime, në bazë të të cilave duhej ndryshuar përsëri afro shtatëdhjetë për qind e tablosë, Alajdin Arbana zbriti nga shkalla i lodhur.

— Vërtet u vonove, Alajdin, — shtoi aktori, — por ama nxore një kryevepër.

— Kryeveprave gjithmonë u është nevojitur shumë kohë; — shtoi shkrimtari.

Rreth orës nëntë, kur shiu u duk se pushoi, tre miqtë akademikë u ngritën për të dalë. Piktori i përçolli. Nuk pranoi të kthehej në shtëpi aq herët. Atë natë dhe një javë tjetër rrësht pas saj ai e ripunoi tablonë duke u mbështetur në vërejtjet e sugjerimet e reja të shokëve dhe më në fund, me një besim të palëkundur, ia dorëzoi komisionit.

Lajmin e pranimit të tablosë në ekspozitë Miltiadher Nerënxa, Kristo Shigjeta e Ajet Shkëmbi e morën një mbrëmje në bufenë «Gjuetari», ndërsa po e prisnin me ankth kthimin e Alajdin Arbanës nga galeria e qytetit. Ai hyri në lokal buzagaz.

— Veprën ma pranuan. Ekspozita hapet më datën 17.

Shokët i shtrënguan dorën me radhë.

— Do ta pranonin me sy të plasur, — tha shkrimtari. — Tani, a ta festojmë haberin?

- Detyrimisht, — shpértheu Alajdin Arbana.
— Kamerier, na sill verë!

Mbrëmjen e 17 marsit në galerinë e arteve figurative të qytetit amatorët e pikturesh ishin të shumtë. Lajmi se piktori Alajdin Arbana kishte paraqitur një tablo kompozicionale tashmë qarkullonte poshtë e lart pa ndërprerë. Ora po i afrohej gjashtës kur shoqëria e katër artistëve, e zgjeruar si gjithmonë në të tillë ceremoni nga gratë, mbërriti në ekspositizen e re. Njerëzit ua hapën rrugën me respekt.

— Alajdin, na pri, — tha shkrimtari duke nxjerrë në pah shokun. — Kjo mbrëmje është jotja.

Sapo piktor Alajdin Arbana hyri në galeri, me dhjetëra vështrime ranë mbi të.

— Shenja e parë e suksesit të plotë, — pëshpëriti Ajet Shkëmbi.

— Do t'i marrim pikurat me radhë apò do të ndalemi te vepra e Alajdinit? — pyeti Sofia.

— Më mirë me radhë, — tha Kristo Shigjeta duke rregulluar syzet mbi hundë me një pamje prej kritizeri të pamëshirshëm.

Ata filluan të çapiteshin nëpër galeri në grup duke vështruar të përqendruar e duke diskutuar hap pas hapi në mënyrë të tillë që të binin në sy rrëth e rrötull dhe të pasqyronin kulturën e tyre estetike. Fjalët që dëgjoheshin më shpesh ishin: «Çka, e dobët, mizerabël fare, surrogato, pa ndjenjë, diletanteske» dhe «shumë më poshtë nga Alajdini». Para nja dy peizazheve

të piktor Niko Sukthit Miltiadher Nerenxa nënqeshi.

— Shikoni, a i afrohet dot ky liceist Alajdinit?

Ndërsa dy portretistë të vjetër, Ajet Shkëmbi i quajti «fotografë të pakualifikuar».

Dalengadalë veprave të ekspozitës po u afrohej fundi, por tabloja «Përpara përfitore të reja» nuk po dukej. Alajdin Arbana u pre. Shokët e tij filluan të vështroheshin të hutuar.

— Alajdin, ç'i kanë bërë kryeveprës sate? — pyeti i trembur shkrimitari.

Alajdin Arbana u nis me ngut drejt përgjegjësit të galerisë. Pas pak u kthyesh me nofulla të shtrënguara. Sytë i shkreptinin si reflekset e saldatrigeve.

— Kjo është thallisht skandaloze, — tha i prekur. — Sot paradite kryetari i komisionit të veprave dhe inspektori i kulturës, Gjergj Kruja, paskan urdhëruar që tabloja ime të hiqet.

— Turp! Fyerje përfitor! — thirri Miltiadher Nerenxa. — Ejani t'ua përplasim në surrat.

Ata të katër e gjetën inspektorin e kulturës diku nga mesi i galerisë dhe e rrethuan.

— Duam të dimë pse e fshehët tablonë «Përpara përfitore të reja» — tha Kristo Shigjeta duke i hequr syzet e duke i tundur kërcënueshmëm.

— Ajo vepër ishte skematike, — tha inspektori qetësisht. — E parealizuar artistikisht.

— Ju keni bërë një krim artistik! — ia përplasi Kristo Shigjeta.

— Për këtë duhet të hidheni në gjyq! — ia priti shkrimtari.

— Nuk e kuptoj si mund të jetë inspektor një njeri si ju! — tha Ajet Shkëmbi.

— Mediokritetin kërkojeni mes jush, — tha inspektori po me qetësi.

— Është e kotë të merremi me të, — nënqeshi inxhinieri. — Një inspektor si ky s'ka koncept të drejtë për mediokritetin. Na ngatërron me veten. Shkoni, inspektor, shkoni! Dhe punoni për ngritjen tuaj teorike.

Pas pak ata të katër iu turrën kryetarit të komisionit.

— Si guxuat të ma preknit tablonë? — iu kërçenua Alajdin Arbana.

Kryetari i komisionit mblodhi supet.

— More, për atë tablo jemi marrë vesh këq herë, më duket. S'bën ajo për në ekspozitë.

— Ashtu?! Ju më keni zili, sepse vetë jeni një njeri i dështuar.

— Ju jeni një korb! — thirri Kristo Shigjeta.

— Bile një peshkaqen që dëmtoni veprat e rralla të artit.

— Njeri me gusto anakronike, — e pasoi Ajet Shkëmbi.

— Mbajeni mend këtë datë, kryetar, — tha i prekur Miltiadher Nerënxa, — se do t'ju duhet ta kujtoni shpesh më vonë, kur tabloja e Alajdin Arbanës të futet në Galerinë Kombëtare. Atëherë të gjithë do t'ju quajnë njeri me vlera artistike të dyshimta.

— Përderisa këto m'i thoni ju të katër, i pranoj të gjitha, — kryetari i komisionit tundi kokën

tërë siklet. — Tani, a ka mundësi të më lini rehat, se më keni rrrethuar si destrojerë.

Pasi u bënë shenjë grave që po prisnin të hutuara në një cep të ekspozitës, ata të katër dolën nga galeria në mënyrë demonstrative. Miltiadher Nerënxa i hodhi piktorit fatkeq krahun supeve në mënyrë ngushëlluese. Ajet Shkëmbi po ashtu.

— Alajdin, rëndësi për njeriun kanë bindjet, — filozofoi Kristo Shigjeta siç e kishte shpesh zakon — Le të dërdëllisin të tjerët ç'të duan. — Shkrimtari ndali për një çast dhe foli duke psherëtirë:

— Arti i madh gjithmonë ka triumfuar. Edhe mua ma kthyen pesë herë vëllimin poetik «Fllade e Stuhi», por më në fund u detyruan të më kërkonin ndjesë. Tani po më lusin që t'ua çoj që ta futin drejt e në shtyp.

Të tjerët u ndalën të çuditur.

— Është e vërtetë, Milto?!

— Po. Sot bisedova në telefon. Vëllimin do të ma botojnë. Nga vera besoj se del libri.

— Milto, kjo është një mrekulli! — thirri Kristo Shigjeta.

Ndërkohë Sofia i jepte zemër së shoqes së piktorit:

— Eh, moj Liri, edhe Alajdinit tënd i ndodh gjithmonë si Miltos tim, nuk ia pranojnë veprat. I kanë zili dhe i pengojnë gjenitë, moj motër, ç't'i bësh! Por Miltoja im ua tregoi mirë qejfin. Futi miq nja dy kushërinj që punojnë në Ministri të Arsimit dhe e rregulloi vëllimin poetik. Tani do t'ia botojnë. Thuaji edhe Alajdinit të lëvizë ca.

injë. Ben shkrimi i mbrëmjeve që
dhe kompozicionat e pikturëve janë si që
si dëshirat që jep atyre vizualizuar
të kanë qëndruar që tash bëjnë që
të pikturët përfundojnë sëmundjet e pikturave
që idomëria e tij. A mundur që pikturat
të pikturave të pikturave sëmundjet
dëshirat qëndruar që tash bëjnë që
XII

Atë mbrëmje të trishtuar të padrejtësive të
mëdha ndaj tablosë kompozicionale «Përpara për
fitore të reja» dhe grindjeve në galerinë e ar-
teve figurative shokët e ngushtë e përcollën
Alajdin Arbanën deri në shtëpi duke i dhënë
vazhdimisht zemër e duke ia krasuar veprën
e dështuar me arritjet më të shquara të pikturës
botërore.

— Unë nuk i humb shpresat, — u tha pik-
tori duke u shtrënguar dorën. — Eksposita do të
hapan përsëri.

Ajet Shkëmbi e Kristo Shigjeta e miratuan
njëzëri duke u uruar atij e së shoqes natën e mi-
rë. Pas pak edhe inxhinieri i hekurudhave kér-
koi leje të largohej, sepse i duhej të përkthente
deri vonë. Miliadh Nerënxa i futi krahun Ajet
Shkëmbit ashtu si edhe Sofia së shoqes së aktorit.

— Shkojmë edhe në, i dashur. Ndonëse e
hidhur, kjo mbrëmje për ne të dy do të ketë

një rëndësi të veçantë, — tha shkrimtari. — Sonte do të të dorëzoj tragjedinë e daktilografuar që të fillosh punë me rolin e primit.

— Vërtet?! — u ngazëllye tjetri. — Sa mirë, Milto! Ka kohë që ndiej boshllék. S'është në gjendje asnjë dramaturg të të ofrojë një rol për së mbari. Ne aktorët jemi fabrikë përpunimi. Presim material nga autorët. Po kur të vjen materiali surrogato, a ia vlen t'ia hysh përpunimit?

— Ke të drejtë, i dashur. Unë shpresoj shumë te ti. Besoj se deri nga fundi i prillit do të jesh gati. Deri atëherë edhe këshilli artistik do ta ketë miratuar tragjedinë.

— Patjetër!

Çastet e lënies së dosjes së tragjedisë «Liria do të kthehet përsëri» në duart e aktorit nga ana e shkrimtarit qenë me të vërtetë prekëse. Kur i erdhi radha përqafimit, edhe dy gratë e artistëve nuk mundën të përbaheshin pa u hedhur në krahët e njëra-tjetrës.

— Në besën tënde për suksesin, Ajet, — tha Miltiadher Nerënxa.

— Rri i qetë, — ia ktheu shoku. — Ti si autor e bëre tënden. Tani fillon beteja ime.

Beteja aktoriale e Ajet Shkëmbit e pati aksionin e parë që atë natë. Ai ndenji deri vonë duke e lexuar tragjedinë me laps në dorë. Kjo gjë i bëri së shoqes shumë përshtypje. Ajo u detyrua të ngrihej nga krevati për ta thirrur dhe e gjeti të shoqin duke gërhitur përbys mbi fletët e daktilografuara të veprës së Miltiadher Nerënxsës.

Tri ditë rresht Ajet Shkëmbi ia kushtoi zber-

thimit të rolit të princit në rrafshin ideor, artistik dhe atë psikologjik. Fillimisht ai u përqendrua te temperamenti dhe, për çudi, arriti në përfundimin se mes tij e fisnikut Shkodran kishte një ngjashmëri të madhe. Princi ishte i shkathët në veprime, humbiste shpesh në mendime, prekej lehtë e nervozohej brenda sekondës, kishte shpesh shfrime të vrullshme ndjenjash e myllje në vetmi, veçori që shfajqeshin rregullisht edhe tek ai si Ajet. Më tej zbuloi se, si karakter shqëror, princi gjëzonte disa përjashtime e anë positive që klasës së vet i mungonin; ai ishte i butë me popullin dhe për reforma në favor të tij, urrente diktatin turk, kërkonte unitet kombëtar, i shkrinte të gjitha pronat e pasuritë e veta për luftën popullore dhe i vlerësonte masat si forcë vendimtare në luftën kundër pushtuesit. Kurse ai karakter individual fisniku shkodran shquhej për drejtësi, singjeritet, dhimbësuri, modesti. Ai ishte aq i dashur dhe i afrueshmë me kështjellarët e tij, saqë Ajet Šhkëmbi shënoi në kllapa: (Tamam si një komisar i Luftës Nacionalçlirimtare me partizanët).

Zbërthimi në tre rrafshe i princit e mahnitë edhe vetë Miltiadher Nerënxon që e kishte krijuar atë.

— Po më çudit, Ajet, — i tha ai aktorit i ngazëllyer. — Ti paske zbuluar gjëra interesante që unë s'i kisha vënë re. Kjo është prova e parë e suksesit tënd. Urime!

Më në fund, me tragjedinë e zbërthyer përpara, Ajet Šhkëmbi i hyri punës për mësimin e tekstit përmendsh. Myllur në studio, ai filloi të lexonte me zë të lartë të gjitha batutat e veta

duke têrhequr vëmendjen e kolegëve me atë rol të padëgjuar. Por shpejt në institucion u përhap lajim se libretisti i teatrit kishte dorëzuar për shqyrtim në këshillin artistik një tragjedi historike me gjashtë akte, kryerolin e së cilës ia kishte besuar shokut të vet të ngushtë.

Puna këmbëngulëse e Ajet Shkëmbit me batutat e primit vetëm fillonte në studion e teatrit, turni i saj i dytë vazhdonte në shtëpi. Ato ditë fundmarsi fqinjët e tij filluan të pësh-përisnin se në familjen e aktorit kishte plasur grindja keqazi. Ai u bërtiste si i çmendur së shoqës dhe fëmijëve, por ishte tepër e vështirë të merrej vesh se përse grindeshin. Disa kishin dëgjuar shpesh fjalët «turk, Turqi, osmanllinj, letër, pritje në kështjell» dhe u përhap lajmi nëpër pallat se së shoqes së aktorit i kishte ardhur një letër nga disa kushërinj të së emës në Turqi, për ekzistencën e të cilëve Ajeti s'kishte ditur gjë. Një natë shumë prej fqinjëve ishin trembur kur e kishin dëgjuar aktorin të thërriste si në kllapi: «Rojë, roje, po më mbysin! Mos e lini kështjellën të bjerë në duart e osmanllinjve!» Kështu, të nesërmen në mëngjes s'kishin mundur të qëndronin pa e pyetur të shoqen se ç'po ndodhete. Kur ajo u tregoi se Ajeti i saj po përgatitej për rolin e vështirë të një princi mesjetar që luftonte kundër turqve, fqinjët u qetësuant dhe dalëngadalë fjalët e përhapura për grindjet e letrën nga Turqia filluan të shuheshin.

Por vëtmia në punën lodhëse me rolin e primit e mërziti Ajet Shkëmbin shpejt dhe po e pengonte ritmin me të cilin ai i përvetësonte zakonisht pjesët. I nevojitej patjetër një partner,

sidomos pér rolin e komandantit tē garnizonit tē kështjellës me tē cilin kishte shkëmbimin e pjesës më tē madhe tē batutave. Cili prej kolegëve mund ta merrtë përsipër atë barrë? Ishte e kotë tē lodhte gojën. Ata më mirë pranonin tē mësonin përmendsh «Mesharin» e Gjon Buzukut, sesa rolet e Miltiadh Nerënxsës që shquheshin pér shkallën e lartë tē vështirësisë.

Në ato rrëthana gëzimi i Ajet Shkëmbit qe i papërbajtur kur një mëngjes në fillim tē prillit një trokitje e drujat ur u dëgjua në derën e studios së tij dhe një gjimnazist hyri i emocionuar duke i zgjatur një letër. *Ajet, ylli teatral i motrës, — shkruhej në të, — djaloshi që po tē dërgoj është i biri i një shoqes sime tē ngushtë, tepër i talentuar dhe me horizont. Dëshiron tē konkurrejë pér dramaturgji. Të lutem mbaje pranë dhe ndihmoje. Ai tē vlerëson te shumë ty si aktor. Të fala, Vjollca*

Ajet Shkëmbi brofi në këmbë me krahët hapur dhe e përfshiu gjimnazistin e hutuar në ta.

— Mirë se erdhe, djalosh! — tha me basin e vet tē kumbueshëm. — Paske zgjedhur një rrugë tē vështirë dhe, pér guximin, unë do tē ndihmoj. Ulu. Si tē quajnë?

— Arđian, — iu përgjigj gjimnazisti.

— Të lumtë, Arđian! Ne do tē punojmë bashkë dhe ti do tē shkëlqesh në konkurs. Të jesh i sigurt pér këtë. Të gjithë ata djem që kanë dalë nga bashkëpunimi me mua sot janë aktorë tē talentuar.

Gjimnazisti nuk dinte si ta shprehte respektin e vet. Hutimi ende s'po i kalonte. Thirrjet e Ajet Shkëmbit vazhdonin t'i ushtonin në veshë.

— Unë do t'ju bezdis ca, shoku Ajet, — tha i skuqur.

— Bah, çështë ajo fjalë, i dashur! — ia ktheu aktori. — E ndiej si detyrë profesionale ndaj teje. Kjo është një detyrë fisnike. Ne të dy do të merremi me role klasike, Ardian! Me figura të mundësive të mëdha interpretuese! E njeh shkrimtar Miltiadher Nerënxon, shokun tim?

Gjimnazisti mblođhi supet.

— Patjetër që e njeh!

— È... po... po.

— Nga tragjedia e tij «Liria do të kthehet përsëri» ti do të zgjedhesh rolin e komandantit të kështjellës.

— Po kjo tragjedi...

— Mos ki merak! Derisa të vijë koha e konkurrimit, kjo tragjedi do të jetë bërë e famshme anembanë vendit.

Ndonjë gjysmë ore Ajet Shkëmbi e mbajti gjimnazistin gozhduar duke i folur për vlerat e shumta të tragjedisë së shokut të vet, për shkallën e lartë të vështirësisë së rolit të princit, me të cilin ai po merrej, dhe të komandantit të garnizonit të kështjellës që s'mbeste më prapa. Pastaj ia dha tekstin e daktilografuar të veprës për ta lexuar duke e lënë në vetminë e studios.

— Unë s'do të vonohem shumë, — i tha duke u nisur për të pirë kafenë e zakonshme me Miltiadher Nerënxon. Djaloshi, i dashuruar pas teatrit, u zhyt në botën mesjetare të tragjedisë.

Kur Ajet Shkëmbi ia mbërriti rishtazit në studio, e gjeti nxënësin e tij edhe më të hутuar.

— Hë, si po të duket roli, — e pyeti me qejf.

— È? I bukur... shumë i bukur, — u përgjigj gjimnazisti tërë siklet.

— Ti do ta befasosh jurinë, Ardian. Vetëm ki besim.

Kështu aktori i sprovuar dhe nxënësi i tij i ri tërë prillin iu futën roleve të tyre me një këmbëngulje të pashembullt. Gjimnazistit s'po i kalonte hutimi, por mjeshtri mundohej ta çlironte me përvojën e vet. Përfito nga unë, Ardian, e këshillonte herë pas here. Më imito. Mundohu të arrish përsosmérinë time. Mos e këndo batutën në fund! Shqiptoje natyrshëm, fuqishëm! Ti je komandant garnizoni.

— Kam shumë emocione, shoku Ajet, — i ankohej nxënësi.

— Duhet të çlirohesh nga çdo lloj emociioni. Një komandant s'duhet të dridhet nga emocionet si një fëmijë!

Kishte raste kur në dialog e sipër mjeshtri harronte batuta të tëra dhe nxënësi mbetej gojëhapur. Shoku Ajet, shkuat para, murmuriste ai me druajtje. S'ka gjë, ia kthente aktori i sprovuar, këtë e bëj për të kontrolluar kujtesën tënde. Dihej nga të gjithë kolegët se Ajet Shkëmbi harronte shumë batuta gjatë shfaqjeve. Njëherë, gjatë interpretimit në rolin e një oficeri zogist, ndërsa ndodhej në rrugë me ca miq të tij, ai u ishte drejtuar atyre: «Dhe tani urdhëroni e uluni, zotërinj! Dreka është gati.» Mos u ngut, Galip, kishte ndërhyrë me lezet njëri prej partnerëve, dreka s'është shtruar akoma. Kemi edhe disa gjëra për të sqaruar...

Pothuaj çdo ditë, pas punës së lodhshme me rolet, mjeshtri merrte kitarën e tij që e mbante varur në vendin më të dukshëm të studios dhe kalonte në shfrime lirike. Nxënësi e dëgjonte i mekur. Në teatër Ajet Shkëmbin e njihnin të gjithë për interpretues virtuozi të këngëve korçare të dashurisë dhe të pjesëve amerikano-latine. I binte kitarës me aq pasion e vrull, saqë në çdo dy-tre ditë ishte e pamundur të mos këpuste nga një tel.

Kur e pa se kishin ecur mirë në përvetësimin e roleve, Ajet Shkëmbi vendosi t'i mbildhe një pasdite shokët për një spektakël të improvizuar në studio. Spektakli u la për të shtunën e fundit të muajit, por papritur të premten Miltiadher Nerënxa u njoftua se vepra e tij «Liria do të kthehet përsëri» ishte hedhur poshtë pa as më të voglin debat nga këshilli artistik, me motivacionin: «Vepër e dobët artistikisht, një eksperiment i dështuar, i mbushur me anakronizëm, me gabime historike, me modernizim të tepruar të epokës së zhvillimit të ngjarjeve dhe i ngritur mbi një subjekt krejt të papërshtatshëm për skenën.» Autori i tragjedisë, duke u lëkundur i téri nga goditja e befasishme, mundi të mbërrinte deri në studion e Ajet Shkëmbit dhe aty u plandos në një kolltuk duke rënkuar:

— Ajet, injorantët e mediokrit do të më luajnë mendsh. Tragjedinë ma hodhën poshtë.

— Si?! Si guxuan? Po mundi ynë? Po téré ato përgatitje? Idiotët!

Tërbimi i aktorit qe aq i furishëm, saqë edhe shkrimtari u detyrua të vinte në vete.

— Ajet, mos u mërzon, — filloi ta qetësonë ai shokun. — Unë tragjedinë do ta ripunoj. Sa të jem gjallë, nuk e lë pa engjitur në skenë!

Kristo Shigjeta e Alajdin Arbana e morën vesh lajmin e hidhur në lulishten në qendër të qytetit, para shëtitjes së zakonshme të mbrëmjes.

— Kështu ndodh kur mblidhen korbi, laraska, qyqja e lakuriqi i natës për të gjykuar këngën e bilbilit, — tha duke nënqeshur inxhinieri i hekurudhave. — Pika që s'u bie!

— Tmerrësishët sjellje harbute, — e pasoi piktori. — Dhe ndaj cilës? Ndaj tragjedisë së parë të realizimit tonë socialist!

Miliadh Nerënxa tundi kokën me keqardhje.

— Unë e di që ata duan të njollozin reputacionin tim, por lumi malor nuk mund t'i pritet rrjedha me gurë e purteka. Së shpejti unë do të shpërthej. Vëllimi «Florde e stuhit» është futur në shtyp. Gjithsej 80 poezi, 80 kulme, 80 brilante! Në çvrima do të futen atëherë injorantët e mediokritët! Më thoni, ju lutem!

— Për ta s'do të gjenden vrima fare, — iu përgjigj piktori.

— Atëherë Milton trezik se e tërheqin në Tiranë, — tha aktori.

— Sigurisht, — e mbështeti Alajdin Arbana.

— Duhet ta emërojnë kryeredaktor të «Dritës» ose «Nëntorit».

Në asnjë mënyrë! — kundërshtoi shkrimitari. — Unë s'do të pranoj. Unë nuk largohem nga ju, çfarëdo që të ndodhë.

Ndërsa katër shokët e ngushtë u nisën për te «Gjuetari» për të pirë kafétë e ngushëllimit

si shpeshherë në raste të atilla dështimesh, Ajet Šhkëmbi mendonte për nxënësin e tij që do të vinte të nesërmen i përgatitur për spektaklin e tij të parë. Fundja, një rol s'është gjë tjetër veçse një kilometër në rrugën e pafund të teatrit, tha ai me vete. Le t'i bëhet atij djaloshi përvojë për rolet e ardhshme. Le të lodhet ca siç jam lодhur edhe unë me dhjetëra herë.

Të shtunën pasdite gjimnazisti i dashuruar pas teatrit trokiti në studion e mjeshtrit të tij i emocionuar dhe mbeti disi i shtangur kur e pa atë tepër, të mënduar.

— Ç'ka ndodhur, shoku Ajet? — pyeti me druajtje.

— Spektaklin në duet s'do ta bëjmë, Ardian, — u përgjigj mjeshtri me sytë përdhe. — Unë do të heq dorë nga roli i princit dhe ti nga ai i komandantit të garnizonit të kështjellës.

— E pse?

— Tragjedia do të vihet në skenë vitin tjetër.

— Po unë ç'të bëj tanë?

— Do të zgjedhim një rol tjetër.

— Si...si, rol... tjetër?

— E pra, tjetër, nga drama «Ruga e suksesit» e shokut tim, Miltiadher Nerenxës.

— Të fillojmë edhe një herë nga fillimi?!

— Po, rruga e teatrit është e lodhshme, djalosh!

— Ti qenke i çmendur! Shko mbushu me gjithë teatrin tënd! Pak se më torturove një muaj me atë komandantin e kështjellës, por do të më ngatërrosh prapë me rolet e atij matufit. Fajin ma ka mamaja që më ngatërrroi me ty. As kam për të konkurruar fare!

— Ajet, mos u mërzit, — filloi ta qetësonte ai shokun. — Unë tragjedinë do ta ripunoj. Sa të jem gjallë, nuk e lë pa engjitur në skenë!

Kristo Shigjeta e Alajdin Arbana e morën vesh lajmin e hidhur në lulishten në qendër të qytetit, para shëtitjes së zakonshme të mbrëmjes.

— Kështu ndodh kur mblidhen kórbi, larakë, qyqja e lakuriqi i natës për të gjykuar këngën e bilbilit, — tha duke nënqeshur inxhineri i hekurudhave. — Pika që s'u bie!

— Tmerrësishët sjellje harbute, — e pasoi piktori. — Dhe ndaj cilës? Ndaj tragjedisë së parë të realizimit tonë socialist!

Miltiadhi Nerënxa tundi kokën me keqardhje.

— Unë e di që ata duan të njollozin reputacionin tim, por lumi malor nuk mund t'i pritet rrjetëha me gurë e purteka. Së shpejti unë do të shpërthej. Vëllimi «Fllade e stuhi» është futur në shtyp. Gjithséj 80 poezi, 80 kulme, 80 brilante! Në ç'vrima do të futen atëherë injorantët e mediokritët! Më thoni, ju lutem!

— Për ta s'do të gjenden vrima fare, — iu përgjigj piktori.

— Atëherë Milton rrëzik se e tërheqin në Tiranë, — tha aktori.

— Sigurisht, — e mbështeti Alajdin Arbana.

— Duhet ta emërojnë kryeredaktor të «Dritës» ose «Nëntorit».

Në asnjë mënyrë! — kundërshtoi shkrimtari. — Unë s'do të pranoj. Unë nuk largohem nga ju, çfarëdo që të ndodhë.

Ndërsa katër shokët e ngushtë u nisën për te «Gjuetari» për të pirë kafetë e ngushëllimit

si shpeshherë në raste të atilla dështimesh, Ajet Šhkëmbi mendonte për nxënësin e tij që do të vinte të nesërmen i përgatitur për spektaklin e tij të parë. Fundja, një rol s'është gjë tjetër veçse një kilometër në rrugën e pafund të teatrit, tha ai me vete. Le t'i bëhet atij djaloshi përvojë për rolet e ardhshme. Le të lodhet ca siç jam lodhur edhe unë me dhjetëra herë.

Të shtunën pasdite gjimnazisti i dashruar pas teatrit trokiti në studion e mjeshtrit të tij i emocionuar dhe mbeti disi i shtangur kur e pa atë tepër të menduar.

— Ç'ka ndodhur, shoku Ajet? — pyeti me druajtje.

— Spektaklin në duet s'do ta bëjmë, Arđian, — u përgjigj mjeshtri me sytë përdhe. — Unë do të heq dorë nga roli i princit dhe ti nga ai i komandantit të garnizonit të kështjellës.

— E pse?

— Tragjedia do të vihet në skenë vitin tjetër.

— Po unë ç'të bëj tanë?

— Do të zgjedhim një rol tjetër.

— Si...si, rol... tjetër?

— E pra, tjetër, nga drama «Ruga e suksesit» e shokut tim, Miltiadhi Nerënxs.

— Të fillojme edhe një herë nga fillimi?!

— Po, rruga e teatrit është e lodhshme, djalosh!

— Ti qenke i qmendur! Shko mbushu me gjithë teatrin tënd! Pak se më torturove një muaj me atë komandantin e kështjellës, por do të më ngatërrosh prapë me rolet e atij matufit. Fajin ma ka mamaja që më ngatërrroi me ty. As kam për të konkurruar fare!

Gjimnazisti doli me vrull. Ajet Shkëmbi mbeti ca çaste gojëhapur si ata peshqit e akuariumit kur i afrohen qelqit. S'ia kishte marrë kurrë mendja se ai djalosh aq i druajtur mund të shpërthente në atë mënyrë.

— Ti, mor pizeveng, kurrë s'ke për tu bëre faktor!

Ajet Shkëmbi u mat t'i turrej gjimnazistit nga prapa, por ndërkohë dy kolegë të tij u dhanë në korridor dhe ai u detyrua ta përmbanë vete. «Njeriu pa vullnet qenka jo vetëm dembel, por edhe i pasjellshëm», murmuriti me vete.



FRAGMENT I SHKËPUTUR NGA TRAGJEDIA
«LIRIA DO TË KTHEHET PËRSËRI», AKTI IV,
SKENË VII

Princi: — Ç'qe ajo zhurmë në portën e kështjellës, Gjorg?

*Komandanti i garnizonit: — Pashai i zi turk ju
dërgon një letër, imzot.*

Princi: — *E ç'thotë në të!*

Komandanti: — Avazin. Ju kérkon tē dorëzoheni, tē njollosni me turp emrin e arbit.

Princi: — I ktheni përgjigje të mos lodhet koto me letra. Arbri s'ka rënë kurrë i gjallë në duart e armikut. Pashai, po deshi luftë, le të urdhërojë. Ne e presim.

Komandanti: — Vullneti juaj do të bëhet, imzot.

Princi: — Do të bëhet vullneti i historisë, Gjorg. Dikush duhet të përballonët kujedrën turke dhe përkëtë historia na zgjodhi ne. Osmanlinjtë janë një perandori e madhe.

Ata do tē pērpiqen tē pērbysin Evropēn, tē pengojnē zhvillimin e kulturës me injorancën e tyre. Prandaj qëndresa jonë do tē hyjë nē histori, Gjorg. Stërnipërit tanë do tē mësojnë se hordhitë turke mberritën deri nē Arbëri, por aty u ndalën me turp.

Komandanti: — Åshtu është, imzot. Dikush do ta shkruajë historinë tonë.

Princi: — Patjetër, Gjorg. Prandaj tē gjitha dokumentat e shkresat tē groposen sa më thellë. Edhe nëse ne shuhemi brenda këtyre mureve, lufta nuk do tē pushojë. Liria do tē kthehet përsëri. Arbri s'rron dot pa liri. Ai do tē ngrihet në kryengritje për t'u shkëputur nga zgjedha turke. Dhe kur kjo kështjellë tē ketë rënë përsëri në duart e stërnipërvë tanë, ata do tē kërkojnë tē dhëna për tē kaluarën e stërgjyshërvë tē tyre. Kështu do tē zbulojnë dokumentet e shkresat tona.

Komandanti: — do t'i zbulojnë patjetër, imzot.

Princi: — Dhe atëherë ata do tē shkruajnë historinë tonë.

Komandanti: — Tepër tē lavdishme, imzot.

Princi: — Dokumentet e shkresat do t'u duhen edhe për gjuhën, Gjorg. Qeni turk do tē përpiqet ta zhbëjë gjuhën shqipe dhe për një periudhë tē gjatë do tē ketë sukses. Por më vonë gjuhë e arbitr do tē lindë përsëri më e bukur.

Komandanti: — Po afron koha e flijimit tonë, imzot.

Princi: — Po afron, Gjorg. Dhe do të jetë një flijim i lavdishëm. Tashmë ne i përkasim historisë...

Fragmente bisede në kafe «Gjuetari»

- Si është përmirësuar koha! Sikur të shkoni nesër për peshk, Milto?
- Pse të mos shkojmë!
- Edhe Ajeti me Kriston mund të vijnë.
- Jo! Unë s'vij, Alajdin! Mos më thoni më as për peshk, as për plazh, për kurrgjë!
- Pse kështu, Kristo?!
- Sepse kini kaq kohë që më gënjeni se do të vini për të parë lokomotivat me avull!
- Për këtë qenke mërzitur?!
- Mosinteresimi i cilidho njeri për lokomotivat më mërzit.
- Kristoja ka të drejtë. I kemi premtuar kaq herë se do të shkojmë në oficinë. Duhet të shkojmë!
- Do të shkojmë. Unë kam shumë qejf të hipi në një lokomotivë me avull.
- Edhe unë. Është njohje jete, me shumë vlera.
- Atëherë do ta lëmë për të hënën.
- Mirë. Kristo, na prit të hënën...

-nariobas ñer ñi rokoh sein ñi atdias a doring
ñi sagittorum a surinam amazônico ñi rókoh
ñi serebórum asiq a ujumak ñi ñi irab ñi
ñi ñigou ñi ñi muntal asiq a nñimant :
tayus a asiq rukitig nñimant a uskullod. asiq tñimant
asiq ñigurri ogo ñi atdias asilis aq krokt ñi
torekiswad asiq, ñidu idu nñimant asiq ñi aq
elison ñer a nñebi aqñi pedi asiq ñi mit tñimant a
-ñi ñer ñi ob aqñi' ñi ñi rókoh ñi ñigou ñi
(ii) ñi *Fragmente nga ditari artistik* a nñimant

Fragmente nga ditari artistik

Tepër i mjerë dhe i patalentuar duhet të jetë ai shkrimtar që ankohet se jeta është e varfër, monotone dhe nuk të ofron subjekte për vepra interesante. Natyrisht kjo është psikologjia e krijuesit të zyrës, i cili nuk e njeh jetën që vlon përreth. Shkrimtari i vërtetë duhet të përplaset me subjektet dhe heronjtë e vet ashtu si ajo anija që përplaset pa pushim nëpër dallgë. Ja eksperiencia ime në këtë drejtim:

Sot paradite isha me Alajdin Arbanën në kase «Adriatiku» dhe, ndërsa po debatonim për konvencionin në art, na e tërroqi vëmendjen një tip gagareli që ofendoi kamerieren. Nuk durova dot dhe u ngrita ta qortoja, por djali, i mbytur në shfaqje të huaja, ma ktheu harbutce:

«Ik, or xhaje, se do t  t  m soj vertikaleni!»
Ishte e tmerrshme! P rvesha m ng t, por
Alajdini nuk m  la t ia tregoja vendin gagarelit.
Qet sohu, Milto, m  tha, ulu. Nuk t  takon ty
kjo pun . Fjal t e tij m u duk n bind se. Nuk
ia vlente ta njollosja reputacionin tim me n je
rrugac.

U hidhërova shumë kur më treguan se ga-

gareli e kishte të atin drejtor të një ndërma-rrjeje të rëndësishme. Shkakun e mbërritjes së tij deri në atë gjendje e pata menjëherë të qartë: familja e kishte llastuar që në vogëli, të mirat dhe bollëku e kishin prishur duke e kthyer në njeri pa vullnet. Ashtu si ajo rrufeja mesreve që ndriçon natën mbi dhë, edhe hemisferat e trurit tim i ndriçoi befas ideja e një novele të gjatë, në qendër të së cilës do të jetë familja e një drejtori dhe figura e djalit të tij që ka shkarë në rrugë të gabuar. Ai manifeston shfaqje të huaja, braktis shkollën e mbrëmjes, kërkon të mashtrojë një vajzë të ndershme. I ati i djalit sëmuret nga koka, së ëmës i bie infarkt. Por ndërhyjn menjëherë dora e fuqishme e kolektivit dhe gjendja përmbyset. Bartësi i këtyre shfaqjeve negative dërgohet në minierë për riedukim. Aty lindin tek ai nëpërmjet punës virtytet e larta të të riut tonë revolucionar. Mbyllja: lumturi në familje, babait i shërohet koka, nënës i forcohet zemra sërisht, djalit takon vajzën që dikur donte ta mashtronte dhe fejohet me të. Skena e fundit: pirja e kafeve.

Ah, sikur dita të kishte 50 orë! Jam i rrethuar si ai ishulli mes detit nga subjektet që më presin...

Së shpejti më duhet të shkoj në Tiranë, në Lidhje, për t'u interesuar për lejen krijuese. Skam asnjë dyshim se do të më jetë miratuar. Fillimi i qershorit është kohë më e përshtatshme për t'u nisur për një fshat. Tashmë romani më ka mbërthyer të terin si një oktapod. Do të shpëtoj prej tij vetëm kur ta kem mbaruar. Ah, sa e vështirë qenka jëta e shkrimitarit!..

XIII

Ora po i afrohej njëmbëdhjetës kur shkrimtari, piktori dhe aktori i zbritën autobusit në Oficinën Mekanike Nr. 1 të Ndërmarrjes së Hekurudhave. Dita e bukur e majit dhe deti i shtruar që kaltëronte aty pranë e mahnitën aq shumë aktorin, saqë ai pshëretiu me dhimbje:

— Ah, plazh, o plazh! Pse nuk më latë ta filloja sezonin që në prill? Shikoni ç'ngjyrë ka marrë deti!

— Na lër tani, Ajet, se kemi ardhur përtjetër punë, — i foli shkrimtari. — Ç'tu tek për plazh?

Ndërsa tre artistët hynë në oborrin e madh të oficinës, lajmi i mbërritjes së tyre u përhap në të gjitha repartet. Filloi të diskutohej se shkrimtari shikonte ardhur për të njohur jetën e klasës punëtore, ndërsa piktori për të nisur një tablo të madhe kompozicionale. Për aktorin u tha se ai do t'i hynte vënies në skenë të «Fa-

miljes së peshkatarit», dramë të cilën e kishte realizuar edhe me tri ndërmarrje të tjera të qytetit. Por diskutimet kaluan pa vonesë në një plan tjetër kur artistët njoftuan me modesti se kishin ardhur thjesht për një vizitë.

Kristo Shigjeta doli t'i priste shokët me krahët hapur.

— Më në fund erdhët, — u tha buzagaz. — Sa mirë! U kisha thënë të gjithëve se do të vinit.

— O, Kristo, s'është nevoja për bujë, — kundërshtoi shkrimtari. — Fundja ne jemi njerëz të zakonshëm.

— Plotësisht të zakonshëm, — e mbështeti piktori.

— Jo, jo! Te ju bashkëqytetarët shohin artin e tyre. Përderisa njiheni në popull, nuk mund të jeni të zakonshëm.

— Ashtu është, — pranoi aktori. — Por ama artistët, sado të mëdhenj, kanë jetën e tyre private, si gjithë të tjerët.

Duke diskutuar katër shokët e ngushtë e përshkuat të tërë oborrin e madh të ndjekur si shpeshherë nga vështrime plot kureshtje.

Tani, para se të shkojmë te lokomotivat me avull, le të bëjmë një vizitë sipërfaqësore rrëth e rrotull, — tha Kristo Shigjeta duke u prirë shokëve drejt hyrjes së gjerë të një reparti. — Ja, këtu bëhet remonti i lokomotivave «Dizel». Mund të hidhni një sy.

Artistët çanë përmes repartit duke vështruar majtas e djathtas plot habi sikur të kishin zbritur në ndonjë planet tjetër.

— Shoku Kristo, i thoni shokut Miltiadhi të

shkruajë një dramë për trupën tonë, — thirri
ndërkokë një djalë i ri.

Shkrimtari buzëqeshi.

— Keni të drejtë, shok. Do të reflektoj përf
këtë problem.

— Dramën e duam me ilirë ose me pellazgë,
— ia priti një djalë tjetër. — Na térheqin su-
bjektet historike.

— Ashtu?! — buzëqeshi shkrimtari. — Ideja
juaj është vërtet ngacmuese. Do të mendohem.

— Po ju, shoku Alajdin, s'do të na bëni
ndonjë afreskë këtu në hyrje të ndërmarrjes? —
pyeti njëd vajzë.

Piktori ngriti supet.

— Më vjen keq, shoqe, por unë jam i predi-
spozuar vetëm për peizazhe dhe tablo kompozi-
cionale.

— Shoku Ajet, kur do ta organizojmë ce-
remoninë e hapjes së plazhit? — iu drejtua
aktorit një amator noti.

Ajet Shkëmbi përshtëndeti me dorë.

— Ja... punë ditësh.

— Në ndërmarrjen time jeni shumë të njo-
hur, djema, — u tha i kënaqur Kristo Shigjeta
shokëve. — Gjithmonë më pyesin për ju, Eh, art
i madh, interesim i madh.

Të ndjekur nga pyetjet e kureshtarëve dhe
artdashësve, miqtë dolën nga reparti të kënaqur.
Pasi kaluan edhe nëpër dy reparte të tjera, ku
dendësia e pyetjeve dhe e interesimit erdhë duke
u shtuar, Ajet Shkëmbi që po llogariste me
vete nja dy orë plazh, propozoi që të fillonin
me lokomotivat me avull.

— Urdhëroni, — tha i ngazëlyer Kristo Shi-

gjeta. — Le të fillojmë me avulloret, mire e ka Ajeti. Kemi njérën në riparim e sipër.

Miqtë kureshtarë qëndruan kësaj here para lokomotivës me avull që po riparohej sikur të ndodheshin para piramidës së Keopsit.

— G'ngrehinë gjigante! — Ajet Shkëmbi lëshoi një fërshëllimë.

— Ç'konstruksion! — e pasoi Alajdin Arbanai.

— Sa spunë i është dashur njerëzimit për të mbërritur deri këtu! — psherëtiu shkrimtari.

— Pa na fol ca, Kristo, nã fol.

Specialisti i avulloreve u mbush thellë me frymë.

— Ky tip lokomotive është një rebus i vërtetë, djema. Do të lodheshit po t'i numëroja të gjitha. Ja, ky i gjati si tunel është kazani horizontal; i mbushur me tuba avulli. Para tij është kazani vertikal; brenda të cililit kryhet dje-gia dhe realizohet avulli. Avulli me anë të distributorit shkon te cilindrat, cilindrat vënë në lëvizje mekanizmin biellëmanivel dhe kështu rrotat e mëdha vrapuese vihen në udhë.

— Ç'komplikacion! — tha aktori.

— Tmerrësisht rrëmujë, — e pasoi piktori. I fortë je, Kristo, që nuk ngatërhoresh në këtë xhüngël hekurishtesh.

— Dhe të mendosh gjithë ato pjesë që nuk duken! — tha shkrimtari. — Kristo, tani po e kuptoj lodhjen tënde. Tërë atë studim për rationalizimin.

— Vërtet, ku qëndron në esencë rationalizimi, Kristo? — pyeti aktori.

— Racionalizimi im, djema, është ky: lokomo-

tiva s'do të punojë më me qymyrguri, por me solar. Lënda djegëse me anë të dy konikëve do të sprucohët në dhomën e zjarrit, e cila për pasojë do të modifikohet së bashku me depozitën e karburantit dhe një sërë pjesësh të tjera.

— Fantastike! — thirri Ajet Shkëmbi, i pari si gjithmonë. — Këtij i them racionizim unë!

— Dhe flasim pastaj për shkencë! — nënqeshi Alajdin Arbana. — Ca docentë, ca gjoja profesorë! Vetëm për këtë racionizim, po të isha kryetar i Akademisë, unë do të të bëja ty, Kristo, doktor.

— Shkencëtari i vërtetë i shmanget bujës, — tha Miltiad Nerënxa. — Kristoja është modest dhe kapacitet si Edisoni kur punonte telegrafist i thjeshtë në postë.

Pasi racionizatori foli edhe ca për problemet e tij teknike, Alajdin Arbana u ngjit nëpër shkallët e lokomotivës çapkënçe.

— Ejani ta shohim një herë nga brenda.

— Jo, — thirri inxhinieri. — Kam planifikuar një shëtitje të vogël me lokomotivë. Do të hipim në një tjetër. Ejani me mua!

Miqtë kureshtarë u vështruan mes tyre.

— Kristo, më mirë hipim këtu, — kundërshtoi piktori.

— Vërtet, e ndalur lokomotiva shihet më mirë, — tha shkrimitari.

— S'ka edhe zhurma, — shtoi aktori.

— Jo, — këmbënguli racionizatori. — Dua që ta shihni lokomotivën në punë. Aty është bukuria. Ejani!

Ai u priu shokëve përmes oborrit të pasmë të oficinës dhe i nxori jashtë, pranë linjës he-

kurudhore ku ishte një lokomotivë me avull në pritje të një lëvizjeje vagonash ngarkuar me mineral. Makinisti dhe ndihmësi i tij kishin zbritur dhe po bisedonin ndenjur në një brez barë aty pranë.

— Tungjatjeta, shokë! — i përshëndeti Kristo Shigjeta. — Nja dhjetë minuta do të ma lini mua lokomotivën në dorë sa t'u bëj një shëtitje të vogël këtyre miqve.

Makinisti dhe ndihmësi vështruan përgjatë shinave të trembur.

— Sikur të vija edhe unë, shoku inxhinier, — tha makinisti.

— Mës ki merak, Gani. Ti më njeh. Unë ua di huqet këtyre pelave plaka. Hopa, djema, hipni!

Katër artistët u gjendën në kabinën e ngushtë e të nxeh të lokomotivës.

— Si shfryn azgania, si një luaneshë e egërsuar, — rrahu duart shkrimtari.

— Mirë e the Milto, si një luaneshë, — e mbështeti inxhinieri. — A nisemi tan? Presioni atmosferë. Bukuri. Manometrat e fjerë në rregull. Ec para, moj pelë e thinjur veterane! — ai tërhoqi nga vetja një levë të ngjyer me të kuqe. Por, për habinë e miqve, lokomotiva s'u tund nga vendi. Kristo Shigjeta buzëqeshi si me siklet. — Kështu kanë ca naze këto, si plakat, — ai mbërtheu një levë tjetër, e tërhoqi, por përsëri luanesha e egërsuar nuk lëvizi. Vetëm shfrytë avull. Mjeshtri shtrëngoi nofullat. Miqtë vështronin nga dritaret duke u shtirë sikur s'e kishin mendjen.

— Shoku inxhinier, levën jeshile, — thirri makinisti që e nuhati gjendjen menjëherë.

— Po, po, — ia ktheu Kristo Shigjeta i lehtesar. — E di.

Ai e tärhoqi levën jeshile dhe lokomotiva bëri përparë.

— Bukur, ë? — tha Ajet Shkëmbi. — Të duket vetja i gjithëpushtetshëm mbi rrota hekuri.

— Gjithë toka përreth dridhet, — tha shkrimtari i emocionuar. — Pale sikur të lëvizte lokomotiva më shpejt.

— Shpejtësinë e kemi në dorë, — Kristoja ishte në qejf. — Ja, e rrisim me këtë dorezën e rrumbullakët.

— Jo! — thirri piktori. — Ç'keni me shpejtësinë? Jemi mirë kështu.

— Goxha shpejtësi kemi, — e mbështeti Ajet Shkëmbi. — Mos na ngatërroni kot.

— Gjithë bukuria është te shpejtësia, — tha mjeshtri. — Mos u trembni.

— Lokomotiva po i largohej gjithnjë e më shumë oficinës.

— Me ç'shpejtësi po ecim? — pyeti piktori.

— Me tridhjetë kilometra në orë.

— E ha! Rraketë fare. Kristo, si e ngjet gjithë këtë bina mu si bicikletë!

Kur vuri re se po i largoheshin si shumë qytetit, Ajet Shkëmbi hapi krahët së i zënë në hall.

— Kristo, nuk e kuptoj si do të kthehemitani. A ecin mbëapsht këto pela veterane?

— Patjetër, i dashur. A doni të kthehemit?

— Po, — thanë miqtë njëzëri.

— Atëherë i këpusim një të frenuar, — mjeshtri tärhoqi një levë blu në morinë e ngatë-

rruar të instrumentave të komandimit dhe pëpritur një sirenë gjërricëse gjëmoi sikur tingujt dilnin nga fundi i dheut.

Kristo Shigjeta nuk e humbi qetësinë.

— Si rregull i bihet sirenës para frenimit. Mbahuni fort tani! — ai tërroi një levë tjetër, por më kot. Lokomotiva vetëm sa shfryu tym të zi. Ekskursionistët ngrinë.

— Kristo, kù janë frenat? — lëshoi një zë të dridhur aktori.

— Do t'i gjejmë, Ajet, ruaje qetësinë.

— Ta' rrotulloj këtë dorezën?

— Jo! Ajo është për ndriçimin.

— Po kë të rrotulloj?

— Prit! E gjeta! Është kjo leva e kuqe që luajta në fillim! — mjeshtri e tërroi atë me gjithë krahun, por përsëri luanesha e egërsuar s'deshi tia dinte. Ndërkohë një sirenë u dëgjuat diku përpara. Alajdin Arbana zgjati trupin jashtë dritares.

— E tmerrshme! — klithi. — Po vjen treni i pasagjerëve! Kristo, treni i pasagjerëve! Frenoje dreqin! Bo-bo! U fikëm! Do të përplasemi, Kristo!

— Kristo, manovro të lutem! — thirri aktori,

Vetëm shkrimitari nuk lëvizi nga vendi.

— Mos bërtisni kështu! — urdhëroi me ashëpërsi. — Frenat do t'i gjejmë.

— E pamundur! — murmuriste mjeshtri duke gërmuar nëpër instrumente. — Di t'i kenë ndërruar frenat pa dëjeninë time.

Ai filloi t'i tërhiqte të gjitha levat e t'i rrotullonte të gjitha dorezat me radhë, megjithatë

lokomotiva vazhdonte të çante përpara.

— Djema, shpëtoni kokën! — thirri Ajet Shkëmbi duke zbritur shkallët. — Po afrohet një kanal i gjerë. Unë do të hidhem.

— Mos, Ajet, se do të vritesh! — iu lut Kristo Shigjeta.

— Mos, Ajet! — thirri edhe shkrimtari.

— Ika!

Pas aktorit u vërvit në kanal edhe Alajdin Arbana duke lëshuar një pasthirrmë ngjethëse. Mjeshtri i avulloreve mbërtheu kokën me duar. Miltiadher Nerënxa doli te shkallët dhe filloi të tundte krahun:

— Jemi pa makinist! E hej! Jemi pa makinist!

Ndërkohë një punëtor hekurudhe po kalonte aty pari. I tmerruar ai vrapoi te një ndërruese shinash dhe e nxori lokomotivën me avull në një linjë tjetër. Luanesha e egërsuar u fut në një stacion të vjetër mallrash, ndërsa treni i pasagjerëve kaloi me furi përbri.

Miltiadher Nerënxa mbuloi kokën me xhaketë, ndërsa Kristo Shigjeta ishte mbledhur kruspull ulur në gjunjë. Kur nuk ndieu asnjë lloj përplasjeje, ata filluan ta mblidhnin veten.

— Kristo... tani... kaloi! — belbëzoi shkrimtari — Ç'mrekulli!

— Mos u çudit, Milto. Unë e nxora lokomotivën në linjë tjetër, — rënkoj mjeshtri. — Ky ishte guri i fundit, por i sigurt. Alajdini e Ajeti koto u hodhën në kanal.

— Të lumtë, Kristo!

— Ta hajë dreqi! Tani i gjeta edhe frenat — Kristo Shigjeta tërhoqi, më në fund një levë

tjetër të kuqe pranë këmbëve dhe lokomotiva u ndal më të vërtetë. — Torollakët! Ua kanë ndërruar vendin frenave dhe s'më kanë njoftuar.

- Kristo, paskanit qenë dy lëva të kuqe.
- Tani po i shoh, i dashur.
- S'po më besohet që shpëtuam.
- Çështë ajo fjalë, bre Miltë?! Ne i shihim të sigurt. Po më vjen inat pse u bë kët gjithë ajo rrëmuje. Si thuá, a kthehem i tani?
- Kristo, sikur t'u çonim fjalë makinitit dhe ndihmësit?
- S'është nevojai i dashur.
- Mbaje levën e frenave me dorëiqëtë mos e ngatërrosh.
- Mos ki merak.

Dy shokët e provës së madhe morën rrugën e kthimit duke kërkuar me sy përmakrobatët e kanalit. Ajeti e Alajdini kishin dalë në një sop dhe po shtrydhnin rrobatë dukë u dridhur. Ata ulën kokat duke u shtirë sikur nuk e shikonin lokomotivën që po afrohej. Kristoja u qëndroi pranë.

Djema, më vjen keq që lu lagët, tha më gjysmë zëri. Ejani të ngroheni këtu pranë furrës!

— Jo, ia ktheu prerë aktori. — Do, të kthehem i me ndonjë makinë.

— Ajet, e kemi gjetur levën e frenave, tha shkrimitari.

— Tani pranoj të hipi në anije kozmikë dhet aty nuk vij.

— Po ti, Alajdin?

— Asunë.

— Po më mbani mëri?

— Në asnje mënyrë, i dashur. Ti e kuption, nuk duam të dukemi të lagur andej nga oficina. Vazhdoni ju, në mbrëmje takohemi te lulishtja.

Mjeshtri e vuri lokomotivën përsëri në rrugë.

— A thua do të mbajnë mëri? — iu drejtua Miltiadhit.

Shkrimtari buzëqeshi.

— Kurrsesi. Ne e kemi aq shoqëri, Kristo, sa të rrezikojmë për njëri-tjetrin. Le që ky i sotmi s'qe aspak rrezik.

Alajdini e Ajeti, në këto e sipër, vazhdónin të dridheshin buzë kanalit,

— Ah, ne jemi budallenj, — psherëtiu piktori i penduar. — Marrim rrugën e vijmë hipim nëpër lokomotiva. Më vrafshin mua në ka haber Kristoja nga ato pelat veterane.

— A ramë në kanal ne? — u nxeh aktori.

— Tani fol ç'të duash ti.

Por katër shokët e ngushtë nuk ishin nga ata që mund ta vinin në dyshim miqësinë. Për këtë kishin dhënë plot prova. Në mbrëmje ata shtrënguan duart me njëri-tjetrin te lulishtja në qendër të qytetit, duke buzëqeshur sikur aventura me lokomotivën me avull të kishte ndodhur para nja dhjetë vjetësh.

XIV

Në sheshin e vogël para hyrjes së godinës së Lidhjes së Shkrimitarëve e Artistëve Miltiadhi Nerënxa u dha një herë flokëve sipër me atë gjestin e vet të prerë djaloshar, pastaj shtrëngoi çantën e madhe në dorën e djathjtë dhe i zbritti shkallët me pamjen e atyre figurave të shquara shtetërore që zbresin nga avioni nëpër pritje aeroportesh. Ndihej i kënaqur deri në qelizën më të fundit të organizmit. Seksioni i letërsisë i kishte miratuar një leje dymujore krimtarie të shoqëruar me dieta, ashtu siç e kishte kërkuar. Rédaktor Gent Shijaku dhe dramaturg Stefan Malasi e kishin përgëzuar në vëçanti për nismën e guximshme të fshatit dhe e kishin quajtur njeri me interesa të mëdhenj krijues. Redaksia e gazetës «Drita» i kishte premtuar se do të jepte një njoftim në faqen e parë kur ai të nisej për në fshat.

Pasi kaloi nja dy orë në Bibliotekën Kom-

bëtare, Miltiadher Nerënxa mori trenin për t'u kthyer në shtëpi duke shpërthyer rrugës një debat të fortë me nja dy amatorë të poezisë që pëlqenin vargun e lirë jashtë mase dhe strofën e quanin «mbeturinë të romantizmit». Pasdite u takua me shokët e ngushtë në vendin e zakonshëm, në lulishten në qendër të qytetit dhe ua njoftoi lajmin me solemnitetin që i takonte.

— Sigurisht që leja do të miratohej, — tha i pari Alajdin Arbana. — Ti, Milto, ke dhënë për realizmin socialist.

— Bile duhet t'i kishin dhënë katër muaj, — e mbështeti Ajet Shkëmbi. — Gjashtë fare! Bëhet fjalë për një roman me temën e fshatit që do të eklipsojë edhe «Lumin e vdekur».

— Një artisti sì Miltoja i dhimbset leku i popullit, — tha Kristo Shigjeta, — Me dy muaj leje ai është i kënaqur.

Shkrimtari pohoi me kokë, tepër serioz.

— Duhet të shkojmë tani te «Gjetari» e të bisedojmë shtruar, — tha pastaj. — Më vërtitet në kokë ideja e një plani të madh.

Ata të tre pranuan. Ù ulën në një cep të lokalit dhe porositën si shpeshherë verë e qefull skare.

— Ju, shokë, në çdo rast, në të mirë e në vështirësi, s'më keni lënë kurrë vetëm, — filloj të fliste Miltiadher Nerënxa i emocionuar.

— Kam besim se edhe në fshat s'do të më braktisni.

— Në asnjë mënyrë! — thirri Alajdin Arbana. — Mua më ke me vete. Do ta nisim lejen krijuese bashkë.

Shkrimtari i shtrëngoi dorën. Mbi duart e tyre

u vendos me yrull edhe dora e fuqishlune te Ajet Shkëmbit.

— Me vete më keni edhe mua. Dy javë lejetë, zakonshme plus një muaj që do ta kërkoj përtë vënë, në fshat ndonjë dramë me kooperativistët, bëjnë një muaj e gjysmë. A dalin?

— Goxha janë, — tha piktori. — Po a do të ta japid atë një muaj leje?

— Do të ma japid se s'bën! Unë do të shkoj në fshat përtë gjallëruar jetën kulturore-artistike. Kush ka të drejtë të më pengojë?

Vështrimet e tyre ranë mbi Kristo Shigjetën, i cili ishte përhumbur me vështrimin ngulur në gotën e verës.

— Kristo, po ti nuk do ta sajosh ndonjë muaj leje? — tha Miltiadhi Nerënxa. — Je shpikës, e racionalizator me emër në qytet. Të takon. Tërë ajo literaturë përllokotivat do kohë të shfletohet. Apo jo?

Inxhinieri i hekurudhave u ngjallërua befas.

— Do ta provoj. Një muaj leje besoj se do ta marr. Shto edhe lejen e zakonshme. Jemi në gregul? Milto tingjithmonë, ke qenë mjeri i planeve, të mëdha. Do të nisemi të katër! Pünë e mbaruar, — dora e tij u ngjesh mbi duart e shokëve. Tayolina u drodh.

— Atëherë të vendosim përfshatin, — tha Alajdin Arbana. — Ky është problemi më i dëlikat.

Ata kthyen gotat me verë përtu thelluar në mendime. — Do të shkojmë në Burimas, — tha aktori i pari. — Është më afër?

— Jo, — kundërshtoi shkrimitari. — Burimasi është fshat i vogël, pa frymëmarrje.

— Po në Selishtë? — pyeti piktori.

— Jo! — kundërshtoi përsëri Miltiadhi Nërenxa. — Selishtha është fshat pa të kaluar historike. Në roman do të përqendrohem shumë tek e kaluara dhe periudha e Luftës Nacionalçlirimtare për t'i futur në linja retrospektive.

— Unë do të vija edhe këto kushte, — tha inxhinieri, — veç së kaluarës historike, fshati duhet të ketë afër edhe dy objekte jetikë për ne: pyll dhe det. Mos harroni se jam gjuetar! Çiften, Pipin, Rozën e Majkun, rrjetat e peshkimit e parangallët do t'i marr me vete, s'vij dot pa to.

Të tjerët ulën kokat. Po bëheshin tri stinë që Kristo Shigjeta as ishte ndier për gjueti, çifte e zagarë. S'i ishte larguar qytetit më shumë se plazhi. Thirrja e tij «jam gjuetar» kishte tingëlluar tepër e befasishme njëloj sikur të kishte thënë «jam kozmonaut». Inxhinieri i hekurudhave edhe vetë e kuptoi se shpërthimi kishte qenë tepër i pajustifikuar.

— Më duhet që këtë verë t'ia kushtoj gjuetisë, — tha i menduar, duke dashur ta përmirësonë situatën. — U bë kohë që s'e kam shkrepur. Ju e dini se shiatiku në këmbën e majtë më torturoi. Më është shpifur si ato gjylet që u lidhnin sklevërve nëpër këmbë përtë mos u larguar.

— Shiatiku është vdekja e vërtetë për gjuetarin, — e mbështeti Ajet Shkëmbi. — A ndihesh më mirë tani?

— Po, po. Tani mund t'u dal përtej edhe xhunglave të Amazonës.

Miltiadhi e Alajdini s'ndiheshin. E dëgjonin për herë të parë faktin e hidhur se shoku i tyre vuante nga shiatiku.

— Kristo, ti je snajper! — thirri aktori. — A do të na vrasësh ndonjë derr të egër si ai që vrate parvjet në pyjet e Burrelit?

— Vetëm të ketë se Kristo Shigjeta s'ia përton as leopardit.

— Pale rosat e egra! Do t'i shkojmë në hell!

— Patjetër!

— Brë! Ç'verë ideale na pret, — vazhdoi Ajet Shkëmbi. — Do të kënaqemi duke gjajtur, duke bërë plazh e not. Prisni! Nuk do t'ju lë me veshin shurdhër. Do të marr me vete edhe kitarën.

— Detyrimisht duhet ta marrësh, — tha Alajdin Arbana. — Jeta në natyrë pa muzikë nuk ka kuptim. Kitarë, në breg të detit, fllad, verë të kuqe, peshk, skare, oh, edhe sheikët e Arabisë Saudite do të na kishin zili.

— Alajdin, je shumë romantik, — tha Kristo Shigjeta.

— Nga romatizmi ne vuajmë të gjithë, — arsyetoj Miltiadhi. Nerënxa, — përderisa jemi artistë. Tani, unë them që lejen ta kalojmë në Fushëndritë. Ai është fshati madh, i njohur, pranë detit dhe pranë një pylli të madh me pisha. Kooperativa shquhet për rezultate të larta. Hë, si ju duket?

— Edhe mua më pëlqen Fushëndritë ja shtëzakonisht, — e mbështeti piktori.

— Ah, Milto, më këqetur midenë, — gati brohoriti inxhinieri duke e kthyer gotën e ve-

rës me fund, — Ah, Fushëndritë, sa kujtime gjuetie më ngjall! Sa lepuj, sa rosa të egra, sa qefull e levrek! Është vend i përsosur. Pale bretkosat e kërmijtë! Bëhen pa hesap.

Pas këtyre fjalëve piktori e shkrimtari u kapërdinë si me siklet. Kristo Shigjeta ishte i njohur si ngrënës i pangopur i kërmijve e bretkosave, s'i ndërronte ato kafshëza të adhuruara as me mishin e fazanit. Nëpër qytet flitej se ai kishte gatuar edhe breshka e gjarpërinj, ndaj disa e kishin quajtur «njeri me gusto aziatike», ndërsa disa të tjerë, ca ish-myslimanë të prapambetur, e thërrisin me nofkën «Kanibali».

— Do të rrojmë ca kohë si bij të vërtetë të mëmës natyrë, — vazhdoi të fliste plot zjarr Kristo Shigjeta. — Si indigjenë të vërtetë. Ah, ç'më dha zemra një të therur! Nuk më bëjnë mirë emocionet e forta.

Shkrimtari ia mbushi gotën me verë.

— Ktheje edhe një herë, Kristo, se të mbledh. Ashtu! Ah, sa i kushtojnë njeriut passionet e fuqishme!

— Ajet, po ti ç'thua për Fushëndritën? — pyeti Alajdin Arbana. — Përderisa ka plazh, përmua është mrekulli, — ia ktheu notari kra-hëfuqishëm i distancave të gjata.

— Atëherë u vendos, — tha Miltiadher Nerë-nxa. — Në Fushëndritë. Na daltë për hajër! Tani, bëjini të gjithë thirrje fantazisë. Si mund ta kalojmë kohën sa më bukur në fshat? Ç'pajse të tjera të marrim me vete? Ç'literaturë? Plane, shokë, plane! Jemi para një ekspedite të vërtetë.

Të ngazëllyer nga vera e kuqe dhe nga ideja e ekspeditës së bukur që i priste, katër shokët e ngushtë, katër artistët e pasioneve të ndezura, katër romantikët e dashruar pas natyrës dhe gjahut, u lëshuan nëpër shtigjet e fantazisë derisa afroi ora e mbylljes së lokalit.

Nga bisedat nëpër shkallët e pallatit

- E morët vesh? Miltoja do të niset për në fshat. Do të jetojë atje dy muaj.

— Është e vërtetë?

— Po. E dëgjova vetë nga Sofia.

— Është shkrimtar me sedër ai. Do ta njohë mirë atë që shkruan. Ka në plan një trilogji përfshatin.

— I lumtë, për nder! Tamam si Tolstoi.

— Çdo gjë Miltoja e bën si Tolstoi.

— Jua kam thënë njëqind herë: ai është një snob! Shkon në fshat për të bërë bujë, përtu dukur artist revolucionar, i lidhur me problemet e ditës. Kurse atje do t'ia këputë kovaleshencës.

— Apo s'do të marrë me vete edhe tre shokët e ngushtë!

— Dëgjova se janë pajisur rëndë përgjueti.

— Ta merr mendja!

— E keni gabim. Miltoja është nga ata që

s'bëjnë zhurmë kot. Romanin do ta shkruajë. E harruat tragjedinë me turq?

— Vepra si tē Miltos shkruan edhe vjehrri im.

— Nuk thoni shyqyr! Akoma s'ka shkuar përgjithmonë në fshat! Të shpëtojmë një herë nga ajo makina e shkrimit se na çmendif...

XV

Paraditen e 1 qershorit në sheshin e madh
të taksize të qytetit binte që larg në sy një
grumbull i madh çantash, një kitarë, tre zagarët e
famshëm, të Kristo Shigjetës: Pipi, Roza, e
Majku, që bridhnin pa ndërprerë rrëth e rro-
tull dhe aty pranë shoqëria e njojur e katër ar-
tistëve, e zgjeruar nga gratë e tyre. Shumë ka-
limitarë e kuptuan se shokët e ngushtë po ni-
seshin për diku. Kureshtarët u mblodhën rrotull
pa vonesë duke buzëqeshur me Pipin, Rozën e
Majkun që, të uritur, kërkonin ndonjë copë bukë
apo çfarëdolloj mbeturine, sepse dy javë të tëra
Kristo Shigjeta i kishte torturar me një trajtim
kampi përqendrimi për t'i dobësuar pas tërë asaj
dhjamosjeje të gjatë tristinore. Ndërkohë katër
shokët e ngushtë bënë nja dy fotografi pranë çan-
tave. Gratë e tyre buzëqeshnin aty përbri. Njerë-
zit filluan të pëshpërisnin me respekt kur morën
vesh se katër artistët po niseshin për në fshat
me lejë krijuese.

Pas pak një dispeçer i agjencisë së takrive i ftoi të katër shokët të hipnin në karrocerinë e një kamioni të vogël bashkë me pajisjet e tyre. Bë-heshin gjithsej dymbëdhjetë çanta të mëdha. Ndër to, katër i përkisnin Kristo Shigjetës dhe ishin mbushur njëra me ndërresa e cikërrimat e tualetit, tjetra me literaturë hëkurudhore, ku mbi dhjetë libra trajtonin probleme të lokomotivave me avull dhe dy të fundit me pajisjet e gjuetisë dhe peshkimit. Me të njëjtin numër çantash nisej për në leje krijuese edhe Alajdin Arbana, dy prej të cilave ishin mbushur me orendi profesionale. Ndërsa Miltiadhi Nerënxa e Ajet Shkëmbi kishin marrë nga dy çanta kryesisht mbushur me literaturë artistike. Karroceria e kamionit të vogël u mbush dinga dhe ata u detyruan të qëndronin në këmbë.

Më në fund katër shokët u nisen duke përshtendetur gratë dhe njerëzit që ishin mblehdhur për t'i përcjellë. Ishte një ditë e bukur, e ngrohtë, që tregonte qartë se një verë e mbarë dhe e gjatë tashmë kishte hyrë. Ndërsa kamioni çante me shpejtësi përmes rrugës së gjërë me plepa, Miltiadhi Nerënxa lëshoi befas një psherëtimë filozofike:

— Ah, lëvizja, udhëtimi i duhen artistit vëllezër! Kjo leje krijuese në fshat do të na shpëtojë nga rrethimi i zyrës dhe frazimi intelektualist në trajtimin e jetës. Duhet t'i jemi mirënjohës fshatit.

— Gjithë artistët e mëdhenj e kanë dashur fshatin, — tha Kristo Shigjeta.

Rreth drekës kamioni i la katër artistët, dymbëdhjetë çantat, tre zagarët e gjuetisë dhe

kitarën në të hyrë të Fushëndritës. Ata u ulën në një hije dhe filluan të kundronin me nge fshat përreth.

— Bukur, ë? — pyeti inxhinieri si i rrahur me ato anë,

— Jashtëzakonisht, — tha piktori. — Do të dal pasdite për të kërkuar peizazhe.

— Më ke me vete, — ia priti shkrimtari.

— Deri në breg të detit, — shtoi aktori.

Ndërkohe një grup djemsh shkolle i përshëndetën të porsambërriturit dhe rrëmbyen çantat për t'i ndihmuar. Ata të katër hynë në fshat duke tërhequr vëmendjen e tërér atyre kooperativistëve që po ktheheshin nga puna, e shitësve, e nëpunësve të zyrate të kryesisë dhe pleqve të ulur nëpër hije. Diskutimet u ndezën në çast. Të nisur nga Roza, Pipi e Majku shumë vetë i morën të porsardhurit për gjuetarë, por ky mendim u hodh shpejt poshtë për shkak të veshjes së miqve. Pati nga ata që i quajtën arkeologë, historianë, ekip ministrie, por më në fund një mësues letërsie njohu shkrimtar Miltiad Nerënxon dhe lajmi u përhap vrullshëm se në fshat ia kishin mbërritur katër artistë të famshëm.

Me thjeshtësinë që e karakterizonte dhe aftësinë prej shkrimtari për të komunikuar në çdo lloj mqedisi, Miltiad Nerënxa u fut mes kooperativistëve dhe filloi t'i takonte me radhë. Shembullin e tij e ndoqën edhe Alajdin Arbana e Ajet Shkëmbi. Vetëm Kristo Shigjetën e pentagonin zagarët, sidomos Majku që i vërtitej nëpër

këmbë. Disa kalamaj të vegjël u afruan të luanin më ta.

Pas pak katër miqtë nga qyteti u ulën në një hije mes fshatarëve që u hapën vend dhe i rrëthuan me respekt.

— Të katër shkrimtarë jeni? — pyeti një vajzë.

— Jo, vetëm unë jam i penës, — tha shkrimtar buzagas.

— Miltiadhi Nerënxa, autor i katër librave, — ndërhyri Alajdini. — Edhe një vëllim poetik del tani së shpejti, pesë. Dramaturg i njohur, prozator dhe poet. Kohët e fundit ka përfunduar një tragjedi historike me gjashtë akte.

— Alajdin, këto s'kanë edhe aq rëndësi, — tha Miltiadhi me modesti.

Fshatarët ia ngulën atij sytë pa e përbajtur habinë. Kurrë ndonjë autor tragjedie s'ishte dukur në Fushëndritë, as ndonjë shkrimtar që të kishte dhënë aq shumë vepra në të tria gjinjë.

— Shoku Alajdin është piktor, — e vazhdoi prezantimin Miltiadhi Nerënxa. — Peizazhist i talentuar, portretist, grafist, autor tablosh kompozicionale. Do të keni rast t'i shikoni veprat që do të krijojë këtu. Jua them pa frikë se është piktori më i talentuar i trethit tonë.

Alajdin Arbana buzëqeshi dhe u tundi kokën fshatarëve që kishin mbetur si të mekur. Dora e shkrimtarit u drejtua nga Kristo Shigjeta.

— Këtë shokun e kemi një artist të veçantë. Me profesion është inxhinier hekurudhash, shpikës dhe racionalizator. Krahas profesionit me-

rret edhe me përkthime. Zotëron italishten dhe frëngjishten.

Pas këtyre fjalëve habia e fshatarëve u dy-fishua. Syzet miopike i jepnин Kristo Shigjetës vërtet pamjen e një shpikësi në meditim e si-për.

— Dhe ky shoku simpatik, — vazhdoi shkrimtari, — është aktori i njojur, Ajet Shkëmbi, interpretues i dhjetëra roleve, njoħes i mirë i Shekspirit, i teatrit francez dhe anglez. Do të vërë në skenë me rininë e fshatit një dramë.

— Po zagarët? — pyeti befas një vajzë me gérsheta. — Jeni amatorë gjahu?

— Gjahu dhe peshkimi, — tha Miltiad Nerenxa.

Pasi ndenjën nja një orë aty në hije duke diskutuar me fshatarët për punën e artit e të bujqësisë, për gjendjen e rendimenteve dhe zotimet e marra, për klimën dhe kushtet e Fushëndritës, katër miqtë nga qyteti kerkuan të takoheshin me kryetarin. Ai i priti në zyrë me një respekt të veçantë. Kuptohej se ishte njeri me dobësi për artin.

— Mirë se erdhët, shokë krijues, — foli i emocionuar. — Ky është një nder i madh për kooperativën tonë. Kemi dëshire të na rrini sa më gjatë. Do t'ju mbajmë në pëllëmbë të dorës. A keni qejf t'ju sistemojmë në një apartament këtu në qendër, në pallatin e aksionistëve?

— Vendin e miqve e cakton i zoti i shtëpisë, — tha Miltiadhi. — Kryetari buzëqeshi.

— Atéherë, e kam unë në dorë këtë punë. Juve vetëm frymëzimi të mos ju mungojë. Vjet kishim këtu shkrimtar Kiço Shkumbinin. U kënaq Shkroi edhe gjëra të þukura.

— Ama, Kiço Shkumbini paska qenë! — nënqeshi Alajdini. — Miltoja do të shkruajë për fshatin tuaj një roman epope, mor kryetar, rrëth 900 faqe veprë!

— Roman shumëplanësh, — e pasoi aktori.

— Vepër që e para do të bëjë sintezën e rrugës së fshatit tonë që nga periudha e Zogut e deri në ditët tona, — vazhdoi inxhinieri.

— Vërtet?! Ju uroj sukses, shoku Milto! Be soj, shokë, se edhe jetën kulturore do ta gjallëroni ca.

— Detyrimisht, — tha Alajdin Arbana. — Miltója do fë mbajë një sërë ligjératash për letërsinë, unë, për pikturen dhe skulpturen, Ajeti për teatrin, estradën, për kinematografinë, kurse Kristoja për zhvillimin e industrisë mekanike.

Kryetari u ul në karrige gojëhapur.

— Ju lumtë, shokë! Me sa shoh, do të shpalosni një enciklopedi të téré.

Pas një bisede të ngrohtë pritjeje katër artistët u nisen për t'u sistemuar në apartamentin e pallatit të aksionistëve. I shoqëroi vetë kryetari. Ndërkohë zagarët e Kristo Shigjetës iu sulën atij për ta përshëndetur dhe Majku i dha një të térhequr miqësore për pantallonash, skenë të cilën ai e kaloi si duke qeshur e duke e quajtur Majkun buçko. Miqtë e pëlqyen jashtë mase stre-

hën e tyre të re dhe e falënderuan kryetarin me radhë

— Atëherë, punë e krijimtari të mbarë! — i uroi ai duke dalë si me siklet se mos Majku apo ndonjë prej zagarëve të tjerë i turrej përsëri.

Rreth orës tre, pas një dreke të bollshme e një sërë njojhesh të reja, katër artistët u shtrinë nëpër krevate, i hapën dritaret që të bëhej korrënt dhe nën përkundjen e gërhimës së fuqishme të Ajet Shkëmbit, gjoksi i gjerë i të cilit thithte pa u ngopur ajrin e këndshëm të fshatit, të tjerët ia këputën një gjumi kampistësh.

Pasdite bënë një shëtitje të gjatë parcelave të pafund duke lavdëruar herë pas here mëmënatyrë për hirësitë e saj dhe krahët e palodhur të kooperativistëve që kishin thurur qëndisma të vërteta rrëth e rrotull. Ajet Shkëmbi këmbënguli që të shkonin deri në breg të detit dhe shokët nuk ia prishën. Pishat e larta me kurorra të gjera si çadra, rëra e dendur dhe e trashë, ujët e përskuqur nga dielli që po binte tutje në perëndim, i mahnitën artistët.

— Nuk duroj dot, — tha aktori duke u zhveshur. — Do të futem.

Të tjerët qeshën.

Mbrëmja e ngrohtë e qershorit, një mbrëmje e kthjellët, me një qiell plot yje, të cilën Miltiad Nerënxa e quajti «mbrëmje me tone pushkiniane», i gjeti katër shokët e ngushtë duke biseduar në ballkonin e apartamentit, i cili vështronë nga deti. Dobësia romantike që i karakterizonte i mbajti gjatë aty. Vetëm rrëth orës

nëntë e gjysmë u shtruan nëpër krevate dhe hapën literaturën e bollshme që kishin marrë me vete. Kristo Shigjeta zbriti edhe një herë përtë parë zagarët e tij që i kishte strehuar në kopshtin e një shtëpie aty pranë, pastaj në apartament mbretëroi një qetësi bibliotekë.

Pas një leximi intensiv të rreth tridhjetë faqeve, të parit ia mundi gjumi qepallat Ajet Shkëmbit duke e shkëputur mizorisht nga një libër për tragjedinë antike greke, pastaj i shkau nga dora inxhinierit një vëllim poetik i Zhak Preverit. I treti u dorëzua Alajdin Arbana duke përblysur mbi gjoks një botim nga më të fundit përkiminë dhe pikturen. Vetëm sytë e shkrimitarit ndrisnin si projektorë. Ndërkohë që i tërë fshati humbi në një gjumë të thellë dhe tek-tuk dëgjohej ndonjë qen apo gjel i vonuar, ai hapi ditarin dhe filloi të hidhte mbresat e pafund të përrimit të lejes krijuese.

XVI

Ora e kishte kaluar tetën kur në apartamenti e katëri artistëve gjëmoi zëri i fuqishëm dramatik i aktor Ajet Shkëmbit:

— Djema, tunduni! Boll fjetët! Këto ditë duhet të mendojmë pak edhe për formën e trupit. Do të vendosim regjim. Në mëngjes do të bëjmë gjimnastikë.

Deshën s'deshën, ata u ngritën duke murmuritur të pakënaqur, u lanë në bel e sipër si spartanë të vërtetë, pastaj dolën në sheshin para pallatit duke tundur krahët. Nën drejtimin e aktorit filluan të zhvillonin ushtrime me katër dhe tetë kohë. Kush kalonte aty para, i vështronte me zili dhe i përshëndeste me respekt:

— Me krahë të lehtë, shokë artistë! E paskeni programin e punës tepër të ngjeshur.

Pasi i dhanë fund gjimnastikës me një vrap rreth e rrötull pallatit, katër shokët e ngushtë u veshën dhe u nisën për në mensë të lehtë si gjethi. Por dera e mensës kishte kohë që ishte

mbyllur. Kuzhinieri dhe një ndihmëse e tij po qëronin oriz aty në prag.

— Mirëmëngjesi, shokët e artit të kulinarisë!
— përshëndeti Kristo Shigjeta. — Si u gdhitë?
Kuzhinieri dhe ndihmësja e tij u vështruan
një herë të hutuar.

— Mirëdita! — thanë pastaj.

— Ç'do të na ofroni për të ngrënë?
Kuzhinieri ngriti supet.

— Më vjen keq, por mensa është mbyllur.
Miltiadherenxa qeshi shpenguar.

— Ah, vëlla, ti ndoshta s'e di që ne jemi
artistë. Dhe artistë do të thotë që shpesh mën-
gjesin ta hash në drekë, drekën në të errur dhe
darkën në dy të natës. Më kuption?

— E... po... po, të kuptoj, — belbëzoi ku-
zhinieri. — Ejani, po mundohem t'ju rregulloj.

Pasi vëndosën një harmoni të plotë në mes
të trupit të lehtesar nga gjimnastika dhe sto-
makut, katër shokët e ngushtë u ngritën, u për-
shëndetën me kuzhinierin dhe ndihmësen e tij,
pastaj mörën përmes fshatit.

— Tani do të fillojmë të mbledhim të
dhënat — tha shkrimtari duke nxjerrë bllokun
e shënimeve dhë stilografin. — Për të sotmen
dhe të kaluarën.

— Ç'illoj, të dhënash? — pyeti aktori.

— Të çdo natyre, Ajet. Roman do të thotë
kompleksitet, univers. Ja, të ndalemi te kjo par-
celë misri për shembull. Ç'rendiment do të ketë?

— Të pyesim.

Aktori i thirri një djalit të ri.

— Sa kuintalë për hektar merrni në misër,
shok?

— Mesatarisht shtatëdhjetë në gjithë si-përfaqen, — u përgjigj **djali**.

— Hë, më ju lumtë! — shkrimtari shënoi në bllok. — Po para Çlirimit?

Djali vështroi rrötull si për të kërkuar ndihmë.

— Ah, për këtë s'dua t'ju gënjej. Sikur të pyesnit pleqtë? Sidomos xha Taren.

— Kush është ky xha Tarja?

— Ai është muzeu i gjallë i fshatit tonë. Mban mend që nga koha e Turqisë.

Miliadhi Nerënxa tundi kokën.

— Do të më duhet ky njeri. Të faleminderit, djalosh!

Të takohet patjetër një plak i vjetër me emrin Tare për ta vjelë, shënoi pastaj në bllokun e vet.

— Milto, sikur të shkonim edhe nga stallat e kooperativës, — tha inxhinieri. — Besoj se të intereson prodhimi blegtoral.

— Patjetër, i dashur. Të shkojmë menjëherë!

Ata të katër u afroan në sheshin e gjerë para stallave të lopëve me pamjen e katër kureshtarëve që hyjnë në ndonjë park zoologjik të kafshëve të rralla të Afrikës. Dy mjelëse të reja që po kujdeseshin për ca viçë i përshëndetën me respekt. Miliadhi prezantoi shokët.

— Po, — tha njëra prej vajzave, e cila mbante shami. — Kemi dëgjuar për ju. Me se mund t'ju ndihmojmë?

— Shoku Milto po shkruan një roman përfshatin tuaj, — tha inxhinieri i hekurudhave.

— I duhen të dhëna. Ja, për prodhimin e qu-mështit, për lindjen e viçave, mbarështrimin e tyre,

— Lindjet i kemi pasur të mbara, — foli vajza me shami. — Tani kemi arritur mesatarisht në 15 kilogramë qumësht për lopë.

— Jashtëzakonisht me vlerë, — thirri Alajdini. — Shënoje, Milto. Me sa shoh, këto tre viça ngjakan shumë me atë lopën laramane, shoqë, — piktori tregoi një lopë të shëndetshme që përtypej me nge aty pranë. — Mos janë të sajtë që të tre? Unë them se po.

— Vajza me shami vështroi shoqen si me frikë.

— Ju e keni fjalën a... a i ka pjellë Lara këta tre viça??

— Pikërisht.

— Edhe unë them se janë trinjakët e Larës, — ndërhyri inxhinieri.

— Ju lumtë! — hyri në bisedë mjelësja tjetër. — E gjetët!

— Kolosale — thirri shkrimitari. — Një lopë lind tre viça. Shikoni ç'rezultate arrijnë blegtoresh tonë!

Dy mjelëset s'duruan dot. Megjithëse vunë duart para gojës, e qeshura u shpërtheu me zhurmë.

— Qeshin vajzat e fshatit tonë, qeshin, — tha Miltiadher Nerënxa. — Ato janë të lumtura, të gëzuara, puna në blegtori u jep kënaqësi të veçantë.

— Shumë, — thanë vajzat. — Na falni se po qeshim ca pa takt. Kështu na kap shpesh kjo dreq e qeshur.

— E qeshura tregon optimizëm, moj vajzë, — iu drejtua Alajdin Arbana mjelëses me shami. — Kur mund të vij t'ju bëj një portret?

— Oh, ju jeni ai piktori? Kur tē doni. Pēr ne ̄eshtē nder tē ndihmojmë artistë si ju. A ju pēlqen tē vizitoni stallat? Ndérkohë bëni edhe pyetje.

Ata pranuan. Bota e pasur e lopëve e tērhoqi Miltiadħ Nerënxeñ jashtë mase dhe faqet e blokkut tē tij filluan tē mbusheshin me shpejtësi. Alajdin Arbana hodhi nē fletët e dosjes sē tij nja pesë skica tē vrullshme. Kristo Shigjeta u bë shumë kureshtar pēr sistemin e transportimit tē ushqimit, i cili realizohej me vagona tē lehtë qē lēviznin mbi shina tē ngushta dekovili, kurse Ajet Shkëmbi zgjodhi me një mprehtësi tē pagabueshme tri vajza pēr nē teatér. Mē nē fund u ndanë miqësish me mjelëset duke u premtuar se do tē vinin përsëri pēr t'u mbajtur ndonjë bisedë. Ato i përcollën me tē qeshura tē forta.

Katér shokët vazhduan rruġġen. Ajet Shkëmbi po ziente nga vapa dhe mbante sytē vazhdimisht nga deti. Ndérkohë Kristo Shigjeta bridihte me imagjinatë nēpér pyllin e famshem me pisha. Kur e pa se tē dhēnat qē duheshin mbledhur s'kiskin fund, ai tha si me tē lutur:

— Milto, unë me Alajdinin po dalim njéherë pēr tē zgjedhur ndonjë peizazh. Mirë? Ku do tē takohemi?

— Nē breg tē detit, — tha Ajeti pa vonesë.

— Mirë, — pranoi shkrimtari. — Takohemi atje nga mesdita.

Ajet Shkëmbi i vështroi ata tē dy me zili tek largoheshin. Po i hanin shpatullat pēr pak not. Miltiadħ Nerënxa i futi krahun dhe da-

lëngadalë u afroan të një bli degëgjerë në të dalë të fshatit. Që nö të parë kuptohet se ishte një pemë e mocmë. Në hije të saj po çlodhet një grup kooperativistësh. Njëri prej tyre lexonte me zë një gazetë.

— Ky ah duhet të jetë shekullor, — i tha shkrimitari shokut. — Dhe një nga pikat më të njoitura të fshatit.

— S'është ah, — kundërshtoi aktori, — por rrap.

Ata u përshëndetën me kooperativistët dhe u ulën të hije.

— Vëllezër, sa i vjetër duhet të jetë ky rrap? pyeti Miltiadhi Nerënxa. — A mblidheni shpesh këtu?

— Është tepër i vjetër, — u përgjigj një burrë. — Edhe pleqtë e mbajnë mend që nga fëmijëria. Xha Tarja ndoshta e di me saktësi.

— Ky xha Tarja i ditka të gjitha!

— Xha Taren e këmi të zgjuar. Këtu, mor shok, mblidhemi pothuaj çdo pasdite. E kemi, si lulishtet tuaja në qytet. Veç...

— Hë? — pyeti shkrimitari.

— Nuk është rrap, por bli.

— S'ka edhe aq rëndësi. Këtë pemë të vjetër unë do ta fut në roman. Ajet, në një linjë retrospektive. Këtu vijnë gjermanët dhe varin, në degët e tij dhjetë fshatarë përmizori.

— Më falni, shoku shkrimitar, — tha një burrë me mustaqe, — por në fshatin tonë gjermanët s'kanë hyrë kurrë.

Miltiadhi Nerënxa buzëqeshi.

— Ah, ju lexuesit vuani shpesh nga ky realizëm vulgar. Besoni se çdo gjë që shkruhet

në libra ka ndodhur diku dhe dikur patjetër. Arfi, mor mik, çështë konvencion. Unë kam të drejtën e trillimit. Në fshatin tuaj kam të drejtë të përshkruaj djegie, masakra, bile edhe ndonjë betejë.

— Ashtu?! — ia bëri burri me mustaqe. — Nuk i dija këto. Domethënë të gjitha sa tregon ti i shpik nga mendja?

— Pothuaj të gjitha.

— Të lumtë pér nder! Kjo është zotësi.

— Romanin pér fshatin tonë do ta shkruani?

— pyeti një djalë.

— Po.

— A do të bëni shumë shpikje në të?

— Patjetër.

— Po atëhere ç'është nevoja të vinit këtu?

— Dëgjo, djalosh, njohja teorike duhet shkrirë me praktikën. Jeta e fshatit s'është njëlloj me atë të qytetit. Unë kam ardhur këtu pér të njohur jetën tuaj, punën tuaj.

— Me sa shoh, paske punë të vështirë.

Miliadh Nerënxa pohoi me kokë.

— Të shkruash një roman, do të thotë të ngrish i vetëm një piramidë nga ato të Egjiptit.

Kooperativistët shprehën habi dhe respekt njëkohësisht. Pasi u foli edhe ndonjë gjysmë ore se si shkrihej në një vepër njohja teorike me praktikën, pér raportin e trillimit me faktet jetësore, pér procesin e tipizimit dhe përgjithësimit (duke i ilustruar të gjitha këto nocione me tragjedinë e vet «Liria do të kthehet përsëri»), shkrimitari kërkoi leje të vazhdonte njohjen e fshatit. Kooperativistët e përcollën duke i uruar

punë, të mbarë me romanin dhe iu lutën që ta mbaronte sa më shpejt që të kishte mundësi. I kënaqur jashtë mase, Miltiadherë Nerënxa i futi përsëri krahun shokut. Ajet Shkëmbi mezi po duronte. Mendjen e kishtë te valët e kaltra, të detit, dhe te rrëvë e trashë e bregut.

— Milto, me kaq ta mbyllim, — tha si me ankim. — Vazhdojmë pasdite.

— Do ta mbyllim, Ajet, bëj durim. Këtu afër është një baxho. E shohim edhe atë. Jam shumë kurioz.

— Baxho? Për to edhe unë jam kurioz.

Ata hynë në ndërtesën e ulët të baxhos, rrethuar më plepa, dhe iu përshëndetën me dy baxhoxhinjtë që po lanin disa voza djathi. U prezantuan dhe Miltiadherë Nerënxa hyri drejt e në temë dukel hapur bllokun.

— Ju lutem, shokë, t'bulmetit, na tregoni diçka për punën tuaj.

Njëri prej baxhoxhinjeve, që mbante një këpuç të bardhë, filloi të fliste për punët e përditshme pa e kuptuar se ç'gjë me interes kishte në to për t'u mbajtur shënim. Pasi mbaroi larjen e vozave të djathit, baxhoxhiu tjetër foli buzagaz:

— T'ju sjell ca dhallë, shokë, t'artit? Ju ka djegur vapa.

— Mos keni gjë kos? — pyeti aktori.

— Pos! Urdhëroni.

Ai i çoi te një kazan i madh, i hoqi atij, kapakun dhe mbushi një garuzhde litorshe, me kos të trashë e elastik si gomë. Ajet Shkëmbi e thau garuzhden me një frysë duke lëshuar një

«ideal!» prapa. Shkrimtari e mbaroi litrin e tij me dy ndalesa, duke medituar.

— Kosi eshtë deleje, — tha. — Jam i bindur.

— S'e keni gabim, — e mbështetën baxhoxhijtë. —

— E dallova nga aroma. Kundërmon si një livadhi me lule. Ç'kanë kullotur delet dje?

— Bar, ç'të kullotin tjetër! — u përgjigj baxhoxhiu me kapuç.

— Jo, shokë. Ato kanë ngrënë edhe diçka tjetër aromatike.

— U! — ia bëri baxhoxhiu tjetër duke i rënë shokut në sup. — U kanë dhënë gjethë dafine të grirë në silazh.

— Po, tamam dafinë, — tha baxhoxhiu me kapuç.

Shkrimtari buzëqeshi.

— E shikoni që s'u gabova? Më fañni ta shënoj në bllok. Ajet, shijoje kosin ti, vazhdo shijoje.

Ajet Shkëmbi e mbushi rishtazi garuzhden dhe filloi të pinte duke e lëvizur lukthin e fytit poshtë e lart si ndonjë piston motori. Kosi gurgullonte nëpër laringun e tij të gjerë. Miliadhi e pasoi.

Baxhoxhijtë u vështruan mes tyre si të trembur.

— Shokë artistë, mos pini shumë se do t'ju dhembë barku, — tha baxhoxhiu me kapuç. Por aktori arriti të thante edhe dy garuzhde të tjera. Shkrimtari nuk e barazoi dot. Mbetën katër me tre. Baxhoxhijtë ia vunë kapakun kazanit si me marifet.

— Shokë të bulmetit, ju faleminderit! — tha

Miltiadħ Nerënxa duke gogësiré. — Tani puné
tē mbarë dhe mirupafshim!

— Hajt, udhë tē mbarë! — ia ktheu baxho-
xhiu me kapuç.

— Bo-bo! — murmuriti tjetri. — Shtatē ki-
le kos.

Dy artistet u nisën pér nē bregdet duke fér-
kuar barkun heré pas here, por nuk mundén tē
shkonin dot larg. Aktorit filloj t'i therted sto-
maku. Shkrimtari ndiente njälloj sikleti. U shtriné
nē njé hije plepi duke rēnkuar si tē plagosur
dhe dalengadalé, iżuri gjumi nē kokerr tē shpi-
nés.

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

— Iż-żejt, iż-żejt, iż-żejt... — ġej, ġej, ġej... — ġej,

Fragmente nga ditari artistik

Fragmente nga ditari artistik

Sa e çuditshme qenka jeta! Ç'surpriza të sillka ajo! Shkrimtarit i qëlluaka të ndeshet me heroin e veprës së vet, të cilin po e konturon prej kohësh në mendje. Dhe ky hero është aq konkret e i gatshëm, sa të vjen ta fotografosh.

Sot, ndërsa po kaloja pranë një parcele të mbjellë me misër, dallova një djalë e një vajzë që prashisnin pranë njëri-tjetrit buzagaz. Si gjithmonë intuita nuk më gaboi. Ata të dy duhej. Djali ishte aksionist i ardhur nga qyteti dhe kjo më befasoi. Menjëherë mendova se edhe vajza duhej të ishte nga qyteti si në projektin e romanit tim. Por jo. Vajza ishte fshatare. I vura gishtin kokës dhe reagova gjatë. Realiteti s'të lejuaka të ngresh skema. Ja ku ndodheshin heronjtë e mi!

Vendosa pa vonesë ta ndërtoj subjektin e romanit sipas sugjerimit të shokëve dhe ashtu si

ma ofroi njohja e jetës. Një djalë vjen nga qyteti dhe martohet me një vajzë nga fshati. Dotë ketë dy dashuri: një të dështuar dhe një të lumtur. Djali në qytet donte një llogaritare, por ajo s'pranon të shkojë me të, sepse është rritur me teka mikroborgjeze dhe s'i pëlqen balta. Herroi e kupton se e tërë dashuria e tij ka qenë një zhgënjim dhe ka forca të ndahet si burrë. Por në fshat ai gjen dashurinë dhe lumturinë e tij te një vajzë e thjeshtë kooperativiste. Antiteza ka një nëntekst mjafët të qartë: dashuria e vërtetë lind në frontin e punës dhe jo nga dobësi të rastësishme sentimentale...

Po e ndiej se është e kotë të pres më. Fillimin e romanit tashmë e kam të qartë e të prekshëm, sa më duket gabim po të mos i përvishem...

Nga Tirana mora lajme të mira. Vëllimi «Fllade e stuhit» është në procesin e lidhjes. Oh, sa të kam pritur, vepra ime e dashur!...

shqipëritë, që i kishin gjithashtu qëndruar. Në këtë mënyrë, që
nëpërveç vërtetë së përmendurit, ka qenë që nuk ka
qenë shumë e lartë që këto vjet, që këto vjet, që
nëpërveç vërtetë së përmendurit, ka qenë që nuk ka
qenë shumë e lartë që këto vjet, që këto vjet, që
XVII që këto vjet, që këto vjet, që këto vjet, që këto vjet, që këto vjet,

Po mbushëj javë e mbërritjes në Fushëndritë
dhe tashmë për këdö ishte tepër e vëشتirë t'i gjen-
te të katër artistët qoftë edhe një minutë të lirë.
I pari zhdukej nga apartamenti Kristo Shigjeta;
dukeniut shiangur edhe gjimnastikës. Me çif-
ten, në sup, i veshur me një kostum të lehtë;
doku, çizme, me qafa, një kasketë, një kokë, me
gjerdaniët e fishekëve, kryqëzuar, në egjoks, me
një çantë të madhe, në shpinë, dhe me Pipin,
Majkun, e Rozën që vi lodronin, nëpër këmbë, ai
nisej drejt pyllit me pisha, në jug të fshatit, për-
tull, kthyer, prej landej, vetëm në të perënduar.
Megjithatë, pas katër ditësh të lodhshme, gjahu-
kishte sjellë të vrarë, vetëm një thëllëzë, të vogël.
Darkë, për darkë, duke shfryrë me binat,
mjeshtri i gujetisë fillonte tregonte rastet e
shumtaj që kishte pasur. Një lepur e kishte
plagosur keqazi, por zagarët nuk e kishin gjetur
dot, në një tufë rosash, për dreninuk i kishte
shkrepur çiftja, një herë tjetër i kishin, rënë;

syzet e plot tersilëqe të tjera që ai nuk po e kuptonte se kush ia ndillte. Por rastë më legjendar kishte ndodhur thellë në pyll me një derr të egër, i cili kishte qenë aq i tmerrshëm, sa u ishte vërsulur zagarëve. Kristo Shigjeta kishte arritur t'i këpuste dy plumba, por ajo bishë e lemerishëmë nuk donte t'ia dinte, e kishte pasur lëkurën si çelik tanku. Tre shokët e tjerë, të bërë jashtë mase kuriozë pas gjuetisë, po i luteshin mjeshtrit që të shkonin një ditë bashkë në pyll. Ja, duroni, ua kthente ai, sa të gjemë edhe një cifte tjetër dhe do të shkojmë.

I dyti, aty rrëth orës dhjetë, me çantën mbushur me bukë dhe me literaturë, nisej për në breg të detit Ajet Shkëmbi. Pás disa kilometrave not e banjash dielli, ai ia mbërrinte në fshat bashkë me rrezet e perëndimit që i reflektonin në lëkurën e bronztë. Në endjet e tij për të mbledhur të dhëna Miltiadher Nerënxa kishte filluar të mbetej vetëm. Alajdin Arbana e shoqëronte një copë herë, pastaj me kutinë e bojërave në sup nisej për nga bregu i detit duke thënë si me keqardhje:

— Milto, më duhet të vazhdoj një peizazh. Takohemi më vonë...

Një të shtunë mbrëma, nga një kopsht aty pranë pallatit vinin në apartamentin e katër artisteve tingujt e gëzuar të një klarinete. Bëhej dasmë. Miltiadher Nerënxa u vesh, pastaj ngriti nga krevati edhe Alajdinin e Kriston.

— Ejani shpejt! Do të shkojmë te kjo dasma këtu afër për të mbledhur material. Në dasmë më shumë se kudo fshatari e zbulon botën e tij të pasur shpirtërore. Po Ajeti ku është?

— Ka shkuar te kryetari i kooperativës, — tha Alajdini. — Për atë grupin teatral.

Ata të tre dolën pa vonesë. Aktorin e ndeshën në oborr të nxehur.

— Ç'ka ndodhur? — pyeti Alajdini.

— U grinda me kryetarin, — Ajeti tundi kokën i pakënaqur. — Çudi e madhe! Ti vjen nga qyteti për të vënë dramën këtu, për të përhapur kulturën, ai të thotë s'të jap njerëz. Jam në prag fushate, e kam litarin në fyt. Po deshe, organizo ndonjë koncert të vogël.

Kristo Shigjeta qeshi.

— Dhe ti më turfullon kështu, si levrekut në rrjetë? Hajde, Ajet, hajde! Bukuri për ty. Kryetari s'do. Bëj një koncert dhe... Äpo jo?

— Atij i dhimbset koha dhe jefat teatrale, — tha shkrimtari. — Nuk ke faj, Ajet, ta kuptoj shqetësimin.

— Ti ë bëre luftën tënde, Ajet, — i dha zemër piktori. — Moš u mërzit tanë. Eja, do të shkojmë në dasmë.

— Fundja kryetari le ta mbajë përgjegjësinë, — tha Ajet Shkëmbi. — Nuk e vlerëson sa duhet teatrin për mobilizimin e njerëzve në punë.

Ata të katër hynë në oborrin ku po bëhej dasma me pamjen e atyre turistëve që i tërheq ekzotikë. Orkestra pushoi menjëherë. Njerëzit hapën vend me respekt. I zoti i shtëpisë doli t'i priste. Migtë i ulën në pjesën më të dukshme të oborrit.

— Shumë vend i bukur për dasmë, — iu drejtua Miltiadhi të zotit të shtëpisë. — Kë martoni, djalin?

— Po.

— T'ju trashëgohet! Sa vjeç është?

— I ri është, 22.

— Bukur! Shumë bukur! Ta shënojmë,

— shkrimtari nxori me vrull bllokun. — Sa të rinj martohen djemtë e fshatit! Ky është kuptim i drejtë pér jetën dhe një mësim i madh pér ata beqarët e qytetit që gjejnë nuse kur kalojnë të tridhjetat.

— Djali e mori vajzën me dashuri?

I zoti i shtëpisë qeshi.

— Po shejtani, e gjeti vetë. Ne deshëm t'i bënim një me shikuesi, por nuk pranoi. Dashuria të merr mendtë, mor shoku shkrimtar.

— E bukur! — thirri i ngazëlliyer shkrimtari. — Ta shënoj. Të rintjtë e fshatit sot martohen me dashuri. Kjo është një fitore e madhe jo vetëm në planin kulturor, por edhe ideologjik.

Një vajzë e shikathët u solli miqve raki dhe nga një meze të lehtë. Pasi Miltiadher Nerenxa rreshtoi edhe nga dhjetë pyetje të tjera, pér të cilat mbajti shënime të hollësishme, biseda kaloi te dasma dhe telashet e shumta të saj. Ndërkohë orkestra gjëmonte, vallja dridhej nëpër oborr dhe Ajet Shkëmbi s'mundi të duronte. Kristoja e shoqëroi dhe të dy kërkuan «Vallen e rinisë», të cilën e hoqën mbështetur sup më sup duke dredhur belin si djelmosha. Pati quartrokës. Pastaj Alajdin porositi këngën e Malanakes dhe miqtë u përqendruan te rakia.

— A e keni zbuluar dhomën e çiftit? — iu drejtua Kristoja të zotit të shtëpisë.

— Na duket se po, — u përgjigj ai.

— Po sikur t'i shtonit edhe një pikture? Pikturë ideale, tamam pér një dhomë dhëndri

e nuseje. Shoku Alajdin është piktor. Ai do t'jua shiste me kënaqësi peizazhin e vet «Mbrëmje dashnorësh mbi liqen».

I zoti i shtëpisë mblodhi supet.

— Me gjithë qejf, ta shohim.

— Jua sjell unë për pesë minuta, — tha Alajdin Arbana.

Kur piktori u kthyte nga apartamenti me peizazhin në duar, mrekullimi i dasmorëve që i përgjithshëm.

— Ua, c'pozë, moj nène! — psherëtiu një vajzë. — Ç'dashuri! Si nëpër përralla.

— Ç'ngjyra të émbla! — e pasoi një djalë.

— Shikoni hënën si shkëlqen mbi liqen dhe mbi flokët e vajzës së dashuruar.

— Një barkë si një fole lumturie, — tha një vajzë tjetër. — Oh, ky qenka peizazh.

— I bukur qenka vërtet! — I zoti i shtëpisë nxori portofolin. — Do ta blej, mor shoku piktor.

— Nga fundi i muajit kam edhe unë dasmë, shokù Alajdin, — tha ndërkohë një mik i shtëpisë. — Do të ma sajosh një peizazh si ky? Çmimin vëria vetë.

— Patjetër, — buzëqeshi piktori. — Patjetër. Do të mundohem t'ju kënaq.

Pas këtyre fjalëve pati edhe tri kërkesa radhazi për peizazhin e famshëm «Mbrëmje dashnorësh mbi liqen».

— Mos u mërzitni, — tha Alajdin Arbana. Unë do të qëndroj gjatë këtu, do të pikturoj për të gjithë.

Katër artistët qëndruan në dasmë deri nga ora nëntë, pastaj, duke e uruar të zotin e shtë-

pisë për djalin, u ndanë miqësisht. I ngacmuar nga rakia dhe «Vallja e rinisë», Kristo Shigjeta tha befas tepër i menduar:

— Milto, ti bën gabim që s'mbledh të dhëna edhe nëpër shtëpitë e fshatarëve, te ndonjë burrë i vjetër, te ndonjë veteran. Ja, mund të shkojmë që tani.

— Jashtëzakonisht ide e bukur. — e mbështeti Alajdini.

— Shfrytëzoje këtë mundësi, Milto, — tha Ajeti.

— Po mirë, — pranoi shkrimtari. — Ejani. Kam dëgjuar për një plak të vjetër me emrin Tare. Ia di edhe shtëpinë.

Ata hynë në një oborr të mbushur me kumbulla e hardhi. I ulën në një verandë të gjerë dhe i zoti i shtëpisë i përqafoi me radhë. Ishte një plak i qeshur e i shëndetshëm.

— Mirë se të gjetëm, xha Tare! — e përshëndeti Miltiadher Nerënxa.

Plaku mbloindi vetullat.

— Hëm, mirë se erdhët, por unë... s'jam Tarja. Jám Dule Dëllinja.

Ata të katër shtangën.

— Na falni, — kërkoi ndjesë shkrimtari, — por unë mbledh të dhëna për një roman dhe...

— Ah, ti je ai shkrimtari! — thirri Dule Dëllinja. — Sa mirë! Po pse, mos Tarja di më shumë se unë? Tarja vërtet është më i vjetër, por edhe unë kam parë e dëgjuar shumë në këtë dynja. Do të të tregoj ç'të duash.

— Të faleminderit, xha Dule!

Piktori, aktori e inxhinieri u çiruan nga

emocionet. Ndërkohë në tavolinë u vendos një shishe e bukur rokie me grykë të gjatë.

— Milti, respekoje xha Dulen me pyetje,
— tha Kristo Shigjeta.

— Po... Ja fillova. Mua më intereson jeta e fshatit tuaj në të kaluarën, revolta e fshatarëve kundër beut. A keni pasur bej këtu?

Dule Dëllinja tundi kokën i menduar.

— Kemi pasur, or mik, kemi pasur. Do të
të tregojë Dulja ty.

Ndërkohë që xha Dulja fliste dalëngadalë duke theksuar herë pas here shprehjen «me sa më kujtohet» dhe Miltiadhi mbante shënime, tre artistët pinin e hanin me oreks. Befas, nga gardhi i kopshtit u dëgjuan të lehura të ashpra qensh. Kristo Shigjeta brofi në këmbë. E njozu zerin e Majkut menjëherë.

— Janë zagarët e mi të gjuetisë, — iu drejtua të zotit të shtëpisë. — Më mirë më lini mua pa ngrënë sesa ata.

— Futini zagarët brenda dhe ushqejini! — urdhëroi Dule Dëllinja.

Pasi kishte shkruar ndonjë orë, Miltiadhi e mbylli blokun i lodhur dhe tha duke buzëqeshur:

— Tani do të ngremë edhe unë me xha Dulen nga një kupë.

Por ata të katër nuk kishin si ta dinin se ai xha Dule që dukej si i përgjumur mbahej ende në fshat si një nga kandidatët kryesorë për kampion në raki. Si fillim morën prej tij një shëndet për familjet e tyre kolektivisht, pastaj nga një shëndet veç e vec, me fund. Ajet Shkëmbi mendoi se plaku i kishte vënë në po-

zitë dhe propozoi një dolli pér të. Kështu doilia pasoi dollinë dhe, të ndezur prej lëngut erë-këndshëm të rrushit, miqtë filluan të zbërthenin bagazhin e tyre profesional duke folur njëri pér lokomotivat me avull, tjetri pér rrymat e ndryshme në pikturë, i treti pér truket filmike dhe i fundit e më i përbajturi, pér tipizimin e personazhit negativ të një beu.

I pari dha shenja jo të mira piktori. Ai vështroi sipër, mes hardhive, një copë qiel me yje dhe thirri i ngazëllyer:

— Oh, ç'natë pér peizazh! Van Gog, ku jë? Ku je, idhulli im? Unë vërtetë të imitoj ty në stil, por jam gati të të imitoj edhe në vëprime, — pas këtyre fjalëve piktori rrëmbeu një thikë buke. — Unë mund ta pres edhe veshin.

— Qyqja! — ia bëri e zonja e shtëpisë. — Ç'ke me veshin, mor bir?

Ajeti u vërsul dhe ia mori shokut thikën.

— Çojeni të flerë! — urdhëroi Dule Dëllinja.

— Jo, po ta dini se unë veshin mund ta pres! Ta dini! — thërriste Alajdin Arbana ndërsa e tërhiqnin pér krahësh.

Pas tij u ngrit inxhineri të mbante një fjalim pér lokomotivat me avull.

— Ju sigurisht nuk e dini që lokomotivën e parë në botë e shpiku anglezi Stevenson, — thirri duke rregulluar syzet mbi hundë. — E ç'ishte ky Stevenson, do të pyesni ju. Jua them unë. Unë i di të gjitha sekretet e lokomotivave me avull.

— Bëjeni gati krevatin! — urdhëroi Dule Dëllinja.

— A doni të dini sa e gjatë ka qenë heku-rudha e parë në botë? — vazhdonte të ligjë-ronte Kristo Shigjeta. — Ajo ka qenë vetëm dhjetë kilometra.

Pas një gote tjetër me fund befas Miltiadher Nerënxa pati një shfrim artistik për figurën e beut në roman.

— Tashmë beun e kam të qartë si tip. Ai është mizor, intrigant, pijanec dhe feminist. Individualizmi gjuhësor: i mbahej goja kur fliste. Portreti: i shëndoshë, me mustaqe, feste, çizme, kërbaç dhe kalë.

— Çojeni edhe këtë! — urdhëroi i zotit i shtëpisë.

— Ju lutem mos ma fikni dritën e dhomës, — ankohej shkrimitari. — Kam për të plotë-suar ditarin. Unë natë për natë plotësoj ditarin artistik.

Ajet Shkëmbi mbeti i vetëm përballë Dule Dëllinjës. Ndiente një turbullim të përgjithshëm, megjithatë nuk donte të dorëzohej. Herë pas here i kujtoheshin batuta nga roli i princit. I zoti i shtëpisë i buzëqeshte.

— Ja edhe një herë shëndeti yt, shok i te-atrit. — tha ai duke mbushur gotat, me fund! Trupi vigan i aktorit u lëkund në karrige. Djersët i shkonin çurg.

— Ti kërkon të ma punosh, o pasha i Turqisë, — i tundte gishtin tregues Dule Dëllinjës. — Por kjo kështjellë ka zot. Nuk dorëzohet pa gjak! Uik. — uik, — e ndërpren lemtza. — Unë dhe kështjellarët e mi trima, uik, do të luftoj-

më deri në fund, uik. Kjo kështjellë, uik... unë sì princ, uik...

— Rregullojeni edhe këtë princin me shokët, — u tha Dule Dëllinja djemve. — Aha, përfjalë të mbytkan këta artistët, por për raki...

Katër shokët e ngushtë as që do të ishin zgjuar nga gjumi i rëndë sikur nga ora dhjetë e mëngjesit Kristo Shigjeta të mos kishte dëgjuar si nëpër èndërr kuisjen e zagarëve të tij. Ai brofi duke u lëkundur dhe doli jashtë. Di-kush po e qëllonte Majkun me shkop duke thirrur i nxehur:

— Kafshë dembele! Lepujt e mi gjete të sulmosh ti? Na! Bobo! Katër lepujt e eksperimentit!

Kristoja u vërsul jashtë dhe e mbërtheu rrahësin e zagarëve përfyt.

— Si guxon të godasësh një kafshë kaq fisnikë, mor xhahil?

— Më kanë ngrënë lepujt e eksperimentit! Ekupton! Ku t'i gjej unë lepujt tani? — u ankuat ritësi i lepujve, një djalë te të tridhjetat.

— Lepujt do t'i paguaj unë.

— Unë s'dua para, dua lepujt.

Djemtë e Dule Dëllinjës dolën me ngut dhe i ndanë.

— Shoku Kristo, mos u nxeh, — iu lutën mikut. — Ky fqinji ynë është mësues biologje. I kishte lepujt përfeksperiment. Fajin e kemi edhe ne. Zagarët duheshin lidhur.

— Lepujt do t'i paguaj unë, — tha Kristoja.

— Majk, të vau shumë, xhan? Hajde, hopa, — ai e mori kryezagarin e tij në krah, i cili lëpinte buzët e përgjakura tërë kënaqësi. Ndërkohë tre

artistët e tjerë u dhanë jashtë me sy të buhavitor e flokë të hallakatur. Mësuesi i biologjisë murmuriti diçka nëpër dhëmbë dhe u largua i mërzitur.

— Gjynah, — ia bëri inxhinieri. — I kishte edhe për eksperiment. Për shkencëtarët unë kam respekt. Do t'i gjej katër lepuj të tjerë.

— Hajdeni, or miq, — u foli Dule Dëllinja artistëve. — Freskohemi ca se do të pimë nga një gotë raki e kafe.

Sa dëgjuan fjalën raki, ata u vështruan mes tyre të trembur. Shkrimtarit i gjëmonte koka, aktorit i therrte stomaku, piktorit i digje urthi, ndërsa inxhinierit të hekurudhave i merreshin mendtë sikur ta kishte zënë deti.

— Shpejt, të ikim në apartamentin tonë, — pëshpëriti Ajeti.

Ata u takuan me Dule Dëllinjën e djemtë e tij dhe, pasi u premtuan se s'do ta linin me aq, bënë për nga pallati i tyre duke mbajtur njëri-tjetrin për krahu. Ranë përbys drejt e në krevat dhe s'luajtën më deri nga ora katër e pasdites.

XVIII

Vetëm të hënën katër shokët e morën disi veten pas betejës në verandën e këndshme të Dule Dëllinjës. Paradite vendosën të mos lëviznin nga apartamenti se bënte shumë vapë. Filluan të shfletonin literaturë.

— Djema, e dini se u turpëruam fare me fshatarët, — tha befas Miltiadhi Nerënxa. — U bëmë kaq ditë këtu në Fushëndritë dhe s'kemi mbajtur asnjë bisedë.

— Vërtet duhet ndrequr menjëherë ky gabim, — e mbështeti Kristo Shigjeta. — Ja, sot pasdite, meqë jemi të çlodhur, mund të organizojmë diçka në shtëpinë e kulturës. Ajet, Alajdin, dakord jeni ju?

— Plotësisht, — tha piktori.

Me përgjegjësin e shtëpisë së kulturës doli të bisedonte shkrimtari dhe së bashku vendosën që biseda të zhvillohej jashtë, në fushë, mes brigadave, që veprimitaria të merrte ka-

rakter sa më popullor dhe artistët ta ndienin veten sa më afër me masën e gjerë tē artdashësve, pa poza, pa zyrtarizma e intelektualizma.

Në orën shtatë pasdite, në një plepishte jo shumë larg magazinave të kooperativës, katër artistët ia mbërritën tē qeshur, veshur tepër thjesht: me pantallona dokumente, këmisha poliestri, me nga një dösje tē vogël në dorë e nga një stilograf, në xhep. Kooperativistët e brigadës së foragjereve dhe asaj tē perimeve që do të merrnin pjesë në bisedë, i priten me duartrokitje. Përgjegjësi i shtëpisë së kulturës bëri një hapje tē Ishkurtër.

— Përrarritjet e letërsisë sonë, këto vitet e fundit mendoj t'ia lëmë fjalën autorit tē injohur, Miltiadher Nerënxsës, tha ai pastaj duke treguar me dorën e shtrirë shkrimitarin.

Miltiadher Nerënxa u dha një herë flokëve sipër me gjestin e vet çapkën që tashmë ishte bërë i njojur edhe në fshat, pastaj filloj tē fliste krejt i qiruar nga emocionet.

— Shokë kooperativistë, letërsia është artimë demokratik te ne. Vi f pas viti ajo po shënon suksese. Te ne botohen shumë, ky është një fakt. Tani së fundi do tē dalë në qarkullim edhe vëllimi im, poezi «Fllade» e stuhi». Mendoj se ky vëllim do tē jetë një arnitje në poezinë tonë. Pse e them këtë? Sepse vepra ime u është nënshtuar shkërkësave tē larta. Në të unë kam gërshetuar bukurunin poetik me heroin lirik, lirizmin e embël me nota tē fuqishme epike, forcën e mendimit me lakonizmin e vargut, gjuhën metaforike me grimën, duke sy-

nuar gjithmonë drejt qëndrimit meditativ. Poëzia ime përiret drejt imazhit të qartë. Në fokusin tim poetik përmblidhen gjetjet emocionuese. Unë synoj drejt gjetjeve origjinale, besafusese. Ja, për shembull, një poezi njëstrofëshe me titull «Peizazh»:

*Lart në qiell mblidhen re,
dielli fshehur diku rri,
e menduar ecën një vajzë atje,
së shpejti do të bjerë shi.*

Kooperativistët mbetën si të mekur. Në fytyra u lexoheshin mbresat e thella që u kishët lënë kuptimi i fjälëve të shkrimitarit dhe poëzia «Peizazh». Majtas e djathtas filluan pëshpëritjet. Ky qenka kokë, tha një djalë. Ndërsa një vajzë pshëretiu e druajtur. Shikoni q'artist, edhe gjestet i ka të embla si rimat. Por pati edhe gra që filluan të mendonin për gjellën e darkës, kurse disa burra të vjetër nemi dremia.

— Shoku Milti, a s'keni menduar fare për një vepër të madhe autobiografike? — pyeti një vajzë.

— Kjo pyetje e gjeti shkrimitarin të papërgatitur. — Patjetër, — improvizoi ai qetësisht. — Po mendoj prej kohësh për autobiografinë tme. Besoj se kam një jetë të pasur për të nxjerrë një vepër tertiqëse.

— Ndondjë çerek ore, me atë aftësinë e vet magjepsëse të të rrëfyerit, Miltiadhi N'erënxa i mbajti gozhduar dëgjuessit me linjat kryesore të autobiografisë së vëto. Ndërkohë disa gra filluan

të punonin triko, një grup vajzash u harruan pas një modeli fustani, një grup djemsh hapën «Sportin popullor», ndërsa ata që po dremitnin u mbështetën edhe më mirë te njëritjetri. Kur shkrimtari mbaroi së foluri dhe falënderoi për vëmendjen, pati një valë duartrokitjesh.

Përgjegjësi i kulturës prezantoi piktorin Alajdin Arbanën.

— Ndihem jashtëzakonisht i nderuar që ndodhem mes jush, — filloi të thoshte ai. — Më pëlqen interesimi juaj. Ju duhet ta bleni pa ngurrim pikturen dhe t'i zbuluron shtëpitë tuaja. Piktura është një art i vjetër, shokë e shoqe kooperativiste.

Historisë së lindjes së pikturel Alajdin Arbanë i kushtoi plot njëzet minuta. Në këto e sipër gratë e trikove kishin ecur goxha radhë, vajzat po pëshpërisnin për bukurinë e Sofisë, gruas së hijshme të Miltiadher Nerënxsë, për të cilën kishin mësuar se ai e kishte rrëmbyer duke rrezikuar kokën, djemtë kishin kaluar te faqja e katërt e «Sportit popullor», ndërsa ata të dremitjes ia kishin marrë me gërhima të lehta.

— Qyqja, — ia bëri një grua duke pshëretirë e mërzitur. — Na i thartoi trutë fare. Kështu është kur lexon shumë libra, flet si përcart.

— Shoku Alajdin, a keni fituar ndonjë çmim nëpër ekspozita? — pyeti befas një djalë.

Piktori ngriu ca çaste, pastaj u mundua të buzëqeshte.

— Si t'ju them? Ndoshta ju mund tē habiteni, por unë nuk e njoh konceptin çmim. Për mua nuk ka asnje rëndësi marr apo nuk marr çmim.

Dëgjuesit lëshuan me përtesë një duartrokitje. Por plogështia e tyre sikur u zhduk dhe vëmendja u përqendrua jashtë mase kur përgjegjësi i shtëpisë së kulturës prezantoi Kristo Shigjetën me fjalët: «Shpikës dhe racionalizator i famshëm i ndërmarrjes së hekurudhave. Po merret me një racionalizim tepër tē rëndësishëm te lokomotivat me avull.

— Hë më i lumtë! — u zgjua një burrë i vjetër. — Ky qenka usta.

— Ehë, — e mbështeti një tjetër. — Bëka shkencë, pér së mbari, jo si këta artistët me bojëra e lule.

Por, pér habinë e dëgjuesve, Kristo Shigjeta tha tepër serioz:

— Fillimi sht unë do t'ju flas ca pér dy poetë tē mëdhenj bashkëkohorë, sepse po i përkthej. Këta dy poetë janë Zhak Preveri dhe Salvatore Kuazimodo. Ju nuk mund ta besoni se sa thjeshtësi ka në poezinë e Preverit. Gjithashtu nuk mund ta imagjinoni se sa ndjenjë do tē gjenit te Kuazimodoja po ta lexonit.

Kishte kaluar ndonjë çerek ore nga ligjëratë e përkthyesit pér dy poetët e tij tē preferuar, kur një djalë zeshkan u pëshpëriti shokëve rrrotull duke nënqeshur:

— U bëfsha unë Kuazimodo po s'ia këput kot ky.

— Je në vete! — e kundërshtoi njëri prej djemve.

— Ja, shikojeni kur t'ia këpus edhe unë
kot fare, — këmbënguli zeshkani. — Shoku Kri-
sto, më falni, — iu drejtua përkthyesit. —
Unë nuk e kuptoj se si ju ka tërhequr vëmen-
djen Kuazimodoja dhe jo një poet i madh ita-
lian i dy dekadave të fundit si Amadeo de Ama-
deos?

Kristo Shigjeta e ndjeu veten tepër ngushtë
si në rastet kur në gjueti i dilnin para derra
të egër. Nuk ia kishte marrë mendja se aty
mund të kishte njohës aq të thellë të poezisë
italiane.

— Ah, djalosh, — buzëqeshi ai. — Ju nuk
e dini se kohët e fundit De Amadeosi ka shfa-
qur pikëpamje neofashiste.

— Vërtet?! — u çudit zeshkani. — Sa keq!
Shokët e tij ranë gati përbys për të mos
u dukur.

— E patë se ç'filozofë na kanë ardhur në
fshat? — tha zeshkani.

Kristo Shigjeta u kthyë përsëri te Preveri
e Kuazimodoja, por, kur pa se askush s'po e
dëgjonte, vendosi të kalonte te lokomotivat. Për
ndonja njëzet minuta inxhinieri hyri në hollë-
sira tekニー të profesionit të tij duke i detyruar
kureshtarët e shumtë të ktheheshin përsëri në
dremi, në punimin e trikove, te gruaja e bu-
kur e Miltiadherë Nerënxsës dhe «Sporti popu-
llor». Një djalë me flokë kaçurrel, që ishte de-
tyruar të shtynte një takim me të fejuarën
për të mos munguar në atë bisedë, nuk duroi
dot më.

— Më falni, shoku inxhinier, ne po shkoj-
më drejt shekullit XXI apo XIX? — pyeti.

Racionalizatori ngriti syzet mbi hundë me inat dhe u ul.

— Duam të dëgjojmë edhe shokun e teatrit, — tha një vajzë.

— Me shumë qejf! — Ajet Shkëmbi u ngrit në këmbë. — Unë do t'ju interpretoj disa monologë nga roli i princit në tragjedinë «Liria do të kthehet përsëri» të shokut Milto dhe poemën e tij «Fshat, i bukur fshat», të shkruar këto ditë për Fushëndritën.

Zëri i tij prej basi i tundi nga vendi të gjithë. Ishte e pamundur të diskutoje për sport, për Sofinë e bukur e aq më pak të dremisje kur gjëmonin thirrjet luftarake: «Mos u përkulni, kështjellarët e mi trima, s'përkulet shqiptari, mor qen turk, pasha, ju gënjen mendja, pasha, në shekuj do të na ndjekë, fjala «liri». Ajet Shkëmbi u fut aq thellë në rol dhe filloi të bënte aq shumë gjeste teatrale, saqë dëgjuesit u detyruan të duartrokisnin gjatë për ta sjellë në vete. I gjori, murmuriti një vajzë. I dhimbka dhëmballa më duket. Aktori u përkul me respekt, pastaj u mbush thellë me frymë dhe kaloj te poema «Fshat, i bukur fshat».

Lirizimi i poemës, me shfrime të hérëpas-herershme ndjenjash, me apostrofa të fuqishme dhe me përsëritjen e shpeshtë të foljeve «eci, shikoj, mendoj», i preku dëgjuesit thellë. Në fragmentin:

*Eci mes fushave me këmishën zërthyer,
flladi i ëmbël flokët m'i përkëdhel.*

Në të majtë vështroj grûrin që zverdhon,

*në të djathtë pambukun që zbardhon,
dhe mendoj: ç'ishte dje këtu?*

Duartrokitjet zgjatën rrëth një minutë. Në mes të duartrokitjeve autorë, Miltiad Nerënxa, ia shtrëngoi aktorit të dyja duart i përmalluar, pastaj u përkul para kooperativistëve.

Pas pak përgjegjësi i shtëpisë së kulturës i falënderoi miqtë për bisedën e këndshme, duke u kërkuar të mblidheshin përsëri ashtu. Koo-
perativistët filluan të shpérndaheshin me ngut.

— Ah, kush qe ai që na i bëri peshqesh
këta të katër të fantaksur, — tha me inat djali
që kishte humbur takimin me të fejuarën. —
S'mbaj mend asgjë nga c'dëgjova.

— I qumë se do n'e bëjë përditëse pëto se që kjo
nështë mënyra që vjen nga përfundim i zhvillimit
i këtij kohë. —

modleroda ip mësuarinë këtij se n
vadhi qëndra i kohës së vjetër

është shumë e lartë që këtij kohës së vjetër
në qytetin e Tiranës është përfshirë
një vjet që i cili është i njohur si
"vjeti i vjetër". Në këtij vjeti i vjetër
i cili është i njohur si "vjeti i vjetër",
që i cili është i njohur si "vjeti i vjetër",
që i cili është i njohur si "vjeti i vjetër",
që i cili është i njohur si "vjeti i vjetër",
XIX

Kishte ditë që pajisjet e peshkimit qëndron
në të paprekura në një cep të apartamentit.
Mjeshtri i çiftes, Kristo Shigjeta, s'donte që
s'donte të hijte dorë nga pylli me pisha, ndonëse
kishte mbetur ende me një thëllëzë dhe disa
pëllumba të egër. Vetëm Ajeti e Alajdini i kishin
hedhur disa herë grepat, ndërsa bënин
plazh në breg të detit. Shkrimtar Miltiadhi Ne-
rënxa ende nuk e kishte nuhatur erën e pe-
shkut, sepse mbledhja e materialit për romani
nuk i linte asnjë minutë kohë të lirë.

Një pasdite, ndërsa katër shokët e ngushtë
ishin ngritur nga një gjumë i thellë dhe po pi-
nën kafe në ballkonin e freskët të apartamentit,
befas Kristo Shigjeta vështroi nga qielli si
ata detarët e vjetër dhe tha:

— E dini se po më pëlqejnë këto re dhe kjo
juga që po fryn? Është tamam kohë peshkimi.
Apo jo, Alajdin?

— Jashtëzakonisht bukur. — e përkrahu piktori. — Peshku do pak dallgë e turbullirë.

— Si thoni, i hedhim mrezhdën e parangallët?

Aktori fërkoi duart me qejf.

— I hedhim. Dhe peshkun ta pjekim mu atje në breg. Apo s'ka një verë të mirë kjo ushqimorja e fshatit!

— Edhe unë kam nevojë për ca çlodhje, — tha shkrimitari. — Shkojmë pa vonesë që të bëjmë ca meze për parangallët.

— Atëherë, në këmbë djema! — thirri Kristoja çapkënçe. — Qëllofshim!

Katër shokët u nisën me duart ngarkuar, me kasketa e kapela kashte në kokë. Përshëndeteshin buzagaz me fshatarët që kthehen nga puna dhe pyetjeve të tyre «Për ku kështu, shokë artistë», u përgjigjeshin: «Për peshk, vëllezër, për peshk. Pasioni i vjetër është si mikrobi, s'të lë të qetë.

Me të mbërritur në breg, ata u zhveshën, nxorën nga dy toja secili, zunë vende pranë njëri-tjetrit, ushqyen grepat dhe më në fund i vërvitën tuje me qejf. Por kaloi gjysmë ore dhe nuk po vinte asnje ngacmim, sikur grepat të kishin rënë në Detin e Vdekur. Shkrimitarin, aktorin e piktorin i mbërtheu mërzia shpejt,

— Fijet e mia unë po i lidh këtu në breg, — tha Alajdin Arbana. — Po dal njëherë këtej rrötull. Ka ditë që më tërheq një peizazh.

— U, — ia bëri me qejf aktori. — Më ke folur edhe mua. Prit, po shkojmë bashkë.

— Do tju shoqëroj edhe unë, — tha pa vonesë shkrimitari.

Ah, s'keni mend pér peshk ju jo, — murmuriti me inat Kristo Shigjeta.

— Kristo, mos u mérzit, — folën ata njëzëri.
— Ja, u kthyem.

— Vazhdoni pa merak, — tha mjeshtri i gjuetisë. — Merrem unë me të gjitha fijet.

Tre shokët iu larguan ca bregut, hipën mbi një sop dhe prej aty piktori filloi të përcaktonte kufijtë e peizazhit të tij që përfshinin disa para-cela dhe një shtëpi aty pranë rrethuar me kopsht.

— Gjetja është origjinale, — tha aktori. — Sidomos kopshti i kësaj shtëpisë këtu të futet i tërë. Bre, ç'paska ca fiq! Shiko, edhe pjeshkë!

— Sa mirë do të ishte të kisha një kopsht të tillë! — psherëtiu shkrimtari si nëpër gjumë.
— Do ta punoja vetë, si Çehovi.

Ndërkohë që tre shokët bënin shenja me duar në drejtim të kopshtit, një mesoburrë doli te gardhi i tij dhe u foli me respekt:

— Hajde, bujrëm, shokë! Hajdeni të rrini ca në hije!

Artistët u vështruan një herë mes tyre.

— Mikpritja është karakteristike në këto anë, — tha piktori. — Ejani. Ta shikojmë kopshtin më konkretnish. I zoti i shtëpisë i priti miqtë me një respekt të pakufishëm. I përqafoi me radhë, pastaj i ftoi të uleshin në një qilim të madh shtruar mbi bar, nën një kumbull të madhe.

— Paska kuptim të drejtë pér artin ky njeri, u pëshpëriti shkrimtari shokëve. — Artistëve ua bëka nderet ashtu siç u takojnë. Me siguri duhet të ketë goxha bibliotekë në shtëpi.

— Edhe piktura, — e mbështeti Alajdini.

— Me sa duket i kanë folur hollë-hollë për ne, — tha aktori.

Paš pak i zoti i shtëpisë u kthyesh me një shportë të madhe plot me pjeshkë e fiq dhe një damixhanë raki.

— O, çështë kjo! — Miliadh Nerënxa foli si me ankim. — Ne erdhëm sa për pesë minuta. Nuk që nevoja... sikur... ne...

— Ju lutem, — tha i zoti i shtëpisë. — Nderi është imi. Ju më vini për herë të parë Grua! — i thirri pastaj së shoqes. — Merru pak me atë gjelin e zi që i ka ikur zëri e nuk këndon më! Shpejt!

Pas këtyre fjalëve dhe gëtës së parë me raki fytyrat e miqve sikur ndriçuan.

— A ju kanë lodhur punët, shokë? — pyeti i zoti i shtëpisë. — Këto ditë me vapë besoj ju bezdisin.

— Puna jonë ka specifikën e saj, — tha piktori. — Në çdo lloj frethane ajo na kënaq ja shtëzakonisht.

Pasi kishin biseduar ndonjë gjysmë ore për gjëra të përgjithshme dhe shportës me fruta po i dilte fundi, i zoti i shtëpisë e ndryshoi befas tonin duke thënë:

— Shokë inxhinierë, ju lutem, shikojeni pak atë drejtimin e kanalit!

Tre artistët hapën sytë sikur i zoti i shtëpisë të kishte filluar të fliste indonezisht.

— Si?! — ia bëri me siklet piktori. — Kanali? Çfarë kanali?

Tjetri u mundua të buzëqeshte.

— Kanalin e madh që do të hapni. Shmangeni po deshët nga kopshti se i bie plani mes

për mes. A nuk është gjynah të prishet ky kopsht kaq i bukur?

— Nuk po ju kuptojmë, — tha shkrimtari.
— Ne nuk jemi inxhinierë.

I zoti i shtëpisë lëvizi vendit.
— Nuk jeni ju të Ndërmarrjes së Ujérave?
— fytyra e tij në fillim u mbulua nga të kuqtë si qelli në të perënduar, pastaj erdhi e u nxi si qelli kur bie mbrëmja.

— Jo, mor shok, — ia ktheu aktori. — Ne jemi artistë. Kemi ardhur këtu me leje krijuese. Po ti, nuk na njihke?!

I zoti i shtëpisë rrëmbeu tapën e damixhanës dhe e mylli atë me njëvinat turfullues.

— Ashtu, ë? Me demek ju qenkeni ata që mblidhni të dhëna nëpër fshat e mban fjalime? Atëherë mua do të më falni se kam ca punë. Grua! Lëshoje gjelin e zi!

Miqtë u ngritën kokulur.
— Ditën e mirë! — thanë me zë të fikur.

— Edhe ne kemi punë, duhet të dalim.
— Hapt, rruga e mbarë!

Tre shokët u larguan duke vështruar prapa me përcnim.

— Dallaverexhiu! — shau aktori. — Bah, çfarë servili i paturpshëm.

— Tërësisht qesharak, — e pasoi piktori. — Na pandehu për teknikë kanalesh.

— Mos u çudisni, — tha shkrimtari. —

— Nuk kanë të gjithë njerëzit të njëjtën ngritje kulturore e estetike.

Ata u kthyen turivarur drejt bregut. Befas panë Kriston majë një guri brenda në det duke u lëktundur me krahët hapur. Pas pak sek-

ndash ai e humbi drejtpeshimin plotësishët dhe
ra në ujë duke thirrur sikur të kishte rënë nga
ndonjë direk vaponi. Shokët u sulën për ta
ndihmuar.

— Syzet, — murmuriti mjeshtri, — më humbën syzet. Ah! Ç'më iku goxha dental! Duhej
të ishte nja dy kile. O bo-bo, syzet!

Ata filluan të kërkonin të katër në ujet e
turbullt. Pas ndonja dhjetë minutash aktori, që
qëndronte i zhytur si një fokë e vërtetë, i ngriti
syzet lart duke bërë që xhamat e tyre të shkël-
qenin.

— Bre, ç'tersllék, — shfryu Kristo Shigjeta.
— Është hera e parë që tersi më qepet kështu.
Pasi mjeshtri vuri syzet dhe hoqi dorë nga
ideja për të peshkuar majë shkëmbit, katër
shokët dolën në breg. Ndërkohë një burrë i mo-
shuar me qeleshe që po kalonte atypari u bë
kureshtar.

— Gjuetia e mbarë! — përshëndeti duke u
afruar. — Apo ju ecën?

— Çka, jo edhe aq keq, — tha Alajdini.

— Nga ju kemi?

— Si?! — u çudit shkrimitari. — Nuk na
njeh? Nuk paske dëgjuar se në Fushëndritë
kanë ardhur katër artistë me leje krijuese?

— Ehë, ju jeni ata të katër nga qyteti! —
burri rregulloi qeleshen mbi kokë. Po si s'kam
dëgjuar! Sidomos për njërin që shpikte lokomo-
tiva me avull, më kanë folur shumë.

Miltiadher Nerënxa, uli kokën.

— Po mirë, punë ju quhet kjo ardhja në
fshat? — pyeti burri përsëri.

— Patjetër punë, — tha shkrimitari me inat.

— E ç'punë bëni këto ditë?

— Njohim jetën, xhaxha, fshatin, mbledhim fakte e të dhëna, studiojmë literaturë.

— Ashtu? Ju lumtë! Po rroga, ju ecën?

— Oj, të ecur! Artistët dhe shkencëtarët te ne kanë kushte speciale, nuk varen nga qesja me para e borgjezëve si në vendet e huaja.

— Domethënë ju ecka rroga? Sa mirë! Hajt punë të mbarë tani dhe më falni se ju pengova.

Ata i kthyen përshëndetjen dhe u përqendruan rishtazi te fijet. Ndenjën aty deri nga ora tetë e gjysmë, deri sa Kristoja zuri një qefull, të cilin e quajtën rekord, pastaj ushqyen parangallët dhe me peshkun e zënë. Me hedhjen e tyre mjeshtri i gjuetisë ngarkoi Miltiadhin dhe Alajdinin, ndërsa përmrezhdën mori me vete Ajetin. Vetëm kur dielli humbi tutje në horizont, duke lënë pas një copë të përskuqur qelli, të cilën piktori e quajti «njollë vangogiane», katër shokët morën rrugën e kthimit.

— Sonte duhet të biem herët në gjumë, — tha Kristoja. — Po s'u ngritëm nesër menatë gjuetia na shkoi kot. Të paktën në orën katër të jemi jashtë.

— Mos kini merak, — tha shkrimtari. — Ju zgjoj unë. Sonte do të punoj deri vonë. Vendosa ta nis romanin.

— Pa mbaruar punë me mbledhjen e materialit? — pyeti Ajeti.

— Do të eci paralel. Për kapitujt e parë të romanit jam gati.

— Atëherë u vendos, — tha Kristoja.

Zgjimi u bë në orën dy fiks, megjithatë

Alajdini, Kristoja e Ájeti nuk tundeshin nga vendi. Është herët, murmuriste aktori, është shumë herët. Të presim edhe ca. Tani del peshku e kullot.

— Atëherë po shtrihem edhe unë, — u mërzit shkrimtari.

— Jo, jo, — kundërshtoi Kristoja. — Ja, u ngritim.

Ora duhej të ishte rrëth tre kur peshkatarët mbërriten në breg, u zhveshën, u futën në det, e mbërthyen mrezhdën dhe filluan ta tërhiq-nin. Befas u dëgjuan thirrje të forta:

— Duart lart! Dilni jashtë me duart lart!

Peshkatarët ngrinë. Në breg qëndronin tre ushtarë me automatikë.

— Jemi patrullë kufiri, — foli komandanti i tyre. — Nxirrni letërnjoftimet!

— I kemi në apartament, — tha piktori. — Ne jemi ata katër artistët...

— Lejet e gjuetisë!

— Shokët ushtarë, unë jam anëtar nderi i Shoqatës së Gjuetarëve, — tha Kristo Shigjeta. — Mos dyshoni te ne.

— Ne jemi artistë, — tha i prekur Miltiadhi. — Ju duhet të na kuptoni. Unë jam shkrimtar Miltiadhi Nerënxa.

— As e kam dëgjuar e lexuar ndonjëherë këtë emër, — ia priti komandanti i patrullës.

— Ju për mua jeni shkelës kufiri. Nisuni në postë! Duart mund t'i ulni.

Katër shokët u vështruan të hutuar.

— Shokët ushtarë trima, është keqkuptim — tha shkrimtari. — Ne jemi artistë dhe amatorë peshku.

— Marsh pa fjalë!

Patrulla i vuri para. Ata të katër vështronin herë pas here me bisht të syrit automatikët e ushtarëve. Miltiadhi e Kristoja dridheshin nga të tjetët. Alajdini murmuriste me vete, ndërsa Ajeti shante peshkun dhe ata që e kishin shpikur gjuetinë e tij. Mbërritën në postë pas ndonjë gjysmë ore. Oficeri i rojës ishte një djalë i ri. Ai diç bisedoi me komandantin e patrullës për ngjarjen.

— Duhet të qëndroni këtu derisa të verifikojmë se kush jeni, —iu drejtua pastaj katër gjuetarëve. — Kë të thëresim në fshat për të biseduar?

— Thërrisni kryetarin e kooperativës. Ai na njeh mirë.

— Në rregull.

Derisa ia mbërriti kryetari në postë, në orën gjashtë e gjysmë, katër artistët u detyruan të qëndronin mbyllur në një dhomë, ulur në një stol të gjatë, ngjeshur sup më sup te njëri-tjetri. Kristo Shigjeta tërë kohën mendonte për parangallët, mrezhdën dhe ndonjë gjobë të mundshme që i priste, Alajdin Arbana betohej e stërbetohej se s'do të dilte kurrë më për peshk, Ajet Shkëmbi e falënderonte fatin që ushtarët s'i kishin grirë me automatikë, ndërsa Miltiadhi Nerënxa ankohej se s'i kishte pasur mundësi që ushtarët të mos i njihnin katër njerëz të artit që i mbante në gojë gjithë rrethi.

Vetëm pas një bisede të gjatë me kryetarin, oficeri i shërbimit i liroi shkelësit duke i para-

lajmëruar rreptë që të mos dukeshin më në
breg të detit natën.

— Mor po tani s'vijmë më ne edhe sikur të na lusësh. — murmuriti piktori.

Katér artistët qëndronin para kryetarit si fajtorë.

— Pse, mor shokë të artit, kështu? — tha ai.
— Nuk ju doli gjithë dita për të peshkuar?

— Eshtë lloji i gjuetisë, kryetar, — ia ktheu Kristoja. — Bëhet natën.

— Nejse, ejani tani dhe shikoni më mirë punët e krijimtarisë. Ç'ju duhet gjetia?

— Nevoja shpirtërore, kryetar, çlodhje psikologjike, — psherëtiu aktori. Mifti ëndrror

Kur kat r artist t mbet n vet m, Miltiad
Ner nxa u mbush thell  me frym , pastaj tha
duke qeshur:

— Eh, aventurë e lezetshme, ë? Ka nevojë njeriu edhe për të tilla qyfyre, sepse ndryshe jeta do të ishte tepër e mërzitshme dhe monotone. Apo jo?

xx

Po bëheshin tri ditë që shkrimtar Miltiadher Nërenxa rrinte mbyllur në apartament për shkak të një rrufe të bezdissime që e kishte mbërthyer natën e famshme të gjuetisë së peshkut. Me gjithë gjendjen e rëndë vazhdonte të punonte me ngulm mbi romanin e ri, shtrirë në krevat. Ndërkohë s'i kishte prerë bisedat me njerëz të të gjitha moshave për të vjelë material. Shumë kooperativistë i kishin pritur aty në apartament, megjithatë asnjëri s'po e kënaqte si duhet. Ai ishte bërë tepër kureshtar për ta takuar xha Taren, plakun më të moshuar të fshatit, për të cilin të gjithë i thoshin se ishte një historian i vërtetë dhe dinte me data të sakta me dhjetra ngjarje. Flitej se ai ishte takuar personalisht edhe me Haxhi Qamilin, për kryengritjen e famshme të të cilit Miltiadher Nërenxa interesohet veçanërisht dhe po matej prej kohësh për të shkruar diçka. Disa herë shkri-

mtari ishte nisur për të biseduar me xha Taren,
por s'e kishte gjetur.

Një parade fundqershor, ndërsa i duhej
të qëndronte ende i mbyllur në apartament, i
vetëm, sepse tre shokët e tjerë ia kishin mba-
thur për në plazh, Miltiad Nerënxa iu lut një
djali që t'i conte xha Tares një copë letër ku
ai i shkruante:

Shumë i nderuari dhe i mençuri xha Tare.

*Besoj se ke dëgjuar që në fshatin tuaj ka
ardhur një shkrimtar. Ky shkrimtar ka shumë
dëshirë të takohet me ju e të bisedojë. Ju jeni
një arkiv i gjallë, xha Tare, dhe unë do t'ju
shfrytëzoj nëse do të më lejoni. Ju pres sa
më shpejt këtu në apartament.*

Miltiad Nerënxa, poet, dramaturg e pro-
zator.

Rreth orës 11 dera e apartamentit trokiti me
zhurmë dhe brenda u fut një plak me qeleshe,
serioz, me sy të shndritshëm e plot gjallëri, me
ca mustaqe të thinjura e një llullë në cep të
gojës.

— Tungjatjeta, shoku shkrimtar! — thirri
ai. — Tare Cikalleshi më thonë. Ja ku më ke,
të më shfrytëzosh sa të duash. Kam dëgjuar
shumë fjalë të mira për ty, se ke bërë goxha
vepra e shkruan deri në të gdhirë. Të lumtë,
mor bir! Edhe shokët i kiske koka, më thanë,
sidomos njëri që sajonte lokomotiva me tym.
Ju lumtë për nder!

Shkrimtari i shtrëngoi dorën me respekt
dhe e uli përballë vetes.

— Që ta dish, mor bir, edhe unë jam ca si
bejtexhi, — vazhdoi Tare Cikalleshi. — Kam
nxjerrë shumë bjejt që i di gjithë fshati.

— Vërtet?! Po atëherë qenkemi kolegë. Bejt-
tet e popullit janë një mësim i madh për ne
shkrimtarët e shkolluar, xha Tare.

— Falemnderit! Kisha qejf të të takoja, U
gëzova që ka ardhur një njeri me kulturë dhe
mbledh histori të vjetra. Tani, unë po mbush
llullën dhe ti më thuaj q'të duhet.

Miltiadħ Nerënxa hapi blokkun i menduar.
— Kam dëgjuar, xha Tare, se në fshatin tuaj
ka kaluar Haxhi Qamili me kryengritësit e tij.
A është e vërtetë?

— Posi, mor shoku shkrimtar, është e vërtetë, — Tare Cikalleshi tundi kokën dhe fërkoi
mustaqet duke u zhytur thellë në labirintet e
kujtesës së tij. — Haxhi Qamilin e kam parë me
këta dy sy. Kam qenë nja dhjetë vjeç atëherë.
Na erdhi në shtëpi.

— Vërtet? A mund të ma përshkruash?
— Posi! Ishte një burrë trupmesatar, i shka-
thët, trim, me mjekër e mustaqe, pinte duhan
të dredhur, bile e dridhte me dorën e majtë.
Fliste rrallë, por fjalë me mend.

— Interesant! Po në fshat, a ndenji gjatë?
— Vetëm një ditë. E dì atë blirin e madh
që kemi ne? Mu atje e lidhi beun dhe ia preu
mustaqet me brisk. Sarajet ia dogji.

— Sa interesant! T'i shënoj këto, xha Tare.
Pastaj?

— Kur na erdhi në shtëpi, më përkëdheli mua
flokët dhe më tha: A do të vish me trimat e

mi? Dua, iu përgjigja. Në fillim mëso të shtesch me pushkë, më këshilloi.

— Tjetër, xha Tare, tjetër!

Tare Cikalleshi thithi fort llullën.

— Unë, more shoku shkrimtar, kam në shtëpi nga dy kujtime nga Haxhi Qamili, por nuk ia tregoj njeriu se mos m'i marrin ata të muzeut historik të rrethit.

— Po më çudit! E ç'janë këto kujtime?

— Një pushkë dhe një kuti duhanë. Ia la peshqesh tim eti vetë Haxhi Qamili para se të ikte.

Miltiadher Nerënxa brofi në këmbë.

— Mua do të m'i tregosh, xha Tare.

— Më jep fjalën se s'do t'u thuash atyre të muzeut?

— As mos ki merak.

— Eja pra!

Tare Cikalleshi dhe shkrimtari çanë me ngut përmes fshatit, pastaj hynë në një oborr ku binte në sy një man i lartë. Miltiadher Nerënxa u ul në hije të tij.

— Ja, kështu si ti u ul atëherë edhe Haxhi Qamili, — i tha i zoti i shtëpisë. — Pinë duhan dhe bënë muhabet me plakun tim. Tani mos u mërzit se do të të sjell pushkën e kutinë.

Pas ndonja pesë minutash Tare Cikalleshi u kthye me një belgjik të vjetër në dorë, i cili kishte afro tri dekada që kishte dalë nga përdorimi dhe të nipit ia kishin dhënë në shtëpinë e kulturës kur rinia e fshatit kishte luajtur një dramë, para nja dy vjetësh. Shkrimtari e mori pushkën haxhiqamiliane i mahnitur dhe e vështroi gjatë.

— Prijesi i kryengritësve e kishte të vetën këtë? — pyeti.

— Po.

— Dhe ia dhuroi babait tënd?

— Ia bëri peshqesh pa iu dridhur dora. Ja edhe kutia e duhanit, — Tarja nxori nga xhepi një kuti gjysmë të ndryshkur, të cilën e kishte blerë që në vitet pesëdhjetë te një mjeshtër kavajas. Shkrimtari e vuri belgikun mbi gjunjë dhe mori kutinë. Provoi ta hapte, por ishte e kotë.

— Çudi, xha Tare! — tha i menduar. — Si i ke ruajtur kaq vjet! Sikur ta dije se Haxhi Qamili do të hynte në histori.

— Peshqeshet ruhen, shoku shkrimtar. Ja, nëse ti më bën peshqesh një libër tëndin sot, nesër a pasnesër nipat e mbesat e mia mund të mburren me të, sepse edhe ti mund të hysh në histori.

Miltiadher Nerënxa buzëqeshi i kënaqur.

— T'ia lëmë kohës këto prova, xha Tare. Të lutem më trego ndonjë gjë tjetër, se po më lind ideja për të shkruar diçka për kryengritjen haxhiqamiliane.

Tarja fërkoi mustaqet e thinjura, veprim i cili me sa dukej i pëllqente.

— Ç'të të tregojë Tarja ty?

— Ndonjë betejë, xha Tare.

— Betejat i kam me të dëgjuar vec.

— S'prish punë.

— Dy ditë pasi u largua nga fshati ynë Haxhi Qamili me trimat e tij u ndesh në afërsi të Shkumbinit me disa çeta bejlerësh. Horrat

s'donin ta llinin që të kalonte lumen, por ai u hodh matanë me pushkë në dorë. Luftë e madhe u bë dhe u vranë nga të dyja palët. Se si plasi e vajti lufta, këtë ti mund ta sajosh vetë. Apo jo?

— Patjetër, xha Tare. Kjo është detyra ime. Me këto që po më thua, ti po më jep piketat e një novele 80-ose 100-faqëshe. Po ndonjë mendim i prijesit të kryengritësve a të kujtohet? A i tha ai gjë plakut tënd?

— Po, më kujtohet. Në muhabet e sipër Haxhiu i tha tim eti se kishte vendosur të bëhej si Ali Pashë Tepelena.

— Shiko, shiko! Ç'pikëpamje!

— I tha gjithashtu se, me të fituar luftën, do të bënte reformën agrare.

— Vërtet?! Ky është një zbulim, xha Tare! Ky zbulim do të hedhë poshtë statusin e mendimit historik.

— Eh, mor shoku shkrimitar! Haxhi Qamili ishte edhe kundër fesë. Këtu afër fshatit tonë ai zuri një dervish, i rroi mjekrën, i hoqi xhyben dhe pastaj i dha shatin që të punonte në arë.

— Pa-pa, çfarë fakti!

— Kurse burrat që luanin bixhoz e pinin rakin, i kishte shumë zët. I dënonte e i gjobiste pa mëshirë.

— Ta shënoj të lutem!

Tare Cikalleshi fërkonte mustaqet e nënqeshite pa rënë në sy. Pasi ia mbushi shkrimitarit edhe ndonjë gjysmë ore bllokun me fakte e ngjarje «të para e të dëgjuara», ai e ftoi të pi-

nin aty në hijetë manit nga një gotë raki, sepse edhe vjetë Haxhi Qamili aty e kishte pirë një kafe.

— Xha Tare, ti do të hysh në novelën time, — tha Miltiadher Nerënxa i ngazëllyer, pas gotës së parë me raki.

— Jo, mua mos më fut, — kundërshtoi plaku. — Fut vetëm tim atë.

— Do të të fut edhe ty, xha Tare, sepse ke qenë i vogël dhe nëpërmjet bisedës sate me prijësin do të jap pikëpamjet e tij për brezat e ardhshëm. Më kuption? Po për gratë q'pikëpamje kishte prijësi vallë?

— Ah, për habi, ishte shumë përparimtar, evropian i vërtetë. Martesat me shkuesi s'i durronte dot, sidomos shitblerjen e grave.

— Sa mrekulli! Më fal, xha Tare, ta nxjerr edhe një herë bllokun.

Në pije e sipër shkrimitari e nxori edhe disa herë të tjera bllokun e tij për të shtuar gjëra të reja që Tare Cikalleshit i kujtoheshin ppritur ose që dilnin nga pyetjet. Ata ndenjën bashkë deri nga ora dy, pastaj i zoti i shtëpisë e përçolli Miltiadher Nerënxon deri jashtë në rrugë.

— Më jep fjalën se do të takohemi prapë, xha Tare, — iu lut shkrimitari.

— Patjetër!

— Ndërkohë, një grup djemsh të rinj që po ktheheshin nga puna, e panë shkrimitarin tek ndahet me Tare Cikalleshin dhe filluan të qeshnin.

— Nuk e di ky i shkreti se xha Tarja është

qyfyrerhiu më i madh i fshatit, — ia bëri njëri prej tyre.

— Pale ç'do t'i ketë përrallisur, — ia priti një tjetër. — Ama ç'kenka një pikë shkrimtari ky! Lexohen ato veprat e tij të shkruara natën? U bë telef qyqari duke bredhur poshtë e lart, kurse ata shokët e vet u kënaqën në plazh.

IXX

llojtë kodën e tij, i dhënë i lloj me mënyrën
qëndrore që është këtia. I shëtëzuar
të paktën, qëllig është këtia që është — mësuesi
magazinat e Kombinatit Poligrafik, Miltiadhi Ne-
rënxa e mori vesh një mbrëmje ndërsa po bi-
sedonte me Sofinë në telefon. Pesë kopjet e
autorit shtëpia botuese ia kishte postuar në
shtëpi.

XXI

Lajmin se vëllimi i tij poetik «Fllade e stu-
hi» kishte përfunduar dhe ishte paketuar në
magazinat e Kombinatit Poligrafik, Miltiadhi Ne-
rënxa e mori vesh një mbrëmje ndërsa po bi-
sedonte me Sofinë në telefon. Pesë kopjet e
autorit shtëpia botuese ia kishte postuar në
shtëpi.

— Milto, sa libër i bukur ka dalë! — klithi
e ngazëlyer Sofia. — Ç'kopertinë të kaltër, të
ëmbël që ka! Dhe brenda është plot me xheva-
hire. Oh, i dashur, urime! Ia arrite qëllimit
më në fund.

— Të falemnderit për lajmin, Sofi! — i tha
ai i emocionuar. — Ky është lajmi më i bukur
që më kanë dhënë prej kaq vjetësh.

Shkrimtari u kthye në dhomë me sy të për-
lotur. Tre shokët e tjerë ngrinë kur e panë.

— Milto, mos ka ndodhur ndonjë fatkeqësi?
— pyeti Alajdini.

Miltiadhi thithi ajër me tërë gjerësinë e
mushkërive.

— Vellezër, — tha me zë të dridhur, — vëllimi «Fllade e stuhi» doli në qarkullim.

Pas këtyre fjalëve apartamenti ushtoi nga thirrjet dhe duartrokositjet.

— Milto, ky është një lajm i madh, — tha piktori duke e përqafuar.

— Urime, Milto! Kjo datë duhet shënuar me të kuqe në kalendarin poetik kombëtar, — tha inxhinieri me tonin e tij filozofik duke ngritur syzet mbi hundë.

— Milto, na lejo të lутеми, — tha aktori

— Duhet ta festojmë ashtu siç e meriton. Që sot.

— Do ta festojmë, vellezër, do ta tundim!

— ia priti autor i vëllimit,

— Ah, jo, — u hodh Kristo Shigjeta. — Festimin e marr përsipër unë. Do ta bëjmë nesër në buzëmbrëmje, me verë dhe me ca meze princërore. Paradite do të dalim të gjuajmë pér kërmij e bretkosa.

Të tjerët e vështruan të hutuar.

— Kristo, mos është pak ekstravagante? — tha shkrimitari.

— Në asnje mënyrë! — kundërshtoi inxhinieri.

— Kristo, do të na marrësh në qafë, — tha Alajdini. — Do na helmosh.

— Mos më fyej, Alajdin. Nuk më njihke mirë më duket.

— Kristo, do të na shohin fshatarët dhe do të na keqkuptojnë, — tha aktori.

— Mos ki merak, Ajet. Ne kemi ardhur këtu pér të përhapur kulturën dhe cilivizimin në çdo sferë të jetës. Bretkosat dhe kërmijtë i ha Ev-

ropa e civilizuar. Pse të mos i hamë edhe ne? Gatimin e marr përsipër unë. Rrini të qetë.

Të nesërmen rrëth orës nëntë të katër shokët e ngushtë u nisën për në gjuetinë e famshme. Miltiadhit e Ajetit Kristo Shigjeta u besoi kërmijtë meqë ishte më e lehtë për t'i mbledhur, ndërsa bretkosat, që teknikisht paraqisin vështirësi i mori vetë përsipër bashkë me Alajdinin si ndihmës. Te bliri i madh në të dalë të fshatit ata u ndanë duke vendosur që të takoheshin përsëri nga mesdita.

Me nga një qese të madhe plastmase në dorë shkrimtari dhe aktori filluan të kërkonin ferrë më ferrë e gropë më gropë, rrëzë mureve e rrëzë pemëve, nëpër hije e vende me lagështirë, kërmij të mëdhenj me guaskë të bardhë e të kuqerremtë. Mundoheshin të mos binin në sy. Kur ndonjëri i shikonte duke kërkuar dhe i pyeste i bërë tepër kureshtar, ata i përgjigjeshin se po mblidhnin një bimë medicinale me shumë vlera kuruese.

— Sa interesante ështëjeta! — murmuriste herë pas here Miltiadhit Nerënxa. — Po më duket vetja si ata kërkuesit e dikurshëm të floririt.

Ndërkohë Kristoja e Alajdinit bridhnin nga njëri kanal në tjetrin me kallama në duar. Gjuetia e bretkosave ishte shumë zbavitëse dhë piktorit i hyri shpejt në qejf. Trasta e tyre u mbush ngadalë, veç ishte siklet të dëgjoje kuakje të mbytura sikur vinin thellë ndonjë pusi.

Takimi te bliri u bë në orarin e caktuar dhe, pasi mjeshtri i gjuetisë e vlerësoi prenë të bollshme dhe të majme, katër shokët dolën në

hijen e ca plepave, buzë një kanali ujitetës. Me vete kishin marrë thika, brisqe, gërshërë, si kirurgë të vërtetë. Pastrimi i kërmijve e bretkosave dhe nxjerrja e pjesëve të tyre të ushqyeshme ishte një proces delikat, kështu që Kristoja e pa të arsyeshme të mbante një leksion të shkurtër anatomie, shoqëruar me çarje, prerje e këputje konkrete organesh. Ishte një punë makabre, megjithatë tre të tjerët arritën ta përmbanin sëkëlldinë që i mbërtheu.

Kishte ndonjë gjysmë ore që në hipe të plepave vazhdonte faza e parë e përgatitjes së mezeve princërore kur befas, në anën tjetër të kanalit, u dëgjuan thirrje e klithma të mytura.

Një kooperativiste e re kishte ardhur te kanali për t'u freskuar dhe, kur kishte parë koka bretkosash, kërmij të thyer, zorrë, gjak, thika, brisqe e gërshërë të përlyera, katër veta me këmisha lidhur rreth ballit qe lebetitur. Pas pak një grup kooperativistësh ia mbërriti në vendin e lemerishëm me shata në duar. Të gjithë u shtangën kur panë se aty ndodheshin vetëm katër artistët nga qyteti dhe kurrfarë indiani. Filluan të pështyrat, të kolliturat.

— Ju, shokë artistë, merreni edhe me kërkime biologjike? — pyeti një djale.

— Jo, — ia ktheu Kristoja. — Këto bretkosa e kërmij po i përgatisim për t'i ngrënë.

Habia qe e papërbajtur. Pështymat e kollitjet u trefishuan. Një vajzë u hoq mënjanë për të vjellë, ndërsa një gruaje i ra të fikët.

— Sigurisht që po talleni, — tha djali. Kristo Shigjeta qeshi shpenguar.

— Aspak, i dashur! Bretkosat e kërmijtë i hanë francezët, italianët, gjithës njerëzit e civilizuar. A e dini jū se bretkosa është më e shishme se mishi i pulës? A e dini se mishi i kërmillit ka vlera ushqyese të rralla? Se kuron reumatizmën, plevitin? Bile një shkencëtar ka zbuluar se kërmilli lufton edhe kancerin.

— Mos u gjenjeni nga kjo pamje, shokë kooperativistë, — ndërhyri piktori. — Mrekullia ndodh pas gatimit.

— Çdo gjë e pagjallë në natyrë bħahet, mjaf-ton tē dish ta gatuash.

Kjo sentencë e prerë u lëshua nga Ajet Shkëmbi.

Kur e panë se artistët e kishin tepër seriozisht, kooperativistët filluan tē tērhiqeshin hap pas hapi.

— Po ju, shoku Milto, i hani bretkosat e kërmijtë? — pyeti një vajzë që ushqente një simpati tē veçantë pér shkrimtarin.

Miltiadhi Nerënxa u mundua tē buzëqeshte.

— Po, shoqe, i ha. Në emër tē kulturës, cilivizimit. Kulturë dhe cilivizim do tē thotë që klimi nga paragjykimet e vjetruara.

— Ju kuptova, — tha vajza. — Afëherë, ju bëfshin mirë! Shëndet!

Kooperativistët u larguan duke përshëndetur me gjysmë-zëri

— Fole bukur, Milto, — tha Kristoja duke mbërthyer një bretkosë. — Sot u treguam përapës tē vërtetë tē kulturës e tē civilizimit, Jepini tan, tē imbarojmë!

Me gatimin e mezeve princërore u mor vetë mjeshtri i gjuetisë, duke mbajtur si ndihmës

Alajdin Arbanën e duke i thënë se, me gjithë ndikimin e madh që kishte nga kuzhina franeze, prapëseprapë ishte origjinal në shumë gjëra. Ndihmësi vetëm e dëgjonte dhe mendonte tërë siklet çastet kur do t'i duhej të gëlltiste kërmij. Kristoja betohej se do t'i bënte ata të kundërsulmonin si karkalecë deti. Ndërkohë Miltiadhi e Ajeti dolën nëpër dyqane dhe u ngarkuan me verë «Merlot», djathë, sallatë të konservuar, domate e vogëlsira të tjera pikante.

Kur dielli filloj të humbte në horizont dhe një fllad i freskët të frynte nga deti, katër shokët dolën në një lëndinë jo shumë larg pallatit të tyre, shtruan një mushama, nxorën ushqimet, vunë në qendër mezet princërore dhe u ulën të kënaqur. Aktori mbante pranë kitarën e tij. Vendi ishte i bukur, kundërmonte aromë bari e lulesh. Rrotull s'i shqetësonë njeri. Shtëpia më e afërt ishte një tridhjetë metra dhe ata gjithashtu nuk shqetësonin kënd.

U hapën katër shishe verë dhe Kristo Shigjeta foli siç i ka hije një dollibashi:

— Një kryevepër, shokë, meriton më shumë mund, por ne besoj se e bëmë tonën. Për vëllimin e famshëm «Fllade e stuhi»!

Pasi shkrimitari i falënderoi shokët, vera gurgulloj nëpër gurmazë.

— Tani do të më merrni në provim, — tha Kristo Shigjeta i kënaqur. — Shijoni ju lutem bretkosat e kërmijtë.

Ata të tre mbërthyen me majat e gishtave nga një kofshë bretkose. Ato dukeshin më të lezetshme se më parë. I futën në gojë duke

menduar ndonjë helmim, infekzion ose ngatërrim zorrësh, por, për habinë e tyre, u detyruan të lëpinin buzët.

— C'mrekulli! — thirri aktori. — Kaluar thëllëzës.

— Çuditërisht të shijshme! — ia bëri piktori.

— Kristo, ti je í pakrahasueshëm, — shtoi shkrimtari.

Mjeshtri buzëqeshi i përkëdhelur në sedër.

— Tani, provoni kërmijtë, — tha me padurim.

— Më vonë, — tha Alajdini si me ankim.

— Unë kam alergji nga këta butakë, — shtoi Ajeti.

— Jo! — këmbënguli Kristoja. — Do t'i provoni tani, medoemos.

Ata të tre morën nga një kërmill me duar të dridhura sikur po kapnin nga një nepërË.

— Milto, provoje ti i pari se të shërbën për njohje jete, — tha piktori.

Shkrimtari e hapi gojën i vendosur, e futi kërmilliin brenda, e përtypi heroikisht, pastaj e gëlltiti duke u çelur në fytyrë.

— Habi e madhe! — thirri. — Sa gjëra mësuaka njeriu në fshat! Të lumtë, Kristo!

I dyti e gëlltiti kërmillin piktori duke përdredhur trupin e qafën si balerinë.

— Fatkeqësisht u trembkemi kot nga mrekullitë, — tha duke psherëtirë.

Pas një përpjekjeje titanike edhe aktori e futi butakun në gojë. Bula djerse iu formuan në ballë, por pa vonesë qeshi gëzueshëm.

— Kristo, kur do të na organizosh prapë gjueti? Bre! Kaluar viçit e pulës!

Mjeshtri i gjuetisë dhe i kuzhinës ngriti shi-

shen e verës i përkëdhelur në sedrën profesionale.

— Më bëhet qejfi që u kënaqët. Të kthehem i te kryevepra e Miltos tani.

Ndërsa shijonin prenë e gjuetisë së tyre dhe pinin «Merlot» të zi, katër shokët filluan t'i thurnin lavde e t'i caktonin vendin në fondin e kryeveprave kombëtare vëllimit «Fllade e stuhi». Kristo Shigjeta mburrte mesazhin e thellë filozofik që bartte poezia e Miltiadhit dhe aftësinë e tij si autor për ta detyruar lexuesin që të futej në mendime. Alajdin Arbana ngriti lart figuracionin e pasur dhe ëmbëlsinë naimiane të rimave, ndërsa Ajet Shkëmbi theksoi spontaneitetin dhe aktualitetin e poezeve. Përveç Naim Frashërit, e Migjenit të gjithë poetët e tjerë u nxorën zhuxhë të vërtetë para madhështisë së firmës Nerënxa. Të gjithë ata kritikë e studiues që nuk do të arrinin të zbulonin vlerat e vëllimit «Fllade e stuhi» u quajtën të paaftë e të trashë, lexuesit që nuk do ta blinin librin u cilësuin njerëz pa shije. Modestia që e karakterizonte e detyroi autorin e kryeveprës të fliste rrallë, vetëm kur zbulonte profilin e vet poetik dhe ku falënderonte shokët për vlerësimet e larta.

Ora dalëngadalë po i afrohej dhjetës ashtu si verës po i afrohej fundi. Kur e ndjeu vreten plotësisht në formë, Ajeti rrëmbeu kitarën dhe e mbushi lëndinën me tingujt e akordit të të ëmbël la minor.

— Nisja me një putpuri korçare, — tha Kristoja. — Hë! Ilaçet nuk më bëjnë gjë, s'm'i shërojnë plagët...

Shokët filluan ta shoqeronin. As vetë nuk e

kishin imagjinuar se mund të formonin një kuartet aq të përsosur. Basi i fuqishëm i aktorit kontrastonte me zërin e hollë të Kristo Shigjetës, mes tyre mbushte bukur dhe me tepër ndjenjë shkrimitari, ndërsa piktori herë pas here futej në një zë të dytë me një mjeshtëri të rrallë. Kënga davaritej valë-valë nëpër natën e ngrohtë e të qetë të qershori, ndërsa katër këngëtarët vështronin të përmalluar si dashnorët romantikë nëpër peizazhet e Alajdin Arbanës qielin plot me yje.

Pas potpurisë korçare kuarteti kaloi në një potpuri popullore të Shqipërisë së Mesme dhe pasi Ajeti e kishte tharë verën e yjet filluan t'i dukeshin si miza të shndritshme në fluturim, ndodhi që iu kujtua papritur një këngë estrade që kritikonte ahengxhinjtë e paformuar të dasmave. Kënga i kushtohej një vajze me emrin Lili dhe kishte nota tepër melankolike. Përmendej disa herë ndarja, helmi, spitali. Në strofën:

*Të prita plot tre sahat,
po ti nuk ma vare,
dil pak jashtë, o moj Lili,
se më çmende fare,*

basi i aktorit nuk mundi t'u shmangej toneve të ngashërimit dhe një teli të këputur nga dri-dhjet pasionante të dorës.

Kënga e Lilit sapo kishte mbaruar dhe kitaristi kishte marrë vlerësimet «fantastik», «Klaudio Vila», «Segovia», kur papritur nga shtëpia aty pranë dolën me vrap një burrë i moshuar

dhe dy djem. Në duar tundnin ca hunj të gjatë.
Kuarteti u mek.

— Ah, rrugaçë, edepsëzë! — u dëgjua zëri i burrit. — Më këndoni këngë sevdaje në mes të natës, m'i thirrni gocës: dil përjashta, Lili, Bini, mor çuna, rrugaçëve!

Shpina e Ajetit frikshëm, pastaj edhe ajo e shkrimtarit. Alajdini u ngrit i lebetitur dhe u turr drejt pallatit. Inxhinieri i hekurudhave shpëtoi vetëm me një hu vitheve. Kur iu ngjesh brinjëve edhe huri i dytë, aktori rrëmbeu kitarën dhe u lëshua në pikë të vraptit. Vetëm Miltiadher Nerënxa qëndroi heroikisht në këmbë.

— C'keni, mor të çmendur? — thirri i fyter.
— C'ju bëmë ne?! Me ç'të drejtë na qëlloni? A e dini kush jemi ne apo jo?

— Fafezi! — burri i moshuar ia ngjeshi me shpullë. — Rrugaçë jeni derisa m'i këndoni gocës kongë ashikësh e m'i thërrisni d'il përjashta në mes të notës.

Shkrimtarin e kishte turbulluar vera keqazi.

— Ju patjetër jeni të çmendur, — tha duke u tërhequr. — Kjo s'ka shpjegim. Çfarë goce, çfarë mesnate? Ju... një absurditet... kategori groteske...

Katër artistët u futën në apartament duke turfulluar e rënkuar dhe u shtrinë drejt e në krevate.

— Na sulmuani tinazi, — murmuriti Ajeti.
— Por ne do t'i dërrmojmë nesër.
— Tmerrësisht misterioze! — rënkoj piktori.
— Keqkuptim, — pshëretiu inxhinieri. — Ah, na mbytën keqkuptimet. Milto, po ti ç'thua?

— Për një Lili u ngatërrua puna, — u gjegj shkrimtari. — Kjo është absurdja si kategori, jo, më falni, groteskja. Ah, Lili, Lili!

— Na e mbyllni derën mirë se mos vijnë edhe këtu, — u lut piktori.

Të nesërmen rrëth orës tetë një djalë i njof-toi katër shokët se kryetari i kooperativës i priste në zyrë. Ata u veshën duke murmuritur të pakënaqur dhe dolën të vrenjtur. Sapo hynë te kryetari, një burrë i moshuar që ndodhej aty, brofi në këmbë duke thirrur i nxehur:

— Ja, shoku kryetar, këta janë. Ky azgani na i binte edhe qemanes.

Kryetari i ra ballit me pëllëmbë.

— Ç'na paske bërë, mor xha Kadri! Po këta shokët janë artistë. Kanë ardhur në fshatin tonë me leje krijuese. Bo-bo! Si i paskeni përzënë me hunj?! Po ata gocën tënde s'e njohin fare, mor xha Kadri. Pse, vetëm një Lili paska në gjithë këtë dynja të madhe?

Burri i moshuar vështroi një copë herë i hutuar katër artistët që rrinin turivarur.

— U bu-buja, ç'paskam bërë! — tha me keq-ardhje. — Më falni, more shokë artista, nuk e dija. Mendja më shkoi për keq dhe... Unë kam një gocë që e quajnë Lili...

— S'ka gjë, — tha ftohtë Kristo Shigjeta.

— Mos u shqetësoni.

— Gjëra që ndodhin, — shtoi Ajeti.

— Keqkuptimi është një nga parimet bazë të komëdisë, — tha shkrimtari duke buzëqeshur. — Isha i bindur për këtë keqkuptim.

— Mesele e mbyllur, — tha Alajdini. — Shkon i qetë, xha Kadri.

Kryetari e përcollit burrin e moshuar, pastaj kryqëzoi krahët i menduar.

— Më vjen keqshokë artistë, që u takuan në këto rrëthana. Përpiquni t'i shmangni të tillë keqkuptime, ju lutem.

— Keqkuptimet i kajeta, shoku kryetar. — ia ktheu Miltiadher Nerënxa. — Ato nuk i sajjmë ne.

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

— Tu nuk e ka marrë përgjigje, kryetar. —

Miltiad h Nerënxa imagjinon intervistat e shumta pas suksesit tē bujshäm tē vellimit «Fllade e stuhi».

Në shtyp (gazeta „Drita“)

Redaktori: Tashmë mbarë lexuesi ynë ka mbetur i magjepsur pas vëllimit të shquar «Fllade e stuhi» të poetit të madh, Miltiad Nerënxsës, për të cilin mund të themi pa frikë se e futi veten denjësish në historinë e letërsisë shqipe. Përfitua nga rasti dhe e ndalëm atë tek po shëtiste në bregdet, për t'i bërë disa pyetje.

Shoku Miltiad, si e shpjegoni suksesin e ja-shtëzakonshëm të vëllimit tuaj?

Poeti: Këtë sekret i takon kritikës dhe studiuesve ta zbulojnë.

*Redaktori: Ju a ishit përgatitur për këtë sukses?
Poeti: Natyrish. S'kam dyshuar kurrë në aftësitë e mia.*

Redaktori: Si e shpjegoni faktin që në redaksi

*juva vonuam kaq gjatë këtë vëllim të mrekullu-
eshëm?*

Poeti: *Eshtë thjesht një paaftësi e redaktörëve
tanë për të zbuluar vlerat e vërteta.*

Redaktori: *Një kritik ka vënë në dukje se keni
marrë shumë gjëra nga poeti i njohur M. L. A
e pranoni këtë?*

Pyeti: *Ky kritik s'ka bërë gjë tjetër veçse ka
treguar budallallëkun e vet. Unë jam një na-
tyrë krejt origjinale...*

Në radio

Reporteri: *Erdhëm me mikrofonin tonë, të da-
shur dëgjues, këtu, në studion e poetit të fam-
shëm. Miltiadher Nerënxs, për t'i bërë disa py-
etje të karakterit profesional. Shoku Miltiadher,
cili është stili juaj në punë?*

Poeti: *Shkruaj gjithmonë natën, deri në kat-
të orë pa ndërprerje.*

Reporteri: *A do t'uа këshillonit këtë praktikë
edhe të tjera?*

Poeti: *Me këmbëngulje. Të shkruarit natën i
jep krijimit më shumë sinjeritet dhe ndjenjë.*

Redaktori: *Këtu në studion tuaj shohim shumë
objekte që lidhen me detin. Si e shpjegoni këtë?*

Poeti: *Krijimtaria ime nuk mund të koncep-
tohet dot e ndarë nga deti.*

Reporteri: *Cila është këshilla juaj për poetët e
rinj?*

Poeti: *Të jenë spontanë. Spontaneiteti është
poezia e vërtetë. Ai që e kërkon atë artifica-
list gabon rëndë.*

Reporteri: Ku qëndron e reja që sollët ju në poezinë tonë?

Poeti: Mendoj se kam thënë shumë gjëra të pazbuluara dot nga të tjerët...

Në televizion

Kamera televizive përfshin hyrjen e pallatit ku banon shkrimtar Miltiadher Nërenxa. Aty është mbledhur një grup të rinjsh që mbajnë në duar kopje të vëllimit «Fllade e stuhi». Ndër-kohë poeti i ditës del duke buzëqeshur. Djem e vajza i turren për t'i marrë autografe. Një bionde simpatike i lutet për një fotografi.

Telereporteri: Ja edhe një skenë tjetër që tregon suksesin e pakufishëm të poetit Miltiadher Nërenxës. I afrohemë atij me mundim. Shoku Miltiadher, ju lutemi, telespektatori do të dijë ca hollësira ngajeta juaj.

Poeti: Jeta ime vepra ime.

Telereporteri: Janë të shumtë ata që mendoinë se ju e keni lënë në hipe poetin G. N. është mbarë një kulm i letërsisë sonë. A pajtoheni me këtë mendim?

Poeti: Plotësisht. Kjo është dialektike. Kullmet s'janë kurrë absolute. Ato tejkalojen një ditë.

Telereporteri: Cili është mendimi juaj për nivelin e poeziës.

Poeti: Më duket e ftohtë, herë-herë hermetike. Disa djem të rinj kanë marrë për së koti pas vargut të lirë dhe po vënë shenjën e barazimit mes poeziës dhe prozës. Përmua, rima duhet

ruajtur me çdo kusht. Ajo është e ardhmja e pozisë.

Telereporter: A s'ju duket se kätu ka pak subjektivizüm?

Poeti: Autorëve të rangut tim u lejohet subjektivizimi.

Telereporter: A prisni përkthime të vëllimit tuaj?

Poeti: Po. Besoj n  tri ose kat r gjuh .

Telereporter: C'mund tē na thoni pēr veprat tuaja tē ardhshme?

Poeti: Oh, pér këtë problem do të duhej një emision më vete. Më falmi, kohën e kam tephér të racionuar...

Fragmente nga ditari artistik

Eh, sa të nevojshme e paskam pasur këtë leje krijuese! Sa gjëra të reja po mësoj e sa subjekte interesante po zbuloj!

Sot paradigmë, ndërsa po shkoja për në breg të detit ku më prisnin shokët, befas vura re një vajzë fshehur pas një kaçube. Ishte rrëth të njëzetave, e bukur, e shëndetshme. Dukej e tronditur. Kjo vajzë po pret një djalë, thashë me vete. Edhe një provë tjetër që intuitën e kam të pagabuar. Pas pak te kaçuba u afrua një djalë. Ai e përqafoi vajzën me mall, pastaj e puthi. Ishte me të vërtetë një skenë poetike. Vendosa të shkoja te ta. Sa më panë, të dashuruarit u trembën. Vazhdonin ende fazën e bukur të ilegalitetit.

— *Mos u druani, — u thashë duke buzëqeshur. — Unë s'jam thashethemexhi. A duheni fort.*

Ata pohuan në heshtje.

— Unë ju njoh, — tha befas vajza. — Ju jeni shkrimtar Miltiadher Nerënxa, autor i pesë librave. Keni ardhur edhe në shtëpinë time.

— E kujt je ti, moj vajzë? — e pyeta.

— Jam mbesa e xha Tares, — m'u përgjigj.

— Shoku Miltiadher, — m'u drejtua djali. — Ju jeni një firmë e njohur. Ju lutemi të na ndihmoni se jemi në hall. Unë dua të rrëmbej Mozën. Xha Taren e kam armik numër një. Ai s'pranon që ne të fejohemi, sepse ka pasur ca grindje të vjetra me ata të fisit tim. Si na këshilloni ju?

— Dashuria e vërtetë do të fitojë mbi paragjykimet, — i thashë. — Rrëmbeje vajzën që do.

— Po ju, a do të na mbron? Xha Tarja më ka kërcënuar se, po ia mora të mbesën, do të ketë gjakderdhje.

— Rrini të qetë, — i porosita. — Unë do t'ju mbroj e do t'ju ndihmoj me të gjitha mundësitet e mia. Unë jam shkrimtar, por përfitorë e së resë mund të luftoj edhe pa penë. Kur të keni nevojë, më kërkoni. Shijojeni dashurinë, miqtë e mi. Ju do të futeni në veprat e mia.

Në ato çaste më lindi ideja të shkruaj një trégim të gjatë për atë djalë e për atë vajzë të dashuruar. Ata janë flamurtarë të së resë në fshat, një provë tjetër e emancipimit, e fitores së dashurisë mbi martesat e vjetruara me shkuesi... Gorki ka thënë se realiteti është bërtitës si shitëset e pazarit. E bukur! Mjerë ai krijues që nuk i dëgjon këto bërtitje...

XXII

Një të enjte nga fundi i qershorit mjeshtri i gjuetisë, Kristo Shigjeta, u kthye nga shtëpia, ku kishte qenë për nja dy ditë që të tërhiqte literaturë të re, me një çifte tjetër në sup. Më të hyrë në apartament, ai bëri ca zhurmë që shokët të çoheshin nga gjumi i thellë, pastaj thirri i gëzuar:

— Ja, ku u shtua edhe një çifte. Kishit kaq kohë që më luteshit për t'ju marrë nga pylli me pisha për gjah dhe unë do t'ju marr. Përgatituni për nesër!

Ajet Shkëmbi brçfi në këmbë duke përplasur duart.

— E ha! Me dy ciste do tē bējnē namin!

— Nesér do té më r.jihni edhe mua se kush jam, — tha Alajdin Arbana.

Miltiadherenxa pshereti i kenaqur.

— Po më jepet rasti të plotësoj një bosh-llék të madh në bagazhin tim të njohjes së

jetës. Të falemnderit, Kristo! Nesër do ta shkrepim vërtet.

Nisja e katër artistëve për gjah tërhoqi vëmendjen e gjithë fshatit. Ata ishin ngarkuar me çanta shpine si alpinistë. Grykat e gjata të çifteve shkëlqenin në supet e Alajdinit dhe të Miltiadhit. Tre zagarët venin prapa me një ngathtësi që shumëkush s'po e kuptonte dot. Barku i Majkut dukej i fryrë jashtë mase, ndërsa Rozës po i puliteshin qepallat për gjumë.

— Përgëzime, shoku Milto! — thirri një mësues i ri. — Sot po më ngjan tamam si Hëminguej kur nisej për në xhunglat e Afrikës.

Shkrimtari i buzëqeshi me mirënjojje.

— Shokë artistë, — u thirri kuzhinieri, — sobën po e mbaj ndezur.

— Ta mbash — ia ktheu piktori. — Do të kesh punë sonte.

— Shoku Kristo, po vratë ndonjë derr, lëkurën do të ma shisni mua, — u dëgjua një kërkesë tjetër.

— Patjetër, — ia ktheu mjeshtri.

Katër gjuetarët dolën nga fshati të përcjellë me urime për gjah të mbarë e të bollshëm. Rrugës Kristoja filloi të jepte njëren këshillë pas tjetrës duke renditur në krye mbushjen e çiftes, marrjen e shenjës, pastaj zbulimin e gjahut, zënien e pozicionit të qitjes e duke përfunduar me përcaktimin e zhurmave që bënin kafshët e shpezët e ndryshme të pyllit. Ndonëse u dukej se po trajtoheshin si nxënësa filloreje, tre shokët e tjerë e dëgjuan deri në fund me respekt.

Ata ishin në të hyrë të pyllit me pisha kur befas Ajeti vuri re një tufë pëllumbash të egër që ishin mbledhur në një degë të lartë.

— Ky është shans, — tha Kristoja duke bërë gati çiften e duke rregulluar syzet mbi hundë.

— Alajdin, të dy bashkë. Jepi!

Dy gjuetarët u afroan në majë të gishtave dhe ngritën çiftet drejt gjahut.

— Alajdin, gati, — pëshpëriti mjeshtri. —

— Një, dy... tre!

Çiftet buçiten, zagarët u lëshuan duke lehur, pëllumbat e trembur u ngritën në fluturim, ndërsa shkrimtari e aktori filluan të thërrisin me qejf:

— Bravo! I gritë! I shpartalluat fare!

Të katër shokët u afroan nën degë, por asnjë pëllumb i egër nuk dukej kurrikund. Në xhamin e majtë të syzeve të Kristo Shigjetës kishte rënë një glasë e freskët. Ai e fshiu atë me inat.

— Dy i pashë vetë që i vrava, — tha pastaj.
— Do të kenë mbetur lart në degë.

— Me siguri, — e mbështeti shkrimtari. — Edhe unë i pashë që u vranë.

— Ç'tersllék! — ia bëri Ajeti me keqardhje.

— Mua më ra dielli në sy, se do t'i kishim vrarë të gjithë, — tha piktori.

— Nejse, vazhdojmë më poshtë, — tha i mërzitur mjeshtri. — Hajde, Majk, Roza, Pipi! Para! Me vrap, dembela!

Zagarët u lëshuan nëpër pyll duke lehur. Katër gjuetarët i ndoqën pas.

— Në rast se na del ndonjë derr, çiften do

ta marr unë, Alajdin, — tha aktori. — Ti nuk qenke edhe aq preçiz.

— Po qenë lepuj, do të shtie vetë, — u hodh shkrimtari.

— Jo, lepujve do t'u bie unë, — kundërshtoi piktori.

— Mos e përfisni gjahun! — u vrenjt mjeshtri, — se s'na del gjë fare pastaj. Milto, merre çiften ti tani, më vonë Ajeti.

Kishte kaluar ndonjë gjysmë ore që katër shokët bridhnin nëpër pyll kur papritur zagarët s'u ndien më.

— Mos na humbën? — tha Alajdini.

— Kristo Shigjeta u nxeh keqazi.

— Majk, Roza! — filloi të thërriste me inat!

— Pipi! Ku jeni, kafshë mistrece? Ma plasët shpirtin! Kështu më zhdukeni gjithmonë! Majk, ku je, mor dembel? Qen zonjash! Je edhe kapiten i treshes pale! Llups i dreqit! Ngordhalaq! Të vjen gjumë, ë?

Nga zagarët nuk erdhi asnje përgjigje.

— Është e kotë, — shfryu mjeshtri. — Do jenë larguar shumë. U pa puna. Do të vazhdojmë vetë. Ajet, Alajdin, merrni nga një shkop të gjatë dhe, duke ecur, u bini ferrave e kaçubave. Dini të lejni si qen?

Piktori e aktori u vështruan të hutuar.

— Të lehim si qen?!

— Provogeni njëherë! Na zuri ky hall tani.

Ndërkohë që Ajeti e Alajdini godisnin ferrat e kaçubat me shkopinj e lëshonin ca lehje të çuditshme, të ndjekur nga Miltiadhi e Kristoja me çiftet ngrehur, thellë në një hije të këndshme,

Majku, Pipi e Roza, shtrirë në brinjë, apo ia kishin marrë gjumit. Atë mëngjes kishin ngrënë me bollëk te mbeturinat e kuzhinës së kooperativës dhe rendja nëpër pyll u shkaktonte siklet.

Ora po i afrohej njëmbëdhjetës kur katër gjuetarët me dy çifte ndeshën më në fund në një lepur të murrmë. Veshgjati u doli Kristos e Miltiadhit përballë. Piktori e aktori u hapën anash duke thirrur:

— I bini! Kristo, mos e fal! Milto, matja në ballë!

Çiftet u drejtuani mbi gjahun. Shkrimtari mundohej t'i përbante emocionet. Vendosi të shtinte në gjunjë. Por ndërkokë që përkulej gjuri i majtë iu fut në një gropë, trupi iu anua, çiftja i shkoi shtrembër dhe shkrepi padashur. U dëgjua një klithmë e fortë e Ajet Shkëmbit, rënia barkazi e Kristo Shigjetës, një «Mos» ngjethëse e piktorit dhe pastaj pasoi një heshtje e frikshme. Shkrimtari u ngrit i trembur. Pas tij edhe mjeshtri i gjuetisë.

— Na fike, — belbëzoi ai. — Milto, na more më qafë.

Ata vrapiuan të dy tek Ajeti dhe e gjetën atë shtrirë, duke mbajtur veshin e djathëtë me dorë.

— Më kontrolloni, — murmuriti. — Mos kam ndonjë plagë? Oh, veshi si më shpon!

Shokët e kontrolluan në çdo pjesë të trupit, por më kot.

— Domethënë jam në rregull? — aktori e mbledhi disi veten. — Bre! Plumbi më kaloi mu te veshi.

— Më fal, Ajet! — tha Miltiadhi kokulur.
— Gjuetia i ka këto, — ndërhyri Kristo Sh gjeta. — Shyqyr që kaloi pa rrezik. Aksident kanë marrë më qafë plot veta. Milto, ti e di fatin e hidhur të Heminguejt. Tani, të çlodhemi ca.

— C'na u deshën këto dreq çifte! — shfryu Alajdini. — Ajet, kujtova se na ike. Hera e parë dhe e fundit që dal për gjah.

— S'trembet burri nga një plumb çifteje, — tha Kristoja turivarur. — Apo jo, Ajet?

— C'është ai llaf! — Aktori u çlirua plotësisht nga ankthi. — Gjuetia është shumë e bukur.

Por pas ndonjë gjysmë ore, kur shokët u ngritën për të vazhduar kërkimin e gjahut, Ajet Shkëmbi tha plot vendosmëri:

— Gjuetia s'po na ecën për shkak të zagarëve. Unë po nisem t'i kërkoj. Ju vazhdoni se jua mbërrita.

Tre të tjerët s'kundërshtuan. Aktori i la sa u larguan nga njëqind metra, pastaj gjeti një hije disi të fshehur dhe u shtri në brinjë, i bindur se kishte humbur kot një ditë të mrekullueshme plazhi. Gjumi e mbërtheu shpejt. Se sa fjeti, nuk e mori vesh, por u zgjua befas nga disa krisma të forta aty pranë.

— E godita unë! — u dëgjua befas zëri i Kristos. — Të iku basti, Alajdin!

— Në asnjë mënyrë! — thirri piktori. — Shenjën e rrëzova unë. Ja, le të flasi Miltoja që na pa.

— Për mua shenjën e goditët të dy, — tha shkrimtari.

— Pika që s'ju bie juve në shenjë! — shfryu Ajet Shkëmbi duke fërkuar sytë. — Me demek gjuetarë! S'vrasin dot gjë dhe tani vënë baste kush godet degët e pishës. Pika! Njëri më Tar-tarin se tjetri!

Ai u afrua te shokët i mërzitur.

— Zagarët si pashë kurrkund, — tha duke hapur krahët me keqardhje. — Mos kanë dalë tutje në breg të detit?

— Mos u shqetëso, — ia ktheu mjeshtri. — Vijnë vetë dembelët. Ejani të kthehem.

Katër gjuetarët ishin në të dalë të pyllit kur befas Alajdini ra barkas duke tërhequr edhe Miltiadher Nerenxën.

— Uluni! Një kaproll! Jemi çuditërisht me fat! Kaproll, për nder!

Të tjerët hapën sytë me dyshim duke pandehur se piktori po tallej, por me të vërtetë nja tridhjetë metra më poshtë, pas një kaçube të ulët, dalluan një qafë të kuqërrëmtë.

— Ajo është sorkadhe, — tha shkrimitari. — Kristo, i bini! Do të sfidojmë gjithë Shoqatën e Gjuetarëve. Do të çudisim gjithë fshatin.

— Ai është kaproll, — këmbënguli piktori. — Jam plotësisht i bindur. Kam parë një emision televiziv për kaprollët.

— Edhe unë them kaproll, — e mbështeti aktori. — Kam lexuar në një revistë dikur se këtu ka pasur tufa kaprojsh.

— Është sorkadhe, — tha prerë mjeshtri. — Unë kam parë originalin plot herë. Gati çiften! Alajdin, matu mirë! Gati! Një, dy.

Nuk arriti të thoshte tre, sepse një djalë u foli duke dihatur:

— Mos patë gjë një viç të kooperativës andej, or shokë? Të katër artistët ngritën supet të çuditur, për pak do të kishin vrarë viçin 3-4 muajsh. I bënë me dorë djalit nga kafsha dhe i treguan se ç'mund të kishte ndodhur po të mos kishte mbërritur atë çast.

— Ju jeni të çmendur! — thirri djali. — Ç'deshi sorkadhja këtu, xhanëm? Nga vini ju? Nga Hëna apo nga Marsi? Ç'dreq gjuetarësh qenkeni! Meritoni një gjobë që t'ju vijë mendja vërdallë.

— Fajin e kishte viçi që hyri në pyll, — tha inxhinieri.

— Sikur të mos kishim humbur zagarët, — e pasoi aktori, po nuk e mbaroi mendimin.

U dëgjuan lehjet e gjëzuara të Majkut, Pipit e Rozës që hidheshin e përdridheshin si në cirk. Kristo Shigjeta rrëmbeu një gur dhe ua vërviti.

— Kafshë dembele! Erdhët tani, ë? Haram ju qoftë trajtimi! Më jeni bërë si mace restauranti. Vetëm bukë e gjumë doni. Tyt! Racë e poshtë!

XXIII

Ndërsa mbrëmja po afrohej, katër artistët vazhdonin të qëndronin ende shtrirë në apartamentin e tyre, në heshtje të thellë. Ishte e pamundur të diskutonin. Tashmë i gjithë fshati duhej ta kishte mësuar ngjarjen. Njerëzit mund të ngrinin edhe barcoleta. Por Miltiadher Nerënxa, Aladin Arbana e Ajet Shkëmbi nuk mendonin edhe aq për veten sesa për famën e mjeshtirit, Kristo Shigjetës, që do të njollosej prej një rastësie të hidhur.

Befas dikush trokiti me vrull në derë.

— Shoku Miltiadher, shoku shkrimtar! — u dëgjua një zë i alarmuar.

Miltiadher Nerënxa brofi në këmbë me shkathësinë e një gjimnastikanti. Në prag të derës qëndronte një djalë i ri. Dukej tepër i tronditur.

— Shoku shkrimtar, më mbani mend? — tha ai me druatje. — Jam unë... e rrëmbeva Mozën... mbesën e xha Tares...

— Ah, po! — ia bëri shkrimtari. — Si s'ju mbaj mend! Të lurntë! Më kujtove rininë time. Eh! q'hall ke tani?

— Xha Tarja ka rrëmbyer pushkën. Dëgjova se po vjen të vrasë të mbesën.

— E pamundur! — thirri Miltiadhi Nerënxa. Sapo dëgjuan fjalën vrasje, shokët e tjerë u afruan me një pamje të trembur.

— Sot qenka dita e vrasjeve, — murmuriti aktori. — Dreq o punë!

— E pamundur! — përsëriti Miltiadhi çudinë e vet. — Nuk e bën Tarja atë proçkë.

— Është e sigurt, shoku Milto. E kanë parë duke mbushur pushkën. Ju lutem mos më lini në baltë, — djali ia nguli sytë shkrimtarit plot shpresë.

— Unë s'jam nga ata që i lë miqtë në baltë, — tha ai plot dinjitet. — Më prit se erdha Po qe nevoja, do t'i vë gjoksin pushkës.

Ndërsa Miltiadhi Nerënxa vishej me ngut, shokët e vështronin të hutuar.

— Milto, është pushkë me plumb, thirri mendjes! — e tërroqi Ajet Shkëmbi. — Ai Tarja dc jetë ndonjë plak me trutë e Lekë Dukagjinit.

— Nuk mund të tërhiqem, Ajet, — ia ktheu shkrimtari.

— Milto, s'ke moshë për këto gjëra, — e këshilloi Kristo Shigjeta.

— Unë s'jam trembur kurrë në jetën time, i dashur. Ti e mban mend udhëtimin me lokomotivë kur u irezikuam për shkak të frenave. A s'qëndruam të dy si burra?

— Milto, sigurisht... ti s'po e merr seriozisht këtë punë, — tha piktori.

— Rrezikun e kam tē qartë, Alajdin, por nuk mund tē lejoj që një plak fanatik tē shkate-rrojë një dashuri tē lumtur.

Shkrimtari doli me një hap tē vendosur Djali që kishte rrëmbyer tē dashurën e tij po e priste. Ata s'kishin bërë as dyqind metra rrugë kur para portës së madhe tē një shtëpie dykatëshe panë një plak me pushkë në duar që kishte qëndruar me këmbë hapur si për dyluftim. Ishte Tare Cikalleshi. Shfrynte e bubullinte si një tufan në vërshim e sipër.

— Në goftë se s'më nxirrni mbesën për pesë minuta, do tē vras kë tē më dalë para dhe shtëpinë do ta djeg!

Në tē dy krahët ishin mbledhur njerëz. Disa gra e plaka klithin tē trembura. Një grup vajzash qanin.

— Tare, mblidh mendjen! Tare, ule pushkën! Tare, mos na turpëro, — thirrën disa burra me tē lutur. Por më kot.

— Kush guxon tē afrohet, do ta lë top në vend, — qe përgjigjja e Tare Cikalleshit.

Ashtu si shishet e nxjerra nga frigoriferi që ditëve tē verës vishen me bulëza uji, edhe fytyra e Miltiadher Nerënxs u mbulua nga një valë djersësh. Ai ndjeu gjunjët t'i priteshin, megjithatë gjeti forca për t'u afruar. Njerëzit i liruan udhë. Vetëm kur u gjend pranë Tares dhe njobu në duart e tij pushkën e famshme tē dhruuar nga Haxhi Qamili, e cila kishte vite që s'shkrepte më, në cepat e buzëve tē shkrimtarit lodroi një nënqeshje. Ai çau me gjoksin para dhe qëndroi në prag tē portës së shtëpisë dyka-

tëshe, vetëm pak hapa larg nga gryka e pushkës. Njerëzit e mbledhur rrëth e rrötull shtangën. Tarja po ashtu.

— Para se të hakmerresh mbi dy të dashruar të pafajshëm, o xha Tare, ke punë me mua, kumboi zëri i shkrimtarit. — Vetëm mbi trupin tim mund të kalosh. Veç dije se do ta bëj si Mic Sokoli!

Tare Cikalleshi shtrëngoi nofullat.

— Shoku shkrimtar, mos u ngatërrro kot në këtë mesele. Largohu!

— Nuk largo hem, xha Tare, jo!

— Atëherë po të jap vetëm tri minuta kohë, — Tarja ngriti belgjikun e vjetër dhe iu drejtua Miltiadherë Nerënxsës mu në lule të ballit. Klithmat, thirrjet e të qarat u shtuan. Ndërkohë Kristo Shigjeta, Alajdin Arbana e Ajet Shkëmbi ia mbërritën aty me vrapi. Skena i la të mekur.

— Or plak i çmendur! Or matuf! — thirri Ajeti. — Ule atë pushkë! Ej! Milto, largohu! Të lutem! Je ende i ri.

Shkrimtari buzëqeshi i qetë.

— Jo, Ajet. Do të qëndroj. Në jetën time kurrë s'e kam ndarë artistin nga militanti për çështjen e së resë.

— Milto, mendo për veprat që të presin! — u dëgjuau zëri i Alajdinit. — Ke gati me dhjetëra subjekte.

— Do të ndahem me dhimbje, Alajdin. Duhet.

— Mos, Milto, mos! — u ngashërye Kristoja. — Ti i duhesh letërsisë sonë. Ti je lindur për ta çuar më tej realizmin socialist. Kokat e më-

dha nuk duhen sakrifikuar kështu për një plak derdimen.

— Unë po sakrifikoj për një çështje të madhe, Kristo, — shkrimtari e ngriti kokën edhe më lart me një pamje prej Xhordano Brunoje.

— Edhe dhjetë sekonda! — u çor Tarja. Belgjiku i vjetër filloi t'i dridhej nga nervozizmi.

— Qëllo, xha Tare, mbi një luftëtar të emancipimit, — ia ktheu Miltiadher Nerënxa. — Qëllo mbi një martir të civilizimit!

— Milto, na lër amanetet! — thirri aktori.
— C'të bëjmë me tragjedinë?

— Mundohuni ta vini në skenë, shokë.

— Po më veprat e tjera?

— I ruani. Do të vijë dita që ato të batojen. Me honoraret e vëllimit «Fllade e stuhi» më bëni një varr të bukur merméri.

— Po fletoren e ditarit? — pyeti piktori.

— Mbajeni si kujtim. Subjektet mos ia falni askujt.

— Po bibliotekën? — pyeti inxhinieri i hekurudhave.

— Le t'i mbetet Ernestit. Do të vija dita që studioja ime të kthehet në muze.

— Pra, nuk do të largohesh? — pyeti Tarja duke shfryrë nga inati.

— Jo, — ia ktheu shkrimtari duke e vështruar drejt e në sy pa iu dridhur qerpiku. Atëherë edhe në cepat e buzëve të plakut lodroi një buzëqeshje. Ai e uli pushkën duke thënë i lodhur:

— T'ia dini për nder këtij burri trim, se sot këtu do të kishte shkuar gjaku rrëke. Dëgjuat? Vetëm prej këtij trimi të rrallë po jua

jap mbesën. Merreni dhe bëni një dasmë që të tundet!

— Tare Cikalleshi u largua duke murmurit. Thirrje e duartrokositje mitingu shpërthyen në të katër anët. Burra, gra, djem e vajza u sulën pë ta përqafuar Miltiadher Nërenxën dhe përt'i shtrënguar dorën për mposhtjen gjergjezaliane të bajloz Tares.

— Sot e njoha Milton e vërtetë, — u çudit Alajdini.

— Ky është guxim, — tha Ajeti.

— Miltoja tashmë s'do t'i përkasë vetëm fondit të ndritur të letërsisë, por edhe historisë, — filozofoi Kristoja. — Ç'kanë heronjtë më shumë se ai?

Pasi njerëzit u shpérndanë dalengadalë duke diskutuar pa ndërprerë për aktin heroik të shkrimtarit, për burrërinë e guximin e tij të pakrahueshëm, për militantizmin e pabujshëm dhe plot veti të tjera, Miltiadher Nërenxa hyri i qeshur në oborrin e shtëpisë dykatëshe. Mbesa e Tares dhe djali që e kishte rrëmbyer atë e përqafuan me respekt dhe ai u uroi jetë të lumbur me ton prindëror.

— Ju jeni një shkrimtar i madh, shoku Milto, — i tha nusja e re me respekt. — Është e pamundur që dora e një njeriu të guximshëm si ju të mos nxjerrë kryevepra.

Shpejtësia me të cilën u përhap në të gjithë fshatrat e kooperativës ngjarja e plakut fanatik dhe shkrimarit që me të vërtetë maratonomakiane. Deri natën vonë nëpër veranda, oborre e dhoma ngrënjeje, diskutohej e tregohej guximi i Miltiadher Nërenxës që i kishte nxjerrë gjok-

sin belgjikut për të mbrojtur dy të dashuruarit. Si në shumë ngjarje, e vërteta pësoi edhe ndryshime e zbukurime. Qarkulloi një variant sipas të cilit Tare Cikalleshi ishte matur të qëllonte, por s'i kishte shkrepur pushka, ndërsa sipas një varianti të dytë, plumbi ishte përplasur në ballin e mermertë të shkrimtarit, kishte bërë rikoshetë dhe pastaj ishte ngulur përdhe. U fol nga dikush se shkrimtari kishte porositur që pas vdekjes të gjitha veprat e tij të pabotuara të digjeshin, kurse nga një tjetër që ato të çoheshin për botim vetëm pas njëzet vjetësh. Të nesërmen lajmi i ngjarjes së famshme mbërriti deri në qytet duke vazhduar përpunimin e zbukurimin e mëtejshëm. Pati nga ata që nuk u çuditën, sepse e prisnin një trimëri të tillë prej Miltiadher Nerënxsës, por s'qenë të paktë edhe një palë të tjerë që filluan t'i bënin shkrimtarit një vlerësim krejt të ri.

Dy ditë pas ngjarjes, tepër e tronditur, Sofia e kërkoi me ngulm të shoqin në telefon. Me vete kishte edhe Ernestin.

— Milto, — thirri ajo me zë të dridhur. — C'është ai plak që të ka qëlluar me pushkë? Të lutem, shiko punën tënde, mos zgjidh hallet e botës.

— Qetësohu, e dashur, s'ka ndodhur gjë me rrezik, — ia ktheu ai.

— Po njerëzit thonë se desh të vranë.

— Nuk është ashtu. Unë s'lejova të shtëna.

— Oh, Milto, ki kujdes. Nuk kanë të gjithë mendime të avancuara si ti.

— Mos ki merak, e dashur.

— Na foli pak Ernestit. Jepi zemër se është shumë i mërzitur pér atë problemin...

Miltiadher Nerënxa mblodhi vetullat duke psherëtirë. I biri kishte ngelur në një provim gjuhësie dhe i kishte thënë së ëmës në inat e si-pér që në rast se në jetë do të bënte ndonjë krim, viktima e tij do të ishte gjuhëtar. Këto fjalë i kishin trembur prindërit jashtë mase.

— Alo, baba, — u dëgjua zëri i Ernestit.

— Ç'kemi? Ç'thotë vakanca? Po gjuetia? Me shëndet s'dyshoj që je top.

— Mirë, Ernest, mirë. Po ti po studion nga pak?

— Ashtu, përpinqem. Baba, po si i ke shokët? A i ka lëshuar ndonjëherë zagarët Kristoja?

— Po, po.

— A po njiheni nga afër me jetën e fshatit?

— Plotësisht.

— Ju lumtë! Po sikur e zgjatët shumë. Kthehuni tanë.

— Mos u mërzit, Ernest. Njohja nuk është proces aq i thjeshtë.

— Ke të drejtë, baba. Na, mamaja ka edhe një porosi. Mirupafshim.

Sa vjen e më shumë ky djalë po bëhet i çuditshëm, psherëtiu Miltiadher Nerënxa. Ku do ta ketë hallin xhanëm?

XXIV

Kishte hyrë korriku dhe në apartamentin e katër artistëve vapa ishte bërë e padurueshme, sidomos netëve kur nga tarraca e pjekur tërë ditën në diell, valë të nxehta përshkonin tavanin duke shkaktuar një zaghushi shkretëtire. Katër shokët kishin filluar të vuanin nga pagjumësia. Ajet Shkëmbi kishte nxjerrë sustën e vet në ballkon. Tashmë nuk rrinte zgjuar deri në dy të natës vetëm Miltiadher Nerenxa për të plotësuar ditarin e tij, por edhe Kristo Shigjeta e Alajdin Arbana që ishin bërë shumë nervozë dhe kishin përmendur ikjen nga dy herë. Piktori ankohej herë pas here për një lloj monotonie që po e bezdiste. Ditët e fundit peizazhet e famshme me lijen e me dashnorë romantikë s'po ia blinin më.

Një mbrëmje, ndërsa të katër artistët ishin ulur në sheshin me bar para pallatit, shkrimitari foli befas i ngazëllyer:

— Kam një ide. Drejt saj nuk më shtyn vetëm nevoja e njoftes së jetës, por edhe një domosdoshmëri krijuese, një kondicion i caktuar shpirtëror që më duhet për të qënë sa më realist. Shumë shkrimtarë kanë krijuar në kushte të çrregullta e të vështira, bille një tregimtar i njoftur ka jetuar gjashtë muaj në një kasolle kashte në ishujt Havai. Do të ngre edhe unë një tendë të vogël bari këtu prapa pallatit për të kaluar këto ditë që na kanë mbetur.

— Ide me mend, — tha Kristoja. — Do të shpëtosh nga vapa.

— Milto, je jashtëzakonisht origjinal, deklamoi Alajdini.

— Do të vij edhe unë me ty, — tha Ajeti i vendosur. — E bëjmë të gjerë për dy veta.

Të rrëmbyer nga ideja e shkrimtarit, katër shokët filluan të diskutonin për tendën. Nxorën fleta, kalema e stilografë, vizatuan skema e bënë llogari sikur të ishte fjala për ndonjë hotel njëzetkatësh. Piktori paraqiti një plan që imitonë kasollet e beduinëve, me çati të rrumbullakët, por plani i tij u hodh poshtë për shkak të disa vështirësive teknike. Aktori kërkoi që tenda të bëhej kopje si ato të indianëve të dikurshëm të Amerikës, në formë koni, por ky model shkrimtarit nuk i pëlqeu. Ai ishte për një model ciganësh, me cati të lakuar si tunel, gjë që i pëllente edhe inxhinierit, sepse kishte më pak telashe për t'u ndërtuar. Pas shumë debatesh e kundërshtimesh, të cilat zgjateshin kasten nga katër shokët prej frikës së futjes në apartamentin e ngrohur si serrë, më në fund u vendos që

plani cigan i Miltiadhi Nerënxsës të vihej — në zbatim.

Ndërtimi i kasolles filloi që të nësërmën në mëngjës. Të pajisur me sëpata e hanxharë, katër artistët hynë në një plepishtë afér stallave të kooperativës dhe përgatitën hunj të gjatë, një stivë të tërë, të cilët përbënë skeletin bazë të kasolles. Pas kësaj pune u zgjodh vendi i tendës, pranë një parcele gruri të porsakorrur, dhe sipas piketimeve të Kristo Shigjetës u hapën disa gropë të vogla në formën e një U-je. Hunjtë e ngulur paralelisht u përkulën e u lidhën me kulpra duke formuar një tunel nga dy metra të gjerë e dy e gjysmë të gjatë. Në pjesën e prapme të tunelit hunjtë u lanë pingul, ndërsa pjesa e përparme u la si portë, për t'u mbuluar me një mushama. Puna e katër artistëve tërroqi vëmen-djen e shumë kooperativistëve, të cilët u afroan për të parë. Kur morën vesh se për ç'qëllim po ndërtohej tenda, ata nuk mundën të qëndronin dot pa ndihmuar. Mbulimi me bar të thatë u bë kolektivisht brenda një gjysmë ore dhe tenda e mori formën e saj përfundimtare.

— Vilë e vërtetë! — tha i kënaqur shkrimtari.
— Ju faleminderit, shokë!

Rreth orës dy pasdite, ndërsa në apartament arriti kulmi i vapës dhe Kristoja e Alaj-dini me nga një libër nën sjetull dolën për t'u shtrirë në ndonjë hije, Miltiadhi e Ajeti me dy-shekë në krahë u shpërngulën në tendën e batit. U rregulluan përbri njëri-tjetrit pa vonesë dhe, kur shpinat u gjetën rehat e sytë u ndeshën në tavanin e lakuar, shkrimtari pshëret në thellë, i kënaqur sa më s'bëhej:

— Ah, sa paskajeta! Po më duket vetja si ata ciganët e Pushkinit. Nuhate këtë erë të këndshme bari, Ajet. Ah, sa nevojë paskemi për t'u larguar nga zyrat dhe apartamentet e mobiluara! Në këtë tendë çdo poet do të shkruante kryevepra.

— Ke të drejtë, Milto, — tha aktori duke mbyllur sytë.

— Do ta provoj që tani të thur vargje për tendën tonë.

— Vazhdo, mos e lër frymëzimin të ftohet, — e nxiti aktori dhe pas pak filloj të gërhiste me ritmin e atyre dallgëve që shkumëzojnë në breg. Miliadh Nerënxa u mundua gjatë të hidhët diçka në letër, por gërhima e shokut s'po e lejonte të kombinonte qoftë edhe një rimë. Ai i la fletoren e stilografin mënjanë dhe mbylli sytë.

Dy shokët u zgjuan nga ora pësë e gjysmë.

— Bukur, ë? — aktori foli duke u shtriqur i kënaqur. — Tamam si nëpër përralla.

— Natën do të jetë edhe më bukur, — tha shkrimitari.

Në mbrëmje, Kristoja, Alajdini e Ajeti desh u grindën se cili nga të tre do ta shoqëronte Militadhin në tendën e barit gjatë tërë natës. Inxhinieri i hekurudhave ankohej se vuante nga pagjumësia, piktori seç kishte pësuar ato ditë një ngritje tensioni për shkak të vapës së madhe, por aktori ua mbylli gojën duke thënë se kishte qenë ai i pari që e kishte përkrahur idenë e ngritjes së tendës.

— Shokë, do ta bëjmë me radhë, — i qetësoi shkrimitari. — Sonte le të vijë Ajeti.

Por si çdo natë, pas plazhit e tërë atyre metrave not, aktorin shpatullgjerë ora njëmbëdhjetë e gjeti në gjumë, ndonëse kishte fjetur edhe pasdite. Në numër i revistës «Skena dhe ekranë» i ra mbi gjoks. Shkrimtari u detyrua të fillonte ta shponte e ngacmonte çdo çerek ore për të shpëtuar nga gérhitjet. Ai ecte me vrull faqe pas faqeje në romanin e tij të ri. Tenda e barit dhe drita e një feneri, të vendosur mbi një stol të vogël sikur i shkaktonin një lloj energjie krijuese të veçantë. Nga dritarja e apartamentit, Kristo Shigjeta që s'flinte dot gjumë nga së-këlldia e vapës, atë natë vuri re se në tendën e barit u bë errësirë vetëm pas orës dy.

Ora po i afrohej katrés, kur befas, në një ëndërr të frikshme, tek ecte i vetëm mbi një urë, Ajet Shkëmbi e pa veten të rrethuar nga disa kusarë të armatosur me kobure grykëgjata. Ata e plaçkitën, pastaj e mbërthyen për këmbësh e krahësh dhe e vërvitën poshtë në lumë. Aktori brofi i lebetitur nga dysheku. Jashtë bubullinte e binte shi me rrëmbim. Çatia kullonte sikur të ishte shoshë. Çarçafët ishin bërë ujë.

— Milto, u mbytëm! Milto! — thirri Ajeti duke e tundur shokun fort.

Zgjimi aq shpejt e trembi shkrimtarin.

— Ajet, pse tallesh, — murmuriti ai. — Rri mos më lag.

Aktori e tundi edhe më fort.

— Milto, është shi. Merr plaçkat dhe ngrehu të ikim në apartament.

Ata hodhën dyshekët në kurriz dhe nxituan përmes shiut që vazhdonte të binte me furi.

— Mailkuar qofsh, moj tendë e barit! — troi Ajet Shkëmbi.

— Mos mallko, Ajet, — tha shkrimtari me keqardhje. — Ky është një rrëbesh korriku. Nga drëka çdo gjë të jetë tharë përsëri.

— Po tani, ku të shtrihemi?

— Ti futu në krevatin e Kristos, unë tek Alajdini.

Si për inat të tyre, me të zbardhur dita, qelli u hap në të katër anët dhe një diell i ngrohtë u ngrit në lindje. Brenda pak orëve ai thanu çdo gjurmë të shiut në fshat duke përfshirë edhe tendën e famshme të barit, dyshekët e çarçafët e Miltiadher Nerënxs e Ajet Shkëmbit. Kur mësuan se si e kishin pësuar dy shokët e tyre, Kristo Shigjeta e Alajdin Arbana falënderuan këmbënguljen e aktorit që ua kishte prerë rru-gën për në tendë. Në mbrëmje ata s'ndiheshin, ndonëse Miltiadhi pyeti disa herë se kush do ta shoqëronte në strehën e re.

— Meqë ju u trembkeni nga një shi vere, atëherë do të gdhihem vetë, — tha shkrimtari i prekur.

— Në asnje mënyrë! — u detyrua të thoshte Alajdini. — Do të vij unë. Ti e di që asnjeherë s'të kam lënë vetëm.

Natën e dytë piktori e shoqëroi shkrimtarin deri nga ora dymbëdhjetë e gjysmë duke lexuar një studim për pikturen e Rilindjes Evropiane dhe aq shumë e tërroqi vepra, saqë gjumi e zuri me të mbi fytyrë. Pasi punoi deri në një me kapitullin e tetë të romanit të ri, Miltiadher Nerënxa iu kthye ditarit artistik me të cilin s'kishte ndodhur kurrë të bënte lëshime. Ndër-

sa shkruante mbresat e ditës duke fërkuar herë pas here tëmhat e mpirë, ndjeu se gjumi po e këpuste. Nata e djeshme e kishte lodhur shumë dhe befas erdhi tinëzisht ajo që s'i kishte ndodhur kurrë atij burri me vullnet çeliku; qepallat iu mbyllën pa dashje dhe stilografi i shkau nga dora.

Kishte kaluar ndonjë gjysmë ore me atë gjumë të padëshiruar kur këmba e shkrimtarit u përplas në stolin e vogël, mbi të cilin ishte vendosur feneri, i cili, pasi u lëkund nga dy herë, ra mbi barin e dyshemesë. Zjarri e përfshiu tendën në pak sekonda. Shkrimtari e piktori dolën jashë të lebetitur, me flokë, vetulla e qerpi-kë të përvëluar.

— Ndihmë! Ndihmë! — filluan të thërrisin.

— Ka rënë zjarr! Zjaarr!

U dëgjuan dy të shtëna, pastaj diku nga qendra e fshatit gjëmoi një çangë. Ndërsa njerëzit filluan të mblidheshin me vrap, Miltiad Nerénxa mbërtheu kokën me duar duke vështruar i hutuar tendën që digjej.

— Alajdin, e tmerrshme! Ka mbetur brenda ditari dhe tetë kapituj të romanit të ri. O bo-bo! Do të futem!

— Mos luajte mendsh? — piktori e kapi përkrahу.

— Do të futem, — këmbënguli shkrimtari. — Në atë ditar presin me dhjetëra subjekte, veprat e mia të ardhshme! E kuption?

— Milto, të lutem mos! I thonë zjarr. Tenda mund të zerë brenda.

— Nuk mund t'i lë veprat të digjen përhicqë. Kjo përmua do të ishte vetëvrasje.

— Mos, Milto, mos!

Ndonëse Alajdin Arbana u pérpoq ta mbante, shkrimtari u vërvit mes flakëve me një guxim e trimëri që e bënë trefish më të famshëm sesa ngjarja me belgjikun e Tare fanatikut. Ai doli me këmishë e pantallona të djegura, (si një xhind i vërtetë, tha dikush të nesërmen), por s'donte t'ia dinte fare. Në gjoks shtrëngonte bllokun e trashë të ditarit dhe fletoren me tetë kapitujt e rinj të romanit.

Ndërkohe një grup kooperativistësh filloj të fikte tendën duke mbushur ujë me kova në një kanal aty pranë. Disa të tjerë gërmionin rrëth e rrrotull me lopata për të mos lejuar zjarrin të zgjerohej. As njëzet metra larg ndodheshin tre kavaleta të mëdha me kashtën e grurit të porsakorrur. Kur rreziku u duk se po shmangej, ia mbërriten me një frymë në vendin e ngjarjes Kristoja e Ajeti. Kur panë shokët që rrinin kokulur, ata kuptuan gjithçka.

— Sa keq! — murmuriti inxhinieri. — Sa terllëqe po na ndodhin.

— Gjithsesi nata e djeshme dhe kjo do të mbeten të paharruara, — tha aktori.

Dalëngadalë flakët e zjarrit humbën njëra pas tjetrës dhe nga tenda e barit mbeti vetëm një hi i lagur që lëshonte tym të hidhur. Fshatarët filluan të largoheshin. Kur rrëth e rrrotull ra qetësia, katër artistët u kthyen në apartamentin e tyre dhe u shtrinë përsëri nga dy veta për krevat.

Ca të trokitura nervoze i zgjuan që në shtatë të mëngjesit. Ata u ngriten të katër dhe u veshën me ngut. Në prag të derës qëndronte me

duart vënë kërcënueshëm në bel, kryetari i kooperativës.

— A ka mundësi ta di, mor miq të dashur, se kur e keni planifikuar për t'u larguar nga Fushëndrita? — qenë fjalët e para të tij, të mbingarkuara me inat.

— E pse do ta dish? — pyeti Kristo Shigjeta.

— Sepse kështu siç e keni nisur, do të më shkatërroni gjithë kooperativën!

Inxhinieri i hekurudhave nënqeshi. Ai mezi po e priste rastin për t'u larguar.

— Domethënë ti, kryetar, po na pérzé? — tha duke hequr syzet.

— Unë dua të di se kur do të ikni.

— Atëherë ne do ta ndërpresim lejen krijuese dhe do të largohemi në shenjë proteste, — tha Kristo Shigjeta. — Ju qenkeni njeri i palatuar estetikisht.

Ideja e kthimit në qytet pot e ngacmonte prej ditësh edhe Ajetin.

— Kjo nuk durohet, — tha ai. — Me kaq leja mori fund. Unë po bëj gati valixhet. Kjo sjellje është e padurueshme.

— Me artistët kështu është sjellë vetëm Platon, — thirri përsëri Kristoja.

— Edhe Hitleri me Pinoçetin! — shtoi Aladdin Arbana. — Ku janë valixhet e mia?

— Mos më çani kokën me Platonët e Pinoçetët tuaj, — ua ktheu kryetari. — Rruga ju qoftë e mbarë!

— Largimi i shokëve më detyron edhe mua të bëhem gati për në shtëpi, — tha me hidhërim Miltiadhi Nërënxa. — Ky veprim do t'ju njollösë për gjithë jetën, shoku kryetar.

- Gjithë turpin e mbaj unë, vetëm ju nisuni! — tha kryetari duke zbritur shkallët.
— Armik i artit! — thirri Kristoja.
— S'ke lexuar një roman, — shtoi Ajeti.
— Sektarist! — e pasoi Alajdini.
— Kështu është kur njerëzit nuk e kuptojnë shpirtin e artistëve, — tha Miltiadhi Nerënxa.
Pas pak katër shokët telefonuan agjencinë e taksize për një kamion dhe filluan të bënин gati çantat e valixhet e shumta.

VXX

— Mine se n kthejesh përmes qytetit —

— Buzqash me veshjet e vjetra —

— M. ùt resiev jam tañu o rikom? —
Jeliazda mifide vebuk rikomqat mi — finna
mogari i fridit — tizra i Marik
Mora forde — mifidek ñgu m. resiev —
mifidja roeq u ñu mifidja
mifidja u ñu mifidja tua bñjel mifidja —
mifidja mifidja vebuk — mifidja u mifidja
mifidja mifidja mifidja mifidja vebuk mi —
mifidja mi mifidja vebuk mifidja mi mifidja u
mifidja mi mifidja mi mifidja mi mifidja mi

XXV

Kthimi i shkrimtar Miltiadher Nerënxsës nga leja krijuese qe një ngjarje që nuk mundi tē kalonte pa rënë nē sy ato ditë tē qeta e tē rëndomta koriku. Fqinjët dolën nëpér dritare pa e përbajtur dot respektin. Fëmijët rendën pér t'u marrë çantat e mëdha. Një grup pensionistësh u afruan pér t'i dhënë dorën, Sofia zbriti e ngazellyer nëpér shkallë.

— Mirë se u ktheve, pena e lagjes! — filuan përshëndetjet. — Si ia kalove andej nga fshati?

— Bukur, shumë bukur, — përgjigjej shkrimtari.

— A shkrove ndonjë vepér tē re? — pyeti një djalë.

— Nisa një roman voluminoz.

— Po fshatin a e njohe ndopak?

— Jam bërë specialist bujqësie. Zëreni se jam bujk.

— E zeza! — klithi Sofia e trembur kur pa flokët e përcëlluara të të shoqit. — Milto, ç'të ka ndodhur?

— Asgjë, e dashur. Një magazinë e kooperativës mori flakë dhe unë s'mund të qëndroja dot mënjanë. Mirë se të gjeta, e shtrenjta ime! E kam ndier tmerrësisht mungesën tënde.

Vetëm Ernesti nuk shfaqi ndonjë reagim të veçantë për kthimin e të atit. Me pamjen e vet të mërzitur e indiferente ai po përtypte pjeshka të nxjerra nga frigoriferi ulur në ballkon, duke sharë si shpeshherë me vete gjuhëtarët si njerez të cilëve u shtoheshin titujt dhe rrogat kot fare.

— Milto, djali ka shpëtuar nga një krizë e rrezikshme, — i pëshpëriti Sofia të shoqit. — Pas ngeljes në provim desh u kacafyt me një pedagog të gjuhësisë. Ka përbysur një tenxhere me supë dhe ka thyer dy pjata gjelle. I pëlqen të hajë vetëm gjëra të ftohura në frigorifer.

— Po tani, si ndihet? — pyeti Miltiadhi.

— Më i qetë. Ernest! U kthyebab!

— Ou! Mirë se erdhe, baba! — përshëndeti Ernesti duke u munduar të buzëqeshte. — Na solle ndopak vlagë fshati? Mbresa, emocione? A është e vërtetë se ke bërë dyluftim me një plak fanatic si kaubojsit nëpër filma me «Far Uest»?

— E zmadhuar, Ernest. Vetëm e detyrova të ulte pushkën kriminale. Po ti, si ia ke çuar?

— Ja, e nisa plazhin me një për vjeshtë.

— S'ka gjë, mos u mërzit.

— Gjuhësi hesapi. E kisha llogaritur.

— Hë, po vëllimin tim të ri, e lexove?

— Po.

— Si t'u duk?

Ernestin e gjeti të papërgatitur kjo pyetje.

— Ja, ashtu, — tha pas pak. — Si të tjerët.

Nuk sjell ndonjë gjë të re.

I ati tundi kokën i pakënaqur.

— Ah, mor djalë, ti ke një gusto të çuditshme.

— Ndoshta, — pranoi Ernesti.

— Nejse, do të bisedojmë përsëri.

Pas një banje të ngeshme Miltiadhi Nerënxa hodhi supeve robëdëshambrin e tij të gjatë ngjyrë vishnje, hyri një herë në studio, vështroi gjithçka me mall, që nga tavolina e punës e deri te gaforrja e kuqe në qendër të bibliotekës, pastaj doli dhe u ul i lehtësuar në ballkon. E shoqja i solli në një tabaka të madhe kafenë e zakonshme të pasdites dhe pesë kopjet e vëllimit «Fllade e stuhi». Pasi rrufiti dy gllënjkë lëng të nxehjtë, ai e mori veprën e vet në duar dhe filloi ta kundronte e ta përkëdhelte siç bën nëna e lumtur me fëmijën e saj.

— Edhe stilografin, Sofi, — tha ; mallëngjyer.

Me dorë të dridhur nga emocionet ai filloj të shkruante në njérën prej kopjeve një kushtim për të shoqen.

— E dashur, kjo është për ty, — tha duke e vështruar Sofinë gjatë në sy. — Kur të marr honoraret, do të porosisim edhe një çantë të bukur. Gjithë sukseset e mia t'i dedikoj ty.

Dy lot u shkëputën si dy smeralde nga cepat e syve të Sofisë. Ajo s'qe në gjendje të shqiptonte qoftë edhe një fjälë.

Pasi e mblodhi disi veten, Miltiadhi Nerënxa shkroi edhe tri kushtime të tjera për shokët e tij të ngushtë. Librat ua dhuroi të nesërmën pa-sdite kur u takuan në lulishten në qendër të qytetit.

— Jam jashtëzakonisht i prekur, Milto, — tha Alajdin Arbana me ton ceremonial. — Ky është një nder për mua. Vëllimi «Flladë e stuhi» do të vendoset në vendin më të dukshëm të shtëpisë sime.

— Ti ke qenë mes nesh personaliteti më i rëndësishëm artistik, — tha Ajet Shkëmbi. — Na ke lartësuar në sytë e bashkëqytetarëve edhe ne të tjerët.

Kristo Shigjeta u detyrua të hiqte syzet.

— Duke më dhuruar këtë vepër fondamentele të poezisë së sotmë shqipe, ti, Milto, më vure para një obligimi tepër të madh. Unë do të filloj ta përkthej «Flladë e stuhi» në frëngjisht për çdo eventualitet.

— Ju faleminderit për vlerësimet e larta, shokë, — tha poeti me dorën në zemër. — Tani le të dalim një herë librarive për të parë si po shitet libri.

Katër shokët morën ipërmes bulevardit kryesor duke tërhequr vëmendjen e njërzve pas tërë atyre ditëve mungese. Në fillim hynë në librarinë kryesore të qytetit ku blerësit ishin më të shumtë për shkak të daljes së një sërë botimeve të reja.

— Shikoni si shtyhen, — tha Alajdini. —

Sigurisht për vëllimin e Miltos. Mos u shitën të gjitha kopjet? S'po e shoh të ekspozuar.

— Ja, qenka këtu poshtë, — ia zuri syri Ajetit duke u afruar te banaku. — Shoqja shitëse, si paraqitet gjendja e vëllimit «Fllade e stuhi»?

— Ç'është ky «Fllade e stuhi»? — pyeti shitësja, e hutuar nga kërkesat e shumta.

— Si ç'është?! Ja pra, ai vëllimi poetik në njyrë të kaltër i Miltiadhi Nerënxsës.

— Shqiptar është ky autor?

— Po, moj motër!

— Ehë! Akoma s'është shitur asnjë kopje. Pas këtyre fjalëve Miltiadhi u nxi si mali i Dajtit në ditë shiu.

— Shitëset e librarive tona janë pa kulturë, — tha i prekur. — Nuk dinë t'i publikojnë vlerat e vërteta.

— Shoqja shitëse, nxirreni vëllimin «Fllade e stuhi» në një vend të dukshëm, — thirri piktori. — Ai është një kryevepër. E kupton?

— Milto, mos u mërzit, — e ngushëlloi shokun inxhinieri. — Vëllimi s'është zbuluar akoma. Është ende herët. Kur t'i bëjë jehonë edhe kritika, atëherë...

Duke diskutuar për vlerat e fuqishme të vëllimit «Fllade e stuhi», të cilat ishte e vështirë të kapeshin nga lexuesi i pakualifikuar, katër shokët u kthyen bullevardit dhe hynë në librinë në qendër të qytetit. Atje ishte blerë vetëm një kopje e librit nga një letrar i ri që e kishte pandehur Miltiadhi Nerënxsën autor grek. Kristo Shigjeta e Alajdin Arbana i folën gjatë shitëses se si duhej ta publikonte vëllimin, ku ta

vendoste, si t'u përgjigjej blerësve kur ta pyes-nin.

— E shumta pér një javë libri do të jetë shitur, — tha piktori kur dolën. — Do ta shihni.

Një javë rresht, pasdite pér pasdite, katër artistët hynin e dilnin nga njëra librari në tjetrën pér të parë gjendjen e shitjes së vëllimit «Fllade e stuhi», por më kot. Në tërë qytetin nga blerësit ishin tërhequr vetëm tri kopje. Miltiadher Nerënxa u bë tepér nervoz. I shoqëruar në kor nga shokët, ai shante herë pas here shitëset e pakulturuara, lexuesit pa shije, kritikët guhakë që nuk reflektorin në kohë ndaj vlerave të vërteta letrare. Por inati i tij u bë shpërthyes kur përgjegjësi i veprimitarive kulturnore-artistike në Pallatin e Kulturës nuk pranoi të organizonte një diskutim të zgjeruar krijues të librit, duke e quajtur vëllimin «Fllade e stuhi» të rëndomtë, pa arritje artistike, që nuk i përbollonte kërkесat e një diskutimi të madh. Miltiadher Nerënxa e mbërtheu atë pér këmishe duke i këputur dy kopsa dhe duke i përplasur në fytyrë fjalët.

— Njeri i pakualifikuar! Ziliqar!

Megjithatë autori i librit «Fllade e stuhi» nuk i humbi shpresat, gjendja do të përmbysej plotësisht pasi kritika të zbulonte vlerat e mëdha të librit të tij. Nervozizmit të fillimit ia zuri vendin pritja. Emri Nerënxa u përmend pér herë të parë, pas shumë vjetësh në një artikull pér gjendjen e poezisë të kritikut të mirënjojur, Skënder Milotit, botuar në «Drita» nga fundi i korrikut. Miltiadhi nisi ta lexonte artikullin tepér i përqendruar, ndërsa Sofia i pruri kafenë

e mëngjesit të së dielës në ballkon. Befas, nga mesi i shkrimit, filxhani u drodh në dorën e poëtit, pastaj ra dhe u thye me zhurmë. Kritik Skënder Miloti e kishte cilësuar vëllimin «Fllade e stuhi» të dobët, me motive të përsëritura, ilustrativ, deskriptiv, duke theksuar se redaksia ishte treguar dorëlëshuar ndaj autorit.

Dy ditë rresht kurkush nuk arriti të shikonte një grimë buzëqeshje në fytyrën e Miltiadhs Nerënxs. Por mes hidhërimit të tij oqeanik një letër e çuditshme anonime u fut nën derën e apartamentit. Mbi zafin e saj ishte shkruar: «Shkrimtarit, dramaturgut e poetit të shquar, Miltiadhs Nerënxs, nga një grup adhuruesish, me rastin e botimit të kryeveprës së piezisë së sotme shqipe «Fllade e stuhi».

Ai e përpjau letrën me sy.

Jemi një grup të rinjsh që e kemi ndjekur fajqe pas faqeje krijimtarinë tuaj. Nuk mund të rrnim dot pa ju përshëndetur me rastin e botimit të librit të ri, vëllim të cilin e kemi mësuar pothuaj përmendsh. Ju jeni një gjeni i botës së letrave. Të tilla pena të fuqishme i nevojiten sot letërsisë sonë.

Presim me padurim vepra të tjera

Ajo letër qe si një pranverë e ngrohtë mes dimrit të ftohtë të hidhërimit të Miltiadhs Nerënxs. Ja, paska edhe lexues që më kuptojnë, mendoi ai i lumtur, bile më adhurojnë.

Por acari s'vonoi të kthehej përsëri. Në gazetën «Letrari i ri» një studiues letërsie botoi një shkrim për rëndësinë e njohjes së jetës nga poeti, mangësi e cila nuk mund të fshihet dot në krijimtari. Këtë mendim ai e konkretizonte me vëllimin «Fllade e stuhi» duke theksuar se një talent i ri si Miltiadher Nerënxa «shpesh na jep përjetime që s'tingëllojnë fort jetësore». Vëtëm Sofia qe dëshmitare kur i shoqi e shqeu gazetën «Letrari i ri» në mbi pesëdhjetë copë dhe e vërviti nga dritarja e studios.

Dy ditë pas kësaj ngjarjeje nën derën e apartamentit u fut një letër tjetër anonime, në të cilën, me një stil telegrafik, ishte shkruar tepër ftohtë:

Shoku Miltiadhh, ju këshilloj të hiqni dorë një orë e më parë nga krijimtaria letrare. Mos e loddni veten kot, sepse talenti ju mungon plotësisht: Sprovat tuaja të dështuara po ju bëjnë qesharak në gjithë qytetin. Mos dëgjoni komplimentet e shpëlara të Alajdin Arbanës, Kristo Shigjetës e Ajet Shkëmbit, të cilët janë njerëz pa pikë vlere morale e artistike. Kaq e kaq vite ju jeni ngatërruar gabimisht me letërsinë.

Me respekt; një bashkëqytetar

Më shumë se përbajtja e letrës Miltiadher Nerënxon e shtangu kaligrafia e saj. I ngjante gërmë për gërmë dorës së Ernestit. Si ka mundësi, filloi ai të murmuriste me vete. Si ka mundësi?! Për disa ditë me radhë u mundua të zbulonte diçka në fytyrën e të birit, por më kot. Gjithçka tek Ernesti, falë përgjumjes dhe

indiferentizmit të tij, ishte e padeshifrueshme.

— Mister, — iu ankua shkrimtari së shoqes.

— Kjo shtëpi po bëhet misterioze.

Dimri i hidhërit të autorit të librit «Fllade e stuhi» arriti ngricat e minusin më të madh kur kritiku Vangjo Ngjala batoi në gazeten «Débat lettar» artikullin e gjatë dërrmues «Si shfaqet mediokriteti në poezi», ku të gjitha shfaqjet e mediokritetit ilustroheshin me krijime të Miltiadhit Nerënxs. Pas atij artikulli pothuaj në të gjitha shkrimet vëllimi «Fllade e stuhi» filloi të radhitej te veprat e dobëta e mediokrëtë viteve të fundit. Bile edhe në gazeten lokale një dorë armiqësore nën pseudonimin Adriatik Korabi, shkroi se libri i fundit poetik i Miltiadhit Nerënxs ishte shprehje e mediokritetit dhe kulturës së pamjaftueshme të autorit.

Vangjo Ngjala u bë emri më i zi në jetën e Miltiadhit, gati-gati sinonim i kancerit. Në biseda me shokët e vet të ngushtë ai përdori kundër tij të gjithë bagazhin e sharjeve që zotëronte, e quajti vrasës të reputacioneve letarare, njeri pa karakter, Tartuf të botës së letrave, servil të shkrimtarëve të njojur dhe armik të autorëve nga rrëthet e largëta, ndërkohë që betohej se do të hakmerrej në rastin më të parë. Atë po e çmendte fakti që veprën e vet ia kishte diskredituar aq vandalisht një firmë si Vangjo Ngjala, i cili dihej se e kishte mbaruar fakultetin me kopje. Ai shpesh ishte shquar për akrobacira në shkrimet e veta, për ndjekjen e motos «Nuk ngas njeri, vetëm teorizoj» dhe në plenumin e kohëve të fundit të Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve ishte kritikuar për

mungesë sinqeriteti e parimesh. Ishte një poshtërsi letrare t'i ilustroje krejt rastet e mediokritetit në poezinë shqipe vetëm me vëllimin «Fllade e stuhi». Kjo tregonte edhe një herë se Vangjo Ngjala s'kishte hequr dorë nga akrobacitë dhe se në artikullin e tij ai kishte shkruar për një autor prej të cilit s'mund t'i vinte asnjë e keqe.

Do tē pērgatitem pēr një hakmarrje po kaq diskredituese, vendosi Miltiadher Nerënxa.

Fragmente nga ditari artistik

Habi! Ja, se si u bëra rastësisht dëshmitar i një drame. Po kthehesha natën nga një vizitë kur në një rrugicë të errët vura re një burrë e një grua që përpinqeshin të fshiheshin. Intuita ime si gjithmonë goditi në dhjetëshe të tabëllës. Ishte fjala për një flirt. Gruaja dukej tepër e tronditur. Burri mundohej ta bindte për diçka, por ajo nuk pranonte. Tunda kokën i dëshpëruar. Sa e hidhur është tradhtia bashkëshortore! Sa fatkeqësi sjell ajo!

E mbajta frymën drejt e në studio. Nisa të hedh në letër skicën e një drame me temë morale, në qendër të së cilës do të jetë një familje, bashkëshortët e së cilës janë martuar me dashuri. Por ajo dashuri kishte qenë flakë kashë. Gruaja mendjelehtë fillon flirton. Burri dhe opinioni ynë i shëndoshë e dënojnë sjelljen e saj. Ata të dy ndahan.

Konflikti i dramës është vërtet i ashpër, por pyetja e parë që unë i shtroj vetes s'më lë të

vetëmashtrohem: A është tipike ngjarja për realitetin tonë? A përfaqëson personazhi im gruan tonë heroike dhe shembullore? Kurrsesi. Dramën nuk mund ta shkruaj dot. Në realitetin tonë të bukur e të shëndoshë socialist nuk ndodhin kurrë tradhti bashkëshortore. Gruaja jonë ka qenë denbabaden besnikë ndaj burrit.

Atëherë vendosa të shkruaj një novelë me titull «Lëkundje e shkurtër». Subjekti është i thjeshtë: një grua lëkundet drejt flirtit pas një sërë grindjesh me burrin. Ndërhyr aty këshilli i lagjes dhe gjendja përmbyset. Bashkëshortët pajtohen përsëri dhe rinisjeta e lumtur.

Ah, nuk qenka' e lehtë tē shpëtosh nga skematizmi!... siq i oianev mëdha e qëndrueshëm që dëshja është që s'mundet që zemra e formave e këtojve të cilat përfshijnë këtë vlerë. Nëse e këndojmë që dëshja është që zemra e formave e këtojve të cilat përfshijnë këtë vlerë, atëherë është e mundur që oboushë. Si që është mëdha e qëndrueshëm që dëshja është që zemra e formave e këtojve të cilat përfshijnë këtë vlerë, atëherë është e mundur që oboushë. Dëshja është që zemra e formave e këtojve të cilat përfshijnë këtë vlerë, atëherë është e mundur që oboushë.

XXVI

Lajmin se kritiku Vangjo Ngjala kishte ardhur me pushime në plazh pesëmbëdhjetëditheshin e parë të shtatorit Miltiadher Nerenxa e mori vesh rastësish gjatë një bisede në degën e Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të rrethit. Pasi u bind se të dhënat ishin plotësish të vërteta (kritikun e kishin parë duke lexuar në ballkonin e një vile në stacionin «Bylis»), autori i vëllimit të persekutuar padrejtësish u hoq mënjanë dhe buzëqeshi i kënaqur si dhelpra në përrallat përfëmijë kur sheh se planet e veta të gjuetisë po i shkojnë mbarë.

Deri natën vonë, ndërsa data katër e shtatorit ndërrohej me pesën, mbyllur në studion e tij, me kokën shtrënguar mes duarve, Miltiadher Nerenxa mendoi e mendoi për grackën që duhej t'i ngrinte armikut të vet më të madh letrar. Hakmarrja do të ishte vetëm morale. Ai do të arrinte të provonte se gjithçka që Vangjo Ngjala kishte shkruar kundër tij ishte shpifje dhe se sy-

nonte të godiste një kryevepër që pritej të sillte një çekuilibër në panteonin e poezisë shqipe. Në këtë betejë të vështirë poeti kishte një plus të madh; nuk njihet nga kundërshtari, ndërsa ai mund ta dallonte fytyrën dinake të Vangjo Ngjalës qoftë edhe mu në mes të shkallëve të stadiumit «Qemal Stafa».

Ora duhej ta kishte kaluar njëshin, kur befas, i mbytur në djersë, Ernesti u zgjua tepër i tronditur pas një èndrrë të frikshme, gjatë së cilës kishte vrarë pedagogun pedant të gjuhësisë, Stilian Kallmetin, duke e shtypur me një motor të madh «Suzuki» mu në mes në Rrugës së Elbasanit. Ndërsa ai psherëtinte i lodhur në çastet e zhgjendrës, dëgjoi të atin të thërriste: «Eureka! Eureka!» Ernesti u ngrit me vrull dhe hapi dorën e studios. Me dorën e djathjtë mbledhur grusht, i ati i kërcënohej dikujt tutje nga dritarja.

— Baba, ç'pate? — e pyeti Ernesti. — Mos zbulove ndonjë ligj të ri fizike?

Miltiadher Nerënxa u çudit kur e pa të birin aty.

— Po ti?!

— Ja, më doli gjumi nga vapa.

— Ehë. Thashë se mos kishe zbuluar ndonjë gjuhë të vdekur.

— Kush, unë?! Më mirë pranoj të hap edhe një herë i vetëm Kanalin e Suezit sesa të lodh trutë me gjuhë të vdekura, — u nxeh Ernesti.

— Mirë de, mirë, — e qetësoi i ati. Shko, shtrihu tani.

Në orën dhjetë paradite Miltiadher Nerënxa i zbriti autobusit të plazhit në stacionin «Bylis».

Një palë syze të mëdha dielli, me xama të rrumbullakët si fund kavanozi dhe flokët e lëshuar mbi ballë, i mbulonin pothuaj gjysmën e fytyrës. «Qyqja, i pëshpëriti një vajzë shoqes, si ngjaka ky burri si detektiv japonez.» Autori i librit «Fllade e stuhi» e kishte parashikuar edhe rrethanën e mbrapshtë që kritik Vangjo Ngjala mund ta njihte. Ai mori një çadër, e ngriti shpejt në rërë, u zhvesh e filloj të kërkonte me sy përreth. Iu desh të lëvizte poshtë e lart ndonjë gjysmë ore. Më në fund e dalloi shkatërruesin e reputacionit të vet nën një çadër blu tek bënte nënvizime në një roman të kohëve të fundit me pamje prej skeptiku; vetulla' të ngritura lart e buzë të mbledhura ironikisht.

— Më prit, o armik i kryeveprave, — murmuriti. — O grerë që i zilepsesh bletës, o shterpë që i zilepsesh gruas shtatzënë.

Iu afrua çadrës së kritikut i qetë dhe përshtëndeti miqësisht.

— Tungjatjeta, shoku Vangjo! A ju bezdis prania ime përpak minuta? Do të doja t'ju shkëpusja nga leximi.

— Kurse unë do të doja të dija se kush jeni, — tha Vangjo Ngjala.

Miltiadhi Nerënxa buzëqeshi. Planin e kishte të detaujar.

— Unë jam një amator i letërsisë, mekanik, quhem Dhimitër, pushoj këtu në kampin e punëtorëve, elbasanas. Shkrimet tuaja më pëlqejnë shumë, shoku Vangjo. Ju jeni një nga kritikët tanë më të mprehtë dhe më me horizont.

Pas këtyre fjalëve fytyra e Vangjo Ngjalës u çel e tëra si trëndafili në maj.

— Faleminderit për konsideratën! Më bëhet qejfi që një punëtor si ju i ndjek nga afër problemet letrare. Uluni, uluni ju lutem. Bisedojmë sa të doni. Edhe unë jam i lirë.

— Për mua është një njeri i madh të bisedoja me ju.

Kur e pa se pjessa më delikate e planit kaloi me sukses, shkrimtari e ndjeu veten plotësisht të çliruar. Tani i nevojiteshin vetëm aftësitë aktoriale të Ajet Shkëmbit. Ndërkohë që armikun e kishte pranë dhe nga urrejtja i vinte ta ngulte me kokë në rërë, i duhej të tregohej sa më i qeshur, të futej në botën e një mekaniku.

— C'mendim keni për nivelin e kritikës sonë, shoku Dhimitër? — pyeti Vangjo Ngjala.

— Më duket shumë operative, konstruktive. Do të thosha se qëndron më lart se letërsia. Kjo bën mu.

— Ja, këto janë fjalë me mend! — thirri i ngazëllyer kritiku. — Ankohen disa se kritika ka mbetur prapa, se gjoja nuk është objektive dhe në nivelin që kërkon kohë.

— Në asnjë mënyrë, shoku Vangjo. Këto vitet e fundit kanë qënë vite suksesesh për kritikën tonë. Sidomos libri juaj «Stafeta veprash dhe autorësh» ka disa artikuj të mrekullueshëm. Kjo tregon se ju keni një aftësi të veçantë përti kapur problemet shqetësuese në kohën e duhur.

— Ju faleminderit për vlerësimin!

Shprehjen e fundit Vangjó Ngjala u detyrua ta përsëriste disa herë me radhë; sepse Miltiadhi

filloi t'i lëshonte lëvdatat e komplimentet vrullshëm, si përrua mali, me një terminologji profesionale të ngritur, duke dalë kështu padashur nga roli i mekanikut elbasanas me emrin Dhimitër. Kur biseda u fut në problemet e poezisë, ai e priti me padurim rastin për t'i fryrë plagës që i digjte prej aq kohësh. Pasi kritiku i mbajti një leksion të gjatë për teknikat e poezisë bashkëkohore, Miltiadher Nerënxa që e kishte dëgjuar duke sharë vazhdimit me vete, tha me një ton të sigurt:

— Në poezinë tonë ju e përbysët gjendjen menjëherë, shoku Vangjo. Artikulli «Si shfaqet mediokriteti në poezi» qe një e shtënë topi që i detyroi të gjithë të ngrinin veshët përpjetë e të dëgjonin. Ishte shkruar me dorën e një kirurgu të sprovuar që i përcakton plagët dhe linjat e operacionit pa hezitim.

— Atë artikull ma kanë pëlqyer vërtet, — tha Vangjo Ngjala.

— Pale ç'ii bëjet atij poetit... si e quanin... Miltiadher, hë! Miltiadher Nerënxa. Ia grijë vëllimin «Flladë e stuhi» si në makinë të mishit.

— Eh, ai ishte paçavure, s'ishte vëllim.

— Po autorë si t'u duk nga formimi?

— Dava bëjtexhiu, plagjiat, një copë romantik i vonuar.

— Ke të drejtë. Edhe mua s'më ka pëlqyer fare. E njihni këtë Miltiadher Nerënxon?

— Jo. Kam dëgjuar se është tip psikopati. Ka shkruar edhe një tragjedi me gjashtë akte. Mendja të bën hatanë, mor vëlla.

— Åshtu është, Miltiadhi u kapërcye sikur po kalonte poshtë një gotë me helm. «Ah, vetëm

mos më ardhtë radha, murmuriti me vete. Do të ta tregoj unë qejfin ty, mor maskara. Ah!»

Biseda e ngrrohtë mes kritik Vangjo Ngjalës dhe mekanikut elbasanas, amatorit të letërsisë, Dhimitrit, vazhdoi deri nga mesdita me një rritje të ndjeshme të lëvdatave dhe komplimenteve në adresë të të parit, ndërkokë që shtohej edhe afiniteti miqësor mes të dyve, duke krijuar rreth e rrötull përshtypjen e të njoburve të vjetër. Ndarja e tyre nuk mund të kalonte pa një përqafim.

— A do të më jepet rasti t'i dëgjoj përsëri mendimet tuaja me vlerë, shoku Vangjo? — pyeti amatori i letërsisë.

— Oh, në çadrën time do të jeni kurdoherë i mirëpritur, — ia ktheu kritiku.

Të nesërmen, me të mbërritur në plazh, Miltiad Nerënxa nisi pjesën sulmuese të planit të tij. Te pista e shpërndarjes së barkave e motoskafëve tërhoqi për nja dy orë një barkë me rema dhe, duke vozitur mbi të vrullshëm si ata detarët e Odisësë, iu afrua vendit ku pushonte kritik Vangjo Ngjalë. Doli në cekëtinë, pastaj nxitoi drejt çadrës së tij. Armikun e vet më të urryer e gjeti përsëri duke lexuar e duke bërë nën vizime, por kësaj here në një vëllim me poezi.

— Shoku Vangjo, sot mendova t'ju krijoj pak variacion, — i ai foli shpenguar, duke i lënë mënjanë përshëndetjet e rëndomta. — A ju pëlqen shëtitja me barkë?

— Oh, shumë, — ia bëri kritiku buzagaz. — Bile kam vendosur t'i propozoj Federatës së

Sporteve që të hapë edhe një kampionat kënotazhi.

— Atëherë, ejani! Barka po na pret.

Pasi Vangjo Ngjala u rehatua në këçin e gjéré si në një kolktuk, Miltiadherë Nerënxa çau drejt thellësisë si një ujk i vjetër deti. Duke hapur përsëri bisedë letrare, shkuante tepër larg, atje ku bluja e ujit fillonte e bëhej e errët dhe kur-kush nuk mund t'ia mbërrinte me not. Kritiku mbeti i mrekulluar. Ai vështronte rrrotull me ngazëllimin e një detari që ka kohë pa lundruar. Miltiadhi ngriti remat lart.

— Hë, shoku Vangjo po ju pëlqen?

— Jashtë mase. Vetëm këtu s'ka gjë pér të kritikuar.

— Shijojeni kënaqësinë deri në fund atëherë. Lahuni.

— Oh, not di fare pak. Pastaj paska edhe dallgë.

— Mos e humbni rastin, shoku Vangjo. Do ta mbani mend pér gjithë jetën. Hidhuni vetëm një herë.

— Mirë e ke. Do të hidhem, — kritiku u çua.

Ah, tani do të të bëj unë të kënaqesh, mor kriminel kryeveprash, murmuriti Miltiadherë Nerënxa. Sapo Vangjo Ngjala ra në ujë, ai uli remat, krahëve, u largua nga njëzet metra, pastaj hoqi syzet e mëdha dhe i ngriti flokët mbi ballë.

— Këtu roli im mbaroi, Vangjo Ngjala, — tha duke shfryrë vetëm ironi. — Ti je një kameleon dhe tani do ta provosh këtë.

— Ç'është kjo shaka? — thirri kritiku. — Afrojeni barkën. Unë nuk di not. Kush jeni ju?

— Unë jam Miltiad Nerenxa, autor i vëllimit «Fllade e stuhi», të cilin ju e masakruat aq botërisht.

— Si?! Ju Miltiad Nerenxa?! — nga hutimi kritiku piu dy gllënka ujë të kripur dhe filloj të kollitej me të madhe. — Shoku Milto, afrojeni barkën ju lutem! Le të bisedojmë shtruar.

— Unë s'kam ç'bisedoj me ty. Tani kthehu me not po deshe.

— Ndihmë! Ndihmë! — filloj të therriste Vangjo Ngjala. — Po më braktisin! Po më mbysin!

Miltiad Nerenxa qeshi.

— Mos u çirr kot. S'të dëgjon njeri.

— Shoku Miltiad, po ç'është kjo sjellje?! Unë kam analizuar vetëm veprën tuaj. Me individualitetin tënd nuk jam marrë fare.

— Ah, dhëlpër! Nuk më zbut dot jo!

— Po të dëshironi, unë mund të shkruar një artikull tjetër për të nxjerrë në dukje anët pozitive të vellimit «Fllade e stuhi».

— Ashtu, ë? Nuk kanë ç'më duhen lëvdatat e tua.

— Ju lutem afroni barkën! Ç'dreqin kërkon nga unë?

— Kam një kërkesë fare të thjeshtë. Tani, thirri me të madhe se vëllimi «Fllade e stuhi» është një kryevepër dhe se Miltiad Nerenxa është një poet i madh.

— Ç'do të thotë kjo?

— Kjo do tē thotë që tē pranosh një tē vërtetë!

Kritik Vangjo Ngjala po përpëlitez i lodhur mes thellësisë në blu tē errët.

— Hë, do tē thërrisni apo t'ju lë këtu? — e kërcënoi shkrimtari.

— Po... do tē thërras... E... hëm... «Fllade e stuhi» është një kryevepër! Miltiadher Nerënxa është poeti ynë mië i madh!

— Bukur! Tani kapu këtu në fund tē bar-kës. Ashtu! Jo, mös hip! Dotë tē têrheq unë deri në breg. Kështu e meritoni.

Tërë rrugën kritiku nuk u ndie. Kafshonte bûzët e shkrofëtintë duke futur kokën në ujë nga inati. Vetëm kur këmbët i shkelën në këtinë tē sigurt ai u largua nga barka, mori frymë i lodhur, pastaj filloj tē shante;

Miltiadher, qenke një gomar e bir gomari, shtatë brezash! Idiot! Xhahil! Bejtexhi! Vëllimi yt është një paçavure! E more vesh?

Miltiadher Nerënxa iu zhakerrye duke tundur kokën:

— Ah, po tē gjeta edhe një herë brenda në det!

— Qëdo tē jetoje kjo?

— Sotia është që kohë do i tregojet
një lloj semundje të speciale shkrimtarësh.
— Qëndra e mëtëveshi se kësaj Milton
ba shkririn një lloji tonës që tashmë ka 300 faks.
— Bespi i më durrë kësaj Miltonit
— Qëdo është gjithmonës
— Më zinxhi diperë shkrimtarët e mëdhenj.
— Kritikë përdidur që së paktën
fotografi është dotëzuar...
— Qëdo është gjithmonës

Nga bisedat nëpër shkallët e pallatit

— Është e vërtetë ajo që flitet? Milton do ta
heqin nga teatri për paaftësi.

— Mirë do t'ia bëjnë. Sështë pér atë punë
ai.

— Habi! Po Miltoja u këput duke shkruar
goxha vepra!

— Ama, veprat e tij! Ato i shkruaj edhe unë
që më ka dalë letërsia tresh në gjimnaz.

— Thonë se paska bërë edhe gabime ideolo-
gjike në një vëllim me poezi.

— Jo në poezi, por te tragjedia me gjashtë
akte.

— Nga ai çdo lloj gabimi mund të presësh.

— Një shok nga Tirana më tha se kritik
Vangjo Ngjala qenka ankuar në degën e Lidhjes
të rrethit tonë se Miltoja ka tentuar ta mbysë
në det pér hakmarrje.

— Një shkrimtar që shkruan natën edhe
këtë mund ta bëjë.

— Pse s'thoni se ai paska kaluar fare.

- Sofia në të vërtetë ka kohë që i trembet një lloj sëmundjeje speciale shkrimtarësh.
 - Çuna, a e morët vesh se xhaxhi Miltoja po shkruan një roman të trashë gati 900 faqe?
 - Babi im e quan xhaxhi Milton grafoman.
 - Ç’do të thotë grafoman?
 - Me siguri quhen shkrimtarët e mëdhenj.
 - Kurse babi im tha një ditë se xhaxhi Miltoja është «dështak» që s’pranon të dorëzohet....

Aug. 18, 1917. This afternoon went to

so so often went up the hill, and I am
glad to say he is now a good
man & a true friend.

Die Arbeit ist eine Tugend, die Freizeit ein Übel. Ein Mensch, der sich nicht mit Arbeit beschäftigt, ist ein Mensch, der nichts zu tun hat.

meistering öf fownd inisipä jei' mör in eppi
kilkö es sdt ſen amariV mör mör. Mör
eipili e nöpeli ſen amariV mör mör. Mör
ßayenit ut vörnöpeli eipili ſen ſen. Mör
mör. Mör. Mör. Mör. Mör. Mör. Mör.
mör. Mör. Mör. Mör. Mör. Mör. Mör.
mör. Mör. Mör. Mör. Mör. Mör. Mör.

XXVII

Nga fundi i shtatorit, kur koha u freskua dhe gjurmët e vona të verës filluan të mbeteshin pas, për shkrimitar Miltiadher Nerënxon ia mbërritën ca ditë zagushie të tmerrshme që ia rrëmbyen edhe gjumin e ëmbël e të gjatë të pasdites. Në teatër pritej një lëvizje e vrullshme kuadri. Ai si institucion ishte cilësuar «strofkë e paaftëve». Këta të paaftë nisnin që me drejtorin dhe përfundonin me piktorin e dekoreve. Ndërtë parët në këtë listë radhiteshin libretisti dhe aktori i njohur me aderencë tragjike, Ajet Shkëmbi.

Kur Miltiadher Nerënxa dëgjoi për qarkullimin e afërt, në fillim u ngazëllye. Arti nuk mund të shkojë përpëra pa mënjanuar nga rruga të pa-aftët, deklaroi para një grupei kolegësh. Teatri ynë ka nevojë për një shkundje gjashtë a shtatëballëshe. Më vonë, kur i thanë se në listën e të qarkulluarve bënte pjesë edhe ai, libretisti nënqeshi me pamjen e një mjeshtri për të cilin janë

përhapur thashetheme të pakëndshme. Përkundrazi, unë do të jem tek ata që do të përpilojnë listën e të paaftëve, të cilët duhen lëvizur, thirri ai përsëri para një grupi kolegësh.

Por, kur mësoi me një siguri të padiskutueshme se ishte i dyti në listën e qarkullimit, Miltiad Nerënxa u prek aq thellë, saqë pësoi një prerje oreksi dhe këputje të frikshme, shenja të cilat, tepër e trembur, Sofia i mori për atë sëmundjen speciale të shkrimtarëve.

— Kjo duket qartë, si hëna e netëve të korrikut, se më kanë inat dhe duan të më zënë vendin, — u tha ai shokëve të ngushtë një mbrëmje në kafe «Gjuetari».

Kristo Shigjetaj hoqi syzet si gjithmonë në çaste tepër të rëndësishme.

Qarkullimin mos e prano, Milto, — tha vrenjtur: — Të quashnë paaftë një autor të kilibrit tënd, është çmenduri dhe anakronizëm.

— Më duket tmerrësish e pabesueshme, — vazhdoi Alajdin Arbana. — Cdo enigmë mund ta zgjidhje, por këtë s'e zgjidh dot.

— Milton gjithmonë e kanë pasur inat në teatër, sepse i sfidonte të gjithë me kulturën e tij, — tha me gjysmë zëri Ajet Shkëmbi. — Prej tij, më vunë edhe mua në listë, sepse jemi shokë të ngushtë, Kjo është tamam xheloz profesionale.

— Mos u mërzit, Ajet, — e ngushëlloi Miltiad Nerënxa. — Ata do ta kërkojnë një aktor si ti, por s'do ta gjenë dot dhe do të vijnë të të luten pastaj.

— Të dhënë aktoriale të Ajetit vetëm ata që janë miopë artistikë s'mund t'i vënë re, — tha inxhinieri i hekurudhave me tonin e vet

filozofik. — Kjo është paradoksale. Të paaftët godasin talentet!

— Jashtëzakonisht e çuditshme! — e mbëshe-teti piktori. Ah, e keqja është thelbësore, vë-llezër.

Me të tilla ankime, shfrime pakënaqësie, hâbie, çudie, lavdërimë e ngushëllime vlerash e meritash, stërzmadhime e zbukurime, katër shokët kaluan një javë rresht mbrëmjet në kafe «Gjue-tari», me atë singjeritet e solidaritet, me atë ngrrohtësi e shpirt sakifice që i kishte karakterizuar gjithmonë, ndërsa prisnin ndonjë lajm të ri.

Ishte një paradite e turbullt e dy tectorit kur libretist Miltiad Nerën-xën e injoftuan në zyrën e tij se pas dhjetë minutash fillonte një mbledhje tepër e rëndësishme e kolektivit për problemet e paaftësisë profesionale e të qarkullimit. Ai u ngrit i vrenjtur dhe vështroi nga autoportreti i Rembrandtit, mbi raftin e mbushur me dosje dramash. Gjyq, mjeshtër, murmuriti, do të më gjykojnë. Do të më thonë se jam i paaftë. Dhe kujt?!

Hyrja e Miltiadher Nerën-xës në sallën e madhe të mbledhjeve i ngjauasaj të një ambasadori të ngarkuar ngab qeveria e tij me dorëzimin e një mesazhi për prerje marrëdhëniesh diplomatike. Ai zuri vend me pamje të indinjuar, pâ vështruar as majtas e as djathtas, duke lënë të kuptohej se as që pranonte që aftësitë e tij të viheshin në diskutim. Duart i dridheshin nga nervozizmi dhe sytë i rrezatonin vetëm ironi.

Drejtori vendosi qetësi në sallë dhe pastaj bëri një hyrje të shkurtër për domosdoshmërinë

e një vale qarkullimesh në kolektiv. Me një vetëmohim të pashebullt ai mori guximin ta quante veten «jo plotësisht të aftë dhe në nivelin e kohës», duke theksuar se ndiente të nevojshme të kalonte në një detyrë tjetër. «Ti, edhe magazinier dekoresh, tepër e ke, mor qyqar, murmuriti Miltiadher Nerënxa me vete. — Vendin tënd e meritonte kush e meritonte.»

— Shokë, grapi i studimit për problemet në fjalë, — vazhdoi drejtori, — e sheh të arsyeshëm edhe qarkullimin e libretistit, Miltiadher Nerënxs. Le të diskutojmë me radhë.

— Këtu s'ka asgjë për të diskutuar, — u dëgjua pa vonesë zëri i regjisator Kleo Bregut. — Shoku Miltiadher të lirojë vendin një orë e më parë. U bë kaq vjet libretist këtu dhe s'ka shkruar qoftë edhe një dramë që t'i afrohet të paktën nivilit mesatar. Për këtë janë dëshmitarë të gjithë.

— Unë do të shtoj se Miltoja ka edhe një kulturë profesionale të cunguar, — tha aktor Arben Erzeni. — Më duket tepër anakronik për kérkesat e sotme.

Miltiadher Nerënxa vetëm nënqeshi. Nuk e kishte besuar se do të kishte aq shumë armiq. Gjashtë diskutantë të tjera radhazi iu kundërvunë duke e quajtur «të paaftë, mendjemadh, fodull, mosnjohës të skenës e të dramës, shkrimitar mediokër» e të tjera cilësimë të tillë fyese për një penë të fuqishme. Autori i pesë librave po priste që në sallë të buçiste në mbrojtje të tij basi i Ajet Shkëmbit, por më kot. Shoku i ngushtë ilmbante sytë përdhe. Kur e pa se largimi i tij angat teatri po ligjerohej plotësisht,

Miltiadhi Nerënxa brofi në këmbë duke thirrur me inat:

— Mjaft! Unë s'pranoj që figura ime të gjy-kohet këtu. Të gjitha sa u thanë i hedh poshtë. Do ta bëj vetë kërkesën për largim. E shoh të pamundur qëndrimin në këtë institucion.

— Bëj ç'të duash, vetëm liro vendin sa më shpejt, — ia priti regjisori Kleo Bregu.

— Ti, Milto, gjithmonë ke jetuar në një botë iluzive, — tha drejtori. — Me sa duket akoma s'do të shkëputesh prej saj. Si të duash. Kjo është e drejta jote. Vazhdojmë, shokë! Grupi i studimit mendon se edhe aktori Ajet Shkëmbi duhet të kalojë në një vend tjeter pune. Le ta shohim. Duam diskutime bindëse.

— Më mirë të mos humbasim kohë me diskutime, — u dëgjua zëri i fikur i Ajet Shkëmbit. — Edhe unë jam dakord me mendimin e grupit të studimit. Këto vitet e fundit kam një rënie të ndjeshme profesionale, dhe kjo ka ardhur, sepse nuk kam arritur të gjej plotësisht veten. Tani e kam kuptuar se kam aftësi të veçantë për inspektor skene, bile edhe për libretist. Shokët le ta shohin mundësinë e kalimit timi në këto dy vende pune.

Ashiku si ajo lava që zien me të madhe para shpërthimit nga krateri, filloi të ziente brenda Miltiadhi Nerënxsës një urrejtje e befasishme, e përzier me çudi dhe përcëmim. Si ka mundësi, murmuriti ai me vete duke kërkuar sytë tinë-zarë të Ajet Shkëmbit. Si ka mundësi?! Ardhka një ditë dhe befas zbulon se për shok të ngushtë ke mbajtur një Jago. Si njeri i pasioneve të forta e shpërthyese, shkrimtari nuk duroi dot më.

— Tradhtar! — thirri duke u çuar vrulltazi.
— Gjarpër! Kobër! Anakondë! Fytyra jote kërkon
të bëhet libretist?! Ti s'duhet të shkelësh më në
teatër? Ekupton? Trajner noti dhe e ke shumë
Jago!

Salla ngriu. Vështrimet u kthyen nga aktori.
— Në këtë institucion s'duhet të shkelësh më
ti, Miltiadherënxa, — tha ai duke nënqeshur.
— Jenjë kalemxhi! I bën dramat si këpucët me
porosi. Jenjë matuf! Me plot gojën matuf, për-
derisa shkruan tragjedi me turq. Më torturoye
edhe mua koft me atë rolin e prïncit,
— Ti s'ë ke merituar kurë jetën teatrale,
— iu kthye ishkrimtari. — Dembel! Ke qenë
gjithmonë një figurant! Të pëlqen vetëm pla-
zhi. Një muaj e ca ndenje në fshat kofare.

— Kot ndenje ti! Merreshe me ide të gmen-
dura. E harrove kasollen, e barit? U bëra qull
vetëm prej teje. Gjithmonë shoqërimi me ty, më
ka prishur punë, më ka ulur vlerat.

— E tmerrshme! Ti je një njollë në historinë
e teatrit, mor qyqar! Njeri kofare. Jeton vetëm
për të ngrënë dhe për të bërë plazh.
— Kurrse ti gjithë karrierën tënde ke shkruar
vetëm budallallëqe!

— Shkolla më zullap, se s'iia vlen të merresh
mentyl otrorik

— Shkolla më zullap, se s'iia vlen të merresh
mentyl otrorik

— Balenë e dhjamosur!

— Shkarravites i dështuar!

— Nulitet artistik!

— Sharjet e atij dialogut të ashpër kushedi sa

do të kishin, vazhduar e çnatyrë do të kishin

marrë sikur dy kundërshtarët të mos i kishin ulur duke i tërhequr për krahësh.

— Ju të dy mund t'i hapni blloqet e intimiteteve kur të dilni përjashta, — tha drejtori i vrenjtur. — Na lini tanë të vazhdojmë punë.

Miltiadher Nërenxës po i dukej karrigia si çark. Shfrynte e turfullonte si ato çezmat para se të vijë uji. Disa herë e dëgjuan të murmuriste fjalët kobër dhe Jago. Pas pak kërkoi leje për t'u larguar duke thënë se s'ndihej mirë. Pasi përplasi në zyrë një sërë orëndish dhe flaku përdhe disa libra, ai e hodhi çantën e madhe në shpinë si hejbe, pastaj doli duke vazhduar të njëjtin referen: kobër, Jago.

Tronditja e fortë e shkaktuar prej tradhtisë së Ajet Shkëmbit nuk mundi t'i kalonte Miltiadher Nërenxës një javë rresht. Tri ditë ndenji shtrirë në shtëpi me raport mjekësor. Vetëm Sofia e kuptonte dhe arrinte ta ngushëllonte. Ajet Shkëmbit i trembesha gjithmonë, i thoshte ajo herë pas here. Nuk ishte i sinqertë. Qeshte kot më kot si kalë. Edhe të shoqen e ka shumë intrigante. Më mirë që u prishe me të. S'e meritonte ajo fytyrë shoqërimin me ty. Këtë ma kishin thënë edhe fqinjët.

Ngaqë takimet e zakonshme në lulishten në qendër të qytetit tashmë ishin të pamundura, Miltiadher Nërenxa u çoi fjalë Alajdin Arbanës e Kristo Shigjetës që t'i vinin për vizitë në shtëpi medoemos. Por mori dy përgjigje tepër të dyshimta. Inxhinieri i hekurudhave i shkroi në një pusullë se ishte tepër i zënë me shfletimin e një materiali dhe s'mund të dilte dot nga

shtëpi, ndërsa piktori e njoftoi se për disa arsyesh jashtëzakonisht private nuk mund të vinte. Qëndrimi i Alajdinit po e çudiste Miltiadhin. Ashtu si ata beduinët e sprovuar të shkretëtirës që e nuhasin në kohë afrimin e stuhisë me shtëllunga të verdha rëre, edhe ai e kuptoi se një çarje e forte akullnajore do të afrohej së shpejti.

Një paqësime Sofja u kthye në shtëpi tëpër e prekur, dhe i tregoi të shoqit se kishte ndeshur në prugë piktorin me bashkëshorten, por ata në mënyrë fye se ishin shtirë sikur nuk e kishin parë kurrë. S'kaluan dy ditë dhe rastësisht, nga dritarja e zyrës Miltiadhi Nerënxa e pa piktorin tek takohej përzemërsisht me Ajet Shkëmbin. Qe me të vërtetë një skenë neveritëse. Tashmë e vërteta dallohej, tepër larg si horizonti pas shiut; Alajdin Arbana ishte bërë aleat me njëriun më të urryer, të tij. Mikun e armikut të tij e kishte rrjedhimish armik.

Kulmi i pafytyrësise së Alajdinit arriti një të diel paradite ndërsa ai kalonte, me duar, në xhepa para pallatit të shkrimitarit në kohën që Miltiadhi Nerënxa ndodhej në ballkon duke shfletuar «Dritën». Tek kthente faqen e gazetës, ai e vuri re piktorin dhe nuk mundi të përmbarhej.

— Alajdin, o zoti Alajdin! — i thirri,

Piktori ngriti kokën i çuditur.

— Me mua e keni?

— Po, po. Me ty. Nuk po më njihke sot, ë? Sa e more vesh që do të largohem nga teatri, po më largohesh sikur kam murtajën. Pse kështu, zoti Alajdin?

— Nuk më pëlqen të kemi relata me njerëz të cilësuar mediokër e të paastë, hirësia juaj, — tha piktori duke nënqeshur. — Vëçanërisht me të qarkulluar.

Shkrimtari shtrëngoinofullat.

— Ashtu, ë! Ah, Tékist i qelbur! Më largohesh tanisëske më dekorë. S'fiton dot. Ku je, Van Gog, ku je! Piktori qenesh dherdashnorësh melankolikë. Shitës pseudoveprash!

Alajdin Arbanë hapi këmbët e vuri duart në bel. Shiko, kush na flet! Je një penë e ndryshkur Miltiadhi. Don Kishot i botës së letrave! Veprat e tua të shpin migrënë.

— Kurse ti je një bojaxhi nga ata të ndërmarrjes komunale që lyejnë banësat. Veprat e tua të sjellin zorrët të fytin. Pale kajo tabloja e famshme kompozicionale!

— A kë më idiotizëm se tragjedia jote më gjashtë akte? Po ato vjershët! Pika që s'të bie! Edhe fëmijët e tetëvjeçares i bëjnë më të bukura.

Dy ish-shokët filluan të ngrinin zërin e t'i shtonin të sharat, gjë që tërhoqi vëmendjen e kalimtarëve dhe të banorëve të pallatit që filluan të dilnin nëpër ballkone e dritare. Shkrimtari umbështet me bark në parvaz dhe e kërcënoi kundërshtarin me grusht duke iu referuar përsëri familjes së madhe të gjarpërinjve.

— Paske qenë nepërkë, Alajdin! Gjarpër me ngjyra!

Piktori i bëri duart hinkë para gojës që t'i shërbenin si altoparlant.

— Futu bërenda, mor psikopat! Ti shkruan natën dhe fle ditën.

— Ik, mor lustraxhi! Peizazhet e tua unë s'i vë as në depon e druve.

— Kurse unë vëllimin tënd «Fllade e stuhi» e kam varur në atë gozhdën...

— I poshtër! Ty s'të lidh kurrgjë me artin.

— Mos kujton së të lidh ty?! Shko andej nga kodrat dhe ndërtó ndonjë kasolle tjetër me bar se aq mend ke ti. Dësh më përvëlove të gjallë në Fushëndritë me ato budallallëqet e tua.

— Ah, nepërkë! Nuk ke faj ti! Mashtrues! Komplimentaxhi!

— Ika, i dashur Don Kishot, se ti ke shumë fjalë si nëpër veprat e tua.

Alajdin Arbana u detyrua vërtet të largohej me vrap, sepse Miltiadhi rrëmbeu një stol përt qëlluar, veprim që i bëri banorët e pallatit dhe kalimtarët e mbledhur në rrugë të klithnin të trëmbur. Pas shumë të luturash dhe të têrhequrash për robëdëshambri Sofia arriti ta fuste të shoqin brenda. Ai u mbështet pas saj i plagosur shpirtërisht dhe pshëreti i lodhur.

— Edhe ky më doli Jago, Sofi, tradhtar. Sa gjenjeshtare qenka jeta! Ah, Bajron, mirë e kishe. Vetëm gota e verës të mbetet besnikë në këtë botë.

— Mos u mërzit, i dashur, — e qetësoi ajo.

— Më mirë që u ndave me të. Alajdini ishte te-për hileqar. Vetëm të gjenjente dinte. Gjithmonë

donte të përfitonte nga lavdia jote. Atë të shoqen e ka dhëpër.

— Ke të drejtë, Sofi. Ai ishte njeri i hileve. Tani më shoqërohet buzagaz me Ajet Shkëmbin, por prit kur të prishet edhe me të.

— Po Kristoja me kë është në këtë mes?

— Me askurrkënd... Trembem se ai do të na braktisë të gjithë njëlloj. Është tepër batakgj dhe gënjeshtar. Dava gjuetari! S'e ka problem të zëre shokë të tjerë.

— Edhe të shoqen ia shoh me lloj-lloj grash. Parashikimet e Miltiadhs Nerënxs nuk vonuan të realizoheshin me një saktësi të habitshme. Pa u mbushur java çifti Arbana dhe çifti Shkëmbi u grindën keqazi mu në mes të mapos së madhe të qytetit duke u afruar blerësve e shitësve një spektakël të rrallë. Shkak ishin bërë fjalët e piktorit thënë një fqinji të aktorit, sipas të cilave Ajet Shkëmbi ishte një gomar, por atij i kishte zënë rrota bishtin dhe nuk i shmangej dot shoqërimit me të. Këto fjalë kishin mbërritur deri në veshët e aktorit dhe pati nga ata që thanë se, sikur zënka të mos kishte ndodhur në mapo, por në ndonjë vend tjeter, piktori do të kishte dalë me brinjë të thyera.

Dy ditë pas kësaj ngjarjeje Kristo Shigjeta u dërgoi tre ish-shokëve të tij nga një pusullë diplomatike ku u shkruante:

Mendoni sikur s'jemi njohur kurrë bashkë. S'dua të më shqetësoni më. Mos u lodhni të më kërkoni sqarime, sepse nuk do t'i grabis më asnjë minutë kohë shkencës për t'u marrë me ju.

Prishja e shoqërisë së katër artistëve bëri bujë të madhe në qytet. Të gjithë u çuditën se si mund të ndaheshin aq papritur shokët e ngush-të, të cilët kishin qarë së bashku tërë ato halle dhe një kafe nuk u shkonte dot poshtë pa njëri-tjetrin. Në atë ndarje katastrofike një pjesë e madhe e bashkëqytetarëve i dhanë të drejtë shkrimitarit, para potencës artistike dhe famës së të cilit tre të tjerët ishin insekte të vërteta. Një pjesë tjetër quajtën viktimë e të pafajshëm in-xhinierin, i cili, siç kishte dekluarat vetë, kishte mbetur tepër i zhgënjiyer nga shoqëria. Ai kishte pandehur se mbante lidhje me artistë të vërtetë, ndërsa shokët i kishin dalë ca mediokër grindavecë. I pushtuar nga hidhërimi Kristo Shigjeta ishte tërhequr plotësisht në vetmi duke iu përkushtuar edhe më shumë racionalizimit në lokomotivat me avull, punë e cila vazhdonte ende me vjeljen e literaturës së huaj. Pati nga ata që përkrahën Ajet Shkëmbin, duke e quajtur më të thjeshtin e të singertin e katër shokëve, të cilin tre të tjerët me lavdinë e tyre, ishin përpjekur ta eklipsonin tërësisht. Edhe mbrojtësit e Alajdin Arbanës nuk qenë të paktë. Ata e përcaktuan atë si viktimë personale të Miltiadher Nerënxsës, i cili gjithmonë ishte përpjekur të dilte koka më e madhe e shoqërisë, ndër të cilin e meritonte piktori. Pati bashkëqytetarë të veçantë, të cilët, duke iu drejtar shprehjes së famshme «Kërkohet sherrin te gruaja», thanë se shkaku i prishjes kishin qenë bashkëshortet e artistëve, veçanërisht ajo e shkrimitarit dhe e piktorit, të cilat kishin pasur mes tyre një luftë të gjatë e të hesh-tur për emrin e primadonës së grupit. Sipas një

varianti tjetër përçarja kishte ardhur për faj të Miltiadher Nerënxsës, i cili ndodhej në prag të një sëmundjeje të rrezikshme profesionale dhe prirëj drejt vëtmisë. Dhe kështu hamendjet e variantet e mundshme për atë katastrofë titanike ndiqnin njëra-tjetrën...

Me qëndrim e përmes korrashit të institucioneve i mbrojtur, pa përshtendetur kurikend me një përfio njeri i cili gjithnjë përcaktoj përcaktoj si një Dantë i vërtetë. Tësia që e parë ato që nuk rrugë e mundë gjatë mësuarës duke i bëkatë, jaqet që kishin filluar të vinte **HIXXX** taqer vjetet, se si përfundoi në prag të një sëmundjeje të rrezikshme profesionale.

Me qëndrim i përmes korrashit të institucioneve i mbrojtur, pa përshtendetur kurikend me një përfio njeri i cili gjithnjë përcaktoj përcaktoj si një Dantë i vërtetë. Tësia që e parë ato që nuk rrugë e mundë gjatë mësuarës duke i bëkatë, jaqet që kishin filluar të vinte **HIXXX** taqer vjetet, se si përfundoi në prag të një sëmundjeje të rrezikshme profesionale.

Me qëndrim i përmes korrashit të institucioneve i mbrojtur, pa përshtendetur kurikend me një përfio njeri i cili gjithnjë përcaktoj përcaktoj si një Dantë i vërtetë. Tësia që e parë ato që nuk rrugë e mundë gjatë mësuarës duke i bëkatë, jaqet që kishin filluar të vinte **HIXXX** taqer vjetet, se si përfundoi në prag të një sëmundjeje të rrezikshme profesionale.

XXXIII

Njoftimin zyrtar për t'i ndërprerë marrëdhëniet e punës me teatrin dhe për të kaluar në degën e shpërndarjes së librit Miltiadher Nerënxa e mori më 10 nëntor. I përhumbur plotësisht në mendime, me supe të varura e kokulur, ai hyri në zyrë, qëndroi ca në këmbë në mes të saj, pastaj u kthye nga autoportreti i Rembrandtit, vendosur mbi raftin e dosjeve me vepra dramatike. E keqja u bë, mjeshtër, i foli. Ajo së cilës i trembesha prej kohësh ndodhi: Mjerim artistik, mjeshtër, mjerim.

Pas pak Miltiadher Nerënxa hapi çantën e mardhe dhe filloi të fuste në të gjithçka të tijën. Duart i dridheshin. Pas gjashtë vjetësh jetë artistike tanë i duhej të largohej me lavdi teatrale të njollosur. Por do të vijë koha e suksesit të tragjedisë «Liria do të kthehet përsëri», murmuriti ai duke përkëdhelur miqësish tavolinën e punës, do të vijë patjetër. Unë s'po ia mbath

si një i dështuar. Më larguan nga teatri, por nga drama s'më largojnë dot.

Kur hapi dërën për të dalë, shkrimtari nuk mundi t'i përbante lotët. Ai hodhi çantën e madhe supit dhe kaloi përmes korridorit të institucionit i heshtur, pa përshëndetur kurrkënd me një pamje nënveftësimi ndaj gjithçkaje përrreth, si një Dante i persekuuar. Ata që e panë atë ditë në rrugë, e ndoqën gjatë me sy duke i besuar fjalët që kishin filluar të përhapeshin nëpër qytet, se ai ndodhej në prag të një sëmundjeje të rezikshme profesionale.

Sofia s'mundi ta përbante një klithmë njgjethëse kur i shoqi hyri në shtëpi. Ai e përaqfoi për ta qetësuar.

— Milto, c'ka ndodhur? — pëshpëriti ajo.

— Kurrgjë, e dashur. U largova përfundimisht nga teatri dhe do të filloj punë në degën e shpërndarjes së librit.

— Oh, më mirë, i dashur. Kudo që të jesh ti do të shkëlqesh.

Ndërkohë Ernesti, shtrirë në dhomën e tij me duart nën kokë dhe pamjen e zakonshme të përgjumjes në fytyrë, dëgjonte në magnetofon pjesë simfonike. Ai kishte ngelur në riprovimin e vjeshtës dhe për një vit ishte shkëputur nga fakulteti. Sharjet e tij ndaj gjuhëtarëve ishin shpeshuar, fjalët i ishin rralluar edhe më shumë, donte vetëm gjumë dhe vetmi. Por, kur i biri kishte filluar të dëgjonte në magnetofon pjesë simfonike, Sofisë i ishte shtuar frika se ai do të pësonte ndonjë krizë nga hidhërimi.

— Ernest, fike atë magnetofon! — i foli ajo e mërzitur.

Djali u ngrit dhe doli në korridor duke fërkuar sytë.

— Hë, ç'kemi, mama? Ç'paska babai kështu?

— Mos na fol se jemi bërë zehër.

— Baba, u largove nga teatri?

— Po.

— Sa mirë! Tani s'të detyron kurrkush të shkruash drama e tragjedi.

Miltiadher Nerënxa shqeu sytë.

— Ernest, ç'janë këto fjalë?! — pëshpëriti Sofia.

— Pse habitesh, mama? Babai tani shpëtoi. Ajo s'ishte punë për të.

— Ç'do të thuash me këtë? — pyeti Miltiadher Nerënxa i vrenjtur jashtë mase.

Ernesti buzëqeshi.

— Dua të them se tani mund të heqësh dorë nga krijimtaria letrare, baba.

I ati brofi në këmbë.

— Si guxon?! Ti s'je në vete.

— Unë jam shumë në vete, baba. Më vjen shumë keq që ta them, por ti duhet të heqësh dorë nga letërsia.

— E pse?

— Sepse shkrimtar nuk mund të bëhesh dot me zor.

— Oh, Ernest, — rënkoj Sofia — si i flet baba kështu?!

— Domethënë ti... ti qenke autor i asaj letrës anonime?! — murmuriti Miltiadher Nerënxa i shtangur. — Ti më shkruaje se më mungon talenti? Se po bëhem qesharak në gjithë qytetin?

Ernesti tundi kokën qëtësisht.

— Po, baba. Unë jam autor i letrës. Ti duhet ta kuptosh një herë e mirë të vërtetën.

— Oh! Oh, Sofi!

Pas këtyre thirrjeve trupi i gjatë i shkrimtarit u lëkund dhe, me dorën në zemër, ai mundi të afrohej deri te një kolltuk ku u këput krejt i pafuqishëm.

— Ernest, ç'i bëre babait! — u ngashërye Sofia. — Si guxon të sillesh kështu? Ernest, vrapi! Një mjek! Shpejt, një mjek!

Për herë të parë që pas ngeljes në provim Ernesti erdhi plotësisht në vete dhe vrapi shkallëve me një shkathësi që i çuditi fqinjët. E solli mjekun brenda çerek ore, pastaj u mbyll në dhomën e tij që të mos e shihte kurrikush.

Miltiadher Nerenxa e mblođhi shpejt veten. Ai kërkoi vetëm një kafe, pastaj u shtri për të fjetur duke iu lutar së shoqes që t'i qëndronte pranë. Ajo u ul mbi një stol dhe me dorë të dridhur filloi t'i përkëdhelte flokët duke murmuritur e ngashëryer:

— Oh, Milti, i dashur! Sa herë të pati thënë që t'i ruheshe asaj sëmundjes speciale! Sa herë të isha lutar që të mos lodheshe shumë! Ja tani, ç'na gjeti. Oh, i dashur, s'mendoje pak për veten, por vetëm për artin.

— Do të më kalojë shpejt, e dashur, mos u trondit, — e qetësoi ai. — Qe dicka momentale. Nuk e prisja që edhe Ernesti të më dilte Jago si ata të tjerët. Do të më kalojë, të jesh e sigurt. Do t'i përvishem përsëri punës. Tani që m'u vu në dyshim reputacioni letrar më duhet patjetër të mbaroj romanin që nisa në fshat. Dua t'ua thyej turinjtë të gjithëve, Më kupton? Ky ro-

man do të jetë bombë, Sofi. Bombë e vërtetë.

— Milto, të lutem, sikur të shkruaje vetëm vjersha. Romani është shumë i lodhshëm dhe...

— Jo, e dashur, ti e di që unë s'i bëj lëshime vetes.

Dhe vërtet, që të nesërmen, me një këmbëngulje të rrallë balzakiane, me një vetëmohim prej shkrimtari vigan, Miltiadher Nerënxa vazhdoi të mbyllej në studion e tij në orarin e zaxonshëm 22 me 2, duke punuar mbi romanin me temë nga fshati.

Qe një natë e ftohtë fundnëntori kur Sofia, si gjithmonë, me robëreshambrin supeve, u arrua te dera e studios për t'i shprehur të shoqit merakun e vet, por nuk mori përgjigje. E trembur, e hapi derën me vrull dhe e pa romancierin e saj rënë përmbyss mbi tavolinë. Penën e shtrëngonte fort në dorën e djathtë. Sëmundja speciale murmuriti ajo, pastaj klithi aq fort, saqë edhe Ernesti, që s'tundej sikur t'i futje në dhomë ndonjë lokomotivë, brofi nga krevati i lebetitur.

— Ernest, ambulancën! — thirri eëma. — Të gjorët ne... babai... u fikëm... oh, Milto, Milto!...

Pothuaj të gjithë banorët e rritur të pallatit dolën dhe e përcollën shkrimtarin kur u nis për në spital. Nga mëngjesi, në gjithë lagjen u hap fjala se Miltiadher Nerënxa kishte kaluar një goditje parainfarkti. Gjendja e tij po vinte duke u përmirësuar, por, sipas thënieve të Sofisë, ca pasoja të rrezikshme do të mbeteshin për një kohë të gjatë.

Në historinë e madhe të krijimtarisë artistike botërore vështirë se mund të gjendet ndonjë rast i ndonjë artisti, kur gruaja të ketë vendosur

për hir të dashurisë së pakufishme ta shkëpusë të shoqin përgjithmonë nga veprat e tij. Në një nga ditët e shtrimit të Miltiadherënës në spital këtë e bëri Sofia. Me lotët që i rriddhni faqeve ajo i doli para përgjegjësit të repartit të kardiologjisë duke iu lutur:

— Doktor, ju jeni vetë bashkshort dhe duhet të më kuptioni. Im shoq vuan nga një sëmundje e rëndë. Ai nuk duhet të shkruajë më.

Mjeku nënqeshi.

— Po mirë, le të mos shkruajë.

— Nuk është kaq e lehtë, doktor, Ju nuk e njihni tim shoq. Vetëm vdekja, larg qoftë, mund ta shkëpusë atë nga veprat e veta. Ju lutem bindeni ju që të mos shkruajë më. I thoni se është shumë i sëmurë, i thoni të vërtetën. Kjo është një sëmundje speciale shkrimtarësh, doktor. Ju lutem bëjeni këtë në emër të së ardhmes së familjes sime.

Kur pa se lotët e asaj bashkëshorteje ideale u shtuan, mjeku hapi krahët si i zënë në faj.

— Dakord, do të përpinqem ta bind. Fundja do t'i jap ultimatum. Qetësohuni tani.

Bisedën që u zhvillua mes përgjegjësit të repartit të kardiologjisë dhe shkrimtar Miltiadherënës e dëgjoi vetëm një infermiere. Sipas rrëfimit të saj dialogu që pak a shumë ky:

«Mjeku: Shoku Miltiadher, ju jeni shkrimtar i njobur dhe unë ju respektoj për talentin. Më vjen shumë keq, por më duhet t'ju komunikoj diçka të hidhur. Për arsyen shëndetësore duhet të hiqni dorë nga krijimtaria. Zemra juaj nuk e përballon dot më këtë punë.

Shkrimtari: Është e pamundur, doktor!

Mjeku: Ju siguroj se është tepër e vërtetë.

Shkrimtari: Nga krijimtaria nuk mund të tërhijem, doktor. Është e kотë.

Mjeku: Ashtu? Atëherë me hidhërim po ju them se ju pret infarkti sikur të shkruani qoftë edhe një poezi. Më kuptuat? Pas infarktit besoj e dini se ç'vjen.

Shkrimtari: Doktor, ju lutem, nuk mund të ketë ndonjë zgjidhje?

Mjeku: Asnjë lloj zgjidhjeje. Ju duhet të hiqni dorë nga krijimtaria. Zemra nuk ju përballon asnjë lloj emocioni artistik. Ky është me të vërtetë një krim i natyrës, por s'kemi ç'bëjmë. Ajo është e mbifujshme.

Shkrimtari: Për sa kohë duhet të heq dorë, doktor?

Mjeku: Të paktën për dhjetë vjet.

Shkrimtari: Oh, natyrë mizore! Oh, veprat e mia!...»

Sipas infermieres këtu dialogu u ndërpre, se pse shkrimtarin e mbytën lotët nga hidhërimi.

NË VEND TË EPILOGUT

Pasditeve e mbrëmjeve të dhjetorit, pas daljes nga spitali dhe regjimit të shtratit të mbajtur në shtëpi, bashkëqytetarët e panë Miltiadherënxën të dilte shëtitje me të shoqen me një pamje tepër tronditëse; të kërrusur nën pallton e trashë dopiope, mbledhur me shall, me një republikë gri në kokë, të zbehtë në ftyrë e me një vështrim të përhumbur, sikur kërkonte diçka tutje në horizont. Shumëkush e besoi plotësisht se ai ishte mbërthyer keqazi nga një sëmundje e rrallë artistësh që mund ta lëshonte vetëm pas shumë kohësh. Kujdesi me të cilin Sofia e mbante për krahu ishte vërtet për t'u admiruar. Sytë e saj ishin të pikëlluar, ftyra e zymtë, shenja që tregonin se shkrimitari ishte në gjendje të rëndë. Në bulevardin kryesor dhe në shëtitoren pranë bregut të detit Miltiadherënxën e prisnin dhe e përcillnin me vështrime kurreshtare. Shumë u fol e u diskutua për ish-libretistin e teatrit pas tërheqjes letrare. Pati nga ata

që thanë se ai kishte lënë përgjysmë disa kryevepra, të cilat i kishte fshehur harpagonçe që të mos ia vidhnin subjektet. Disa të tjerë hapën fjalë se Miltiadherë Nerënxa kishte qenë plotësisht një gjeni, kjo ishte provuar nga një radiografi që i ishte bërë trurit të tij dhe nga disa matje speciale, prej të cilave doli se ai i peshonte 2,007 kg, ndërkokë që truri i Ivan Turgenievit, një nga më të rëndët në botë, kishte qenë 2,012 kg. Një palë e tretë përhapi mendimin se shkrimtari kishte rënë viktimë e kohës, e nivelit të ulët të shikuesve, lexuesve, kritikëve dhe redaktorëve anadollakë, të cilët s'e kishin kuptuar dot. Nga ky stonim me kohën i kishte ardhur edhe sëmundja. Në përgjithësi, në qytet u hidhëruan së tepërti pas lajmit se koka balzakiane e Miltiadherë Nerënxsë nuk do të krijonte më. Bile një pjesë thanë me keqardhje: Gjene mirë, shqyr që s'shkoi deri në çmendinë apo vetëvrasje.

Për inerci të stereotipit të vjetër, nuk ishin të pakta netët kur shkrimtari ngrihej orët e vona duke u munduar të mos e zgjonte të shqen, që kishte filluar kohët e fundit të gërhiste thellë, hidhte supeve robëdëshambrin e kadifenjtë dhe hynte i menduar në studion e tij. Çapitej ca nëpër të duke vështruar gjithçka me një mall mbytës, pastaj fillonte e përkëdhelte dosjet e mbushura me dorëshkrime, veçanërisht tragjedinë «Liria do të kthehet përsëri» dhe romanin e pambuar me temë nga fshati. Prisni, perlat e mia, prisni, fliste me vete. Prisni, bombat e mia. Do të vijë edhe koha e shpërthimit tuaj, e shkëlqimit verbues. Një dekadë nuk është një shekull. Ajo do të kalojë shpejt. Unë do ta rrëmbej penën

përsëri dhe atëherë... Ah! Fat mizor! Pse më dë-nove kështu?...

Ndërkojë tre ish-shokët e shkrimtarit vazhdonin jetën dhe veprimtarinë e tyre artistike e shkencore plot gjallëri. Aktor Ajet Shkëmbi kishte filluar punë si përgjegjës i vatrës së kulturës në një fshat pranë detit, kishte blerë motorikletë, kishte hequr mustaqet, u ishte futur thellë studimeve për mjeshtërinë e regjisurës dhe ishte bërë shok i ngushtë me një agronom që po përgatitej të mbronte një disertacion për mundësitë e kultivimit të preshit në tokat kodrinore.

Piktori Alajdin Arbana kishte dalë rrëth krushqie me drejtorin e ri të teatrit dhe i ishte qepur atij si mizë kali për t'i zhvatur ndonjë porosi dekoresh. Peizazhet me liqene të ndritura nga hëna dhe me dashnorë sentimentalë i vazhdonte në seri, ndërsa flitej pa pushim se po merrej me një tablo të famshme kompozicionale. Në qytet e shikonin pothuaj përditë me skulptorin e talentuar, Spartak Gjelin, i cili prej kohësh ishte detyruar të braktiste profesionin për shkak të një reumatismi në shpatullën dhe krahun e djathët.

Kurse inxhinieri i hekurudhave, Kristo Shigjeta, vazhdonte pa ndërprerë vjeljen e materialeve në italisht e frëngjisht për lokomotivat me avull dhe gjuetinë. Nëpër kafene, në bibliotekë dhe në breg të detit, me fijet e peshkimit në dorë, atë e gjeje bashkë me një teknolog të një fabrike salcërash, për të cilin flitej se e kishte pasur vjehrrin prift, zotëronte latinishten dhe po merrej me përkthimin e «Eneidës» së Virgjilit...



Canosinaj, Viktor

Katër «Yje» në qytet: Roman satirik

/Viktor Canosinaj; Red.: N.

Dulaku. — T.: Naim Frashëri

1989. — 308 f.; 18 cm

891.983—31

+ 891. 983 —7

C 19

Tirazhi 8000 kopje Formati 49x78/16 Stazh 2204—82

KOMBINATI POLIGAFIK — Shtypshkronja e Re —

— Tirana 1989

VIKTOR CANOSINAJ

Ka lindur në vitin 1960 në Durrës. Ka mbaruar studimet e larta në ILP Shkodër, dega gjuhë-letërsi.

Punon si mësues në Shupenzi të rrëthit të Dibrës.

Ka botuar për pionierë nove-lën «Koha na rriti» (1981) dhe romanin «Përmbi dallgë e zjarre» (1984).

«KATËR «YJE» në QYTET» është romani i tij i parë për të vritur.

